Përfshin	Kjo klasë përfshin: - nxjerrjen e fosfateve natyrore dhe kripërave natyrore të kaliumit; - nxjerrjen e squfurit natyror; - nxjerrjen dhe përgatitjen e piritit dhe pirotinave, përveç pjekjes; - nxjerrjen e sulfatit të bariomit natyror dhe karbonateve (baritet dhe uidheritet), boratet natyrore, sulfatet e magnezit natyror; - nxjerrjen e mineraleve me ngjyrë, fluoritit dhe mineraleve të tjera, të vlerësuara kryesisht si burime kimikatesh

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - nxjerrjen e plehut organik - nxjerrjen e baltës mjekësore - proceset e nxjerrjes për prodhim litiumi nga ujërat e kripura
---------------------	---

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - nxjerrjen e kripës, shih 08.93 - pjekjen e piriteve të hekurit, shih 20.13 - prodhimin e plehrave sintetike dhe përzierjeve të azotit, shih 20.15
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	08.92
Përshkrim	Nxjerrja e torfave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - nxjerrjen e torfave; - përgatitjen e torfave për të përmirësuar cilësinë ose lehtësuar transportin/magazinimin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet ndihmëse të veçanta për nxjerrjen e torfave, shih 09.90 - prodhimin e briketeve të torfave, shih 19.20 - prodhimin e përzierjes me dhe si p.sh. të torfave, dheut, dheut natyror, rërës, argjilës, të produkteve plehëruese me përmbajtje minerale, shih 20.15. -përpunimin e atrikujve të torfave, shih 23.99
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	08.93
Përshkrim	Nxjerrja e kripës
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - nxjerrjen e kripës nga nëntoka, përfshirë përmes tretjes dhe pompimit - prodhimin e kripës përmes avullimit të ujërave detarë ose ujërave të tjera të kripura - thërrmimin, pastrimin dhe rafinimin e kripës nga prodhuesi
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - përpunimin e kripës në kripë ushqimore, p.sh. kripë e jodizuar, shih 10.84 - prodhimin e ujit të pijshëm përmes avullimit të ujit të kripur, shih 36.00
NVE Rev 2.1 kod	08.99
Përshkrim	Aktivitetet të tjera minerare dhe nxjerrëse
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - nxjerrjen minerare dhe nxjerrjen nga guroret të mineraleve dhe materialeve të ndryshme: • materialet gërryerëse, asbest, materiale fosile silicore, grafit natyror, steatit (talk), feldspat, etj. • asfalt natyror, asfaltit dhe gur asfalti; bitum të ngurtë natyror • gurë të çmuar, kuarc, mikë, etj.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	09
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse minerare
Përfshin	Kjo ndarje përfshin shërbime mbështetëse të specializuara lidhur me veprimtaritë minerare, të ofruara mbi bazën e tarifave ose kontratave. Ndarja përfshin shërbimet e kërkimit përmes metodave tradicionale të kërkimit, p.sh. marrjen e kampionëve bazë dhe vëzhgimet gjeologjike, si dhe shpimin, shpimin si test ose rishpimin për puse naftë, minerale metalike dhe jo metalike. Llojet të tjera shërbimesh mbulojnë ndërtimin e themeleve të puseve të naftës dhe gazit, betonimin e veshjes së brendshme të pusit të naftës ose gazit, nxjerrjen e lëndës me kovë ose piston nga pusët e naftës ose gazit, kullimin dhe pompimin e minierave, etj.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	09.1
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	09.10
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e shërbimit për nxjerrjen e naftës dhe gazit për llogari të të tretëve: • shërbimet e shfrytëzimit në lidhje me nxjerrjen e naftës dhe gazit, dmth metodat tradicionale të kërkimit si p.sh. vëzhgimet gjeologjike në zona me perspektivë • shpimet dhe rishpimet me drejtim; 'shpimet fillestare'; ngritje e strukturave derrick në vend, riparim dhe çmontim; betonim të veshjeve të brendshme të puseve të naftës dhe gazit; pompim të puseve; taposje dhe braktisje të puseve, etj. • lëngëzimin dhe rigazifikimin e gazit natyror për qëllime transportimi në objektin e minierës • shërbimet e pompimit, për llogari të të tretëve • shpime testimi në lidhje me nxjerrjen e naftës ose gazit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimet zjarrfikëse në fushat gazmbajtëse dhe naftëmbajtëse dhe shërbimet e parandalimit të zjarreve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimit të kryera nga operatorët e fushave naftëmbajtëse ose gazmbajtëse, shih 06.10, 06.20 - riparimin dhe mirëmbajtjen e specializuar të makinerive dhe pajisjeve të shpimit dhe nxjerrjes, shih 33.12 - instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e specializuar në det të pajisjeve që janë pjesë përbërëse e platformave pluskuese, shih ndarjen 43 - lëngëzimi dhe rigazifikimi i gazit natyror për qëllime transporti tokësor ose ujor, që nuk bëhet në vendin e minierës, shih 52.21 ose 52.22 - vrojtimit gjeofizike, gjeologjike dhe sizmike, shih 71.12
NVE Rev 2.1 kod	09.9
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse për aktivitetet e tjera minerare dhe nxjerrëse
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	09.90
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse për aktivitetet e tjera minerare dhe nxjerrëse
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shërbimet mbështetëse për llogari të të tretëve, të nevojshme për aktivitetet e minierave të ndarjeve 05, 07 dhe 08: • shërbimet e shfrytëzimit me anë të metodave tradicionale të kërkimit, si marrjen e kampionëve bazë dhe vëzhgimet gjeologjike në zona me perspektivë • shërbimet e shpimit dhe pompimit, për llogari të të tretëve • shpime testi dhe hapje gropash për test - sigurimin e puseve dhe tuneleve të minierave - shembjen dhe çmontimin e objekteve minerare nëntokësore
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin : - shfrytëzimin e minierave apo guroreve për llogari të të tretëve, shih ndarjen 05, 07 dhe 08 - riparimet dhe mirëmbajtjet e specializuara të makinerive të minierave, shih 33.12 - shërbimet e vrojttimeve gjeofizike, për llogari të të tretëve, shih 71.12

NVE Rev 2.1 kod	C
Përshkrim	INDUSTRIA PËRPUNUESE
Përfshin	Ky seksion përfshin transformimet fizike, mekanike, kimike dhe biologjike të materialeve, substancave apo komponentëve në një produkt të ri, megjithatë kjo nuk mund të përdoret si një kriter i thjeshtë, i përgjithshëm për përcaktimin e përpunimit. Materialet, lëndët apo komponentët që i nënshtrohen transformimit janë lëndë të para materiale ose produkte bujqësore, të pyjeve, peshkimit, nxjerrjes po aq sa edhe nga produktet e aktiviteteve të tjera të përpunimit. Ndryshimet e rëndësishme, rinovimi apo rikonstruksioni i mallrave konsiderohet përgjithësisht si përpunim. Në procesin e përpunimit, rezultati mund të jetë i përfunduar, që do të thotë se produkti është gati për përdorim ose konsum, ose mund të jetë gjysmë i përfunduar, duke nënkuptuar se do të hyjë përsëri në proces për një përpunim të mëtejshëm. Për shembull, prodhimi i aluminit nga rafineria është materiali bazë që përdoret në prodhimin primar të aluminit; alumini është materiali bazë që përdoret në prodhimin e telave të aluminit dhe teli i aluminit është materiali bazë për prodhimin e produkteve të fabrikua me tel. Prodhimi i komponentëve dhe pjesëve të specializuara, si dhe aksesorëve dhe shtojcave për makineri dhe pajisje, si rregull i përgjithshëm, klasifikohet në të njëjtën kategori si prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve për të cilat janë destinuar pjesët dhe aksesorët. Ndërsa prodhimi i komponentëve dhe pjesëve të pa specializuara të makinerisë dhe pajisjeve (për shembull, motorët, pistonat, motorët elektrikë, montimet elektrike, valvulat, marshet, kushinetat rrotulluese) klasifikohet në kategorinë përkatëse të prodhimit, pa marrë parasysh makinerinë dhe pajisjet në të cilat mund të përdoren këto artikuj. Prodhimi i pjesëve dhe aksesorëve të specializuar nga materialet plastike përmes derdhjes në një formë ose kallëp ose nxjerrjes përmes një die, e cila është një vegël me një hapje që ka formën e dëshiruar, zakonisht klasifikohet në grupin 22.2

Montimi i pjesëve përbërëse të produkteve të përpunuara është konsideruar përpunim. Ky proces përfshin montimin e produkteve, qoftë nga komponentët e prodhuar vetë apo nga komponentët e blerë.

Riciklimi i mbetjeve, d.m.th. përpunimi i mbetjeve për t'i kthyer ato në lëndë të para të dyta* është klasifikuar në grupin 38.2. Megjithëse ky proces mund të përfshijë ndryshime fizike, mekanike, biologjike ose kimike nuk konsiderohet pjesë e aktiviteteve prodhuese. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve është trajtimi ose përpunimi i mbetjeve dhe prandaj ato klasifikohen në seksionin E. Megjithatë, prodhimi i produkteve të reja nga lëndët e para të dyta klasifikohet si prodhim, edhe nëse në këto procese përdoren mbetjet si material hyrës (p.sh., prodhimi i argjendit nga mbetjet e filmave konsiderohet proces prodhimi).

Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinerive dhe e pajisjeve industriale, tregtare dhe të ngjashme, në përgjithësi klasifikohet në ndarjen 33. Megjithatë, riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personale dhe shtëpiake klasifikohen në ndarjen 95.

Instalimi i makinerive dhe pajisjeve, kur kryhet si aktivitet i specializuar, klasifikohet në klasën 33.20.

Mirëmbajtja, riparimi dhe instalimi i pajisjeve që janë pjesë përbërëse të ndërtesave ose strukturave të ngjashme, p.sh. mirëmbajtja, riparimi dhe instalimi i shkallëve lëvizëse ose i sistemeve të ajrit të kondicionuar, klasifikohet si ndërtim në seksionin F, nëse kryhet në kantier.

Ky seksion përmban gjithashtu aktivitetet e prodhuesve të produkteve pa fabrikë (FGPs), që delegojnë aktivitetet e transformimit të prodhimit, në industrinë përpunuese (shih udhëzimet hyrëse, paragrafi xx).

Si rregull i përgjithshëm, aktivitetet në seksionin e përpunimit përfshijnë transformimin e materialeve në produkt të ri. Rezultati i tyre është një produkt i ri. Për sqarim, aktivitetet e mëposhtme konsiderohen përpunim në NVE:

- përpunimi i peshkut të freskët (hapja e guackave (gocave të detit), filetimi i peshkut) që nuk kryhen në varka peshkimi, shih 10.20
- pasterizimi dhe ambalazhimi i qumështit, shih 10.51
- regjja e lëkurës, shih 15.11
- stazhionimi i drurit, shih 16.12
- printimi dhe aktivitete të lidhura me to, shih 18.1
- riprodhimi dhe tërheqja e gomave, shih 22.11
- prodhimi i betonit të gatshëm, shih 23.63
- galvanizimi, nikelimi, etj. dhe veshje të tjera metalike ose jometalike të metaleve, shih 25.51
- trajtimi me nxehtësi i metaleve, shih 25.52
- rimbushja e mbajtësve të bojës, shih 26.20
- rimbushja e aparateve të fikjes së zjarrit, shih 28.29
- rindërtimi dhe ripërpunimi i makinerive, p.sh. motorët e automjeteve, shih 29.10
- montimi i ofruar nga një shitës ose përzierja e disa produkteve për t'u shitur. Nëse montimi ofrohet nga një kontraktor, ky aktivitet duhet të klasifikohet si prodhim.

Në të kundërtën ka aktivitete që megjithëse disa herë përfshihen në procese transformimi, klasifikohen në seksione të tjera të klasifikimit (me fjalë të tjera ato nuk klasifikohen në përpunim).

Këtu përfshihen:

- prerja dhe transportimi i trupave drusorë, klasifikohen në seksionin A
- përftimi i produkteve bujqësore, klasifikohen në seksionin A
- përgatitja e vakteve për konsum të shpejtë në vend, klasifikohet tek ndarja 56
- përftimi i metaleve dhe mineraleve të tjera, klasifikohen në seksionin B
- prodhimi i lëndëve djegëse të gazta për furnizim me energji përmes një rrjeti të përhershëm, të klasifikuar në seksionin D
- prodhimi i kompostos nga mbetjet organike, i klasifikuar në seksionin E
- montimi i ofruar si pjesë e një dërgese ose nga një shitës. Megjithatë, nëse montimi është aktiviteti kryesor i ofruar nga një kontraktor, ai klasifikohet në prodhim.
- aktivitetet e shkarkimit të mallrave nga kontenierët dhe rishpërndarjes në pjesë më të vogla, duke përfshirë paketimin, ripaketimin ose mbushjen e produkteve, si p.sh pije ose kimikate; klasifikimin dhe rishitjen e skrapit; përzierjen e bojrave sipas porosisë së klientit; prerjen e metaleve sipas porosisë së klientit; trajtimin që nuk rezulton në një të mirë tjetër, të klasifikuar në seksionin G
- botimi dhe aktivitetet e kombinuara të botimit dhe shtyp.shkrimit klasifikohen në seksionin J

Shënim: * lëndët dytësore janë materiale dhe produkte që mund të përdoren si lëndë të para me ripërdorim të thjeshtë, ose nëpërmjet riciklimit dhe rikuperimit.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

10

Përshkrim

Prodhimi i produkteve ushqimore

Përfshin

Kjo ndarje përfshin përpunimet e produkteve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në ushqime dhe pije për njerëzit apo kafshët, dhe përfshin prodhimin e produkteve ndërmjetëse të ndryshme që nuk janë direkt produkte ushqimore. Aktiviteti shpesh prodhon produkte bashkëshoqëruese me vlerë më të madhe ose më të vogël (p.sh. lëkura nga therja ose materiali i mbetur pas prodhimit të vajit). Kjo ndarje është organizuar sipas aktiviteteve që trajtojnë lloje të ndryshme produktesh: mish, peshk, fruta dhe perime, yndyrna dhe vajra, produkte qumështi, produkte të drithërave nga mulliri, ushqim për kafshët dhe produkte të tjera ushqimore. Prodhimi mund të realizohet për llogari të veta, si dhe për llogari të tretëve, si therja me porosi. Disa aktivitete konsiderohen prodhim (p.sh, produktet e furrës, dyqanet e ëmbëlsirave dhe dyqanet e përgatitjes së mishit etj. të cilat shesin produktet e tyre) edhe pse këtu është tregti me pakicë e produkteve në dyqanin e vetë prodhuesit. Megjithatë, kur përpunimi është minimal dhe nuk mund të lejojë një transformim të vërtetë, njësia klasifikohet në Seksionin G.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu prodhimin e lëngjeve që konsiderohen si ushqim ose që përdorin procese të ngjashme prodhimi, psh. qumësht dhe lëng ose koncentrat frutash.

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin përgatitjen e ushqimeve për konsum të shpejtë, shih ndarjen 56.

NVE Rev 2.1 kod	10.1
Përshkrim	Përpunimi dhe ruajtja e mishit dhe produkteve me bazë mishi
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.11
Përshkrim	Përpunimi dhe ruajtja e mishit, përveç mishit të shpendëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e thertores si vrasja, regjja apo paketimi i mishit: si viç, derr, qengj, lepur, dele, deve, etj. - prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë, në karkasa - prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë, në copa
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - therjen dhe përpunimin e balenave në tokë ose në anije të specializuara - prodhimin e gëzofëve dhe lëkurëve që vijnë nga thertoret, p.sh. tregtimi i gëzofëve dhe kriposja - nxjerrjen dhe rafinimin e dhjemit të derrit dhe yndyrna të tjera me origjinë shtazore - përpunimin e të brendëshmeve - prodhimi i leshit nga qethja
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - nxjerrjen e yndyrnave nga shpendët, shih 10.12 - prodhimin e mishit të tharë, tëkripur ose të tymosur dhe produkteve të mishit, shih
10.13.	
NVE Rev 2.1 kod	10.12
Përshkrim	Përpunimi dhe ruajtja e mishit të shpendëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e thertores si vrasja, regjja apo paketimi i mishit të shpendëve - prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë në porcione individuale - nxjerrjen e yndyrnave nga shpendët
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - pastrimin, dezinfektimin, trajtimin për ruajtjen dhe prerjen e puplave dhe pushit
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.13
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të mishit dhe produkteve të mishit të shpendëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mishit të konservuar, p.sh. përmes gatimit, tharjes, kriposjes ose tymosjes
- prodhimin e produkteve të mishit:
 - salçiqe, sallam të ndryshëm, dhe proshuta të ndryshme etj

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e vakteve të përgatitura nga mishi dhe shpendët , shih 10.85
- përgatitjen e supës që përmban mish, shih 10.89
- tregti me shumicë të mishit, shih 46.32

NVE Rev 2.1 kod

10.2

Përshkrim

Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

10.20

Përshkrim

Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- përgatitjen dhe konservimin e peshkut, krustaceve dhe molusqeve: p.sh ngrirja, ngrirje e thellë, tharja, tymosja, kriposja, mbajtjen në shëllirë dhe futja në conserva
- prodhimin e produkteve të peshkut, krustaceve dhe molusqeve: fileto peshku, vezë, haviar, nënprodukte të haviarit etj
- prodhimin e vakteve të ushqimit me peshk për konsum njerëzor apo ushqim për kafshë
- prodhimin e ushqimeve dhe lëndëve të tretshme nga peshku dhe kafshë të tjera ujore të pa përshtatshme për konsum njerëzor

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetin e anijeve fabrikë që nuk lidhen me peshkimin dhe ku kryhet vetëm përpunimi dhe konservimi i peshkut
- përpunimin e leshterikëve
- heqja e kokave të peshkut, nxjerrja e të brendshmeve, prerja e peshkut në copa dhe më pas ngrirja

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin dhe konservimin e peshkut në anijet e peshkimit, shih 03.11
- përpunimin e balenave në tokë apo anije të specializuara, shih 10.11
- prodhimin e vajrave dhe yndyrave të peshkut dhe gjitarëve detarë, shih 10.41
- përpunimin e ushqimeve të përgatitur me peshk, shih 10.85
- prodhimin e suprave të peshkut, shih 10.89

NVE Rev 2.1 kod

10.3

Përshkrim	Përpunimi dhe ruajtja e frutave dhe perimeve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.31
Përshkrim	Përpunimi dhe ruajtja e patateve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - përpunimin dhe ruajtjen e patates: • prodhimin e patateve të ngrira të përgatitura • prodhimin e purese se patateve të dehidratuara • prodhimin e patateve të prera • prodhimin e patatinave • prodhimin e miellit te patates • qërimin dhe prerjen e patates
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.32
Përshkrim	Prodhimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e koncentreve nga frutat dhe perimet e freskëta
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin : - prodhimin e pijeve të prodhuara me nektar frutash, shih 11.07
NVE Rev 2.1 kod	10.39
Përshkrim	Proçese të tjera përpunimi dhe ruajtje të frutave dhe perimeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e ushqimit të përbërë kryesisht prej frutave ose perimeve, përveç vakteve të gatshme në formë të ngrirë ose të ambalazhuar në metal - ruajtjen e frutave, arroveve ose perimeve: p.sh. ngrirjen, tharjen, tharjen me ngrirje, tharjen me rrezatim me infra të kuqe, futjen në vaj ose në uthull, ambalazhimin në metal, me trysni të lartë, me temperaturë të lartë - prodhimin e produkteve ushqimore me fruta ose perime - prodhimin e reçelevë, marmelatave, ose reçelevë të tavolinës - heqjen e lëvoreve, qërimin dhe pjekjen e frutave arrove - përpunimin e ushqimeve dhe pastave prej frutave arrove

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - përpunimin e ushqimeve të përgatitura me fruta apo perime që prishen shpejt si psh: • sallatë; sallatat e miksuara, te paketuara • perimet e qëruara apo të prera • tofu(djathë)
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32 - përpunimin e miellit nga legumet, shih 10.61 - konservimin e frutave dhe frutave arvore, shih 10.82 - përpunimin e ushqimeve të përgatitura me perime, shih 10.85 - përpunimin e koncentreve artificiale, shih 10.89
NVE Rev 2.1 kod	10.4
Përshkrim	Prodhimi i vajrave dhe yndyrave bimore dhe shtazore
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e vajrave dhe yndyrnave të papërpunuara dhe të rafinuara nga materialet bimore ose shtazore
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin përpunimin ose rafinimin e dhjavit dhe yndyrnave të tjerë të gjedhëve, deleve, dhive, derrave, shih 10.1
NVE Rev 2.1 kod	10.41
Përshkrim	Prodhimi i vajrave dhe yndyrave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimi i vajrave vegjetale të papërpunuara dhe të rafinuara, p.sh. vaj ulliri, vaj soje, vaj kërpi , vaj lulëdielli, vaj nga rrepa - prodhimin e miellit të farërave, të arrave ose bërthamave - prodhimin e vajrave bimore të rafinuara: vaj ulliri, vaj soje, vaj lulëdielli, vaji rrepës etj - përpunimin e vajrave vegjetalë, p.sh. fryrjen me ajër në temperaturë të lartë, vlimin, dehidratimin, hidrogjenimin
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu : - prodhimin e vajrave dhe yndyrnave shtazore jo të ngrënshme - nxjerrjen e vajit të peshkut dhe nga gjitarë të tjerë detare - fabrikimin e mbetjeve të pambukut, bërësive dhe mbetjeve të tjera nga prodhimi i vajit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - përpunimin dhe rafinimin e dhjavit si dhe yndyrnave të tjere të ngrënshme të gjedhëve, deleve, dhive ose dhjavit të derrave, shih 10.11 - rafinimin e yndyrnave të ngrënshme të pulave, shih 10.12 - prodhimin e margarinës, shih 10.42 - bluarjen e misrit me proces të lagësht, shih 10.62 - prodhimin e vajit të misrit, shih 10.62 - përpunimin e vajrave esenciale, shih 20.59 - trajtimin e vajit dhe yndyrnave nga proceset kimike, shih 20.59

NVE Rev 2.1 kod	10.42
Përshkrim	Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngjashme të ngrënshme
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e margarinës - prodhimin e yndyrnave të përziera e të ngjashme - prodhimin e yndyrnave për gatim
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.5
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të qumështit dhe produkteve të ngrënshme prej akulli
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - prodhimin e zëvendësuesve të qumështit me bazë bimore, shih 11.07
NVE Rev 2.1 kod	10.51
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të bulmetit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e qumështit të freskët, të pasterizuar, sterilizuar, homogjenizuar dhe / ose ato që i nënshtrohen një trajtimi me nxehtësi shumë të lartë - prodhimin e pijeve me bazë qumështi - prodhimin e kremit nga qumështi i freskët, pasterizuar, sterilizuar, homogjenizuar - prodhimin e qumështit pluhur, ose i qumështit të kondensuar, i ëmbëlsuar ose jo - prodhimin e qumështit ose kremit në formë të ngurtë - prodhimin e gjalpfit - prodhimin e kosit - prodhimin e djathit dhe gjizës - rafinimi dhe stazhionimi i djathit - prodhimin e hirrës - prodhimi i kaseinës (proteine e marrë nga qumështi) - Prodhimi i produkteve të qumështit pa laktozë
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - Prodhimin e kefirit të qumështit- prodhimin e laktozës dhe shurupit të laktozës
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e qumështit të papërpunuar të gjedhit, shih 01.41 - prodhimin e qumështit të papërpunuar nga delet, dhitë, gomerët, kuajt, gamilet, shih 01.43, 01.44, 01.45 - prodhimi i pijeve dietike me bazë qumështi, shih 10.86 - prodhimi i qumështit formulë për foshnjat me bazë qumështi, shih 10.86 - prodhimin e qumështit (p.sh. qumësht me bazë bimore) dhe zëvendësuesve të djathit jo nga qumështi, shih 10.89 -prodhimin e kefirit me fruta dhe ujit të kefirit, shih 11.03

- prodhimi i qumështit me bazë bimore shih 11.07

NVE Rev 2.1 kod

10.52

Përshkrim

Prodhimi i akullores dhe produkteve të tjera të ngrënshme prej akulli

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e akullores dhe produkteve të tjera të ngjashme, p.sh. sorbet

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e akullit nga uji natyral për qëllime ftohjeje, shih 35.30

- aktivitetet dyqaneve të akulloreve, shih 56.1

NVE Rev 2.1 kod

10.6

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të drithërave të bluara, niseshteve, produkteve të niseshtesë

Përfshin

Ky grup përfshin blujtjen e miellit ose të ushqimit nga drithërat ose perimet, pastrimin, lustrimin dhe bluarjen e orizit, si dhe mikronizimin dhe përpunimin termik të miellit dhe prodhimin e përzierjeve të miellit ose brumit nga këto produkte.

Përfshin gjithashtu

Ky grup përfshin gjithashtu bluarjen e njomë të misrit dhe perimeve, prodhimi i niseshtesë dhe produkteve të saj, prodhimin e produkteve të bluara pa gluten.

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin:

- tharjen e drithërave mbi bazë komisioni ose kontrate, shih 01.63

NVE Rev 2.1 kod

10.61

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të drithërave të bluara

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- bluarjen e drithërave: prodhimi i miellit, prodhimi i miellit të imet nga gruri i forte, miell ose granula gruri, thekrës, tërshërës, misrit dhe llojeve të tjera të drithërave

- bluarjen e orizit: prodhimi i orizit të bardhë, të lëmuar, të lyer, i zier pjesërisht ose i përpunuar; prodhimin e miellit të orizit;

- bluarjen e perimeve: prodhimi i miellit nga perimet leguminoze të thata, ose rrënjëve dhe zhardhokëve, ose arvoreve

- prodhimin e ushqimeve me bazë drithërash për mëngjes

- prodhimin e miellit të përzier të parapërgatitur dhe brumit për bukë, kekëve, biskotave, petullave etj

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- përgatitjen e kulturave për tregjet primare, p.sh. pastrimi, gradimi etj., shih 01.63

- tharjen e gruri me pagesë ose kontratë, shih 01.63

- prodhimin e miellit të patates dhe ushqimit, shih 10.31
- bluarjen e misrit me proces të lagësht, shih 10.62

NVE Rev 2.1 kod 10.62

Përshkrim Prodhimi i niseshtes dhe produkteve të niseshtes

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e niseshteve nga orizi, patatet, misri, etj.
- bluarjen e misrit në të njomë
- prodhimin e glukozës, shurupit të glukozës, maltozës, inulinës, etj
- prodhimin e glutenit
- prodhimin tapiokës dhe zëvendësuesve të tapiokës të përgatitur nga niseshteja
- prodhimin e vajit të misrit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e laktozës (sheqer qumështi), shih 10.51
- prodhimin e sheqerit nga kallami i sheqerit, shih 10.81

NVE Rev 2.1 kod 10.7

Përshkrim Prodhimi i produkteve të bukës, dhe produkteve me bazë mielli

Përfshin Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të brumit, makaronave, makaronave aziatike dhe produkteve të ngjashme.

Përfshin gjithashtu Ky grup përfshin gjithashtu:- prodhimin e produkteve të furrave të bukës dhe produkteve të brumit pa gluten

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 10.71

Përshkrim Prodhimi i bukës; prodhimi i produkteve të freskëta të pastiçerisë dhe tortave

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të brumit:
 - bukë dhe panine
 - brumëra, kek, torta, tarta, palaçinka , vafer

Përfshin gjithashtu Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e bukës së pjekur paraprakisht

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve të thata të brumit, shih 10.72
- prodhimin e pastave, shih 10.73
- pjekjen e bukës dhe topave të bukës të pjekura paraprakisht nëse kanë lidhje me shitjen me pakicë, shih 47.24

NVE Rev 2.1 kod	10.72
Përshkrim	Prodhimi i peksimadheve, biskotave, pastigerive dhe tortave që ruhen
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e peksimadhe, biskotave, dhe produkteve të tjera të thata të furrës së bukës - prodhimin e pastave dhe kekëve të konservuar dhe piteve - prodhimin e produkteve aperitive (biskota të thata, krekërs, ...) të ëmbla ose të kripura
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e thërrimeve të bukës, të përfutuara nga bluarja e bukës së thekur
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e patatinave, shih 10.31
NVE Rev 2.1 kod	10.73
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të brumit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e llojeve të pastave, p.sh. makarona dhe makarona aziatike, të gatuar ose jo, ose të mbushura - prodhimin e kuskusit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e vakteve të përgatitura me bazë makaronash dhe kuskusi, shih 10.85 - prodhimin e supës me përmbajtje makaronash, shih 10.89
NVE Rev 2.1 kod	10.8
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e sheqerit dhe ëmbëlsirave, vakteve dhe pjatave të përgatitura, kafesë, çajit dhe erëzave.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	10.81
Përshkrim	Prodhimi i sheqerit
Përfshin	Kjo klasë përfshin:- prodhimin ose rafinimin e sheqerit (sukrozës) dhe zëvendësuesve të sheqerit nga lëngu i kallamit, panxharit, panjës dhe palmës- prodhimin e shurupeve të sheqerit- prodhimin e melasës- prodhimin e shurupit dhe sheqerit të panjës
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e shurupit të panjës të egër, shih 02.30
- prodhimin e laktozës dhe shurupit të laktozës, shih 10.51
- prodhimin e glukozës, shurupit të glukozës, maltozës, shih 10.62

NVE Rev 2.1 kod

10.82

Përshkrim

Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe sheqernave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kakaos, gjalpiti të kakaos, yndyrës së kakaos, vajit të kakaos
- prodhimin e çokollatës dhe bonbonerive me çokollatë
- prodhimin e bonbonerive të sheqerit: karamелеve, cachou-ve, nougat, krem sheqerit për pastiçeri, çokollatës së bardhë
- prodhimin e çamçakëzit
- konservimin në sheqer të frutave, frutave të thata, lëvoreve të frutave dhe pjesëve të tjera të bimëve
- prodhimin e rombeve dhe kuadrateve të bonbonerive
- prodhimin e bonbonerive pa sheqer

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e sheqerit të sukrozës, shih 10.81

NVE Rev 2.1 kod

10.83

Përshkrim

Përpunimi i çajit dhe kafesë

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- dekafeinimin dhe pjekjen e kafesë
- prodhimin e produkteve të kafesë:
 - kafe bluar
 - kafe e tretshme
 - ekstrakti dhe koncentrat i kafesë
- prodhimin e zëvendësuesve të kafesë
- përzierjen e çajit dhe maté
- prodhimi i ekstrakteve dhe përgatitjeve me bazë çaji ose maté

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e ekstrakteve të erëzave (mente, verbenë, kamomil, etj.)
- prodhimin e çajit dhe kafesë të mbushur në qese, bustina ose kapsula

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- tharjen, ndarjen, pastrimin dhe prerjen gjatë përpunimit të bimëve mjekësore nga palët e treta, shih 01.63
- prodhimin e inulinës, shih 10.62
- prodhimin e pijeve alkoolike, birrës, verës dhe pijeve freskuese, shih ndarjen 11
- përgatitjen e produkteve botanike për përdorim farmaceutik, shih 21.20

NVE Rev 2.1 kod	10.84
Përshkrim	Prodhimi i salcave dhe erëzave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e erëzave, salcave dhe produkte të tjera për shije: • majonezë • miell dhe pluhur sinapi • mustardë e përgatitur, etj. - prodhimin e uthullës
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - përpunimin e kripës në kripë ushqimore si p.sh kripë e jodizuar - përpunimin e bimëve duke përfshirë tharjen, klasifikimin, pastrimin dhe prerjen
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kultivimin e bimëve të erëzave, shih 01.28
NVE Rev 2.1 kod	10.85
Përshkrim	Prodhimi i vakteve dhe pjatave të gatshme
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e vakteve dhe pjatave të gatshme (pra të përgatitura, me erëzat përkatëse dhe të gatuar). Këto pjata përpunohen dhe konservohen, p.sh. në formë të ngrirë ose të ambalazhuar në metal, dhe zakonisht pakëtohen dhe etiketohen për rishitje. Pra, kjo klasë nuk përfshin përgatitjen e vakteve për konsum të menjëhershëm, si p.sh. ushqimin e përgatitur në restorante ose nga shërbimet e kateringut. Me qëllim që të konsiderohen pjatë, këto ushqime duhet të përmbajnë të paktën dy përbërës kryesorë të veçantë (përveç erëzave, etj.). Kjo klasë përfshin:- prodhimin e pjatave me mish dhe shpendë- prodhimin e pjatave me peshk, përfshirë peshkun e skuqur me patate të skuqura- prodhimin e pjatave me makarona dhe oriz- prodhimin e pjatave me perime- prodhimin e picave dhe croque-monsieur (lloj sanduiçi me djathë dhe proshutë) të ngrira ose të konservuara në mënyra të tjera
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e ushqimeve të freskëta ose të ushqimeve me më pak se dy përbërës, shih klasën përkatëse në ndarjen 10 - prodhimin e ushqimeve të përgatitura nga fruta dhe perime që mund të prishen, shih 10.39 - prodhimin e ushqimeve të përgatitura që prishen, shih 10.89 - shitjen me shumicë të vakteve dhe pjatave të gatshme, shih 46.38 - shitjen me pakicë të vakteve dhe pjatave të gatshme, shih 47.11, 47.27 - aktivitetet e shërbimeve të kateringut për evente dhe të kateringut me kontratë, shih 56.2
NVE Rev 2.1 kod	10.86
Përshkrim	Prodhimi i ushqimeve të gatshme të homogjenizuara dhe të ushqimeve dietike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e ushqimeve për përdorime të veçanta ushqyese:

- formula për bebe
- qumësht formulë për përdorim vijues dhe ushqime të tjera për përdorim vijues
- ushqime për bebe
- ushqime me energji të ulët ose energji të pakësuar të synuara për kontrollin e peshës
- ushqime për qëllime mjekësore

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve me qumësht pa laktozë, shih 10.51
- prodhimin e produkteve pa gluten, shih 10.6, 10.7
- prodhimin e konfeksioneve pa sheqer, shih 10.82

NVE Rev 2.1 kod

10.89

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t

Përfshin

Kjo klasë përfshin prodhimin e produkteve ushqimore të cilat duhet të konsumohen pas tre ditësh që janë prodhuar:

- prodhimin e supave dhe buljoneve
- prodhimin e ushqimeve të gatshme të cilat prishen, p.sh.:
 - sanduiçe
 - pica të freskëta (të papjekura)
- prodhimin e tartave dhe sanduiçit francez me djathë dhe proshutë

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e majasë
- prodhimin e ekstrakteve dhe lëngjeve të mishit, peshkut, krustanceve ose molusqeve
- prodhimin e zëvendësuesve të mishit dhe djathit
- prodhimin e produkteve të vezëve, p.sh. albuminën e vezëve
- prodhimin e koncentreve artificiale
- përpunimi i mjaltit natyror të blerë
- prodhimin e produkteve gjysmë të përfunduara për akullore dhe pastičeri
- prodhimi i supave dhe noodles të çastit të gatuar më parë 3
- prodhimin e mjaltit artificial dhe karamelit
- prodhimin e ekstrakteve dhe shurubeve të maltit
- prodhimin e ushqimit të insekteve dhe përgatitjeve të tjera me bazë insektesh

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- përgatitjen e ushqimeve që prishen shpejt me fruta apo perime, shih 10.39
- prodhimin e e tofus (pastë fasulesh) shih 10.39
- prodhimi i picës së ngrirë, shih 10.85
- përgatitjen e pijeve alkoolike, birrës, verës dhe pijeve të tavolinës, shih ndarjen 11
- prodhimi i zëvendësuesve të qumështit me bazë bimore (p.sh. kokosi, orizi, bajamet, pijet me bazë soje), shih 11.07
- përgatitjen e vitaminave, shih 21.10

NVE Rev 2.1 kod

10.9

Përshkrim

Prodhimi i ushqimeve të gatshme për kafshë

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 10.91

Përshkrim Prodhimi i ushqimeve të gatshme për kafshët e fermës

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimeve të gatshme për kafshët e fermës, përfshirë dhe koncentre dhe plotësues ushqimorë
- përgatitjen e ushqimeve jo të përziera për kafshët e fermës

Përfshin gjithashtu Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- përpunimin e mbetjeve nga industria ushqimore në ushqim për kafshët

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve të mishit, shih 10.13
- prodhimin e miellit të peshkut për ushqimin e kafshëve, shih 10.20
- prodhimin e bërësive të vajit të farave, shih 10.41
- aktivitetet që rezultojnë në produkte të përdorshme si ushqim për kafshët pa trajtim të veçantë, p.sh. vajrat nga farat (shih 10.41), mbetjet e mullirit të drithërave (shih 10.61) etj.

NVE Rev 2.1 kod 10.92

Përshkrim Prodhimi i ushqimit të gatshëm për kafshë shtëpiake

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake ku përfshihen qentë, macet, zogjtë, peshqit etj.

Përfshin gjithashtu Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- përpunimin e mbetjeve nga therja për të prodhuar ushqime për kafshët

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve të mishit, shih 10.13
- prodhimin e miellit të peshkut për ushqim për kafshët, shih 10.20
- prodhimin e bërësive, shih 10.41
- aktivitetet që rezultojnë në produkte të përdorshme si ushqim për kafshët pa trajtim të posaçëm, p.sh., bërsi (shih 10.41), mbetjet nga bluarja e drithërave (shih 10.61), etj.

NVE Rev 2.1 kod 11

Përshkrim Prodhimi i pijeve

Përfshin Kjo ndarje përfshin prodhimin e pijeve, p.sh. pijet joalkoolike dhe ujë mineral, prodhimin e pijeve alkoolike kryesisht nëpërmjet fermentimit, birrës dhe verës

dhe prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32
- prodhimin e pijeve me bazë qumështi, shih 10.51
- prodhimin e produkteve të kafesë, çajit dhe mate, shih 10.83

NVE Rev 2.1 kod

11.0

Përshkrim

Prodhimi i pijeve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

11.01

Përshkrim

Distilimi, purifikimi dhe përzierja e pijeve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve alkoolike të pijshme të distiluara: uiski, brendi, xhin, likere, etj.
- prodhimin e pijeve të përziera me pije alkoolike të distiluara
- përzierjen e pijeve alkoolike të distiluara- prodhimin e pijeve alkoolike neutrale

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pijeve alkoolike jo të distiluara, shih 11.02 deri në 11.05
- prodhimin e alkolit etilik sintetik, shih 20.14
- prodhimin e alkoolit etilik nga materialet e fermentuara, shih 20.14
- mbushja në shishe dhe ngjitjen e etiketave shih 46.34 (nëse është pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet mbi bazë komisioni ose kontrate)

NVE Rev 2.1 kod

11.02

Përshkrim

Prodhimi i verës nga rrushi

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e verës nga rrushi i freskët- prodhimin e verës me gaz
- prodhimin e verës së fortifikuar- prodhimin e verës nga mushti koncentrat i rrushit

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- përzierjen, pastrimin dhe paketimin në shishe të verës
- prodhimin e verës joalkoolike ose me pak alkool

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e verës nga rrushi i thatë, shih 11.03
- ambalazhimin në shishe dhe etiketimin, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhen mbi bazë komisioni ose kontrate)

NVE Rev 2.1 kod

11.03

Përshkrim

Prodhimi i mushtit dhe pijeve të tjera nga fermentimi i frutave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fermentuar por të pa distiluar të pijeve alkoolike: verë mjalti, sake (verë japoneze kryesisht prej orizit), musht, verë dardhe dhe verëra nga fruta të tjera
- prodhimin e verës nga rrushi i thatë

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e përzierjeve të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike p.k.t
- prodhimin e kefirit të frutave dhe kefirit të ujit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e verës nga rrushi , shih 11.02
- ambalazhimin në shishe dhe etiketimin, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar mbi bazë komisioni ose kontrate)

NVE Rev 2.1 kod

11.04

Përshkrim

Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të pa distiluara

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e verës me aromë nga rrushi i freskët, të cilës i jepet shije me lëndë aromatike, p.sh. Vermut

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- paketimin në shishe dhe etiketimin, shih 46.34 (nëse kryhen si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhen mbi bazë komisioni ose kontrate)

NVE Rev 2.1 kod

11.05

Përshkrim

Prodhimi i birrës

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve me bazë malti (p.sh. birra, birra e zezë dhe birra e fortë)

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e birrës me përqindje të ulët ose pa alkool

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

11.06

Përshkrim

Prodhimi i maltës

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e maltit nga elbi, gruri ose drithëra të tjera

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e ekstrakteve të maltit dhe shurupeve, shih 10.89

NVE Rev 2.1 kod

11.07

Përshkrim

Prodhimi i pijeve freskuese dhe ujit të ambalazhuar

Përfshin

Kjo klasë përfshin prodhimin e pijeve joalkolike (përveç birrës dhe verës joalkolike):

- prodhimin e ujërave minerale natyrale dhe ujërave të tjerë të ambalazhuar në shishe

- prodhimin e pijeve freskuese:

• pijeve jo alkolike me shije dhe/ose të ëmbëlsuar : limonadë, pije me shije portokalli, kola, pije me fruta, ujë tonik etj

- prodhimin e pijeve të tjera joalkoolike

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e pijeve të prodhuara me nektar frutash

- prodhimin e zëvendësuesve të qumështit me bazë bimore (p.sh. kokos, oriz, bajame, pije me bazë soje)

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32

- prodhimin e koncentreve , shih 10.32

- prodhimin e pijeve me bazë qumështi, shih 10.51

-prodhimin e produkteve të kafesë, çajit dhe maté, shih 10.83

- Prodhimi i pijeve me bazë alkooli, shih 11.01 deri në 11.05

- prodhimin e verës joalkoolike, shih 11.02

- prodhimin e birrës joalkoolike, shih 11.05

- thjesht shishe dhe etiketim, shih 46.34 (nëse kryhet si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet me një tarifë ose bazë kontrate).

NVE Rev 2.1 kod

12

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të duhanit

Përfshin

Kjo ndarje përfshin përpunimin e një produkti bujqësor, duhanit, në një formë të përshtatshme për konsum përfundimtar.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 12.0

Përshkrim Prodhimi i produkteve të duhanit

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 12.00

Përshkrim Prodhimi i produkteve të duhanit

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të zëvendësuesve të duhanit: cigare, duhan i prerë imët, puro, duhan për pipë, duhan për përtypje, duhan për thithje nga hunda
- prodhimin e duhanit të homogjenizuar ose të riformësuar

Përfshin gjithashtu Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- heqjen e kërcellit dhe ritharjen e duhanit

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- rritjen ose përpunimin paraprak të duhanit, shih 01.15, 01.63
- prodhimin e lëngjeve të cigareve elektronike, përfshirë rimbushjet e mbyllura, shih 20.59
- prodhimin e cigareve elektronike, shih 32.99

NVE Rev 2.1 kod 13

Përshkrim Prodhimi i tekstileve

Përfshin Kjo ndarje përfshin përgatitjen dhe tjerren e fibrave tekstile si dhe thurjen e tekstileve, përfundimin e tekstileve dhe veshjeve , prodhimin e tekstileve teknike, prodhimin e artikujve tekstile të gatshëm, përveç veshjeve (p.sh. çarçafë, batanije, tapete, litarë).

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin Kjo ndarje nuk përfshin:

- rritjen e fibrave natyrore, shih ndarjen 01
- prodhimin e veshjeve , shih ndarjen 14
- prodhimin e fibrave sintetike dhe artificiale, shih 20.60

NVE Rev 2.1 kod 13.1

Përshkrim Përgatitja dhe tjerria e fibrave tekstile

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

13.10

Përshkrim

Përgatitja dhe endja e fibrave tekstile

Përfshin

Kjo klasë përfshin veprimet përgatitore me fibrat e tekstilit dhe tjerren e fibrave të tekstilit. Kjo mund të bëhet nga lëndë të para të ndryshme, materiale tekstile të reja ose të ricikluara, p.sh. mëndafsh, pambuk, lesh, fibra bimore ose artificiale, fibra me bazë celulozën e letrës (dru, kashtë).

Kjo klasë përfshin:

- proceset përgatitore për trajtimin e fibrave tekstile:

- mbledhja dhe larja e mëndafshit
- përvëlimin e leshit, pra heqjen e yndyrës dhe karbonizimin e leshit

dhe lyerjen e tij

- drejtimin dhe krehjen e të gjitha llojeve të fibrave shtazore, bimore dhe artificiale

- tjerren dhe prodhimin e fillit ose perit përthurje ose qepje, për tregti ose për përpunim të mëtejshëm

- zhveshja e fijeve të lirit
- endja, përdredhja, palosja, tjerria dhe ngjyrosja e fijeve me filamente sintetike ose artificiale

- tjerria e fibrave të ricikluara nga lënda e parë dytësore e papërpunuar

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e fijeve të letrës

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- operacionet përgatitore të kryera në kombinim me bujqësinë, shih ndarjen 01

- njomjen e bimëve që prodhojnë fibra tekstile bimore (jut, liri, etj.), kjo nuk lidhet me rritjen e fibrave bimore, shih 01.63

- zhveshjen e farave nga pambuku, shih 01.63

- prodhimin e fibrave dhe rimorkiove sintetike ose artificiale, prodhimin e fijeve të vetme (duke përfshirë fijet me tensitet të lartë për qilimat) të fibrave sintetike ose artificiale, shih 20.60

- prodhimin i fibrave të qelqit, shih 23.14

-përpunimin e mbetjeve tekstile në lëndë dytësore të papërpunuara, shih 38.21

NVE Rev 2.1 kod

13.2

Përshkrim

Endja e tekstileve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

13.20

Përshkrim

Endja e tekstileve

Përfshin	Kjo klasë përfshin thurjen e tekstileve. Kjo mund të bëhet nga lëndë të para të ndryshme, qofshin fibra të reja apo materiale tekstile të ricikluara, p.sh. mëndafshi, pambuku, leshi, fibra ose letra artificiale, materialet e gjetura të mbetjeve tekstile ose fibrat e reja tekstile. Kjo klasë përfshin: - prodhimin e pëlhurave prej pambuku, leshi, mëndafshi, duke përfshirë fijet e përziera ose artificiale ose sintetike (polipropilen, etj.) - prodhimin e pëlhurave të tjera duke përdorur linin, barin kinez, jutën, fibrat lëkurore dhe fijet e veçanta - prodhimin e pëlhurave të gjera të thurura, nga lëndët e para dytësore
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e turrave ose pëlhurave të lehta si garza, peshqirë mëndafshi etj - prodhimin e fijeve të endura me karbon dhe aramid - prodhimin e gëzofit imitacion për veshje.
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e pëlhurave të endura dhe thurura, shih 13.91 - prodhimin e tekstileve për mbulimin e dyshemesë, shih 13.93 - prodhimin e pëlhurave të paendura, shih 13.95 - prodhimin e pëlhura si rripa të ngushtë, shih 13.96 - prodhimin tendave, mallrave të kampingut të materialeve tekstile dhe vela varkë, mbrojtëse dielli, mbulesa të lirshme për makina, makineri apo mobilie, parashutë, shih 13.96 - prodhimin e pëlhurave të fibrave të qelqit, shih 13.96 - prodhimin e filtrave, shih 13.99 - prodhimin e fibrave të karbonit dhe artikujve të fibrave të karbonit, për qëllime jo-elektrike, shih 23.99
NVE Rev 2.1 kod	13.3
Përshkrim	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstileve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	13.30
Përshkrim	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstileve
Përfshin	Kjo klasë përfshin proceset përfundimtare të përpunimit të tekstileve dhe veshjeve si zbardhjen, ngjyrosjen, stampimin dhe aktivitete të ngjashme. Kjo klasë përfshin: - zbardhjen dhe ngjyrosjen e fibrave tekstile, fijeve, pëlhurave dhe artikujve tekstile, duke përfshirë veshjet - veshjen, tharjen, avullimin, tkurrjen, ndreqja e tekstileve dhe artikujve tekstilë, duke përfshirë edhe veshjet
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - zbardhjen e xhinseve

- palosjen dhe punë të ngjashme mbi tekstilet
- mbrojtjen nga uji, shtresat, gomimin, ose ngopjen e artikujve të veshmbathjeve të blera
- stampimin e pëlhurave tekstile si një proces i ndërmjetëm në prodhimin e tekstileve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- printimin, duke përfshirë shtypjen me sitë mëndafshi, mbi tekstilet dhe veshje, jo si një proces ndërmjetës në prodhimin e tekstileve, shih 18.12
- gdhendje me lazer në tekstile, shih 18.12
- përpunimin e pëlhurave tekstile të ngopura, shtresëzuara, mbuluara ose të laminuara me gomë, ku goma është përbërësi kryesor, shih 22.12

NVE Rev 2.1 kod

13.9

Përshkrim

Prodhi i tekstileve të tjera

Përfshin

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të prodhuara nga tekstilet, përveçse veshjeve , p.sh. e tekstilit të punuar si tapetet dhe qilimat, litarët, copat methurje të ngjeshur, aksesoret.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

13.91

Përshkrim

Prodhi i pëlhurave të thurura ose të punuara në grep

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin dhe përpunimin e copave të thurura ose të endura me grep:
 - pëlhura me push dhe mëndafshi
 - rrjetave dhe pëlhura për dritaret
 - pëlhura të tjera të endura apo të thurura

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e gëzofëve imitacion methurje

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pëlhurave me rrjetë dhe zburimeve të dritareve të tipit dantellë, shih 13.99
- prodhimin e pëlhurave të endura apo të thurura, shih 14.10

NVE Rev 2.1 kod

13.92

Përshkrim

Prodhi i tekstileve shtëpiake dhe artikujve të konfeksionuar për mobilime

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve të çdo materiali tekstil, të endura apo të thurura:
 - batanije, duke përfshirë dhe mbulesat e udhëtimit

- çarçafë, mbulesa tavoline, copa tualeti ose kuzhine
- jorganë, jorganë të mbushur, ndenjës dhe shpinore, pupa, jastëkë, çanta gjumi etj
- prodhimin e artikujve të konfeksionuar për mobilime:
- perde, velenca , mbulesa krevati, kuvertë
- flamuj, banera, flamuj sinjalizimi
- peceta për të fshirë pluhurat, peceta për larjen e enëve dhe artikuj të ngjashëm.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e pjesëve tekstile të batanijeve elektrike
- prodhimin e tapicerive të thurura me dorë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve tekstilë për përdorim teknik, shih 13.96
- prodhimin e grilave dhe perdeve për mbrojtje nga dielli, shih 13.96
- prodhimin e pelenave dhe bebelinave për foshnjat, mbathjeve menstruale dhe artikujve të ngjashëm prej materialesh tekstile, shih 17.22

NVE Rev 2.1 kod

13.93

Përshkrim

Prodhimi i tapeteve, rrugicave dhe qilimave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mbulesave tekstile të dyshemesë, p.sh.:
- tapete, qilima , rrogozë dhe shtroje

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e veshjeve të dyshemesë me tezgjah
- prodhimin e barit artificial (bar sintetik)

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rrogozëve dhe rrogozëve të vegjël prej materiali që thuret gërshet, shih 16.28
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë prej xunkthi, shih 16.28
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë elastike si: vinili, linoleumi, shih 22.24

NVE Rev 2.1 kod	13.94
Përshkrim	Prodhim i kordonëve, litarëve, spangove dhe rrjetave
- prodhimin e metanit për furnizimin, si lëndë djegëse e gaztë, përmes një rrjeti të përhershëm furnizimi, shih 35.21

NVE Rev 2.1 kod	20.15
Përshkrim	Prodhim i produkteve plehëruese dhe përbërjeve të azotit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e produkteve plehëruese: • produkte plehërues të thjeshtë ose kompleks të azotit, fosfatit ose kaliumit • ure, fosfate natyrore bruto dhe kripëra natyrore të kaliumit bruto - prodhimin e produkteve të lidhura me azotin: • acidet nitrike dhe sulfonitrike, amoniak, klorur amoni, karbonat amoni, nitrite dhe nitrate të kaliumit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e dheut për poçeri si përzjerje e dheut natyror, torfës, rërës, argjilës dhe mineraleve, me azot, fosfor ose kalium si përbërës thelbësor - prodhimin e plehrave të tjera me përzjerjen ose trajtimin kimik të produkteve shtazore ose bimore
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - nxjerrjen e plehut organik, shih 08.91 - prodhimin e produkteve agrokimike, p.sh., pesticidet, shih 20.20 - prodhimin e agentëve gëlqerizues, shih 20.59 - prodhimin e përzjerjes së mbetjeve, shih 38.21
NVE Rev 2.1 kod	20.16
Përshkrim	Prodhim i materialeve plastike në formë parësore
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e rrëshirave, materialeve plastike dhe elastomerëve termo-plastikë të pa vullkanizueshëm, përzjerjen dhe bashkimin e rrëshirave sipas porosisë, si dhe prodhimin e rrëshirave sintetike të pa personalizuara. Kjo klasë përfshin: - prodhimin e llojeve të plastikës në formë parësore: • polimere, përfshirë ato të etilenit, propilenit, stirenit, vinilit, kloridit, vinil acetatit dhe akrilikëve • poliamide • rrëshira fenolike dhe epoksidi dhe poliuretanët • rrëshira alkide dhe poliester dhe polieteret • shkëmbyes jonesh bazuar në polimere - prodhimin e silikoneve në formë parësore - aktivitetet e krijimit të përbërjeve plastike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e celulozës dhe derivateve të saj kimike - prodhimin e pudrave, grimcave ose petëzave plastike duke përzierë ose transformuar rrëshirën plastike nga mbetjet plastike të rikuperuara - prodhimin e plastikës së ricikluar në petëza ose grimcave plastike bazuar në mbetjet plastike të patrajtuar pas operacioneve të rikuperimit të materialit

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e fibrave, filamenteve dhe fijeve artificiale dhe sintetike, shih 20.60 - përpunimin, copëtimin, pastrimin, bluarjen e mbetjeve plastike, shih 38.21
NVE Rev 2.1 kod	20.17
Përshkrim	Prodhimi i gomës sintetike në formë parësore
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e gomës sintetike në formë parësore: • gomë sintetike • vaj vegjetal ose shtazor i vullkanizuar i pangopur për prodhim gome - prodhimin e përzierjeve të gomës sintetike dhe gomës natyrore ose kauçukut si gomë (p.sh. balata)
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - ndarjen, copëtimin, pastrimin, bluarjen dhe stivimin e mbetjeve prej gome, shih 38.21
NVE Rev 2.1 kod	20.2
Përshkrim	Prodhimi i pesticideve, dezinfektuesve dhe produkteve të tjera agro-kimike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	20.20
Përshkrim	Prodhimi i pesticideve, dezinfektuesve dhe produkteve të tjera agro-kimike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e insekticidëve, vrasësve të brejtësve, të kërpudhave, të barnave të këqija, morrave, butakëve, biocideve - prodhimin e produkteve kundër mbirjes, rregullatorëve të rritjes së bimëve - prodhimin e dezinfektantëve (për përdorim bujqësor dhe përdorime të tjera) - prodhimin e produkteve të tjera agro-kimike p.k.t.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve plehëruese dhe përbërjeve të azotit, shih 20.15

NVE Rev 2.1 kod	20.3
Përshkrim	Prodhimi i bojërave, vernikut dhe veshjeve të ngjashme, bojës së shkrimit dhe mastiçëve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	20.30
Përshkrim	Prodhimi i bojërave, vernikut dhe veshjeve të ngjashme, bojës së shkrimit dhe mastiçëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e bojërave dhe vernikut, llaqeve ose lustrave - prodhimin e pigmenteve dhe ngjyrave të përgatitura, pakësuesve të tejdukshmërisë dhe ngjyrave - prodhimin e llaqeve dhe smalteve që xhamëzohen dhe përgatitje të ngjashme - prodhimin e mastiçit - prodhimin e përbërjeve të stukos dhe përgatitjeve të ngjashme zjarrruduese për mbushje ose nivelim e sipërfaqeve - prodhimin e tretësve dhe holluesve të përbërë organikë - prodhimin e tretësve të bojrave dhe vernikëve - prodhimin e bojrave të shtypshkrimit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e bojërave, shtufit dhe pigmenteve, shih 20.12 - prodhimin e bojës së shkrimit dhe vizatimit, shih 20.59
NVE Rev 2.1 kod	20.4
Përshkrim	Prodhimi i solucioneve për larjen, pastrimin dhe shkëlqimin
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	20.41
Përshkrim	Prodhimi i sapunëve dhe detergjentëve, solucioneve të pastrimit dhe shkëlqimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e agjentëve organikë në sipërfaqe aktive - prodhimin e letrës, mbushjes celuloze, shajakut etj. të veshur ose mbuluar me sapun ose detergjent - prodhimin e glicerolit bruto - prodhimin e sapunit, përveç sapunit kozmetik - prodhimin e përgatitjeve në sipërfaqe aktive:

- pluhurat larës në formë të ngurtë dhe të lëngët dhe detergjentët
 - përgatitjet për larjen e enëve
 - zbutësit e tekstilit
 - prodhimin e produkteve të pastrimit dhe shkëlqimit:
 - përgatitjet për parfurmosjen dhe aromatizimin e ambienteve
 - dyllit artificial dhe dyllit të përgatitur
 - shkëlqyesit dhe kremrat për lëkurë
 - shkëlqyesit dhe kremrat për dru
 - shkëlqyesit për karroceri mjetesh, xham dhe metal
 - pasta dhe pluhura gërryes, përfshirë letrën, mbushjen celuloze, etj.
- të veshur ose të mbuluar me to

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e përbërjeve të veçanta, të përcaktuara kimikisht, shih 20.13, 20.14
- prodhimin e glicerolit, të sintetizuar nga produktet e naftës, shih 20.14
- prodhimin e sapunit kozmetik, shih 20.42

NVE Rev 2.1 kod

20.42

Përshkrim

Prodhimi i parfumeve dhe solucioneve të tualetit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e parfumeve dhe solucioneve të tualetit:
- parfum dhe kolonjë
- solucione bukurie dhe makijazhi
- solucione për parandalimin e djegies nga dielli dhe nxirjen
- solucione për kujdesin e thonjve të duarve dhe këmbëve
- shampo, llake flokësh, solucione për formimin e kaçurrelave ose drejtimin e flokëve
- pasta dhëmbësh dhe solucione për higjienën e gojës, përfshirë solucione për mbajtjen e protezave
- solucione për rruajtje, përfshirë solucione para dhe pas rrojës
- deodorante dhe kripëra për banjë
- depilatorë
- prodhimin e sapunëve kozmetikë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- nxjerrjen dhe rafinimin e esencave vajore natyrore, shih 20.59

NVE Rev 2.1 kod

20.5

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të tjera kimike

Përfshin

Ky grup përfshin prodhimin e lëndëve djegëse biologjike të lëngshme dhe produktet kimike p.k.t., (p.sh. produktet plasëse dhe piroteknike, ngjitësit e lëngshëm, vajrat esencialë, solucionet e përbëra për diagnostikim).

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

20.51

Përshkrim

Prodhimi i karburanteve të lëngshme biologjike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e naftës biologjike
- prodhimin e etanolit nga biomasa
- prodhimin e përzierjeve të etanolit biologjik dhe etereve të përftuara pjesërisht nga biomasa
- prodhimin e lëndëve djegëse biologjike edhe nëse procesi përdor mbetje si lëndë të parë (input)

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e lëndëve djegëse të ngurta nga biomasa bimore, shih 16.26
- prodhimin e alkoolit etilik, përveç biokarbureve të bio- etanolit, shih 20.14
- prodhimin e eksplozivëve, shih 20.59

NVE Rev 2.1 kod

20.59

Përshkrim

Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pllakave fotografike, filmit, letrës së ndjeshme nga ekspozimi dhe materialeve të tjera të ndjeshme nga ekspozimi, të paekspozuara
- prodhimin e përgatitjeve kimike për përdorim në fotografi
- prodhimin e xhelatinës dhe nënprodukteve të saj
- prodhimin e ngjitësve të lëngshëm dhe ngjitësve përgatitur, përfshirë ngjitësit të e lëngshëm dhe ngjitësit me bazë gomën
- prodhimin e vajrave esenciale
- prodhimin e ekstrakteve të produkteve aromatike natyrore
- prodhimin e produkteve rrëshinore
- prodhimin e përzierjeve të produkteve me aromë për prodhimin e parfumeve ose ushqimit- prodhimin e pluhurave shtytës
- prodhimin e produkteve plasëse dhe piroteknike, përfshirë kapsollat, mekanizmat shkrepës, flakadanët sinjalizues, etj.
- prodhimin e lëngjeve elektronike që përdoren në pajisjet elektronike të duhanit
- prodhimin e produkteve të ndryshme kimike:
 - peptonet, nënproduktet e peptoneve, lëndë të tjera proteinike dhe nënproduktet e tyre p.k.t.
 - vajrat dhe yndyrat e modifikuara kimikisht
 - materialet e përdorura në përfundimin e tekstileve dhe lëkurës
 - pluhura dhe pasta për përdorim në ngjitje, saldim me bronz ose saldim
 - lëndë për përdorim në banjat e çoksidimit të metaleve
 - aditivë të përgatitur për çimento
 - karbon të aktivizuar, aditivë për vaj lubrifikues, përshpejtues për gomën e përgatitur, katalizatorë dhe produkte të tjera kimike për përdorim industrial
 - preparate kundër plasjes(antidetonaante), preparate kundër ngrirjes
 - lëngje për transmisionin hidraulik
 - reagjentë të përbërë diagnostikues ose laboratorikë
 - aditivë për karbuant, p.sh. bazuar në eter tri-bitil eter (ETBE) dhe metil tri-bitil eter (MTBE)

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e bojës së shkrimit dhe vizatimit - prodhimin e shkrepsëve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve aromatike sintetike, shih 20.14 - prodhimin e bojës së printimit, shih 20.30 - prodhimin e parfumeve dhe përgatitjeve të tualetit, shih 20.42 - prodhimin e biokarburanteve të lëngshme, shih 20.51
NVE Rev 2.1 kod	20.6
Përshkrim	Prodhimi i fibrave sintetike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	20.60
Përshkrim	Prodhimi i fibrave sintetike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin shtëllungave të filamenteve sintetike dhe artificiale - prodhimin e fibrave sintetike ose artificiale , të pa drejtura, krehura ose përpunuara në mënyra të tjera për filaturë - prodhimin e fijeve me filament sintetik ose artificial, përfshirë fijet me rezistencë të lartë - prodhimin e monofilamentit ose rripit sintetik dhe artificial - prodhimin e fibrave të ricikluara
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - endjen e fibrave sintetike ose artificiale, shih 13.10 - prodhimin e fijeve prej fibrave të krijuara nga njeriu, shih 13.10 - prodhimin e fibrave të karbonit, shih 23.99
NVE Rev 2.1 kod	21
Përshkrim	Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe përgatitjeve farmaceutike
Përfshin	Kjo ndarje përfshin prodhimin e produkteve farmaceutike bazë dhe përgatitjeve farmaceutike.
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu: prodhimin e produkteve farmaceutike kimike dhe bimore

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

21.1

Përshkrim

Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

21.10

Përshkrim

Prodhimi i produkteve farmaceutike bazë

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e përbërësve farmaceutikë aktivë që përdoren për cilësitë e tyre farmakologjike në prodhimin e produkteve mjekësore, p.sh. antibiotikë, vitamina të thjeshta, acide salicilike dhe O-acetilsalicilike
- përpunimin e gjakut

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e sheqerit kimikisht të pastër
- prodhimin e probiotikëve
- prodhimin e gjëndrave dhe prodhimin e ekstrakteve të gjëndrave etj.

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimi i preparateve farmaceutike me qeliza dhe terapi gjenetike, shih 21.20

NVE Rev 2.1 kod

21.2

Përshkrim

Prodhimi i përgatitjeve farmaceutike

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e barnave:
 - serume dhe përbërës të tjerë të plazmës
 - vaksina
 - medikamente të ndryshme, përfshirë përgatitjet homeopatike
- prodhimin e produkteve kontraceptive kimike për përdorim të jashtëm dhe medikamente kontraceptive hormonale
- prodhimin e përgatitjeve mjekësore diagnostikuese, përfshirë testet e shtatzënisë
- prodhimin e substancave diagnostikuese rrezatuese për përdorim in-vivo
- prodhimin e përgatitjeve farmaceutike bio-teknologjike
- prodhimin e produkteve mjekësore për terapi të avancuar qelizore dhe të gjeneve

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e mbushjeve, garzave, fashave dhe mbulesave mjekësore, etj.
- përgatitjen e produkteve botanike (thërrmim, përpunim, bluarje) për përdorim Farmaceutik
- prodhimin e medikamenteve ose vaksinave virale me bazë vektori
- prodhimin e përgatitjeve farmaceutike për mjekësinë veterinare

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e ekstrakteve bimore (mente, shporiz, kamomil etj.), shih 10.83
- prodhimin e probiotikëve, shih 21.10
- prodhimin e mbushjeve dentare dhe ngjitjes dentare, shih 32.50
- përpunimin e çimentove për rregullim të kockave, shih 32.50
- prodhimin e letrave kirurgjikale me një përdorim (surgical) drape, shih 32.50
- shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike, shih 46.46
- shitjen me pakicë të produkteve farmaceutike, shih 47.73
- kërkimin dhe zhvillimin për produkte farmaceutike dhe produkteve të tjera bioteknologjike, shih 72.10
- paketimin e produkteve farmaceutike, shih 82.92

Përfshin

Kjo ndarje përfshin prodhimin e produkteve të gomës dhe atyre plastike. Kjo ndarje karakterizohet nga lëndët e para që përdoren në procesin e prodhimit. Megjithatë, këtu nuk klasifikohen prodhimi i të gjitha produkteve të bëra nga këto materiale.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu prodhimin e produkteve të materialeve të përbëra në të cilat plastika është materiali kryesor.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	22.1
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të kauçukut
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të gomës.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	22.11
Përshkrim	Prodhimi, riveshja dhe rikonstruktimi i gomave dhe prodhimi i kamerdareve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e gomave prej gome për mjete, pajisje, makineri të lëvizshme, mjete ajrore, lodra, mobilie dhe për përdorime të tjera: • goma pneumatike • goma të plota ose me jastëkë - prodhimin e kamerdareve për goma - prodhimin e luleve të ndërrueshme të gomave, mbrojtëseve të kamerdareve, shiritave përforcues prej gome për riformimin e lules së gomës, etj. - rindërtimin dhe rikrijimin e luleve të gomave

Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e materialeve për riparimin e tubave, shih 22.12 - riparimin, montimin ose zëvendësimin e gomave dhe tubave, shih 95.3

NVE Rev 2.1 kod	22.12
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera të gomës
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e produkteve të tjera me gomë natyrore ose sintetike, të pa vullkanizuar, të vullkanizuar ose të forcuar: • pllaka, fletë, shirita, shufra, forma profili prej gome • tuba, tubacione dhe zorra • rripa transporti ose transmisioni prej gome • artikuj higjienikë gome: prezervativë burrash, biberona, borse uji të nxehtë • artikuj veshjeje prej gome • fill dhe litar prej gome • fiqe dhe copë të gomuar • unaza, rakorderi dhe izolues gome • veshje të rrulave prej gome • dyshekë gome me ajër • tullumbace me ajër - prodhimin e furçave prej gome - prodhimin e filtrave të pipave me gomë të fortë - prodhimin e krehrave, kapëseve të flokëve, bigudive dhe artikujve të ngjashëm me gomë të fortë - prodhimin e nyjave zgjatuese prej gome për industrinë e ndërtimit - prodhimin e gomës qelizore lateks - prodhimin e veshjeve të dyshemesë prej gome

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e produkteve për riparimin e materialeve prej kauçuku
- prodhimin e pëlhurave tekstile të shtresëzuara, mbuluara, ngopura, ose laminuara me kauçuk
- prodhimin e dyshekëve ujqorë prej kauçuku
- prodhimin e kupave dhe platformave prej kauçuku për banjo
- prodhimin e kompleteve dhe kamerdareve prej kauçuku
- prodhimin e artikujve të seksit prej kauçuku
- prodhimin e veshjeve të bëra nga latex

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pëlhurave të holla për goma, shih 13.96
- prodhimin e veshjeve prej pëlhure elastike, shih 14.22, 14.29
- prodhimin e soleteve dhe pjesëve të tjera të këpucëve prej plastike, shih 15.20
- prodhimin e ngjitësve dhe adezivëve prej kauçuku bazë, shih 20.59
- prodhimin e rripave të "shpinës së gamiles", shih 22.11
- prodhimin e transportuesve dhe barkave pneumatike, shih 30.11, 30.12, 30.13
- prodhimin e dyshekëve prej kauçuku porozë të pambuluar, shih 31.00
- prodhimin e artikujve sportivë prej kauçuku, përveç veshjeve, p.sh pishinat për fëmijë, shih 32.30
- prodhimin e lojërave dhe lodrave prej kauçuku (duke përfshirë pishinat e vogla për fëmijë, kafshët, topa, etj, shih 32.40
- rigjenerimin e gomave, shih 38.21

NVE Rev 2.1 kod

22.2

Përshkrim

Prodhimi i produkteve plastike

Përfshin

Ky grup përfshin përpunimin e rrëshirave plastike të reja ose të përdorura (pra, të ricikluara) në produkte të ndërmjetme ose përfundimtare, duke përdorur procese si formësimi me shtypje, formësimi me shtrydhje, formësimi me injeksion, formësimi me fryrje, dhe përmes derdhjes. Për shumicën e tyre, procesi i prodhimit lejon prodhimin e një game të gjerë produktesh.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin:

- prodhimin e pjesëve ose aksesorëve plastikë, të cilat janë të përshtatshëm për përdorim vetëm ose kryesisht në automjetet motorike, shih 29.3

NVE Rev 2.1 kod

22.21

Përshkrim

Prodhim i pllakave, fletëve, tubave dhe profileve plastike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të ndërmjetme:
 - pjata, fletë, blloqe, film, fletë të holla, shirita, etj. plastike
- prodhimin e produkteve përfundimtare:
 - tuba, tubacione dhe zorra plastike, rakorderi zorrash dhe tubacionesh plastike
 - film ose fletë celofani
- prodhimin e pllakave dhe fletëve të përthyeshme ose të papërthyeshme të poliuretanit qelizor
- prodhimin e pjatave, fletëve, filmit, fletës së hollë dhe shiritave plastikë të përforcuar, të laminuar, me mbështetje ose të kombinuar me materiale të tjera në mënyra të ngjashme
- prodhimin e pllakave, fletëve, filmit dhe fletëve të holla dhe shiritave me vetëngjitje

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e plastikës në formë primare, shih 20.16
- prodhimin i artikujve sintetik ose natyral prej kauçuku, shih 22.1
- përvetësimin e tubave metalikë me shkumë dhe mbështjellja me një tub plastik, p.sh. për shërbimet e furnizimit me avull dhe ujë të ngrohtë, shih 22.25

NVE Rev 2.1 kod

22.22

Përshkrim

Prodhim i mallrave plastike të ambalazhimit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve plastikë për ambalazhimin e mallrave:
 - qese, thasë, enë, kuti, arka, damixhane, shishe, etj. prej plastike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e valixheve dhe çantave prej plastike, shih 15.12

NVE Rev 2.1 kod

22.23

Përshkrim

Prodhim i dyerve dhe dritareve plastike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e dyerve, dritareve dhe kornizave të tyre me plastikë

- prodhimin e dyerve dhe dritave me materiale të ndryshme me kornizë prej plastike
- prodhimin e kanatave, grilave (përfshirë grilat veneciane) dhe artikujve të ngjashëm dhe pjesëve të tyre
- prodhimin e kanatave me materiale të ndryshme për dyer dhe dritare me kornizë prej plastike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

22.24

Përshkrim

Prodhimi i materialeve plastike për ndërtim

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e materialeve plastike për ndërtim
 - mbajtëset e plintave
 - depozita, rezervuarë
 - dysheme plastike, veshje muresh ose tavanesh në forma të petëzuar apo në formë tullash etj
 - pajisje sanitare plastike si banjat, banjat e dushit, vaska, lavaman, çisterna etj
- prodhimin e shtresave mbuluese të dyshemesë rezistente, p.sh. vinil, linoleum

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e pajisjeve sanitare prej guri artificial të bërë nga një përzierje e plastikës dhe mineraleve, me mineralet që shërbejnë si mbushës

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dyshemeve prej gome, shih 22.12
- prodhimin e dyerve dhe dritareve plastike, shih 22.23

NVE Rev 2.1 kod

22.25

Përshkrim

Përpunimi dhe përfundimi i produkteve plastike

Përfshin

- Kjo klasë përfshin aktivitete të përgjithshme për përpunimin dhe përfundimin e produkteve plastike, zakonisht të kryera me pagesë ose kontratë:
- përpunimin e plastikës, p.sh. nga prerja, zbërthimi, tornimi, frezimi, kthimi, bluarja, shpimi, filtrimi nga kontrolli numerik kompjuterik (CNC) ose makineri të tjera
 - përkuljen, ngjitjen dhe saldimin e materialeve plastike
 - përpunimin e sipërfaqeve plastike, (p.sh.gdhendjes, goditjes me rërë, goditjes me materiale të imëta, lustrimit
 - veshjen e sipërfaqeve plastike, (p.sh. lyerja, llakimi dhe metalizimi i plastikës)

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- veshjen e tubave metalike me plastikë
- saldimin e rezervuarëve dhe tubave plastikë
- veshjen metalike të plastikës

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- veshjen plastike të sipërfaqeve metalike, shih 25.51

NVE Rev 2.1 kod

22.26

Përshkrim

Prodhim i produkteve të tjera plastike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tavolinave, kuzhinave dhe artikuj të tualetit prej plastike
- prodhimin e produkteve të ndryshme prej materiali plastik:
 - kaska plastike me përjashtim të kapelës së sigurisë, pjesë izolante, pjesë të aparateve të ndriçimit, pajisje për zyra, shkollë, artikuj të veshjes, garnitura për mobiliën, statuja, rripa transmetimi dhe konvejeri, ngjitës plastikë adezivë, letër muri plastike, sfungjer plastik, kallëp për këpucë plastike, mbajtëse cigare dhe cigareta plastike, krehër, bigutina plastike flokësh, artikuj të rinj prej plastike
- prodhimin e produkteve nga argjila polimere

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e pajisjeve plastike për pastrim

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e valixheve plastike, shih 15.12
- prodhimin e këpucëve plastike, shih 15.20
- prodhimin e mobilie plastike, shih 31.00
- prodhimin e dyshekëve të pambuluar me plastikë poroze, shih 31.00
- prodhimin e pajisjeve sportive plastike, shih 32.30
- prodhimin e lojërave plastike dhe lodrave, shih 32.40
- prodhimin e pajisjeve plastike mjekësore dhe dentare, shih 32.50
- prodhimin e mallrave plastike okulistike, shih 32.50
- prodhimin e kapeleve prej plastike dhe pajisjeve të tjera sigurie prej plastike, shih 32.99

NVE Rev 2.1 kod

23

Përshkrim

Prodhim i produkteve të tjera minerare jo metalike

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet prodhuese që lidhen me një substancë të vetme me origjinë minerale. Kjo ndarje përfshin prodhimin e qelqit dhe produkteve të qelqit (p.sh. qelqi i sheshtë, qelqi bosh, fibrat, qelqi teknik), produktet qeramike, pllakat dhe produktet e argjilës së pjekur, çimento, beton dhe allçisë, nga lëndët e para deri te artikujt e përfunduar.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu dhe prodhimin e gurit të formësuar dhe të përfunduar dhe produkteve të tjera minerale. Kjo ndarje përfshin edhe prodhimin e produkteve të materialeve të përbëra, në të cilat qelqi dhe mineralet jo-metalike, p.sh. rëra, zhavorri, guri apo argjila, janë materiali mbizotërues.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	23.1
Përshkrim	Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit
Përfshin	Ky grup përfshin xhamin në të gjitha format e veta, të prodhuar me anë të çdo procesi, dhe artikujt e qelqit.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.11
Përshkrim	Prodhimi i qelqit të sheshtë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e qelqit të sheshtë, p.sh. të derdhur, të petëzuar, të tërhequr ose të fryrë, xham me sipërfaqe të smeriluar (xham akulli) ose të luçiduar në fletë ose fletë xhami dritaresh, të cilat janë bërë të patejdukshme, ngjyrosur me xham me ngjyrë, ose që kanë shtresë thithëse, pasqyruese ose jopasqyruese, përfshirë me tel, xhamit të sheshtë të ngjyrosur tërësisht me xham tjetër ose ngjyrosur me bojë.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - formësimin dhe përpunimin të kryer si pjesë të procesit të prodhimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - formësimin dhe përpunimin e fletëve të sheshta të qelqit, p.sh. përkulja, gdhendja, laminimi, temperimi, shih 23.12
NVE Rev 2.1 kod	23.12
Përshkrim	Dhënia e formës dhe transformimi i qelqit të sheshtë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e fletëve ose profileve të qelqit të përthyer, me anë të punuara, të gdhendura, të shpuara ose të emaluar - prodhimin e xhamit të sigurisë të përforcuar ose të laminuar - prodhimin e pasqyrave prej xhami - prodhimin e xhamit izolues me shumë shtresa dhe njësive të xhamit - prodhimin e xhamit të veshur - trajtimin sipërfaqësor të xhamit të sheshtë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - printimin në xham, shih 18.12 - prodhimin e pasqyrave të automjeteve, shih 29.32

NVE Rev 2.1 kod	23.13
Përshkrim	Prodhimi i qelqit të lugët
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e shisheve dhe mbajtësve të tjerë prej qelqi apo kristali - prodhimin e gotave të pijes, qelqurina të tavolinës ose kuzhinës dhe qelqurina të tjera shtëpiake dhe artikuj kristalor
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e përbërjes së qelqit për enët me vakum - prerjen ose ndryshe dekorimin e gotave të pijes
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - printimin në xham, shih 18.12 - prodhimin e lodrave prej qelqi, shih 32.40
NVE Rev 2.1 kod	23.14
Përshkrim	Prodhimi i fibrave të qelqit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e fibrave të xhamit, përfshirë leshin e xhamit dhe nënproduktet e tij pa thurje - prodhimin e produkteve nga fibrat e xhamit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e fijeve të qelqit për endjen e pëlhurave, shih 13.96 - prodhimin e leshit të skories, leshit të xhamit, dhe leshrave të ngjashëm mineralë, shih 23.99 - prodhimin e kablove me fibra optike për transmetimin e të dhënave ose transmetimin e drejtpërdrejtë të imazheve, shih 27.31
NVE Rev 2.1 kod	23.15
Përshkrim	Prodhimi dhe transformimi i qelqeve të tjera, duke përfshirë qelqin teknik
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e artikujve laboratorikë, higjienikë ose farmaceutikë prej qelqi - prodhimin e xhamave për ora ose ora dore, xhamave optikë dhe elementeve optike të papunuara në mënyrë optike - prodhimin e materialit të qelqi të përdorur në imitimet e argjendarisë - prodhimin e izoluesve dhe rakorderive izoluese prej qelqi - prodhimin mbrojtëseve prej qelqi të llambave - prodhimin e statujave prej qelqi - prodhimin e blloqeve ose tullave, drejtkëndoreve, katrorëve dhe pllakave prej qelqi të llojit që përdoren për qëllime ndërtimi ose në industrinë e ndërtimit, dhe qelqi me flluska gazi ose shkumë xhami në blloqe, panele, pllaka, ose forma të ngjashme - prodhimin e qelqit në formë shufre ose tubi

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e dyerve prej xhami, mureve, etj. - përfundimin e xhamave të tjerë, duke përfshirë xhamin teknik, p.sh. prerjen ose lustrimin mekanik të qelqit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e elementeve optike të punuara në mënyrë optike, shih 26.70 - prodhimin e shiringave dhe pajisjeve të tjera laboratorike mjekësore, shih 32.50

NVE Rev 2.1 kod	23.2
Përshkrim	Prodhimi i produkteve refraktare (zjarrrduese)
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	23.20
Përshkrim	Prodhimi i produkteve refraktare (zjarrrduese)
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e produkteve të ndërmjetme nga mineralet jo- metalike të minierave ose gurore (p.sh. zhavorr, gur ose argjilë) - prodhimin e llaçit refraktar, beton etj - prodhimin e produkteve qeramike refraktare psh: • produkte qeramike izolues nxehtësie prej përbërjeve fosile silicore • tulla refraktare, blloqe dhe tulla etj • enë distilimi me lëfyt, poçe, mufla, pipa, tuba, tubacione etj.

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e artikujve refraktarë që përmbajnë oksid magnezi, oksid magnezi - kalciumi ose kromite
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	23.3
Përshkrim	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej argjile
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.31
Përshkrim	Prodhimi i pllakave dhe pllakave të mëdha prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e pllakave për vatra dhe mure prej qeramike jorefraktare, kube-mozaike etj - prodhimin e pllakave dhe produkteve për shtrim rruge prej qeramike jo-refraktare
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve qeramike zjarrrduese, shih 23.20 - prodhimin e tullave qeramike dhe tjegullave të çatisë, shih 23.32 - prodhimin e artikujve prej guri artificial për përdorim në ndërtim, shih 23.61
NVE Rev 2.1 kod	23.32
Përshkrim	Prodhimi i tullave, pllakave dhe produkteve të ndërtimit me argjilë të pjekur
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e artikujve qeramikë strukturorë që nuk janë zjarrrdues, të përfshirë nga pjekja e materialeve të ndërtimit prej argjile, p.sh. tulla, tjegulla, gypa oxhaku, tuba, tejçues prej qeramike - prodhimin e blloqeve të dyshemesë me argjilë të pjekur
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve qeramike zjarrrduese, shih 23.20 - prodhimin e produkteve qeramike jo strukturore jo refraktare, shih 23.4

NVE Rev 2.1 kod	23.4
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike dhe porcelani
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e produkteve përfundimtare nga mineralet jo metalike të nxjerra nga minierat ose guroret, p.sh. zhavorr, gur, ose argjilë.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.41
Përshkrim	Prodhimi i artikujve shtëpiakë dhe dekorativ prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e produkteve prej qeramike, enëve të kuzhinës, artikujve shtëpiakë, artikujve të tualetit, statujave dhe artikujve të tjerë zbukurues prej qeramike, (porcelan, poçeri të zakonshme, artikuj guri, artikuj balte ose poçeri të cilësisë së lartë)
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e imitimit të stolive, shih 32.13 - prodhimin e lodrave prej qeramike, shih 32.40
NVE Rev 2.1 kod	23.42
Përshkrim	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e hidrosanitareve prej qeramike, p.sh. lavapjata, lavamanë, bazamente për lavamanë, banja, bide, kupa tualeti, depozita për shkarkim uji
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e artikujve qeramikë zjarrdurues, shih 23.20 - prodhimin e materialeve të ndërtimit prej qeramike, shih 23.3

NVE Rev 2.1 kod	23.43
Përshkrim	Prodhimi i izoluesve dhe rakorderive izoluese prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e izoluesve elektrikë dhe artikujve izolues prej qeramike për qëllime elektrike
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve qeramike refraktare, shih 23.20
NVE Rev 2.1 kod	23.44
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera teknike prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e magneteve të përhershëm dhe artikujve për t'u bërë magnetë të përhershme pas magnetizimit, me materiale përveç metalit, p.sh. ferriteve aglomerat - prodhimin e artikujve të qeramikës për përdorim laboratorik, kimik, dhe përdorime të tjera teknike
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e artikujve qeramikë zjarrdurues, shih 23.20 - prodhimin e materialeve të ndërtimit prej qeramike, shih 23.3 - prodhimin e gurit artificial (p.sh. mermer të kultivuar), shih 23.66
NVE Rev 2.1 kod	23.45
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e vazove qeramike, poçeve dhe artikuj të ngjashëm të një lloji të përdorur për transmetim dhe paketim - prodhimin e vazove të qeramikës, vaskave dhe enë të ngjashme të një lloji të përdorur në bujqësi - prodhimin e produkteve prej qeramike të p.k.t
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e pajisjeve sanitare prej qeramike, shih 23.42 - prodhimin e dhëmbëve artificialë, shih 32.50

NVE Rev 2.1 kod	23.5
Përshkrim	Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe allçisë
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.51
Përshkrim	Prodhimi i çimentos
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e çimentos së padjegur dhe çimentove hidraulike, përfshirë çimenton Portland, çimento me oksid alumini, çimento skorje, çimento supersulfati dhe çimento të ngjashme hidraulike, të ngjyrosura ose në formën e çimentos së padjegur
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e llaçit refraktar, betonit etj, shih 23.20 - prodhimin e llaçit dhe betonit të perzier të thatë të gatshëm për përdorim, shih 23.63, 23.64 - prodhimin e artikujve prej çimento, shih 23.65, 23.66 - prodhimin e çimentos për mbushje për përdorim dentar, shih 32.50
NVE Rev 2.1 kod	23.52
Përshkrim	Prodhimi i gëlqeres dhe allçisë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e gëlqeres së pashuar, gëlqeres së shuar dhe gëlqeres hidraulike - prodhimin e allçisë me gips të kalçinuar ose sulfat kalciumi
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e dolomiteve të kalçinuara ose dolomite të djegur (të vdekur) (sintered dolomite)
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e oksidit të pastër të kalciumit dhe hidroksidit të kalciumit, shih 20.12 - prodhimin e artikujve të suvasë, shih 23.62, 23.66

NVE Rev 2.1 kod	23.6
Përshkrim	Prodhimi i artikujve prej betoni, çimentoje dhe allçie
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.61
Përshkrim	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e betonit parafabrikat, çimentos ose artikujve prej guri artificial për përdorim në ndërtim: • pllaka, rrasa shtrimi, blloqe ndërtimi, tulla, rrasa, fletë, panele, tuba, shtylla, etj. - prodhimin e godinave parafabrikat dhe përbërësve strukturorë për ndërtim ose inxhinieri ndërtimi, kontroll ose bllokim qarkullimi prej çimentoje, betoni ose guri artificial - prodhimin e elementeve parafabrikat të prodhuara në fabrikë prej tulle për ndërtimin e godinave parafabrikat për përdorim në ambiente të jashtme dhe mure rrethuese, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të shirave dhe objektet komunale nëntokësore - prodhimin e elementeve të prodhuara në fabrikë me beton - prodhimin e tubave parafabrikat prej betoni për ujë të pijshëm
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e njësive për muraturë silikatesh kalciumi - prodhimin e njësive për muraturë betoni me ajrim dhe autoklavë
Nuk përfshin	Kjo klasë përjashton: - prodhimin e artikujve të tjerë prej betoni, çimentoje dhe suvaje që nuk përdoren në ndërtim, shih 23.66
NVE Rev 2.1 kod	23.62
Përshkrim	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e artikujve të allçisë ose përbërje bazuar në allçinë e përdorur në ndërtim: • bordura, fletë, panele, pllaka dhe artikuj të ngjashëm pa dekorime
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	23.63
Përshkrim	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e betonit të gatshëm për derdhje, pra të cilit i është hedhur uji dhe që zakonisht transportohet me betonierë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e çimentos refraktare, shih 23.20
NVE Rev 2.1 kod	23.64
Përshkrim	Prodhimi i llaçit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e llaçit që nuk është zjarrdurues dhe betonit të pa përzier me ujë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e llaçit zjarrdurues, shih 23.20 - prodhimin e betonit të gatshëm dhe betonit gati për derdhje, shih 23.63
NVE Rev 2.1 kod	23.65
Përshkrim	Prodhimi i fibrave të çimentos
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e paneleve, rrasave, pllakave, blloqeve dhe artikujve të ngjashëm prej lëndëve bimore (p.sh. lesh druri, kashtë, kallama, xunkth) të aglomeruar me çimento, allçi ose lidhës të tjerë minerarë - prodhimin e artikujve të çimentos me asbest ose çimentos me fibra celuloze, p.sh.: • fletëve të valëzuara, fletëve të tjera, paneleve, pllakave, tubave, tubacioneve, rezervuarëve, lugjeve, legenëve, lavamanëve, kavanozave, mobilieve, kornizave të dritareve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e dërrasës prej druri me fibra izoluese, ose prej fibrash të tjera drunore, të lidhura ose jo me rrëshirë apo me substanca të tjera organike, shih 16.21

NVE Rev 2.1 kod	23.66
Përshkrim	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, çimentoje dhe allçie
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e artikujve të tjerë prej betoni, allçie apo prej përbërjeve të bazuara në allçi, çimento ose gur artificial, p.sh. statuja, mobilie, relief të ulët dhe relief të ngritur, vazo, vazo lulesh
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e pareteve të dekoruara ose paneleve prej suvaje, ose përbërjeve me bazë suvaje - artikuj të tjerë prej silikatesh kalciumi - artikuj të tjerë prej betoni me ajrin dhe autoklavë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e artikujve të parapërgatitur prej betoni, çimentoje ose guri artificial për përdorim në ndërtim, shih 23.61

NVE Rev 2.1 kod	23.7
Përshkrim	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	23.70
Përshkrim	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - thyerjen, dhënien e formës dhe definicionin e gurit për qëllime ndërtimi ndërtesash, në monumente funerale, në rrugë, në çati - prodhimin e mobilieve prej guri
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetin e guroreve, psh prodhimin e gurit bruto, shih 08.11 - prodhimin e gurit të mullirit, gurit abraziv dhe produkte të ngjashme, shih 23.9

NVE Rev 2.1 kod	23.9
Përshkrim	Prodhimi i produkteve gërryerëse dhe produkteve minerare jo metalike p.k.t.
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.91
Përshkrim	Prodhimi i produkteve gërryerëse(abrazive)
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e gurëve të mullirit, gurëve bluarës, rrotave bluarëse, etj., pa korniza për bluarjen, mprehjen, formësimin e saktë ose prerjen, mprehjen ose luçidimin me dorë të gurëve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e pluhurit ose kokrrave abrazive natyrale ose artificiale, mbi bazën e materialit të tekstilit, letrës, kartonit ose materialeve të tjera, nëse janë apo jo të prera në formë, të qepura ose të bëra ndryshe
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	23.99
Përshkrim	Prodhimin e produkteve të tjera minerale jo metalike të p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e materialeve të fërkimit dhe artikujve të pamontuar përkatës me bazë lëndë minerare ose celulozë - prodhimin e materialeve minerare për izolim, p.sh.: • vatë skoriesh, lesh guri dhe leshra të ngjashme minerare; vermikulit i hapur, argjila të zgjeruara dhe materiale të ngjashme për izolim termik, izolim akustik ose përthithje zëri - prodhimin e artikujve prej lëndëve të larmishme minerare, p.sh.: • mikë e punuar dhe artikuj muke, torfe, ose grafiti (përveç artikujve elektrikë) - prodhimin e artikujve prej asfalti ose materiale të ngjashme, p.sh. bitum naftë ose katran qymyri - prodhimin e fibrave dhe produkteve prej karboni dhe grafiti (përveç elektrodave dhe aplikimeve elektrike) -prodhimin e korundit artificial
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e leshit të qelqit dhe produkteve të leshit të qelqit jo të endura, shih 23.14 - prodhimin e elektrodave grafit, shih 27.90 - prodhimin e guarnicioneve të karbonit ose grafitit, shih 28.29

NVE Rev 2.1 kod	24
Përshkrim	Metalurgjia
Përfshin	Kjo ndarje përfshin aktivitetet e shkrirjes dhe/ose përpunimit të metaleve me ngjyra dhe pa ngjyra nga xeherorët, giza, mbetjet ose skrap metalik, duke përdorur teknika elektrometalurgjike dhe teknika të tjera të proceseve metalurgjike.
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu edhe prodhimin e aliazhit metalik ose superaliazhit duke futur elemente të tjera kimike në metale të pastra. Produkti i shkrirjes dhe rafinimit, zakonisht në formë lingote, përdoret në operacionet e petëzimit, telëzimit dhe stampimit në të nxehtë për të prodhuar produkte, p.sh. pllaka, fleta, shirita, kallëpe, shufra, tela ose gypa, tuba dhe profile bosh, në formë të shkrirë për të bërë derdhje, të ndryshme nga produktet e metaleve bazë.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	24.1
Përshkrim	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe ferroaliazheve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	24.10
Përshkrim	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe ferroaliazheve
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitete të tilla si reduktimi i drejtpërdrejtë i xeherorit të hekurit, prodhimi i gizës në formë të shkrirë ose të ngurtë, konvertimi i gizës në çelik, prodhimi i aliazhëve të hekurit dhe prodhimi i produkteve të çelikut.

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e furnaltave, konvertuesve të çelikut, uzinave të petëzimit dhe përfundimit
- prodhimin e gizës dhe gizës pasqyrë, blloqesh dhe forma të tjera parësore
- prodhimin e aliazhëve të hekurit
- prodhimin e produkteve të hekurit përmes reduktimit të drejtpërdrejtë të hekurit dhe produkteve të tjera të hekurit poroz
- prodhimin e hekurit me pastërti të jashtëzakonshme me anë të elektrolizës ose proceseve të tjera kimike
- rishkrirjen e skrapit të hekurit të derdhur ose çelikut të derdhur
- prodhimin e hekurit në kokrriza ose në pluhur
- prodhimin e çelikut të derdhur ose në forma të tjera parësore
- prodhimin e produkteve gjysmë të përfunduara të çelikut
- prodhimin e produkteve të çelikut të petëzuar në të nxehtë, në të ftohtë me rryla dhe të petëzuar në formë të sheshtë
- prodhimin e kallëpeve dhe shufrave të çelikut të petëzuara në të nxehtë
- prodhimin e seksioneve të hapura të çelikut të petëzuara në të nxehtë
- prodhimin e elementeve me formë për mur çeliku dhe seksioneve të hapura të salduara prej çeliku
- prodhimin e materialeve të shinave të hekurudhës (shinave të pamontuara) prej çeliku
- prodhimin e gazit të furnaltës

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu:
---------------------	--------------------------------

- prodhimin e produkteve prej çeliku të mbështjella në formë pete të veshura ose jo të

veshura në mbështjellëse ose në gjatësi të drejta me gjerësi mbi 600 mm nëpërmjet rimbështjelljes në të ftohtë të produkteve të sheshta të mbështjella në të nxehtë ose të shufrave prej çeliku

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- telëzimin e shufrave në të ftohtë, shih 24.31

NVE Rev 2.1 kod

24.2

Përshkrim

Prodhimi i tubave, tubacioneve, profileve boshe dhe rakorderive të ngjashme prej çeliku

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

24.20

Përshkrim

Prodhimi i tubave, tubacioneve, profileve boshe dhe rakorderive të ngjashme prej çeliku

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve pa tegel me prerje tërthore rrethore dhe jo rrethore dhe të tubave të pashpuar me prerje tërthore rrethore, për përpunim të mëtejshëm me petëzim në të nxehtë, dhe shtrydhje në të nxehtë ose procese të tjerë në të nxehtë të një produkti të ndërmjetëm, që mund të jetë kallëp ose shufër e përfutur nga petëzimi në të nxehtë ose derdhja e vazhdueshme

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve pa tegel me përmasa të sakta dhe jo plotësisht të sakta nga tuba të pashpuar të petëzuar ose të telëzuar në të nxehtë përmes përpunimit të mëtejshëm, përmes telëzimit në të ftohtë ose petëzimit në të ftohtë të tubave dhe tubacioneve me prerje të tërthortë rrethore dhe përmes telëzimit në të ftohtë vetëm për tubat dhe tubacionet me prerje tërthore jo rrethore dhe profilet boshe

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve të salduar me diametër të jashtëm më të madh se 406,4 mm, të formësuar në të ftohtë nga produktet e sheshta të petëzuara në të nxehtë dhe të salduar për së gjati ose në formë spirale

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve të salduar me diametër të jashtëm prej 406,4 mm ose më të vogël me prerje tërthore rrethore me petëzim të vazhduar në të ftohtë ose në të nxehtë të produkteve të sheshta të petëzuara në të nxehtë ose në të ftohtë dhe të salduar për së gjati ose në formë spirale, dhe me prerje tërthore jo rrethore me formësim në të ftohtë ose në të nxehtë nga shirita të petëzuar rrul në të nxehtë ose në të ftohtë të salduar për së gjati

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve të salduar me përmasa të sakta me diametër 406,4 mm ose më të vogël me formësim në të ftohtë ose të nxehtë nga shirita të petëzuar dhe të salduar për së gjati, të dorëzuar të salduar ose të përpunuar më tej, me telëzim në të ftohtë ose petëzim në të ftohtë, ose të formësuar në të ftohtë për të marrë formë, për gypa dhe tuba me prerje tërthore jo rrethore

- prodhimin e flanxhave të sheshta dhe flanxhave me buzë përmes përpunimit të produkteve të çelikut të sheshta të petëzuara në të nxehtë

- prodhimin e rakorderive me saldim të thjeshtë, p.sh. bërryla dhe reduksione, përmes farkëtimit të tubave dhe tubacioneve të çelikut pa tegel të petëzuar në të nxehtë

- rakorderi të filetuara dhe të tjera çeliku për tuba dhe tubacione

Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e tubave pa tegel dhe tubave prej çeliku me derdhje centrifugale, shih 24.52
NVE Rev 2.1 kod	24.3
Përshkrim	Prodhimi i produkteve të tjera pas transformimit fillestar të çelikut
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të tjera me përpunim të ftohtë të çelikut.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	24.31
Përshkrim	Tërheqja në të ftohtë e shufrave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e shufrave, shufrave të holla dhe seksioneve të ngurta çeliku me tërheqje të ftohtë, bluarje ose përfundim të ftohtë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - tërheqjen në të ftohtë të telit, shih 24.34
NVE Rev 2.1 kod	24.32
Përshkrim	Petëzimi në të ftohtë i rripave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e produkteve prej çeliku të mbështjellë të sheshtë të veshura ose të pa veshura në mbështjellje ose në gjatësi të drejtë me gjerësi më të vogël se 600 mm me rrokullisje të ftohtë të produkteve të sheshta të petëzuara në nxehtësi ose shufra
çeliku	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e produkteve prej çeliku të mbështjellë të sheshtë të veshura ose të pa
veshura	në mbështjellje ose në gjatësi të drejtë me gjerësi më shumë se 600 mm me rrokullisje të ftohtë të produkteve të sheshta të petëzuara në nxehtësi ose shufra çeliku, shih 24.10
NVE Rev 2.1 kod	24.33

Përshkrim	Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimi i seksioneve të hapura me formim progresiv në të ftohtë në një mulli rrotullimi ose palosje në një shtypës të produkteve të mbështjellë të sheshtë prej çeliku - prodhimin e fletëve dhe paneleve sanduiç të formuar në të ftohtë ose të palosur në të ftohtë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	24.34
Përshkrim	Trafilimi në të ftohtë i telave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e telave prej çeliku, të telëzuar në të ftohtë ose tërheqjen e gypave prej çeliku
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - telëzimin e shufrave dhe seksionet e forta të çelikut, shih 24.31 - përpunimin e produkteve të telit të derivuara, shih 25.93
NVE Rev 2.1 kod	24.4
Përshkrim	Prodhimi i metaleve të çmuar dhe metaleve jo-ferrike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	24.41
Përshkrim	Prodhimi i metaleve të çmuara
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e metaleve të çmuara bazë: • prodhimi dhe rafinimi i metaleve të çmuara të papërpunuara ose të përpunuara: ari, argjendi, platini etj. nga xeherori dhe skrap - prodhimin e lidhjeve të metaleve të çmuara - prodhimin e metaleve të çmuara në formë gjysmë të përpunuar ose pluhur - veshjen e metaleve bazë me një mbulesë prej argjendi, ari ose platini, të fiksuar me saldim, brumosje, saldim, petëzimi të nxehtë ose mjete të ngjashme
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e telit të këtyre metaleve me vizatim - prodhimin e pllakave fletëve, shiritave dhe laminateve prej metali të çmuar

- rikuperimin e argjendit nga mbetjet dhe skrapet me rafinim elektrolitik
- shkrirjen dhe derdhjen e metaleve të çmuara në shufra, blloqe ose forma të ngjashme

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e bakrit, zinkut dhe metaleve të tjera me ngjyra, shih 24.54
- prodhimin e stolive të çmuara prej metali, shih 32.12

NVE Rev 2.1 kod

24.42

Përshkrim

Prodhimi i aluminit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e aluminit të papërpunuar, të aliazhuar ose jo, nga alumini ose nga mbetjet dhe skrapet e aluminit
- prodhimin e shufrave, shufrave, profileve dhe telit të aluminit
- prodhimin e tubave të aluminit, tubave, tubave dhe pajisjeve të tubave
- prodhimin e pllakave, fletëve dhe shiritave të aluminit, nëse janë apo jo të lyera, të llakuara ose të veshura me plastikë
- prodhimin e fletës së aluminit, nëse është apo jo i printuar ose i mbështetur me letër, karton, plastikë ose materiale të ngjashme mbështetëse

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e oksidit të aluminit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e aluminit dhe metaleve të tjera të lehta, shih 24.53
- copëtimin e mbetjeve dhe skrapit të aluminit, shih 38.21

NVE Rev 2.1 kod

24.43

Përshkrim

Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e plumbit, zinkut dhe kallajit të papërpunuar, të aliazhuar ose jo, nga xeherorët ose nga mbetjet dhe skrapet nga plumbi, zinku ose kallaji
- prodhimin e shufrave, shufrave, profileve, telit, pllakave, fletëve, shiritave dhe fletëve prej plumbi, zinku ose kallaji

Përfshin gjithashtu

- prodhimin e ventilatorëve të tavanit ose ventilatorëve të banjës me pajisje ndriçimi të integruara, shih 27.51
- prodhimin e pajisjeve elektrike të sinjalizimit, p.sh. semaforët dhe pajisjet për sinjalistikën e këmbësorëve, shih 27.90
- prodhimin e shenjave elektrike, shih 27.90

NVE Rev 2.1 kod

27.5

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve shtëpiake

Përfshin

Ky grup përfshin prodhimin e pajisjeve të vogla elektrike dhe pajisjeve elektrike shtëpiake, ventilatorët për banesë, fshesat me korrent për banesë, makineritë elektrike për kujdesin e dyshemesë për banesë, elektroshtëpiake gatimi për banesë, pajisje lavanderie për banesë, frigoriferë për banesë, frigoriferët ngrirës vertikalë dhe horizontalë dhe pajisje të tjera shtëpiake elektrike dhe jo elektrike, p.sh. pjatolarës, ngrohës uji, njësi për depozitimin e mbetjeve. Ky grup përfshin prodhimin e pajisjeve me burim elektrik, gaz i apo lënde tjetër të djegshme për energji.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

27.51

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve elektroshtëpiake

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve elektrike shtëpiake:

- frigoriferë
- ngrirës
- pjatolarëse
- makina larëse dhe tharëse rrobash
- fshesa me korrent
- fshesa për larjen e dyshemesë
- depozituesit e mbetjeve
- mulli, blender, shtrydhëse për lëngje
- hapëse ambalazhimesh metalike
- makinë rroje elektrike, furça dhëmbësh elektrike dhe pajisje të tjera elektrike për kujdesin personal
- mprehës thikash
- aspiratorë ajrimi ose qarkullimi

- prodhimin e pajisjeve elektrotermike shtëpiake:

- ngrohës elektrik të ujit
- batanije elektrike
- tharëse elektrike, krehër, furça, pajisje për kaçurrela
- hekur elektrik
- kaloriferë dhe ngrohëse fryrëse për banesë, të lëvizshme
- furrat elektrike
- mikrovalë
- pianura, furnela
- tostiera
- zgarë elektrike
- makineri kafe ose çaji
- enë skuqjeje, pjekjeje, aspiratorë
- rezistenca elektrike për ngrohje etj.
- ventilatorët e tavolinave, dyshemeve, mureve, dritareve, tavaneve ose çative

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e ngrohësve jo-elektrikë të hapësirës, shih 27.52
- prodhimin e frigoriferëve dhe ngrirësve tregtarë dhe industrialë, kondicionerëve

për dhoma, ventilatorëve të papafingos, ngrohësve të hapësirës me montim të përhershëm dhe ventilatorëve tregtarë të ventilimit dhe shkarkimit, pajisjeve të gatimit të tipit tregtar; pajisje për lavanderi, pastrim kimik dhe presim të tipit tregtar; fshesa me korrent tregtare, industriale dhe institucionale, shih ndarjen 28

- prodhimin e pajisjeve të ngrohjes qendrore të montuara në mënyrë të përhershme, shih 28.21

- prodhimin e makinave qepëse të tipit shtëpiak, shih 28.94

- instalimi i sistemeve qendrore të pastrimit me vakum, shih 43.24

NVE Rev 2.1 kod

27.52

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve shtëpiake jo elektrike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve shtëpiake jo elektrike për gatim dhe ngrohje:

- ngrohje hapësinore jo-elektrike, rafte gatimi, grila, soba, ngrohës uji, pajisje gatimi, ngrohës pjatash, barbekju

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kaldajave për ngrohje qendrore dhe ngrohësve diellorë të ujit, shih 28.21

NVE Rev 2.1 kod

27.9

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

27.90

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike

Përfshin

Kjo klasë përfshin prodhimin e pajisjeve të larmishme elektrike përveç motorëve, gjeneratorëve dhe transformatorëve, baterive dhe akumulatorëve, telave dhe pajisjeve për lidhjen me tela, ndriçuesve ose pajisjeve shtëpiake.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e karikuesve të baterive, me përçues elektrolit të ngurtë

- prodhimin e pajisjeve për hapjen dhe mbylljen e dymve, elektrike

- prodhimin e zileve elektrike

- prodhimin e zgjatuesve të prodhuar nga blerja e telave të izoluar

- prodhimin e makinerive të pastrimit me ultra tinguj (përveç atyre laboratorike dhe dentare)

- prodhimin e shtretërve për rrezatime (shtretër ku bëhet solar, shtretër për nxirje)

- prodhimin e qelizave të energjisë, furnizim i normuar ose i panormuar me energji elektrike

- prodhimin e furnizuesve të pandërprerë të energjisë elektrike (UPS)

- prodhimin e mbrojtësve nga luhatja e tensionit (përveç për nivelin e tensionit në shpërndarje)

- prodhimin e kablllove për pajisjet elektrike, zgjatuesve dhe kablllove të tjera elektrike me tela të izoluar dhe lidhës

- prodhimin e elektrodave prej karboni dhe grafiti, kontakteve dhe produkteve të tjera të elektrodave prej karboni dhe grafiti
- prodhimin e përshpejtuesve të grimcave
- prodhimin e kondensatorëve, rezistencave, kondensatorëve dhe përbërësve të Ngjashëm
- prodhimin e elektromagneteve
- prodhimin e sirenave
- prodhimin e tabelave elektronike të pikëzimit
- prodhimin e sinjalistikës elektrike
- prodhimin e pajisjeve të sinjalistikës elektrike (p.sh. semaforët, pajisjet e sinjalistikës për këmbësorët)
- prodhimin e izoluesve elektrikë (përveç atyre prej xhami ose porcelani)
- prodhimin e pajisjeve elektrike për saldim dhe ngjitje, përfshirë elektrodën e dorës për ngjitje
- prodhimin e makinerive të elektrogalvanizimit
- prodhimin e karikuesve për mjete motorike që vendosen në mjet
- prodhimin e kablove të montuara të plotësuar me lidhës
- prodhimin e stacioneve të karikimit për automjete

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e izolatorëve elektrikë prej qelqi, shih 23.15
- prodhimin e izolatorëve elektrikë prej porcelani, shih 23.43
- prodhimin e fibrave dhe produkteve të karbonit dhe grafitit (përveç elektrodave dhe pajisjeve elektrike), shih 23.99
- prodhimin e rafinuesve të tipit përbërës elektronikë, qarqeve të integruara rregulluese të tensionit, qarqeve të integruara të konvertimit të fuqisë, kondensatorëve elektronikë, rezistorëve elektronikë dhe pajisjeve të ngjashme, shih 26.11
- prodhimin e qelizave fotovoltaike, moduleve dhe paneleve, shih 26.11
- prodhimin e transformatorëve, motorëve, gjeneratorëve, stabilimenteve, releve dhe kontrolleve industriale, shih 27.1
- prodhimin e baterive, shih 27.20
- prodhimin e telave të komunikimit dhe energjisë, pajisjeve të instalimeve elektrike me rrymë dhe pa rrymë, shih 27.3
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit, shih 27.40
- prodhimi i pajisjeve shtëpiake, shih 27.5
- prodhimi i pajisjeve të saldimit jo-elektrike, shih 28.29
- prodhimi i pajisjeve elektrike të mjeteve motorike, p.sh. gjeneratorë, alternatorë (transformatorë), kandela, instalime elektrike të ndezjes, sisteme elektrike të dritareve dhe dyerve, rregullatorë të tensionit, shih 29.31
- prodhimi i moduleve të inverterit dhe qelizave të karburantit për makina, shih 29.31

Përshkrim

Prodhim i makinerive dhe pajisjeve p.k.t

Përfshin

Kjo ndarje përfshin prodhimin e makinerive dhe pajisjeve që veprojnë në mënyrë të pavarur mbi materialet, qoftë mekanikisht ose termikisht, ose plotësojnë operacione mbi materialet (p.sh. trajtimi (lëvizja), spërkatja, peshimi ose paketimi), duke përfshirë pjesët e tyre mekanike që prodhojnë dhe ushtrojnë forcë dhe çdo pjesë primare të prodhuar posaçërisht. Kjo përfshin prodhimin e pajisjeve fikse dhe të lëvizshme të dorës, pavarësisht nëse ato janë të projektuar për përdorim industrial, ndërtimor dhe punime inxhinierike, bujqësi ose përdorim shtëpiak. Brenda kësaj ndarje bën pjesë edhe prodhimi i pajisjeve speciale për transportin e pasagjerëve ose mallrave brenda kufijve të përcaktuara. Kjo ndarje bën dallimin ndërmjet prodhimit të makinerive për qëllime të veçanta, pra makinerive për përdorim të veçantë në një aktivitet të NVE-së apo një grupit të vogël aktiviteteve, dhe makinerive me përdorim të përgjithshëm, si makineri që përdoren në një diapazon më të gjerë të industrive të klasifikimit.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu prodhimin e makinerive të tjera për qëllime të veçanta, që nuk përfshihen diku tjetër në klasifikim, pavarësisht nëse përdoren apo jo në procesin e prodhimit, p.sh. pajisje argëtimi në panair, pajisje automatike për bowling (lojë me birila).

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin prodhimin e produkteve metalike për përdorim të përgjithshëm (ndarja 25), pajisjet shoqëruese të kontrollit, pajisjet kompjuterike, pajisjet e matjes dhe testimit, aparatet e shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike (ndarjet 26 dhe 27) dhe mjeteve motorike për qëllime të përgjithshme (ndarja 29).

Përshkrim

Prodhim i makinerive për përdorim të përgjithshëm

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Përshkrim

Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të avionëve, automjeteve dhe motoçikletave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e motorëve me djegie të brendshme, përveç motorëve për mjete ajrore, automjete dhe motoçikleta:
 - motorë për flota detare
 - motorët për mjete të transportit hekurudhor
- prodhimi i pjesëve të përshtatshme për përdorim vetëm ose kryesisht me motorët me djegie të brendshme, p.sh. pistona, unaza pistoni, karburatorë dhe të tilla për motorët me djegie të brendshme, motorët me naftë, me përjashtim të mjeteve motorike
- prodhimin e valvulave të hyrjes dhe daljes të motorëve me djegie të brendshme
- prodhimin e turbinave dhe pjesëve të tyre:
 - turbina me avull dhe tipe të tjera me avull
 - turbina hidraulike, rrotat hidraulike dhe rregullatorët e tyre
 - turbina dhe mullinjtë e erës
 - turbina me gaz, përveç turboreaktorëve apo helikave me turbo për shtytjen e mjeteve fluturuese
- prodhimin e turbinave me ujë të ngrohte
- prodhimin e grupeve të gjeneratorëve të turbinave, të përbërë nga një turbinë dhe një gjenerator të montuar së bashku
- prodhimin e motorëve për zbatime industriale
- kontroll i përgjithshëm i fabrikave të motorëve të anijeve dhe varkave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e gjeneratorëve elektrikë (përveç turbinave gjenerator), shih 27.11
- prodhimin e gjeneratorëve me motor parësor (përveç gjeneratorëve të turbinave), shih 27.11
- prodhimin e pjesëve të motorëve me djegie të mjeteve motorike, shih 29.10
- prodhimin e pajisjeve dhe komponentëve elektrikë të motorëve me piston me djegie të brendshme për mjetet motorike, shih 29.3
- prodhimin e pistonëve, unazave të pistonit dhe karburatorëve për automjete, shih 29.32
- prodhimin e motorëve me piston me djegie të brendshme për avionë, shih 30.3
- prodhimin e motorëve të mjeteve ajrore, motorëve turboreaktivë dhe motorëve me turbohelikë, shih 30.31, 30.32
- prodhimin e motorëve shtytës të motoçikletave, shih 30.91
- prodhimi i pistonëve, unazave të pistonit dhe karburatorëve për motoçikleta, shih 30.91

NVE Rev 2.1 kod	28.12
Përshkrim	Prodhimi i pajisjeve me fuqi hidraulike ose pneumatike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e motorëve me fuqi hidraulike dhe pneumatike, cilindrave dhe valvulave - prodhimin e sistemeve hidraulike të energjisë fluide - prodhimin e pajisjeve të transmisionit hidraulik- prodhimin e transmetimit hidrostatik
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e gypave, tubave dhe profileve hidraulikë ose pneumatikë prej gome, shih 22.12 - prodhimin e gypave, tubave dhe profileve hidraulikë ose pneumatikë prej plastike, shih 22.21 - prodhimin e kompresorëve, shih 28.13 - prodhimin e pompave të ndryshme nga pompat e energjisë me lëng hidraulik, shih 28.13 - prodhimin e valvulave për aplikime të energjisë jo të lëngshme, shih 28.14 -prodhimin e pajisjeve mekanike të transmetimit të energjisë, shih 28.15
NVE Rev 2.1 kod	28.13
Përshkrim	Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e pompave me ajër ose vakum, kompresorëve të ajrit ose të gazeve të tjera - prodhimin e pompave për lëngje, me ose pa pajisje matëse - prodhimin e pompave për motorët me djegie të brendshme, p.sh. pompa vaji, uji dhe karburanti për mjetet motorike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e pompave të dorës
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: -prodhimi i pompave të fuqisë së lëngjeve hidraulike, shih 28.12
NVE Rev 2.1 kod	28.14
Përshkrim	Prodhimi i saraçineskave dhe valvulave të tjera
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e saraçineskave dhe valvulave industriale, përfshirë valvulat rregullatore dhe saraçineskat hyrëse - prodhimin e saraçineskave dhe valvulave për pajisjet sanitare - prodhimin e saraçineskave dhe valvulave për radiatorët e ngrohjes qendrore
Përfshin gjithashtu	

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e valvulave prej gome të pavullkanizuar të paforcuar, prej materialesh qelqi ose qeramike, shih 22.12, 23.15 ose 23.44
- prodhimin e valvolave hyrëse dhe dalëse të motorëve me djegie të brendshme, shih 28.11
- prodhimin e valvolave për pajisje transmisioni hidraulik ose pneumatik dhe pajisjet e përgatitjes së ajrit për përdorim në sistemet pneumatike, shih 28.12

NVE Rev 2.1 kod

28.15

Përshkrim

Prodhimi i kuzhinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementeve të drejtimit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kuzhinetave me zare dhe rrul dhe pjesëve të tyre
- prodhimin e pajisjeve të transmisionit të fuqisë mekanike, p.sh.:
 - boshte transmisioni, përfshirë boshtin motorik, boshtin me gunga dhe manivelat
 - shasitë e kuzhinetave dhe kuzhinetat me bosht të rrafshët
- prodhimin e ingranazheve, grupeve të ingranazheve, kutive të ingranazheve dhe ndryshuesve të tjerë të shpejtësisë
- prodhimin e friksioneve dhe aktivizuesve të friksioneve
- prodhimin e volantëve dhe makarave (pulexhave)
- prodhimin e zinxhirëve me unaza të artikuluara
- prodhimin e zinxhirëve të transmisionit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e zinxhirëve të tjerë, shih 25.93
- prodhimin e pajisjeve të transmisionit hidraulik, shih 28.12
- prodhimin e transmisioneve hidrostatike, shih 28.12
- prodhimin e friksioneve për mjete motorike, shih 29.31
- prodhimin e ingranazheve, kutive të ingranazheve dhe pjesëve të tyre për mjete motorike, shih 29.32
- prodhimin e nëngrupeve të pajisjeve të transmetimit të energjisë, të cilat janë të përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me mjete motorike ose mjete ajrore, shih ndarjet 29, 30

NVE Rev 2.1 kod

28.2

Përshkrim

Prodhimi i makinerive të tjera për përdorim të përgjithshëm

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	28.21
Përshkrim	Prodhimi i furrave, furnaltave dhe pajisje të përhershme për ngrohje shtëpiake
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e furrave dhe furnaltave elektrike dhe furrave të tjera laboratorike dhe industriale, duke përfshirë inceneratorët - prodhimin e vatrave të furnaltave - prodhimin e kaldajave të ngrohjes qendrore, kaldajave të ujit me energji diellore dhe pajisjeve të ngjashme - prodhimin e pajisjeve për ftohjen dhe ventilimin e banesave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e furrave mekanike, të mjeteve për largimin e plehrave etj. - prodhimi i pompave të nxehtësisë përgjithësisht të pakthyeshme (që punojnë vetëm në një drejtim), të përdorura kryesisht për ngrohjen e hapësirave ose për furnizimin me ujë të nxehtë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e furrave elektrike për përdorim shtëpiak, shih 27.51 - prodhimin ventilatorëve të tavolinës, dyshemesë, murit, dritares, tavanit ose çatisë, shih 27.51 - prodhimin e tharësve për produktet bujqësore, shih 28.93 - prodhimin e furrave të pjekjes, shih 28.93 - prodhimin e makinave tharëse për drurin, brumin e letrës, letrës ose kartonit, shih 28.99 - prodhimin e sterilizatorëve mjekësorë, kirurgjikalë ose laboratorikë, shih 32.50 - prodhimin e furrave laboratorike (dentare), shih 32.50

NVE Rev 2.1 kod	28.22
Përshkrim	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e makinerive ngritëse, zhvendosëse, ngarkuese dhe shkarkuese, me fuqi krahë ose energji, p.sh.: • çikrik dhe litarët përkatës, argano, argano vertikale dhe krik • vinça me krahë të rrotullueshëm, vinça, vinça urë, transportues me vinç nën shasi • karroca pune të pajisura ose jo me pajisje për ngritje dhe zhvendosje, me ose pa shtytje vetjake, të tipit që përdoren në fabrika (përfshirë karrocet me rrota dhe karrocet e dorës) • manipulatorë mekanikë dhe robotët industrialë të projektuar posaçërisht për ngritje, manipulim, ngarkim dhe shkarkim • prodhimi i pirunëve pa pilot dhe robotikë dhe ngarkues/shkarkues paletash - prodhimin e shiritave transportues, teleferikëve, etj. - prodhimin e ashensorëve, shkallëve lëvizëse dhe vendkalimeve lëvizëse - prodhimin e pjesëve të specializuara për ashensorë dhe pajisje zhvendosëse
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e pajisjeve automatike të ngritjes dhe zhvendosjes për magazina
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e makinerive për sera vertikale, shih 28.30

- prodhimin e ashensorëve dhe transportuesve me veprim të vazhdueshëm për përdorim nëntokësor, shih 28.92
- prodhimin e lopatave mekanike, ekskavatorëve dhe kovave të ekskavatorëve, shih 28.92
- prodhimin e robotëve industrialë për përdorime të shumëfishta, shih 28.99
- prodhimin e autovinçave, vinçave lundrues, vinçave të shinave hekurudhore, shih 29.10,30.11, 30.20
- instalimin e pajisjeve ngritëse dhe ashensorëve, shih 43.24

NVE Rev 2.1 kod

28.23

Përshkrim

Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve të zyrës, përveç kompjuterëve dhe pjesëve periferike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinave të mbledhje zbritjes- prodhimin e kasave të parave
- prodhimin e makinave llogaritëse
- prodhimin e makinave për vulosjen me pullë të postës, makineri për trajtimin e postës (makineri për mbushjen, mbylljen dhe vendosjen e adresës në zarf; makineri për hapje, kategorizim, skanim)
- prodhimin e makinave të shkrimit dhe stenografisë
- prodhimin e pajisjeve për lidhjen e shkresave (pra, lidhje me plastikë ose shirit)
- prodhimin e makinave për ndarjen, numërimin dhe mbështjelljen e monedhave
- prodhimin e mprehësve të lapsave
- prodhimin e makinave për kapjen e letrës
- prodhimin e makinave të votimit
- prodhimin e mbajtëseve të skoçit
- prodhimin e hapëseve të brimave
- prodhimin e makinave të fotokopjimit
- prodhimin e dërrasave të zeza; dërrasave të bardha dhe dërrasave për lapustila me sipërfaqe shkrimi ose vizatimi
- prodhimin e makinave të diktimit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e mprehësve të lapsave, shih 25.61
- prodhimin e kompjuterëve dhe pajisjeve periferike, shih 26.20

NVE Rev 2.1 kod

28.24

Përshkrim

Prodhimi i veglave të dorës me motor

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e veglave portative, me motor elektrik ose jo- elektrik ose drejtues pneumatik, p.sh:
 - sharra qarkulluese dhe me lëvizje vajtje - ardhje
 - sharrë elektrike
 - trapan dhe trapan me çekiç
 - smerilues dore elektrik
 - gozhdues pneumatik
 - rashinues
 - freza vertikale
 - fresibël
 - kapëse dokumentesh
 - pistoleta pneumatike perçinash

- zdrukth
- gërshërë dhe prerës metali
- pistoletë impakti pneumatike
- gozhdues të aktivizuar plasje

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të dorës dhe pjesëve të këmbyeshme për veglat pneumatike dhe me fuqi, shih 25.63
- prodhimin e makinave dhe aparateve elektrike për saldim dhe kallajisje, shih 27.90

NVE Rev 2.1 kod

28.25

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve jo shtëpiake të ajrit të kondicionuar

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve jo shtëpiake të ftohjes ose ngrirjes
- prodhimin e makinerive të ajrit të kondicionuar përveç atyre për mjetet motorike
- prodhimin e ventilatorëve jo shtëpiake
- prodhimin e njësive të shkëmbimit të nxehtësisë
- prodhimin e makinerive për lëngëzimin e ajrit ose gazeve të tjera
- prodhimin e ventilatorëve për ajrimin e papafingove, p.sh. ventilatorët aspirues, ventilatorët e çatisë
- prodhimin e avulluesve dhe kondensatorëve për frigoriferët jo shtëpiake

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e pompave të kthyeshme të nxehtësisë që kanë një ventilator të motorizuar dhe pajisjet për ndryshimin e temperaturës dhe lagështisë së ajrit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pajisjeve shtëpiake të ftohjes ose ngrirjes, shih 27.51
- prodhimin e ventilatorëve shtëpiake, shih 27.51
- prodhimin e pajisjeve për ftohjen e shtëpisë, shih 28.21
- prodhimin e makinave të ajrit të kondicionuar për mjetet motorike, shih 29.32

Përshkrim

Prodhimi i makinerive të tjera për përdorim të përgjithshëm p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive të peshimit (përveç peshoreve të ndjeshme të laboratorëve), duke përfshirë makinat e numërimit ose kontrollit të peshave, p.sh. peshoret shtëpiake ose të dyqaneve, peshoret me platformë, peshoret për peshim të vazhdueshëm, platformave të peshimit, makineritë e peshimit
- prodhimin e makinerive dhe aparaturave për filtrim dhe pastrim për lëngje, p.sh. për naftë, karburant
- prodhimin e pajisjeve për përhapjen, shpërhapjen ose spërkatjen e lëngjeve dhe pluhurave:
 - pistoletat e spërkatjes, fikset e zjarrit, makineritë për pastrimin e rërës, makineritë për pastrimin e etj.
- prodhimin e makinerive për ambalazhim dhe paketim:
 - makineri mbushje, mbyllje, ngjitje, mbështjellje ose etiketimi, etj.
- prodhimin e makinerive të pastrimit (duke përfshirë pjatlarëset) për përdorim jo shtëpiak
- prodhimin e makinerive për pastrimin ose tharjen e shisheve dhe për ajrimin e pijeve
- prodhimin e impianteve të distilimit ose purifikimit për rafineritë e naftës, industritë kimike, industritë e pijeve, etj.
- prodhimin e gjeneratorëve me gaz
- prodhimin e makinave kalendarike ose të tjera me cilindra dhe cilindrato e tyre (përveç për metal dhe qelq)
- prodhimin e centrifugave, përfshirë tharëset me centrifugë (përveç ndarësve të ajkës, tharësve të rrobave dhe centrifugave që përdoren në laboratorë)
- prodhimin e rondevave dhe të ngjashme të llamarinës metalike të kombinuara me materiale të tjera ose prej dy ose më shumë shtresash metali
- prodhimin e makinerive automatike të shitjes së mallrave
- prodhimin e niveleve, metrave shirit dhe veglave të ngjashme të dorës, veglat e sakta të mekanikut (përveç atyre optike)
- prodhimin e makinerive dhe aparateve jo-elektrike për ngjitje dhe saldim
- prodhimin e kullave ftohëse dhe objekteve të ngjashme për ftohje të drejtpërdrejtë përmes qarkullimit të ujit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rondevave prej gome të vullkanizuar, shih 22.12
- prodhimin e peshoreve të ndjeshme (të tipit laboratorik), shih 26.51
- prodhimin e pajisjeve shtëpiake të ftohjes ose ngrirjes, shih 27.51
- prodhimin e ventilatorëve shtëpiakë, shih 27.51
- prodhimin e pajisjeve elektrike për saldim dhe kallajisje, shih 27.90
- prodhimin e pajisjeve spërkatëse për bujqësinë ose hortikulturën, shih 28.30
- prodhimin e makinerive të kompresimit prej metali ose qelqi, dhe të cilindrave të tyre, shih 28.91, 28.99
- prodhimin e tharësve për produktet bujqësore, shih 28.93
- prodhimin e makinerive për filtrimin ose pastrimin e ushqimeve dhe pijeve, shih 28.93
- prodhimin e ndarësve të kremit, shih 28.93
- prodhimin e tharësve tregtarë të veshjeve, shih 28.94
- prodhimin e makinerive të printimit për printimin e materialeve tekstile, shih 28.94
- prodhimin e centrifugave të atij lloji që përdoren në laboratorë shih 32.50

NVE Rev 2.1 kod	28.3
Përshkrim	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	28.30
Përshkrim	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e traktorëve bujqësorë dhe pyjorë - prodhimin e traktorëve për shënjimin e rreshtave- prodhimin e traktorëve të dorës (drejtuar nga këmbësori) - prodhimin e kositësve, duke përfshirë makinën kositëse të barit - prodhimin e rimorkiove ose gjysmërimorkiove vetëngarkuese ose vetëshkarkuese për qëllime bujqësore - prodhimin e makinerive bujqësore për përgatitjen ose kultivimin e tokës, p.sh.: • plugje, lesa, shpërndarës plehu organik, farëhedhës, shpërndarës plehu, etj. - prodhimin e makinerive të korrjes dhe shirjes, p.sh.: • korrëset, shirëset, ndarësit, etj. - prodhimin e makinave të mjeljes - prodhimin e pajisjeve spërkatëse për bujqësinë ose hortikulturën - prodhimin e makinerive të ndryshme për bujqësinë, p.sh.: • makineri për rritjen e shpendëve, makineri për rritjen e bletëve, pajisje për përgatitjen e foragjereve etj. • makina për pastrimin, seleksionimin ose shkallëzimin e vezëve, frutave etj. - prodhimin e makinerive për bujqësinë vertikale

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e veglave të dorës pa motor të një lloji të përdorur në bujqësi, hortikulturë ose pylltari, shih 25.63 - prodhimin e transportuesëve për përdorim në fermë, shih 28.22 - prodhimin e veglave të dorës me motor, shih 28.24 - prodhimin e makinerive transportuese të dheut, shih 28.92 - prodhimin e ndarësve prej kremi, shih 28.93 - prodhimin e makinerive për të pastruar, ndarë ose selektuar farat, drithërat ose perimet e thara bishtajore, shih 28.93 - prodhimin e traktorëve për gjysmërimorkiot, shih 29.10 - prodhimin e rimorkiove ose gjysmërimorkiove për qëllime jobujqësore, shih 29.20
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod

28.4

Përshkrim

Prodhimi i makinerive dhe instrumentave për punimin e metaleve

Përfshin

Ky grup përfshin makineritë dhe instrumentat për punimin e metaleve si prodhimin e instrumentave për punimin e metaleve dhe materialeve të tjera (dru, kockë, gurrë, plastik i fortë, kauçuk i fortë, qelq i ftohtë etj) duke përfshirë këtu edhe makineritë që punojnë me rreze lazer, valë me ultra tinguj, harqe plazme, impulse magnetike.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

28.41

Përshkrim

Prodhimi i makinerive dhe instrumentave për punimin e metaleve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e instrumentave të makinerive për punimin e metaleve, përfshirë ato që përdorin rreze lazer, valë me ultra tinguj, harqe plazma, impulse magnetike, etj.
- prodhimin e instrumentave për makineri për tornimin, shpimin me trapan, shpimin, filetimin, ose shpimin e brimave të filetuara
- prodhimin e instrumentave për makineri për lëmimin, mprehjen, retifikim, hapje të diametrit të brendshëm, smerilim, luçidim, ose përfundimet e tjera të metalit ose cermetit me anë të gurëve smerilues, produkteve abrazive ose luçiduese.
- prodhimin e makinerive të automatizuara me shumë funksione për punimin e metalit
- prodhimin e instrumentave të makinerive për formësimin, formimin, vendosjen, prerjen në disnivel, prerjen e ingranazheve, retifikimin e detaleve ose përfundimin e ingranazheve, sharrimin, prerjen, dhe të veglave të tjera të makinerive që punojnë duke hequr metalin ose çimenton
- prodhimin e instrumentave të makinerive të stampimit dhe presimit të metalit
- prodhimin e presave me goditje, atyre hidraulik, frenave hidraulike, çekiçëve të presave, makinerive farkëtuese, etj.
- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për instrumentat që shërbejnë për punimin e telave
- prodhimin e bankave të telëzimit, makinerive të petëzimit të fijeve për punimin e telave
- prodhimin e makinerive të mbushjes, ribatinave, prerëseve të llamarinës

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e instrumentave të këmbyeshme, shih 25.63
- prodhimin e makinerive dhe aparateve elektrike për saldim dhe kallajisje, shih 27.90
- prodhimin e makinerive për prodhimin e aditivëve, shih 28.97

NVE Rev 2.1 kod	28.42
Përshkrim	Prodhimi i instrumentave të tjerë p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e makinerive për punimin e drurit, tapës, kockës, gurit, kauçukut, plastikës së fortë, qeramikës, betonit, qelqit të ftohtë ose materialeve të forta jo-metalike - prodhimin e bankove të punës për instrumentat - prodhimin e kokave ndarëse dhe pjesë të tjera speciale që i bashkëngjiten për instrumentat - prodhimin e makinerive të palëvizshme për gozhdimin, nguljen, ngjitjen ose montimin e drurit, zunkthit, kockës, kauçukut ose plastikës së fortë etj. - prodhimin e trapanëve ose trapanëve me goditje të palëvizshëm, etj. - prodhimin e presave për prodhimin e rrasave me ashkla, etj.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për instrumentet e listuara të makinerive
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e instrumentave të këmbyeshme me instrumenta, p.sh. trapan, shpuese, stampë, filetuese, prerëse bluarëse, torno, brisqe, thika, shih 25.63 - prodhimin e havive dhe pajisjeve elektrike të dorës për saldim, shih 27.90 - prodhimin e veglave të dorës me motor, shih 28.24 - prodhimin e makinerive mbushëse, ribatinave, prerësve të fletëve, shih 28.41 - prodhimin e makinerive që përdoren në uzinat ose fonderitë e metaleve, shih 28.91 - prodhimin e makinave për miniera dhe gurore, shih 28.92 - prodhimin e makinave për prodhimin e aditivëve, shih 28.97

NVE Rev 2.1 kod	28.9
Përshkrim	Prodhimi i makinerive të tjera për përdorim specifik
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e makinerive për qëllime të veçanta, pra makinerive për përdorim ekskluziv në një industri të kategorizuar në NVE ose një grup të vogël industrish të kategorizuara në NVE.
Përfshin gjithashtu	Duke qenë se këto makineri për përdorime specifike përdoren në procese të tjera prodhim, p.sh. në prodhimin e ushqimit ose tekstileve, ky grup përfshin edhe prodhimin e makinerive specifike për përdorime të tjera (industri joproduhuese), p.sh. pajime për lëshimin e mjeteve ajrore ose pajisje për parqe zbavitjeje
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	28.91
Përshkrim	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e makinave dhe pajisjeve për trajtimin në të nxehtë të metaleve, p.sh. kthimet, kallëpet e lingotave, kupave dhe makineri derdhjeje të një lloji të përdorur në metalurgji ose në shkrirjen e metaleve - prodhimin e makinerive për petëzimin e metalit dhe të rrulave për këto makineri
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e kutive të kallëpeve dhe kallëpet (përveç kallëpet e lingotave) shih 25.63 - prodhimin e makinave të telëzimit, shih 28.41 - prodhimin e makinave për formimin e kallëpeve të fonderisë, shih 28.99
NVE Rev 2.1 kod	28.92
Përshkrim	Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e ashensorëve dhe transportueseve me veprim të vazhdueshëm për mallra dhe materiale, për përdorim nëntokësor - prodhimin e makinerive të shpimit, prerjes ose hapjes së puseve për shpimin e dheut dhe nxjerrjen e mineraleve ose xeherorëve ose qymyrit, ose makinerive që presin gur dhe hapin tunele - prodhimin e makinerive për trajtimin e mineraleve përmes sitjes, kategorizimit, ndarjes, larjes, thërrmimit, bluarjes, përzierjes ose rrahjes së dheut, gurit, xeherorëve dhe lëndëve të tjera minerare, në formë të ngurtë (përfshirë pluhur ose pastë). - prodhimin e përziersëve të betonit dhe llaçit - prodhimin e makinerive transportuese të dheut • buldozerë, buldozerë me thikë këndore, pjerrësues, gërryerës, niveluese, fadroma me kovë përpara, fadroma me kovë edhe prapa etj. - prodhimin e makinave për ngulje dhe nxjerrjen pilotave, shtrueseve të llaçit, hedhësve të bitumit, makinerive të sipërfaqes së betonit, etj. - prodhimin e makinave për përzierjen e lëndëve minerare me bitum - prodhimin e ekskavatorëve për vendosjen e binarëve - prodhimin e thikave të buldozerit - prodhimin e kamionëve shkarkues për terrene të vështira - prodhimin e makinerive borë pastruese
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e pajisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes, shih 28.22 - prodhimin e traktorëve të tjerë, shih 28.30, 29.10 - prodhimin e mjeteve të makinerive për punimin e gurit duke përfshirë makinat për ndarjen dhe pastrimin e gurëve, shih 28.42 - prodhimin e betonierëve, shih 29.20

Përshkrim

Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tharëseve për produkte bujqësore
- prodhimin e makinerive për industrinë e qumështit, p.sh.:
 - skremuese
 - makineri për përpunimin e qumështit, p.sh. homogjenizuesit
 - makineri për konvertimin e qumështit, p.sh. përzierje gjalpi, punuese gjalpi dhe makineri për nxjerrjen e gjalpiti
 - makineri për prodhimin e djathit, p.sh. homogjenizues, formues, shtypës
- prodhimin e makinerive për përpunimin e drithërave, p.sh.:
 - makineri për pastrimin, ndarjen ose kategorizimin e farave, drithërave ose perimeve të thata bishtajore, p.sh. shoshës, rripa sitjeje, ndarës, makineri për pastrimin e drithërave
 - makineri për prodhimin e miellit të grurit, miellit të misrit etj., p.sh. mullinj bluarjeje, përzierës, shoshitës, pastrues krundesh, qërues orizi, qërues bizelesh
- prodhimin e presave, shtypësve etj., p.sh. për prodhimin e verës, mushtit, lëngjeve të frutave
- prodhimin e makinerive për industrinë e pjekjes në furra ose për prodhimin e makaronave, spagetit dhe produkteve të ngjashme, p.sh.:
 - furrat e bukës, përzierësit e brumit, ndarësit e brumit, prerëset në feta, makineri për përgatitjen e kekut
- prodhimin e makinerive dhe pajisjeve për përpunimin e ushqimeve të ndryshme, p.sh.:
 - makineri për prodhimin e ëmbëlsirave, kakaos ose çokollatës; për përpunimin e sheqerit; për fabrikat e birrës; për përpunimin e mishit ose mishit të shpendëve, për përgatitjen e frutave, frutave të thata ose perimeve; për përgatitjen e peshkut, frutave të detit dhe produkteve të tjera ujore
 - makineri të tjera për përgatitjen ose prodhimin industrial të ushqimit dhe pijeve
- prodhimin e makinerive për filtrimin ose pastrimin e ushqimeve dhe pijeve
- prodhimin e makinerive për nxjerrjen ose përgatitjen e vajit dhe yndyrnave shtazore ose bimore
- prodhimin e makinerive për përgatitjen e duhanit dhe për prodhimin e cigareve ose purove, ose për llullën ose duhanin për përtypje ose nuhatje
- prodhimin e makinerive, impianteve dhe pajisjeve për gatimin ose ngrohjen e ushqimeve në hotele dhe restorante

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pajisjeve me rrezatim për frutat dhe qumështin, shih 26.60
- prodhimin e makinerive për paketim, ambalazhim dhe peshim, shih 28.29
- prodhimin e makinerive për pastrim, seleksionim ose ndarjen e vezëve, frutave dhe produkte të tjera bujqësore (përveç farave, drithërave dhe perimeve bishtajore të thata), shih 28.30

Përshkrim

Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurës

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për tekstile, p.sh.:
 - makina për përgatitjen, prodhimin, nxjerrjen, skicimin, endjen ose prerjen e fibrave, materialeve ose fijeve tekstile sintetike
 - makineri për përgatitjen e fibrave të tekstilit, p.sh.: zhveshëse pambuku, zbërthyes dengu, pastrues, përhapës pambuku, përvëlues leshi, karbonizues leshi, krehra, drejtues, tjerres
 - makineri tjerresë
 - makineri për përgatitjen e fijeve të tekstilit, p.sh.: mbledhës dhe tezgjah dhe makineri të lidhura me to
 - makineri thurjeje, përfshirë tezgjahët e dorës
 - makina prerëse
 - makineritë për prodhimin e rrjetës me nyje, tylit, dantellës, thurjeve gërshet, etj.
- prodhimin e makinerive ose pajisjeve ndihmëse për makineritë e tekstilit:
 - karreta, makina zhakard, ndalesat automatike, mekanizmat e ndryshmit të drugës, bosht dhe makinë tjerreje me rrotë, etj.
- prodhimin e makinerive për printimin e tekstilit
- prodhimin e makinerive për përpunimin e pëlhurave:
 - makineri për larjen, zbardhjen, ngjyrosjen, përgatitjen, përfundimin, veshjen ose nginjen e copave me fibër
 - prodhimin e makinerive për mbledhjen në top, palosjen, prerjen ose prerjen me zik-zak të fundit të copave tekstile- prodhimi i makinerive të lavanderisë:
 - makinat për hekurosje, duke përfshirë këtu dhe presimin
 - lavatriçe dhe tharëse rrobash industriale
 - makinat e pastrimi kimik
- prodhimin e makinave qepëse, kokave të makinave qepëse dhe gjilpërave të makinave qepëse (qoftë për përdorim shtëpiak ose jo)
- prodhimin e makinerive për prodhimin ose përfundimin e shajakut ose të materialeve jo të endura
- prodhimin e makinave për prodhimin e lëkurës:
 - makineritë për përgatitjen, regjien ose punimin e lëkurëve ose lëkurës
 - makineritë për prodhimin e riparimin e këpucëve dhe artikujve të tjerë prej lëkure ose lëkure me gëzof

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kartave prej letre ose kartoni për përdorim me makinerinë zhakard, , shih 17.25
- prodhimin e makinave shtëpiake larëse dhe tharëse, shih 27.51
- prodhimin e makinave të kalandrimit, shih 28.29
- prodhimin e makinave që përdoren në lidhjen e librave, shih 28.99

Përshkrim

Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe kartonit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për prodhimin e brumit të letrës

- prodhimin e makinerive për prodhimin ose përfundimin e letrës dhe kartonit
- prodhimin e makinerive për prodhimin e artikujve të brumit të letrës, letrës ose kartonit, përfshirë makineritë prerëse për letrën e të gjitha llojeve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 28.96

Përshkrim Prodhami i makinerive për plastikën dhe gomën

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për prodhimin e gomës së butë ose plastikës për prodhimin e produkteve prej këtyre materialeve:
 - makineri derdhjeje, formësimi në kallëpe, prodhimin dhe ribërjen e gomave dhe makineri të tjera për prodhimin e produkteve të veçanta prej gome ose plastike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e makinerive për prodhimin e aditivëve, shih 28.97

NVE Rev 2.1 kod 28.97

Përshkrim Prodhami i makinerive të prodhimit të aditivëve

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për prodhimin e aditivëve nga metali, plastika, goma, gipsi, çimentoja, depozitimi i qeramikës, etj.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 28.99

Përshkrim Prodhami i makinerive të tjera për përdorim specifik p.k.t

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për tharjen e drurit, brumin e letrës, letrës dhe kartonit dhe materialeve të tjera (përveç produkteve bujqësore e tekstile)
- prodhimin e makinerive për shtypjen dhe libërlidhjen dhe makina për aktivitete ndihmëse në shtypje prej materialeve të ndryshme
- prodhimin e makinerive për prodhimin e pllakave, tullave, pastave qeramike me formë, elektrodave prej grafiti, shkumësit për dërrasë të zezë, etj.
- prodhimin e makinerive për përpunimin e gjysmëpërcjellësve
- prodhimin e robotëve industrial e robotëve industrialë që kryejnë detyra të shumta për qëllime të veçanta
- prodhimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme, p.sh.:
 - makina për montimin e abazhurëve, gypave (valvulave) ose llambave elektrike dhe elektronike
 - makinat për prodhimin ose punimin në të nxehtë të qelqit ose produkteve të qelqit, fibrave ose fijos së qelqit
 - prodhimin e aparateve për ndarjen e izotopeve
- prodhimin e pajisjeve për konvergjencën dhe balancimin e gomave; pajisjet e

balancimit (përveç balancimit të rrotave)

- prodhimin e sistemeve qendrore të grasatimit
- prodhimin e pajisjeve të lëshimit të mjeteve ajrore, katapultave të aeroplanmbajtësve dhe pajisjeve të ngjashme
- prodhimin e pajisjeve automatike të sallave të bowling-ut (lojë me birila), p.sh. vendosësit e birilave
- prodhimin e rrotullameve, shilarësve, galerive të qitjes dhe lojërave të tjera të parqeve të argëtimit
- prodhimin e makinave për shtypjen e mbetjeve
- prodhimin e makinave të suvatimit
- prodhimin e lejekalimeve rrotulluese
- prodhimin e sistemeve të mbledhjes së velave, që përdoren për mbledhjen ose shpalosjen e mekanizmave të velave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pajisjeve shtëpiake, shih 27.5
- prodhimin e makinave fotokopjuese etj., shih 28.23
- prodhimin e makinerive ose pajisjeve për punimin e gomës së ashpër, plastikë së ashpër ose qelqit në të ftohtë, shih 28.42
- prodhimin e kallëpeve të lingotave, shih 28.91
- prodhimin e makinerive për prodhimin e aditivëve, shih 28.97

NVE Rev 2.1 kod

29

Përshkrim

Prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove

Përfshin

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mjeteve motorike për transportin e pasagjerëve ose mallrave. Prodhimi i pjesëve dhe aksesoreve të ndryshëm, si dhe prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove përfshihet po këtu. Riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve motorike të prodhuara në këtë ndarje klasifikohen në 95.31.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	29.1
Përshkrim	Prodhimi i automjeteve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	29.10
Përshkrim	Prodhimi i automjeteve

Përfshin Kjo klasë përfshin prodhimin e mjeteve me motor elektrik, me djegie të brendshme dhe hibride, dhe mjeteve autonome.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e autoveturave të pasagjerëve
- prodhimin e mjeteve tregtare:
 - furgonë, kamionë, maune për gjysmërimorkio, etj.
- prodhimin e autobusëve, tramvajeve elektrike, dhe autobusëve për distanca të gjata
- prodhimin e motorëve të automjeteve, përfshirë motorët elektrikë
- prodhimin e mjeteve të tjera motorike, p.sh.:
 - makina bore, makinat e vogla të golfit, mjetet motorike amfibe
 - karrocat e fshirjes së rrugës
- mjetet për të gjitha terrenet (ATV), go-cart (mjete të vogla për gara) dhe të ngjashme, përfshirë edhe autoveturat e garave

Përfshin gjithashtu Kjo klasë përfshin gjithashtu:-rindërtimin në fabrikë të motorëve të mjeteve motorike- prodhimin e shasisë së montuar së bashku me motorët

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e llambave për mjetet motorike, shih 27.40
- prodhimin e pistonëve, unazave të pistonit dhe karburatorëve jo për automjete ose motoçikleta, shih 28.11
- prodhimin e kamionëve me vinç të montuar, shih 28.22
- prodhimin e traktorëve bujqësorë dhe pyjorë, shih 28.30
- prodhimin e traktorëve për vendosjen e binarëve, shih 28.30
- prodhimin e kamionëve vetëshkarkues për terrene të vështira, shih 28.92
- prodhimin e trupave për mjetet motorike, p.sh., makina zjarrfikëse, biblioteka udhëtuese, betonierëve, shih 29.20
- prodhimin e automjeteve të blinduara, shih 29.20
- prodhimin e pjesëve elektrikë për mjetet motorike, shih 29.31
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për mjetet motorike, shih 29.32
- prodhimin e tankeve dhe mjeteve të tjera të blinduara ushtarake, shih 30.40
- riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike, shih 95.31

NVE Rev 2.1 kod	29.2
Përshkrim	Prodhimi i kabinave dhe pjesëve të kabinave për automjete; prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	29.20
Përshkrim	Prodhimi i kabinave dhe pjesëve të kabinave për automjete; prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e karrocërve, përfshirë kabinat e mjeteve motorike, p.sh.: • mjetet zjarrfikëse, biblioteka lëvizëse, mjete të blinduara • kamionë me betonierë - plotësimin e të gjitha llojeve automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove me tiparet shtesë me përzgjedhje - prodhimin e rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, p.sh.: • cisterna, rimorkio të hapura ose të mbuluara • rulota -ripërtëritjen dhe personalizimin e mjeteve motorike - prodhimin e kontenierëve (përfshirë kontenierët për transportin e lëngjeve) të projektuar dhe pajisur veçanërisht për transport përmes një ose më shumë mënyrave të transportit - prodhimin e shasive për rimorkiot
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e rimorkiove dhe gjysmërimorkiove të projektuara posaçërisht për përdorim në bujqësi, shih 28.30 - prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve të trupave për mjetet motorike, shih 29.32 - prodhimin e mjeteve që tërhiqen nga kafshët, shih 30.99
NVE Rev 2.1 kod	29.3
Përshkrim	Prodhimi i pjesëve dhe aksesoreve për automjete
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e pjesëve të mjeteve motorike dhe aksesorët e të gjitha materialeve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod

29.31

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike për automjete

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve elektrike të mjeteve motorike, p.sh. motorino, gjeneratorë, alternatorë, kandeleta, setet e telave të izoluar të ndezjes, sisteme elektrike për xhama dhe dyer, montimin e matësve të blerë në panelet e instrumenteve, rregullatorët e tensionit
- prodhimin e friksioneve (elektromagnetike) për mjetet motorike

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e moduleve të inverterit dhe rezervuarëve të karburantit të makinat
- prodhimin e seteve të kablllove, seteve të izoluar të përcjellësve dhe seteve të ngjashme të kablllove ose completeve për aplikime në automjete

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e baterive për mjete, shih 27.20
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për mjetet motorike, shih 27.40
- prodhimin e pompave për mjetet motorike dhe motorët, shih 28.13

NVE Rev 2.1 kod

29.32

Përshkrim

Prodhimi i pjesëve dhe aksesorëve të tjerë për automjete

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve të ndryshëm për mjetet motorike, p.sh.:
 - kuti marshesh, friksione, frena, akse, rrotat, amortizatorë
- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve të karrocive për mjetet motorike, p.sh.:
 - parakolpët, rripat e sigurimit, airbag sigurie, pasqyra
- prodhimin e sediljeve të makinave, përfshirë sediljet për foshnja dhe fëmijë
- prodhimin e makinave të ajrit të kondicionuar për mjetet motorike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e gomave, shih 22.11
- prodhimin e tubave dhe rripave prej gome, dhe produkteve të tjera prej gome, shih 22.12
- prodhimin e pistonave, unazave të pistonave dhe karburatorëve që nuk janë për mjete motorike dhe motoçikletave, shih 28.11
- prodhimin e pompave për mjetet motorike dhe motorët, shih 28.13
- riparimin dhe mirëmbajtjen, si dhe modifikimin e mjeteve motorike, shih 95.31

NVE Rev 2.1 kod	30
Përshkrim	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit
Përfshin	Kjo ndarje përfshin prodhimin e mjeteve të transporti, p.sh. prodhimin e anijeve dhe barkave, prodhimin e shinave hekurudhore dhe lokomotivave, mjeteve ajrore dhe hapësinore, motoçikletave dhe biçikletave dhe prodhimin e pjesëve të tyre, prodhimi i të cilave nuk është i klasifikuar diku tjetër.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	30.1
Përshkrim	Prodhimi i anijeve dhe barkave
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e anijeve, barkave dhe jahteve dhe strukturave të tjera lundruese për transport dhe qëllime të tjera tregtare, si dhe për qëllime sportive, argëtimi dhe ushtarake.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	30.11
Përshkrim	Prodhimi i anijeve civile dhe strukturave lundruese
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e anijeve civile, përveç mjeteve lundruese për sport dhe argëtim, si dhe prodhimin e strukturave lundruese.
	Kjo klasë përfshin:
	- prodhimin e mjeteve lundruese tregtare:
	• mjete lundruese për pasagjerë, tragete, anije mallrash, anije cisternë, anije tërheqëse
	- prodhimin e peshkarexhave, anijeve fabrikë dhe mjeteve të tjera lundruese për përpunimin ose ruajtjen e produkteve të peshkimit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu:
	- prodhimin e mjeteve lundruese me jastëk ajri (përveç mjetit lundrues me jastëk ajri për argëtim)
	- prodhimin e platformave të shpimit, lundruese ose zhytëse
	-prodhimin e strukturave lundruese, p.sh.:
	• doke lundruese, ura notuese, kesone hidraulike, platforma lundruese për zbarkim, bova, depozita lundruese, varka, ndriçues, vinça lundruese, trape me fryrje jo për qëllime argëtimi, etj.
	- prodhimin e seksioneve për anije dhe struktura lundruese
	- prodhimin e dronëve nënujorë
	- konvertimin në fabrikë të anijeve
	- montimin e pjesëve të brendshme teknike të barkave
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin:
	- prodhimin e pjesëve të mjeteve lundruese, të ndryshme nga pjesët e mëdha të trupit:
	• prodhim i velave, shih 13.96
	• prodhim i helikave të anijeve, shih 25.99
	• prodhim i spirancave prej hekuri ose çeliku, shih 25.99
	• prodhim i motorëve detarë, shih 28.11
	- prodhimin e instrumenteve të navigimit, shih 26.51
	- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për anije, shih 27.40

- kontrollin në fabrikë të motorëve për anije dhe barka civile, shih 28.11
- prodhimin e mjeteve motorike amfibe, shih 29.10, 30.40
- prodhimin e barkave ose gomoneve për argëtim dhe sport, shih 30.12
- prodhimin e jahteve, shih 30.12- prodhimin e anijeve dhe mjeteve lundruese ushtarake, shih 30.13
- riparimin dhe mirëmbajtjen e specializuar të anijeve civile dhe strukturave lundruese, shih 33.15
- çmontimin e anijeve, shih 38.21
- instalimin joteknik të pjesëve të brendshme dhe përfundimin e barkave, shih 43.3

NVE Rev 2.1 kod

30.12

Përshkrim

Prodhimi i barkave të argëtimit dhe sportive

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e barkave me ajër dhe gomoneve për sport dhe argëtim
- prodhimin e barkave me velë, me ose pa motor rezervë
- prodhimin e barkave me motor
- prodhimin e hovercraft (mjet lundrues mbi jastëkë ajri)
- prodhimin e jahteve- prodhimin e mjeteve lundruese individuale
- prodhimin e barkave të tjera për argëtim dhe sport, p.sh.:
 - kaïke, kajak, barka vozitjeje, barka me rrema

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- konvertimin në fabrikë të barkave për argëtim dhe sport

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pjesëve të barkave për argëtim dhe sport:
 - prodhim i velave, shih 13.96
 - prodhim i spirancave prej hekuri ose çeliku, shih 25.99
 - prodhim i motorëve detarë, shih 28.11
- kontrollin në fabrikë të motorëve të anijeve dhe barkave për sport dhe argëtim, shih 28.11
- prodhimin e dërrasave të lundrimit dhe të sërfit, shih 32.30
- riparimin e barkave të argëtimit, shih 33.15
- dhënien me qira të barkave dhe barkave me vela së bashku me ekuipazh, shih 50.10, 50.30
- dhënien me qira të barkave dhe jahteve të argëtimit pa ekuipazh, shih 77.21

NVE Rev 2.1 kod

30.13

Përshkrim

Prodhimi i anijeve dhe mjeteve lundruese ushtarake

Përfshin

- Kjo klasë përfshin prodhimin e anijeve dhe mjeteve lundruese ushtarake, p.sh. anijet luftarake të pajisura me armë të ndryshme sulmuese dhe mbrojtëse dhe me pajisje mbrojtëse kundër goditjeve me predha, dhe prodhimin e strukturave lundruese ushtarake, p.sh.:
- aeroplanmbajtëse
 - anije amfibe luftarake dhe sulmuese
 - kryqëzorë
 - torpedierë
 - nëndetëse
 - mjete lundruese për zbarkim
 - mjete lundruese tërheqëse për transportin e municioneve ose minave

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- konvertimin në fabrikë të anijeve dhe mjeteve lundruese ushtarake, dhe strukturave lundruese

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e armëve dhe municionit, p.sh., tubave silurues, silurët, shih 25.30
- kontrollin në fabrikë të motorëve të anijeve dhe mjeteve lundruese ushtarake, shih 28.11
- prodhimin e anijeve civile dhe strukturave lundruese, shih 30.11
- prodhimin e varkave ose gomoneve me fryrje për argëtim dhe sport, shih 30.12

NVE Rev 2.1 kod

30.2

Përshkrim

Prodhimi i lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

30.20

Përshkrim

Prodhimi i lokomotivave dhe mjeteve hekurudhore

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e lokomotivave hekurudhore elektrike, me naftë, me avull dhe të llojeve të tjera
- prodhimin e vagonëve hekurudhorë ose të tramvajit, furgonëve dhe kamionëve me vetështytje
- prodhimin e mjeteve të mirëmbajtjes ose shërbimit për hekurudha ose tramvaji
- prodhimin e mjeteve hekurudhore ose tramvaji pa vetështytje, p.sh.:
 - autobusë pasagjerësh për distanca të gjata, furgonë mallrash, vagonë cisternë, furgonë dhe vagonë me vetëshkarkim, furgonë punishteje, furgonë me vinç, vagonë karburanti
- prodhimin e pjesëve të specializuara të lokomotivave ose mjeteve që lëvizin në hekurudhë ose tramvaj, p.sh.:
 - karrelë, akse dhe rrota, frena dhe pjesë të frenave; çengela dhe pajisje lidhëse, tampona dhe pjesë të tamponëve; përthithës goditjesh; skelete lokomotivash dhe vagonësh; karroceri; lidhjet korridor

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e lokomotivave të minierave dhe vagonëve të minierave
- prodhimin e pajisjeve mekanike dhe elektromekanike të sinjalizimit, sigurisë dhe kontrollit të trafikut, p.sh. për hekurudha, tramvaj, rrugë ujore të brendshme, rrugë automobilistike, struktura parkimi, aerodrome
- prodhimin e ndenjësve të vagonëve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e shinave të pamontuara, shih 24.10
- prodhimin e pajisjeve dhe pjesëve të montuara të binarëve të hekurudhës ose tramvajit, shih 25.99
- prodhimin e motorëve elektrikë jo për mjete motorike, shih 27.11
- prodhimin e pajisjeve elektrike të sinjalistikës, sigurisë ose kontrollit të trafikut për hekurudhat ose tramvajet, shih 27.90
- prodhimin e motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të mjeteve motorike, mjeteve ajrore dhe motoçikletave, shih 28.11
- prodhimin e motorëve detarë, shih 28.11

NVE Rev 2.1 kod	30.3
Përshkrim	Prodhimi i makinerive ajrore dhe hapësinore dhe makinerive të ngjashme
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	30.31
Përshkrim	Prodhimi i makinerive ajrore dhe hapësinore dhe makinerive të ngjashme civile
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimi i avionëve për transportin e mallrave ose pasagjerëve, duke përfshirë për qëllime rekreative dhe sportive - prodhimin e helikopterëve - prodhimin e avionëve pa motor dhe deltaplanëve - prodhimin e zepelinëve dhe balonave me ajër të nxehtë - prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për mjetet ajrore të kësaj klase: • pjesët e montuara madhore, p.sh. trupat, krahët, dyert, sipërfaqet e kontrollit, mekanizmin e uljes, serbatorët e karburantit, foletë e motorëve • helikat e avionëve, helikat e helikopterëve dhe fletët e helikave me shtytje • motorët e mjeteve ajrore civile • motorët dhe helikat turboreaktive të llojit që përdoren në mjete ajrore civile • pjesët e përshtatshme për përdorim vetëm ose kryesisht me motorët me pistona me djegie të brendshme për mjetet ajrore civile - prodhimin e mjeteve të trajnimit për fluturim - prodhimin e raketave me drejtim për qëllime hapësinore dhe civile - prodhimin e mjeteve hapësinore dhe mjeteve hedhëse, satelitëve, sondave planetare, stacioneve orbitale, mjeteve ajrore hapësinore - prodhimin e mjeteve ajrore civile pa pilot (dronët)
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - kontrollin dhe konvertimin e motorëve të mjeteve ajrore civile - prodhimin e ndenjësve të mjeteve ajrore civile
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e parashutave, shih 13.96 - prodhimin e raketave për qëllime ushtarake, shih 25.30 - prodhimin e pajisjeve të telekomunikacionit për satelitë, shih 26.30 - prodhimin e instrumenteve të mjeteve ajrore dhe aeronautike, shih 26.51 - prodhimin e sistemeve të navigimit ajror, shih 26.51 - prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për mjete ajrore, shih 27.40 - prodhimi i pistonëve, unazave të pistonit dhe karburatorëve jo për automjete ose motoçikleta, shih 28.11 - prodhimin e pajisjeve të lëshimit të mjeteve ajrore, katapultave të aeroplanmbajtësve dhe pajisjeve të ngjashme, shih 28.99 - prodhimi i pjesëve të ndezjes dhe pjesëve të tjera elektrike për motorët me djegie të brendshme, shih 29.31 - prodhimin e makinerive ajrore dhe hapësinore ushtarake, shih 30.32 - prodhimin e dronëve për qëllime ushtarake, shih 30.32 - prodhimin e dronëve për qëllime argëtimi, shih 32.40 - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe hapësinore civile, shih 33.16

NVE Rev 2.1 kod	30.32
Përshkrim	Prodhimi i makinerive ajrore dhe hapësinore dhe makinerive të ngjashme ushtarake
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e mjeteve ajrore dhe hapësinore dhe makinerive të ngjashme ushtarake. Kjo klasë përfshin prodhimin e: - mjeteve ajrore me krahë të fiksuar - mjeteve ajrore me helikë të lëvizshme - mjeteve ajrore me helikë me shtytje vertikale - dronëve për qëllime ushtarake (Mjetet Ajrore Pa Pilot (UAV-të))
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e mjeteve ajrore dhe hapësinore ushtarake - prodhimin e ndenjësve të mjeteve ajrore ushtarake
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e armëve dhe municioneve, shih 25.30 - prodhimin e raketave për qëllime ushtarake, shih 25.30 - prodhimin e makinerive ajrore dhe hapësinore, dhe makinerive të ngjashme civile, shih 30.31 - riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive ajrore dhe hapësinore ushtarake, shih 33.18

NVE Rev 2.1 kod	30.4
Përshkrim	Prodhimi i mjeteve luftarake ushtarake
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	30.40
Përshkrim	Prodhimi i mjeteve luftarake ushtarake
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e mjeteve ushtarake luftarake, të pajisura ose jo me armatim, dhe të pjesëve të automjeteve të tilla, p.sh.: - prodhimin e tankeve - prodhimin e mjeteve luftarake të blinduara për transport personeli - prodhimin e mjeteve të blinduara për furnizim dhe mjeteve të blinduara për rikuperim me vinq - prodhimin e mjeteve ushtarake amfibe të blinduara - prodhimin e tankeve me drejtim nga distanca - prodhimin e karrocërve të mjeteve luftarake me të blinduara dhe pjesëve të tyre, p.sh. kulla rrotulluese të blinduara, dyer dhe mbulesa të blinduara - prodhimin e pllakave të blinduara që janë të identifikueshme si pjesë të mjeteve luftarake ushtarake - prodhimin e zinxhirëve të veçantë dhe rrotave të veçanta dhe rrotave aktive
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu:

Nuk përfshin

- kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e mjeteve luftarake ushtarake

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e armëve dhe municioneve, shih 25.30
- prodhimin e makinave të pasagjerëve dhe kamionëve me blindazh të lehtë ose me blindazh të heqshëm, shih 29.10
- prodhimin e anijeve ushtarake, shih 30.13
- prodhimin e dronëve për qëllime ushtarake, shih 30.32
- riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ushtarake për luftë, shih 33.18

NVE Rev 2.1 kod

30.9

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve të transportit p.k.t

Përfshin

Ky grup përfshin prodhimin e pajisjeve të transportit përveç mjeteve motorike dhe hekurudhore, ujore, ajrore apo hapësinore të transportit dhe mjeteve ushtarake

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

30.91

Përshkrim

Prodhimi i motoçikletave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e motoçikletave dhe ciklomotorëve
- prodhimin e motorëve për motoçikletë
- prodhimin e koshave për motoçikletë
- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për motoçikleta, p.sh. frenat, kutitë e marsheve, friksionet, rrotat e rrugës, tubat e shkarkimit dhe të mbytjes së zhurmës dhe pjesët e tyre
- prodhimin e pistonëve, unazave të pistonit dhe karburatorëve për motoçikleta

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rrotave pneumatike prej gome, të një lloji që përdoren për motoçikletat, shih 22.11
- prodhimin e biçikletave, shih 30.92
- prodhimin e biçikletave me motor elektrik shtesë, shih 30.92
- prodhimin e karrocave për personat me aftësi të kufizuara, shih 30.92
- prodhimin e mjeteve transportuese personale, p.sh., patina elektrike me rrota dhe skutera, shih 30.92

NVE Rev 2.1 kod

30.92

Përshkrim

Prodhimi i biçikletave dhe karrocave të invalidëve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e biçikletave dhe mjeteve të tjera ciklike pa motor, përfshirë triçiklat (për dorëzime malli), biçikletat me dy vende, biçikletat dhe

triçiklat për fëmijë

- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për biçikleta, p.sh. skeletin, pirunat, disqet dhe telat e rrotave, akset, frenat, shalat, pedalet, marshet dhe mekanizmi i ndërrimit të marsheve
- prodhimin e biçikletave me motor elektrik rezervë
- prodhimin e karrocave transportuese me rrota për personat me aftësi të kufizuara pa motor
- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për karroca me rrota për personat me aftësi të kufizuara
- prodhimin e mjeteve transportuese personale, p.sh., monopatina elektrike dhe skutera- prodhimin e karrocave për foshnja dhe pjesëve të tyre:

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rrotave pneumatike dhe tubave të brendshëm prej gome, të një lloji që përdoren për biçikletat, shih 22.11
- prodhimin e lodrave me rrota të projektuara për t'u ngarë, përfshirë biçikletat dhe triçiklat plastikë, shih 32.40

NVE Rev 2.1 kod

30.99

Përshkrim

Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit p.k.t

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mjeteve me shtytje me fuqi krahu, p.sh.: karroca bagazhesh, karroca dore, saje, karroca për blerje në dyqan
- prodhimin e mjeteve që tërhiqen nga kafshët, p.sh.: pajtonët, karrocë me një aks, karroca varrimi

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- kamionët, të montuar ose jo me pajisje ngritëse ose manipuluese, vetëlëvizës apo jo, të llojit që përdoren në fabrika (përfshirë karroca transporti dhe karroca dore), shih 28.22
- karrocet dekorative të restorantit, p.sh., karrocë ëmbëlsirash, karrocë ushqimesh, shih 31.00

NVE Rev 2.1 kod

31

Përshkrim

Prodhimi i mobilieve

Përfshin

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mobilieve dhe pjesëve të tyre, me përjashtim të fletëve dhe pllakave prej qelqi, guri, betoni ose materiale të ngjashme që përdoren si material për mobilieve. Proceset e prodhimit të mobilieve janë metoda standarde të formësimit të materialeve dhe montimit të komponentëve, duke përfshirë prerjen, formimin dhe laminimin. Skicimi i artikujve, si në kuadër të cilësive estetike dhe funksionale, është aspekt i rëndësishëm i procesit të prodhimit. Disa nga proceset e përdorura në prodhimin e mobilieve janë të ngjashme me proceset që përdoren në sektorë të tjerë të prodhimit. Për shembull, prerja dhe montimi janë procese që kryhen dhe në prodhimin e veglave të drurit që klasifikohen në ndarjen 16. Megjithatë, proceset e përsëritura përcaktojnë prodhimin e mobilieve prej druri nga prodhimi i produkteve prej druri. Në mënyrë të ngjashme, prodhimi i mobilieve metalike përdor teknika që

përdoren gjithashtu në proceset e formimit dhe laminimit të metaleve të klasifikuara në ndarjen 25. Procesi i formimit të mobilieeve plastike është i ngjashëm me procesin e formimit të produkteve të tjera plastike. Megjithatë, prodhimi i mobilieeve plastike priret të jetë një aktivitet më i specializuar.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

31.0

Përshkrim

Prodhimi i mobilieeve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

31.00

Përshkrim

Prodhimi i mobilieeve

Përfshin

Kjo klasë përfshin prodhimin e mobilieeve të të gjitha llojeve, për çdo vend dhe për qëllime të ndryshme. Ajo përfshin gjithashtu prodhimin e pjesëve të mobilieeve, me përjashtim të fletëve dhe pllakave (të prera ose jo me formë) prej qelqi (përfshirë pasqyrat), prej mermeri ose gurë të tjerë, betoni ose materiale të ngjashme.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e karrigeve dhe ndenjësve për zyra, salla pune, hotele, restorante dhe ambiente publike
- prodhimin e karrigeve dhe ndenjësve për teatro, kinema etj.
- prodhimin e mobilieeve speciale për dyqane: banakë, vitrina, rafte etj.
- prodhimin e mobilieeve për zyra
- prodhimin e stolave të laborantëve, stolave dhe ndenjësve të tjera për laboratorë, mobilie për laboratorë (p.sh. dollapët dhe tavolinat)
- prodhimin e mobilieeve për kisha, shkolla, restorante
- prodhimin e mobilieeve të kuzhinës
- prodhimin e divaneve, divaneve me krevat dhe seteve të divaneve
- prodhimin e karrigeve dhe ndenjësve të kopshtit
- prodhimin e mobilieeve për dhoma gjumi, dhoma ndenjeje, kopshte etj.
- prodhimin e dollapëve për makina qepëse, televizorë etj.
- prodhimin e dyshekëve dhe mbështetësve të dyshekut

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- prodhimin e karrocave të kateringut
- prodhimin e komponentëve të inkomporuar për mobilet e dyqaneve
- përfundimin e mobilet, p.sh. sprucimin, lyerjen, lustrimin, shtrimin e tapicerisë
- prodhimin e gardërobave

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e jastëkëve, pupave, jastëkëve këndorë, jorganëve dhe shtresave, shih 13.92
- prodhimin e formave prej druri, që nuk janë pjesë përbërëse e mobilieeve, shih 16.1
- prodhimin e materialeve të zdrukthëtarisë dhe bashkimit, shih 16.23
- prodhimin e dyshekëve prej gome me fryrje, shih 22.12

- prodhimin e dyshekëve prej gome me mbushje uji, shih 22.12
- prodhimin e pllakave dhe rrasave (të prera ose jo në forma) prej qeramike, betoni ose guri, shih 23.42, 23.66, 23.70
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit ose llambave, shih 27.40
- prodhimin e dërrasave të zeza, shih 28.23
- prodhimin e ndenjësve të makinave, shih 29.32
- prodhimin e ndenjësve të bebeve për makina, shih 29.32
- prodhimin e ndenjësve të mjeteve hekurudhore, shih 30.20
- prodhimin e ndenjësve të mjeteve ajrore, shih 30.31, 30.32
- prodhimin e mobilieve mjekësore, kirurgjikale, dentare ose veterinare, shih 32.50
- instalimin dhe bashkimin e modeleve të mobilieve, instalimin e ndarjeve, instalimin e mobilieve të pajisjeve laboratorike, shih 43.32
- instalimin e komponentëve të inkomporuar për mobilitet e dyqaneve, shih 43.32
- riveshjen, ripërfundimin dhe riparimin e mobilieve, shih 95.24

NVE Rev 2.1 kod

32

Përshkrim

Industri të tjera

Përfshin

Kjo ndarje përfshin prodhimin e një larmie mallrash që nuk trajtohen në pjesë të tjera të klasifikimit. Meqenëse kjo është një ndarje e mbetur, proceset e prodhimit, materialet që hyjnë në proces dhe produktet e prodhuara mund të ndryshojë gjerësisht dhe kriteri i përdorur zakonisht për rigrupimin e klasave në ndarje nuk zbatohet për këtë rast.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

32.1

Përshkrim

Prodhimi i stolive të çmuara, bizhuterive dhe artikuj të ngjashëm me to

Përfshin

Ky grup përfshin prodhimin e stolive të çmuara dhe imitimet të tyre.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

32.11

Përshkrim

Prerja e monedhave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- prerjen e monedhave, duke përfshirë monedhat për përdorim si valutë zyrtare, prej metali të çmuar ose jo

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	32.12
Përshkrim	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e perlave të punuara - prodhimin e gurëve të çmuar dhe gjysmë të çmuar në gjendje të punuar, duke përfshirë punimin e gurëve të cilësisë industriale dhe gurëve të çmuar ose gjysmë të çmuar sintetikë ose të riformuar - punimin e diamanteve - prodhimin e stolive prej metaleve të çmuara ose prej metaleve bazë të veshura me metale të çmuara ose gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar ose të kombinimeve të metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar ose gjysmë të çmuar - prodhimin e artikujve të arpunuesve prej metaleve të çmuara ose prej metaleve bazë të veshura me metale të çmuara, p.sh.: • enë ngrënie, takëme kuzhine, enë gatimi, artikuj tualeti, artikuj zyre ose tryeze pune, artikuj fetarë - prodhimin e artikujve teknikë ose laboratorikë prej metali të çmuar (përveç instrumenteve dhe pjesëve të tyre), p.sh.: poçe, spatula, anoda për elektrogalvanizim - prodhimin e rripave të orëve të dorës, byzylykëve dhe zinxhirëve të orëve të dorës, dhe kutive të cigareve me metale të çmuara
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e gravurave me metal të çmuar ose jo
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e rripave jometalikë për ora (p.sh. me copë, lëkurë, plastikë, etj.), shih 15.12 - prodhimin e metaleve bazë të veshur me argjend, ar ose platin, të papunuara më tej, shih 24.41 - prodhimin e statujave dhe dekorimeve të tjera prej metali bazë të veshur me metal të çmuar, shih 25.99 - prodhimin e kutive të orëve, prej metali të çmuar ose jo, shih 26.52 - prodhimin e zinxhirëve të orës prej metali (jo të çmuar), shih 32.13 - prodhimin e stolive imitim, të veshura me metal të çmuar ose jo, shih 32.13 - riparimin e stolive, shih 95.25

NVE Rev 2.1 kod	32.13
Përshkrim	Prodhimi i stolive të imituara dhe artikuj të ngjashëm me to
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e bizhuterive e stolive të imituara, që nuk përfshijnë perla natyrale ose të kultivuara, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar (përveç si larje ose si përbërës të vegjël) ose metal të çmuar ose metal të larë me metal të çmuar, p.sh.: • unaza, byzylykë, varëse, spila, vëth dhe artikuj të tjerë të vegjël për zbukurim personal të prodhuar me metale bazë të larë me metale të çmuara • stoli të imituara që përmbajnë gurë imituar, p.sh. imitimi i gurëve të çmuar, imitimi i diamanteve dhe të ngjashme - prodhimin e zinxhirëve metalikë të orës (përveç atyre me metale të çmuara)

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e stolive të prodhuara prej metalesh të çmuara ose prej veshjesh me metale të çmuara, shih 32.12 - prodhimin e stolive që përmbajnë gurë të çmuar origjinalë, shih 32.12 - prodhimin e zinxhirëve të orëve prej metali të çmuar, shih 32.12
NVE Rev 2.1 kod	32.2
Përshkrim	Prodhimi i instrumentave muzikorë
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	32.20
Përshkrim	Prodhimi i instrumentave muzikorë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e instrumenteve muzikore me tela - prodhimin e instrumenteve me tastierë dhe tela, përfshirë pianot automatike - prodhimin e tastierave të organove, fizarmonikës dhe instrumentat me tastierë të ngjashme me pipëz metalike të lirë - prodhimin e instrumenteve të akorduar dhe të ngjashëm, duke përfshirë dhe harmonikat me gojë - prodhimin e instrumenteve frymore - prodhimin e instrumenteve muzikore me goditje, p.sh. daulle, ksilofone, cembale, kastaneta, maraka - prodhimin e instrumenteve muzikore që krijojnë tinguj elektronikisht, p.sh. pianot digjitale, sintetizatorët - prodhimin e kutive muzikore, të orkestrinave, të gërnetave etj. - prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve të instrumenteve, p.sh.: • metronom, diapazon, fyell toni muzikor, karta, disqe dhe rula për instrumente mekanike automatike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e bilbilave, borive dhe instrumenteve të tjera sinjalizuese që nxjerrin tingull duke u fryrë me gojë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - riprodhimin e kasetave dhe disqeve audio dhe video të regjistruara paraprakisht, shih 18.20 - prodhimin e mikrofonave, amplifikatorëve e altoparlantëve, kufjeve dhe komponentëve të ngjashëm, shih 26.40 - prodhimin e gramafonave, magnetofonave, etj., shih 26.40 - prodhimin e instrumenteve muzikore lodër, shih 32.40 - publikimin e kasetave dhe disqeve audio dhe video të regjistruara paraprakisht, shih 59.20 - riparimin e instrumenteve muzikore që nuk konsiderohen si trashëgimi kulturore dhe jo historike, shih 95.29 - akordimin e pianos, shih 95.29

NVE Rev 2.1 kod 32.3

Përshkrim Prodhimi i artikujve të sportit

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 32.30

Përshkrim Prodhimi i artikujve të sportit

Përfshin Kjo klasë përfshin prodhimin e artikujve të sportit dhe atletikës (përveç veshjeve dhe këpucëve).

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve dhe produkteve për sporte, lojëra salle dhe në ambient të hapur prej çdo materiali, p.sh.:

- topa të fortë, të butë dhe me ajër
- raketa, shkopa për sporte të ndryshme
- shkopinj për ski, lidhëse anësore
- çizme skish, çizme snowboard-i dhe veshje këmbësh për sportin e skive "cross-country"
- dërrasë sërfi dhe ski uji
- artikuj për sportin e peshkimit, përfshirë rrjetat e peshkimit
- 'zogj' të rremë dhe të nevojshmet e ngjashme për gjueti ose qitje
- artikuj dhe pajisje për alpinizëm
- doreza sporti prej lëkure ose përbërje lëkure
- pishina noti dhe pishina të vogla
- patina akulli, patina me rrota
- harqe dhe arbaleta
- pajisje për gjimnastikë, qendra fitnesi ose atletikë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e velave për barka, shih 13.96
- prodhimin e veshjeve sportive, shih 14.29
- prodhimin e shalave dhe kapistrave, shih 15.12
- prodhimin e kamxhikëve dhe pajimeve të kalërimit, shih 15.12
- prodhimin e këpucëve sportive, shih 15.20
- prodhimin e kostumeve ujore dhe kostumeve për zhytje prej gome, shih 22.12
- prodhimi i mbulesave plastike me përjashtim të kapelës së sigurisë, shih 22.26
- prodhimin e armëve dhe municioneve për sport, gjueti ose qitje, shih 25.30
- prodhimin e mjeteve sportive të tjera përveç skive, slitave, etj, shih ndarjet 29 dhe 30
- prodhimin e barkave për sport dhe rekreacion, shih 30.12
- prodhimin e tavolinave të bilardos, shih 32.40
- prodhimin e tapave të veshëve dhe zhurmës (p.sh. për not dhe mbrojtje nga zhurma), shih 32.99
- prodhimin e kapeleve të sigurisë, shih 32.99
- riparimin e artikujve të sportit, shih 95.29

NVE Rev 2.1 kod	32.4
Përshkrim	Prodhimi i lojërave dhe lodrave
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	32.40
Përshkrim	Prodhimi i lojërave dhe lodrave
Përfshin	Kjo klasë përfshin prodhimin e kukullave, lodrave dhe lojërave (përfshirë lojërat elektronike), modelet në shkallë të caktuar dhe mjetet për fëmijë (përveç biçikletave dhe triciklave metalike). Kjo klasë përfshin: - prodhimin e kukullave dhe veshjeve e aksesorëve për to - prodhimin e figurinave të aksionit - prodhimin e kafshëve lodër - prodhimin e lodrave me rrota të projektuara për t'u ngarë, përfshirë biçikletat dhe triciklat plastikë - prodhimin e instrumentave muzikorë lodër - prodhimin e letrave të bixhozit - prodhimin e lojërave dhe lodrave prej letre ose kartoni - prodhimin e lojërave të tavolinës dhe lojërave të ngjashme - prodhimin e lojërave elektronike të tavolinës - prodhimin e modeleve me përmasa të zvogëluara (në shkallë) dhe modeleve të ngjashme për argëtim, trenave elektrikë, seteve të ndërtimit, etj. - prodhimin e makinave të lojërave të fatit - prodhimin e bilardove dhe tavolinave të veçanta për lojërat e kazinove, etj. - prodhimin e artikujve për lojërat e panaireve, lojërave në grup - prodhimin e "puzzle-ave" dhe artikujve të ngjashëm - prodhimin e dronëve për qëllime argëtimi
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - prodhimin e lodrave prej cope
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e konsolave (pulte komandimi) për videolojëra, shih 26.40 - prodhimin e dronëve për qëllime civile, shih 30.31 - prodhimin e biçikletave, shih 30.92 - prodhimin e artikujve për festa, karnavale apo argëtime të tjera, shih 32.99 - shkrimin dhe publikimin e programeve kompjuterike për konsola videolojërash, shih 58.21, 62.10
NVE Rev 2.1 kod	32.5
Përshkrim	Prodhimi i instrumentave dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

Përshkrim

Prodhimi i instrumentave dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare

Përfshin

Kjo klasë përfshin prodhimin e aparateve laboratorike, instrumenteve kirurgjikale dhe mjekësore, pajisjeve dhe artikujve kirurgjikalë, pajisjeve dhe artikujve për stomatologji, mallrat ortodontike, protezat e dhëmbëve dhe pajisjet ortodontike. Përfshihet prodhimi i mobilieve mjekësore, stomatologjike dhe të ngjashme, ku funksionet e veçanta shitesë përcaktojnë qëllimin e produktit, p.sh. karriget e dentistit me funksionet e ujit të përfshira në to.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e perdeve kirurgjikale dhe fijeve dhe pëlhurave sterile
- prodhimin e mbushjeve dhe çimentove dentare (përveç ngjitësve për proteza), dyllit dentar dhe përgatitjeve të tjera dentare me allçi
- prodhimin e çimentove për rindërtimin e kockave
- prodhimin e furrave laboratorike dentare
- prodhimin e makinerive laboratorike për pastrim me ultra tinguj
- prodhimin e sterilizuesve mjekësorë, kirurgjikalë dhe laboratorikë
- prodhimin e centrifugave për laborator
- prodhimin e mobilieve mjekësore, kirurgjikale, dentare ose veterinare, p.sh.:
- shtretërit kirurgjikalë
- shtretërit e ekzaminimit
- shtretërit spitalorë me aksesoret mekanikë
- karriget e dentistit
- prodhimin e artikujve të projektuar enkas për përdorim vetëm për transplante në shkencat mjekësore, kirurgjikale, dentare ose veterinare, p.sh. pllakat që vendosen përgjithmonë në trup, për shembull për zëvendësimin e një pjese ose të të gjithë kockës
- prodhimin e shiringave, ageve, kateterave, gypave, etj.
- prodhimin e instrumenteve dhe veglave dentare
- prodhimin e dhëmbëve artificialë dhe protezave dentare
- prodhimin e mjeteve ortopedike dhe prostetike
- prodhimin e syve prej xhami
- prodhimin e termometrave mjekësorë
- prodhimin e mallrave oftalmike, syzeve optike, syzeve të diellit, lenteve të prodhuara sipas recetës, lenteve të kontaktit, syzeve të sigurisë
- prodhimin e këpucëve ortopedike për matje dhe shtrijave të veçanta të këpucës për korrigjimin e problemeve ortopedike
- prodhimin e maskave mbrojtëse individuale, p.sh., FFP2, FFP3, maskave kirurgjikale

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo nuk përfshin:

- prodhimin e këpucëve të prodhuara me numër të veçantë serie, që mbështesin harkun e shputës, shih 15.20
- prodhimin e pastave dhe pluhurit fiksues të protezës së dhëmbëve, shih 20.42
- prodhimin e mbushjeve, garzave, fashave dhe artikujve të ngjashëm, p.sh., mbulesa mjekësore, allçi, kompresa, substanca farmaceutike të ngjira ose të veshura, shih 21.20
- prodhimin e aparateve elektro-mjekësore dhe elektro-terapeutike, shih 26.60
- prodhimin e aparateve të dëgjimit, shih 26.60
- prodhimin e karrigeve me rrota, shih 30.92
- shitjen me pakicë të syzeve korrigjuese, lenteve dhe syzeve të diellit, shih 47.74

NVE Rev 2.1 kod 32.9

Përshkrim Industri p.k.t

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 32.91

Përshkrim Prodhimi i fshesave dhe furçave

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fshesave dhe furçave, p.sh. furçat e tualetit, furçat shtëpiake, furçat e bojës, furçat e imëta dhe furçat teknike dhe industriale, përfshirë furçat që përbëjnë pjesë të makinave, fshirëseve mekanike të dyshemesë me dorë, shtupave dhe marrëseve të pluhurave, furçave të bojës, sfungjerëve dhe rrulave të bojës, sfungjerëve dhe furçave të tjera, fshesave, shtupave
- prodhimin e furçave të këpucëve dhe veshjeve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod 32.99

Përshkrim Industri të tjera p.k.t

Përfshin Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve të sigurisë dhe mbrojtëse, p.sh.:
- prodhimin e rripave të sigurisë së fillrojtësit dhe rripave të tjerë për përdorim profesional
- prodhimin e jelekëve të shpëtimit me tapë
- prodhimin e helmetave të sigurisë dhe pajisjeve të tjera të sigurisë personale, p.sh. mbrojtëse fytyre prej plastike, p.sh. helmeta atletike
- prodhimin e veshjeve rezistente për zjarrfikësit
- prodhimin e helmetave të sigurisë prej metali dhe pajisje të tjera të sigurisë personale prej metali
- prodhimin e tapave të veshëve dhe zhurmës p.sh., për not dhe mbrojtje nga zhurma
- prodhimin e maskave kundragaz
- prodhimin e veshjeve dhe aksesorëve mbrojtës nga rreziqet biologjike
- prodhimin e jelekëve antiplumb
- prodhimin e veshjeve dhe aksesorëve për dhomat sterile
- prodhimin e stilolapsave dhe lapsave të të gjitha llojeve, mekanikë ose jo
- prodhimin e majave të lapsave
- prodhimin e vulave me datë, izoluese ose numëruese, pajisjeve të dorës për printimin ose shtypjen në të thatë të etiketave, setet e dorës për printim, shiritave të përgatitur të makinave të shkrimt, sfungjerëve me bojë
- prodhimin e globeve
- prodhimin e çadrave, çadrave të diellit, bastunëve, bastunëve me ndenjëse
- prodhimin e kopsave, perçinave, sustave, perçinave të qepjes, grepave të mbërthimit
- prodhimin e cigareve elektronike
- prodhimin e çakmakëve dhe ndezësve të tjerë
- prodhimin e artikujve për përdorim vetjak, p.sh. pipat e duhanit, spërkatësit e

- parfumit, shishet me vakum dhe enët e tjera me vakum për përdorim vetjak ose shtëpiak, parukat, mjekrat e vetullat artificiale
- prodhimin artikujve të ndryshëm, p.sh.: qirinj, qirinj të hollë, etj.; lule, fruta dhe gjethe artificiale; rengje dhe artikuj argëtimi, sita dhe shoshë dore; manekinë për rrobaqepës; arkivole
- prodhimin e shportave, buqetave, kurorave dhe artikujve të ngjashëm me lule
- aktivitetet e balsamosjes së kafshëve
- prodhimin e modeleve në shkallë të projektuar për qëllime ekspozimi

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e fitilave ndezës, shih 13.96
- prodhimin e veshjeve të punës, shih 14.23
- prodhimin e artikujve të argëtimit prej letre,, shih 17.25
- prodhimin e mbulesave plastike me përjashtim të kapelës së sigurisë, shih 22.26
- prodhimin e maskave mbrojtëse individuale, p.sh. FFP2, FFP3, maska kirurgjikale, shih 32.50

NVE Rev 2.1 kod

33

Përshkrim

Riparimi, mirëmbajtja dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve

Përfshin

Kjo ndarje përfshin riparimin e specializuar të mallrave të prodhuara në sektorin e prodhimit me qëllim rikthimin në gjendje pune të makinerive, pajisjeve dhe produkteve të tjera. Ofrimi i mirëmbajtjes së përgjithshme dhe rutinë (pra shërbimi) për këto produkte me qëllim funksionimin e tyre efikas dhe parandalimin e avarive dhe riparimeve të panevojshme. Kjo ndarje përfshin vetëm aktivitetet e riparimit dhe mirëmbajtjes së specializuar. Një numër i konsiderueshëm riparimesh kryhen edhe nga prodhuesit e makinerive, pajisjeve dhe mallrave të tjera, dhe në këto raste klasifikimi i njësive të angazhuara në këto aktivitete riparimi dhe prodhimi bëhet sipas parimit të vlerës së shtuar, të cilat shpesh përcaktojnë aktivitetet e kombinuara të prodhimit të mallrave. I njëjti parim zbatohet për tregtinë dhe riparimin e kombinuar. Rindërtimi ose riprodhimi i makinerive dhe pajisjeve konsiderohet aktivitet prodhimi dhe përfshihet në ndarje të tjera të këtij seksioni.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu instalimin e specializuar të makinerive

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- pastrimin e makinerive industriale, shih 81.22
- instalimin e pajisjeve që përbëjnë një pjesë integrale të ndërtesave ose strukturave të ngjashme(p.sh. instalimi i lidhjeve elektrike ,i shkallëve lëvizëse apo i sistemeve të kondicionimit të ajrit klasifikohet si ndërtim)
- riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe pajisjeve të komunikimit, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e artikujve shtëpiakë, shih 95.2
- riparimin dhe mirëmbajtjen e mallrave që përdoren si mallra kapitale, si dhe të mallrave të konsumit që klasifikohen si riparim dhe mirëmbajtje e mallrave të konsumit (p.sh., riparim i mobilieve të zyrës dhe shtëpiakë), shih 95.24
- riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike dhe motoçikletave, shih 95.3

NVE Rev 2.1 kod

33.1

Përshkrim

Riparimi dhe mirëmbajtja e produkteve metalike, makinerive dhe pajisjeve të fabrikuar

Përfshin

Ky grup përfshin riparimin e specializuar të mallrave të prodhuara në sektorin e prodhimit me qëllim rikthimin në gjendje pune të këtyre produkteve metalike, makinerive, pajisjeve dhe produkteve të tjera. Ofrimi i mirëmbajtjes së përgjithshme dhe rutinë (pra shërbimi) për këto produkte me qëllim funksionimin e tyre efikas dhe parandalimin e avarive dhe riparimeve të panevojshme.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin:

- rindërtimin ose riprodhimin e makinerive dhe pajisjeve, shih klasën përkatëse në ndarjet 25 deri në 30
- pastrimin e makinerive industriale, shih 81.22
- riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe pajisjeve të komunikimit, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e artikujve shtëpiakë, shih 95.2

NVE Rev 2.1 kod

33.11

Përshkrim

Riparimi dhe mirëmbajtja e produkteve metalike të fabrikua

Përfshin

Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e produkteve metalike të fabrikua të ndarjes 25

Kjo klasë përfshin:

- riparimin e depozitave, rezervuarëve dhe kontejnerëve metalikë
- riparimin dhe mirëmbajtjen e tubave dhe tubacioneve
- riparimin e saldimeve lëvizëse
- riparimin e cisternave prej çeliku për transport
- riparimin dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve të avullit të ujit dhe avujve të tjerë
- riparimin dhe mirëmbajtjen e impianteve ndihmëse për përdorim në gjeneratorët me avull:
 - kondensatorët, ekonomizuesit, super nxehësit, kolektorët dhe akumulatorët e avullit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e reaktorëve bërthamorë, përveç ndarësve të izotopeve
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve për kaldajat detare ose të energjisë
- riparimin e pllakave të kaldajave qendrore dhe radiatorëve të ngrohjes
- riparimin dhe mirëmbajtjen e armëve të zjarrit dhe lëndëve plasëse, përfshirë riparimin e armëve të sportit dhe argëtimit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- mprehjen e thikave dhe sharrave, shih 33.12
- riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocave të pazarit, shih 33.17
- riparimin se sistemeve të ngrohjes qendrore, etj., shih 43.22
- riparimin e pajisjeve të kyçjes mekanike, kasafortave, etj., shih 80.09

Përshkrim

Riparimi dhe mirëmbajtja e makinerive

Përfshin

Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve industriale dhe tregtare si mprehjen ose instalimin e teheve dhe sharrave të makinerive; ofrimin e shërbimeve të riparimit të saldimeve (p.sh. për automjete, të përgjithshme); riparimin e makinerive dhe pajisjeve të rënda bujqësore dhe të tjera industriale (p.sh. pirun dhe pajisje të tjera për trajtimin e materialeve, veglat e makinerive, pajisje tregtare për ftohje, pajisje ndërtimi dhe makineritë e minierave), duke përfshirë makineritë dhe pajisjet e ndarjes 28.

Kjo klasë përfshin:

- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve, me përjashtim të mjeteve motorike, anijeve, barkave dhe avionëve
- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të lokomotivave
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pompave, kompresorëve dhe pajisjeve të ngjashme
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive hidraulike
- riparimin e valvulave
- riparimin e elementeve të ingranazheve dhe të drejtimit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e furrnaltave të proceseve industriale
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të ngritjes dhe manipulimit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve frigoriferike industriale dhe pajisjeve të pastrimit të ajrit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive për qëllime të përgjithshme të llojit tregtar
- riparimin e veglave të dorës me motor
- riparimin dhe mirëmbajtjen e veglave dhe aksesoreve të makinerive metalprerëse dhe metalformuese
- riparimin dhe mirëmbajtjen e veglave të tjera të makinerive
- riparimin dhe mirëmbajtjen e traktorëve bujqësorë
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive bujqësore dhe makinerive pyjore të sektorit të druve
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të metalurgjisë
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të minierave, ndërtimit, fushave të naftës dhe gazit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të përpunimit të ushqimit, pijeve dhe duhanit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të prodhimit të veshjeve prej tekstili dhe të lëkurës
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive për prodhimin e letrës
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të plastikës dhe gomës
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të tjera për qëllime të veçanta të ndarjes 28
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të peshimit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinerive automatike të shitjes së mallrave
- riparimin dhe mirëmbajtjen e kasave të parave
- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinave të fotokopjimit
- riparimin e makinave llogaritëse, elektronike apo jo
- riparimin e makinave të shkrimit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të anijeve dhe barkave civile, shih 33.15
- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve ajrore civile, shih 33.16
- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve, anijeve, barkave, mjeteve ajrore dhe hapësinore luftarake ushtarake, shih 33.18

- instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e furnaltave dhe pajisjeve të tjera të ngrohjes, shih 43.22
- instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve dhe shkallëve lëvizëse, shih 43.24
- riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve motorike, shih 95.31

NVE Rev 2.1 kod

33.13

Përshkrim

Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike dhe optike

Përfshin

Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e mallrave të prodhuara në grupet 26.5, 26.6 dhe 26.7, përveç atyre që konsiderohen si mallra shtëpiake.

Kjo klasë përfshin:

- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të matjes, testimit, drejtimit dhe kontrollit të grupit 26.5, p.sh.:
 - instrumentet e motorëve të avionëve
 - pajisjet e testimit të shkarkimeve të automjeteve
 - instrumentet meteorologjike • pajisjet e testimit dhe inspektimit të vetive fizike, elektrike dhe kimike
 - instrumentet e rlevimit (instrumente gjeodezike)
 - instrumentet e zbulimit dhe monitorimit të rrezatimit
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të rrezatimit, elektromjekësore dhe elektroterapeutike të klasës 26.60, p.sh.:
 - pajisjet e imazherisë me rezonancë magnetike
 - pajisjet mjekësore me ultratinguj
 - stimuluesit kardiakë
 - aparatet e dëgjimit
 - elektrokardiografët
 - pajisjet elektromjekësore të endoskopisë
 - aparatet e trajtimit me rreze
- riparimin dhe mirëmbajtjen e instrumenteve dhe pajisjeve optike të klasës 26.70, nëse përdorimi është kryesisht tregtar, p.sh.:
 - dylbi
 - mikroskopë (përveç mikroskopëve me elektrone dhe protone)
 - teleskopët
 - prizmat dhe lentet (përveç atyre oftalmike)
 - pajisjet e fotografisë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- riparimin dhe mirëmbajtjen e makinave të fotokopjimit, shih 33.12
- riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe pajisjeve periferike, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e projektorëve të kompjuterëve, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimit, shih 95.10
- riparimin dhe mirëmbajtjen e televizorëve dhe videokamerave komerciale, shih 95.10
- riparimin e videokamerave familjare, shih 95.21
- riparimin e orëve të dorës dhe orëve të murit, shih 95.25

NVE Rev 2.1 kod	33.14
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektrike
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e mallrave të ndarjes 27. Kjo klasë përfshin: - riparimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve të energjisë, shpërndarjes dhe gjeneratorëve të specializuar - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe seteve motor gjenerator - riparimin dhe mirëmbajtjen e çelësave dhe aparaturave të paneleve të kontrollit - riparimin dhe mirëmbajtjen e releve dhe pajisjeve të kontrollit industrial - riparimin dhe mirëmbajtjen e baterive parëse dhe të magazinimit - riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike të ndriçimit - riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për lidhjen e telave që përçojnë rrymë dhe pajisjeve për lidhjen e telave që nuk përçojnë rrymë për telëzimin e qarqeve elektrike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - riparimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të karikimit të makinave
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve elektrikë të barkave dhe anijeve, të mjeteve motorike dhe motoçikletave, shih 33.15, 95.31 dhe 95.32 - riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe pajisjeve periferike të kompjuterëve, shih 95.10 - riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të telekomunikacionit, shih 95.10 - riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike të konsumit, shih 95.21 - riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve shtëpiake, shih 95.22 - riparimin e orëve të dorës dhe orëve të murit, shih 95.25

NVE Rev 2.1 kod	33.15
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e anijeve dhe barkave civile
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e barkave dhe anijeve civile. Kjo klasë përfshin: - riparimin dhe mirëmbajtjen e anijeve civile - riparimin dhe mirëmbajtjen e barkave të argëtimit - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të anijeve dhe barkave civile, përfshirë motorët elektrikë jashtë bordit - riparimin dhe mirëmbajtjen e strukturave lundruese
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kontrollin në fabrikë të motorëve të anijeve dhe barkave civile, për sport dhe argëtim, shih 28.11 - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e anijeve dhe barkave civile, shih 30.11 - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e barkave për sport dhe argëtim, shih 30.12 - riparimin dhe mirëmbajtjen e anijeve dhe barkave ushtarake, shih 33.18 - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të anijeve dhe barkave ushtarake, shih 33.18

NVE Rev 2.1 kod	33.16
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve ajrore dhe hapësinore civile
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe hapësinore civile.
	Kjo klasë përfshin:
	- riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore civile (përveç konvertimeve në fabrikë, remonteve në fabrikë, rindërtimeve në fabrikë) - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve ajrore
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e mjeteve ajrore civile, shih 30.31 - kontrollin në fabrikë të motorëve të mjeteve ajrore civile, shih 30.31 - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, mjeteve ajrore dhe hapësinore ushtarake për luftë, shih 33.18
NVE Rev 2.1 kod	33.17
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera civile të transportit
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tjera të transportit të ndarjes 30.
	Kjo klasë përfshin:
	- riparimin dhe mirëmbajtjen e lokomotivave dhe konvertimit të vagonëve hekurudhorë - riparimin e karrocave me një ose dy akse të tërhequra nga kafshët - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për personat me aftësi të kufizuara - riparimin e mjeteve me shtytje me fuqi krahu ose të tërhequra nga kafshët
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e lokomotivave dhe vagonëve, shih 30.20 - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të lokomotivës, shih 33.12 - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ushtarake për luftë, shih 33.18 - riparimin e biçikletave, shih 95.29 - riparimin dhe mirëmbajtjen e motoçikletave, shih 95.32

NVE Rev 2.1 kod	33.18
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve tokësore, anijeve, barkave, mjeteve ajrore dhe hapësinore luftarake ushtarake
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, anijeve, barkave, mjeteve ajrore dhe hapësinore luftarake ushtarake. Kjo klasë përfshin: - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore dhe hapësinore ushtarake - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ushtarake luftarake - riparimin dhe mirëmbajtjen e anijeve, barkave dhe strukturave lundruese ushtarake - riparimin dhe mirëmbajtjen e motorëve të mjeteve, anijeve, barkave, mjeteve ajrore dhe hapësinore luftarake ushtarake
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kontrollin në fabrikë të motorëve të anijeve dhe barkave ushtarake, shih 28.11 - kontrollin në fabrikë dhe rindërtimin e mjeteve ushtarake për luftë, anijeve, barkave, strukturave pluskuese, mjeteve ajrore dhe hapësinore, shih 30.13, 30.32, 30.40 - kontrollin në fabrikë dhe konvertimin e motorëve të mjeteve ajrore ose atyre ajrore ushtarake, shih 30.32 - mirëmbajtjen dhe riparimin e barkave, anijeve, mjeteve ajrore dhe hapësinore, dhe mjeteve të tjera civile, shih 33.15, 33.16

NVE Rev 2.1 kod	33.19
Përshkrim	Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera
Përfshin	Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve që nuk trajtohen në grupe të tjera të kësaj ndarje. Kjo klasë përfshin: - riparimin e rrjetave të peshkimit, përfshirë arnimin - riparimin e litarëve, litarëve mbajtës, pëlhurave për vela, dhe mushamave - riparimin e thasëve për mbajtjen e plehëruesve dhe kimikateve - riparimin dhe ripërtëritjen e paletave prej druri, fuçive ose vozave për transport dhe artikujve të ngjashëm - riparimin e makinave të lojërave dhe lojërave të fatit - riparimin e shtretërve spitalorë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - riparimin e mobilieve shtëpiake dhe të zyrës, shih 95.24 - riparimin e biçikletave, shih 95.29 - riparimin dhe ndërrimin e veshjes, shih 95.29

NVE Rev 2.1 kod	33.2
Përshkrim	Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	33.20
Përshkrim	Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale
Përfshin	Kjo klasë përfshin instalimin e specializuar të makinerive. Megjithatë, instalimi i pajisjeve që janë pjesë integrale të ndërtesave ose strukturave të ngjashme, p.sh. instalimi i shkallëve lëvizëse, telave elektrikë, sistemeve të alarmit kundër vjedhjeve, apo i sistemeve të kondicionimit të ajrit, klasifikohet si ndërtim. Kjo klasë përfshin: - instalimin e makinerive industriale në impiante industriale - instalimin dhe montimin e pajisjeve të kontrollit të procesit industrial - instalimin e pajisjeve të tjera industriale, p.sh.: • pajisjet e komunikimit • kompjuterëve qendrorë dhe kompjuterëve të ngjashëm • pajisje rrezatimi dhe elektromjekësore, etj. - çmontimin e makinerive dhe pajisjeve të mëdha - aktivitetet e teknikëve të mullinjve - furnizimin dhe montimin e makinerive - instalimin e pajisjeve të sallave të bowling-ut - instalimin e makinerive dhe pajisjeve të magazinave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - instalimin e rafteve të mëdha, magazinave (jo si pjesë përbërëse të ndërtesave) - instalimin e stacioneve të veçanta të karikimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - instalimin e stacioneve të karikimit në kuti të vendosura në mur, shih seksionin F - ndërtimin e magazinave të plota, shih 41.00 - instalimin e ashensorëve, shkallëve lëvizëse, dyerve automatike, sistemeve të pastrimit me vakum, etj., shih 43.24 - instalimin e dyerve, shkallëve, pajisjeve dhe mobilieve të dyqanit, etj., shih 43.32 - ngritjen e elementeve konstruktive prej çeliku për raftet e sistemimit në magazina, shih 43.42 - instalimin (vendosjen në punë) të kompjuterëve personalë, shih 62.90

NVE Rev 2.1 kod	D
Përshkrim	FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR
Përfshin	Ky seksion përfshin prodhimin, magazinimin, kontrollin, shpërndarjen, tregtimin dhe ndërmjetësimin e energjisë elektrike ose të lëndëve djegëse të gazta për furnizimin me energji përmes rrjeteve të përhershme të linjave, tubave ose tubacioneve. Përfshihet furnizimi me energji për parqet industriale ose godinat e banimit. Ky seksion si pasojë përfshin operimin e shoqërive të gazit dhe energjisë elektrike.
Përfshin gjithashtu	Ky seksion përfshin gjithashtu ngrohjen dhe ftohjen, p.sh. furnizimin me avull dhe ajër të kondicionuar, nëpërmjet një rrjeti të përhershëm.
Nuk përfshin	Ky seksion nuk përfshin: - nxjerrjen e gazit natyror të papërpunuar, shih 06.20 - shërbimet e furnizimit me ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza, shih ndarjet 36, 37 - transportin e gazit përmes tubacioneve, d.m.th. jo përmes rrjetit të shpërndarjes, shih 49.50
NVE Rev 2.1 kod	35
Përshkrim	Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	35.1
Përshkrim	Prodhim, transmetim dhe shpërndarje e energjisë elektrike
Përfshin	Ky grup përfshin prodhimin e energjisë elektrike, transmetimin nga impiantet prodhuese drejt qendrave të shpërndarjes, dhe shpërndarjen drejt përdoruesit fundor. Tregtia dhe magazinimi i energjisë përfshihet gjithashtu.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - prodhimin dhe shpërndarjen e veçantë të avullit dhe nxehtësisë, shih 35.3 - aktivitetet e ndërmjetësuesve ose agentëve të energjisë elektrike që organizojnë shitjen e energjisë elektrike nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes së energjisë që janë në operim nga të tjerë, shih 35.4
NVE Rev 2.1 kod	35.11
Përshkrim	Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet jo të rinovueshme
Përfshin	Kjo klasë përfshin:

- operimin e objekteve gjeneruese që prodhojnë energji elektrike nga burime jo të rinovueshme (p.sh. gaz natyror, qymyr dhe lëndë të tjera fosile), dhe nga burime jo të rinovueshme pa emetim (p.sh. burimet bërthamore)

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, shih 35.12
prodhimin e energjisë elektrike si pjesë të aktiviteteve për ruajtjen e energjisë elektrike, shih 35.16
- trajtimin paraprak të mbetjeve për prodhim energjie, shih 38.22

NVE Rev 2.1 kod

35.12

Përshkrim

Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin me avull, pastrimin me rërë(pastrim i metaleve nga ndryshku) dhe aktivitete të ngjashme për pjesët e jashtme të ndërtesave, shih 81.22

NVE Rev 2.1 kod 43.4

Përshkrim	Punime të veçanta ndërtimi gjatë zbatimit të projektit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	43.41
Përshkrim	Punime të çatisë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - punimet e strukturës së çatisë - instalimin e trarëve të çatisë - izolimi i jashtëm i çative - vendosja e mbulesës së çatisë - izolimi i çatisë - hidroizolimi i çatisë - instalimin e tubave kulluese, ulluqeve dhe tubave të ujit të shiut - instalimin e ndriçueseve të çatisë dhe të baxhave - instalimin e profileve të çarjes së dëborës në çatitë dhe pjerrësinë e duhur - instalimin e rrufe-pritësve në çati
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - izolimin e brendshëm të çative, shih 43.23
NVE Rev 2.1 kod	43.42
Përshkrim	Punime të veçanta ndërtimi gjatë zbatimit të projektit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - punime të specializuara ndërtimi në një aspekt të përbashkët për ndërtimin e ndërtesave, që kërkojnë aftësi apo pajisje të specializuara: • ndërtimi i themeleve për ndërtesat, duke përfshirë vendosjen e pilotave • heqjen e lagështisë së ajrit të ndërtesave që krijohet nga materialet e ndërtimit • ngritja e komponentëve strukturorë prej çeliku të parafabrikuar • ngritja e oxhaqeve dhe furrave industriale
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - ndërtimin ose instalimi i sobave të ngrohjes me tulla, shih 43.22
NVE Rev 2.1 kod	43.5
Përshkrim	Punime të veçanta ndërtimi në inxhinierinë civile

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

43.50

Përshkrim

Punime të veçanta ndërtimi në inxhinierinë civile

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e ndërtimit të specializuara në një aspekt të përbashkët të inxhinierisë civile, që kërkojnë aftësi të specializuara ose pajisje të veçanta:
 - ndërtimin e themeleve për inxhinierin civile, duke përfshirë vendosjen e pilotave
 - shpim pusi në thellësi
 - ngritjen e strukturave të çelikut për projektet e inxhinierisë civile
 - instalimin e barrierave mbrojtëse, shenjave të trafikut etj.
- ngritjen e mureve mbrojtjes kundër zhurmës,(p.sh. përgjatë rrugëve)
- instalimin e pajisjeve rrugore
- instalimin e pishinave të parafabrikuara
- lyerjen e rrugëve dhe vendosjen e sinjalistikës në të
- ngritjen e mureve mbrojtëse prej betoni dhe instalimin e barrierave mbrojtjes për rënien e gurëve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- punime sipërfaqësore, p.sh. asfaltimi i rrugëve me asfalt, beton, gur etj.), shih 42.11
- ndërtimin e pishinave të parafabrikuara, shih 42.99

NVE Rev 2.1 kod

43.6

Përshkrim

Aktivitete shërbimi ndërmjetësimi për shërbime të specializuara në ndërtim

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	43.60
Përshkrim	Aktivitete shërbimi ndërmjetësimi për shërbime të specializuara në ndërtim
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin për shërbime të specializuara ndërtimi duke bashkuar klientët dhe ofruesit e shërbimeve për një tarifë ose komision, ku ndërmjetësi nuk e ofron vetë shërbimin e specializuara për të cilin po ndërmjetësohet. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platformat digjitale ose nëpërmjet kanaleve jo-digjitale (ballë për ballë, telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret nga klienti ose ofruesi i shërbimeve të specializuara të ndërtimit. Të ardhurat nga këto aktivitete ndërmjetësimi mund të përfshijnë burime të tjera të të ardhurave, (p.sh. të ardhurat nga shitja e hapësirës reklamuese).

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	43.9
Përshkrim	Punime të tjera të specializuara ndërtimi

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	43.91
Përshkrim	Punime murature
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shtrimin e tullave, shtrimin e blloqeve, vendosjen e gurëve dhe punime të tjera murature.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	43.99
Përshkrim	Punime të tjera të specializuara ndërtimi p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitete ndërtimi të specializuara në një aspekt të përbashkët por për lloje të ndryshme strukturash që kërkojnë aftësi ose pajisje të specializuara p.k.t: • punime hekur-thyesi për përforcimin e ndërtesës(çelik armaturë), në kantierin e ndërtimit • montimin dhe çmontimin e skelave dhe platformave të punës - instalimin e pajisjeve të sigurisë në kantierin e ndërtimit - punime që kërkojnë aftësi të veçanta për ngjitje dhe përdorimin e pajisjeve që lidhen me të, p.sh. punimi në lartësi mbi struktura të larta - qiradhënia e vinçave dhe pajisjeve të tjera të ndërtimit, të cilat nuk mund të caktohen për një lloj të veçantë ndërtimi me një operator - riparimin/restaurimin e strukturave të betonit të përforcuar,(p.sh. trarët,

kolonat)

- ngritjen e tabelave apo kolonave reklamuese
- punime të betonimit

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- rinovimin, përforcimin, rindërtimin dhe restaurimin e vendeve dhe ndërtesave historike dhe arkeologjike

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- qiradhënien e skelave dhe platformave të punës, pa montim dhe çmontim, shih 77.32
- qiradhënin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit pa operator, shih 77.32

Ky seksion përfshin shitjen me shumicë dhe pakicë (shitje pa transformim) të të gjitha llojeve të mallrave, dhe kryerjen e të gjitha shërbimeve në lidhje me shitjen e mallrave. Mallrat janë objekte fizike të prodhuara, për të cilat ekziston një kërkesë, mbi të cilat mund të vendosen të drejtat e pronësisë dhe pronësia e të cilave mund të transferohet nga një njësi në tjetrën duke u përfshirë në transaksione në tregje. Kjo është në përputhje me përkufizimet dhe konceptet e aplikuar në fushën e Bilancit të Pagesave, Task Forca e Ekonomisë Digjitale G20, Manuali për Matjen e Tregtisë Digjitale etj. Shitja me shumicë dhe pakicë janë hapat e fundit në shpërndarjen e mallrave. Për këtë qëllim, kryhen aktivitete ndihmëse (shih udhëzimet hyrëse, kapitulli xx), të cilat përfshijnë një sërë veprimesh të zakonshme (ose përpunimesh) lidhur me tregtinë, pa transformuar mallrat. Këto veprime (ose përpunime) përfshijnë: renditjen, klasifikimin dhe montimin e mallrave, përzierjen e mallrave (p.sh. rërë), mbushjen e shisheve (me ose pa pastrimin e mëparshëm të shisheve), ambalazhimin, copëzimin dhe ripaketimin për shpërndarje në pjesë më të vogla, magazinimin (qoftë i ngjirë apo i ftohtë). Nëse nuk kryhen si veprime (ose përpunime) të zakonshme që lidhen me tregtinë, aktivitetet e përmendura mund të kryhen si aktivitete kryesore, dytësore ose ndihmëse në seksione të tjera të NVE. Dallimi midis ndarjes 46 (shitje me shumicë) dhe ndarjes 47 (shitje me pakicë) bazohet në llojin e klientit. Tregtia me shumicë është rishitja e mallrave të reja dhe të përdorura ndaj shitësve me pakicë, tregtia midis ndërmarrjeve, p.sh. ndaj përdoruesve industrialë, tregtarë, institucionalë, ose profesionalë, ose ndaj shitësve të tjerë me shumicë, ose ndërmjetësimi në blerjen dhe shitjen e mallit ose shitjen e mallit personave apo ndërmarrjeve. Llojet kryesore të ndërmarrjeve të përfshira janë tregtarët me shumicë p.sh. tregtarë ekskluzivë të mallrave që ata shesin, distributorë industrialë, eksportues, importues, degë shitje dhe zyra shitje (por jo dyqane të shitjes me pakicë) që mbahen nga njësitë e prodhimit ose njësitë e minierave veçmas nga uzinat e tyre ose minierat për qëllime të marketingut të produkteve të tyre dhe që nuk marrin thjesht urdhëra për të furnizuar direkt nga uzinat ose minierat. Gjithashtu përfshihen ndërmjetësit për shitjen e mallrave dhe produkteve, tregtarët e komisioneve, agjentët, grumbulluesit dhe blerësit. Nëse tregtari me shumicë nuk merr përsipër pronësinë e mallrave që tregton me shumicë, atëherë klasifikohet në grupin 46.1. Nëse tregtari me shumicë merr pronësinë e mallrave, edhe nëse vepron në emër të një pale të tretë, klasifikohet në grupet 46.2-46.9. Tregtarët me shumicë shpesh fizikisht i mbledhin, paketojnë dhe klasifikojnë mallrat në sasi të mëdha, e coptojnë mallin e ripaketojnë dhe e rishpërndajnë në sasi më të vogla, p.sh. farmaceutike; depozitojnë, ngrijnë, shpërndajnë, dhe vendosin mallrat, merren me promovimin e shitjeve për klientët e tyre dhe për dizejnimin e firmës. Shitja me pakicë është rishitja e mallrave të reja dhe të përdorura te konsumatori përfundimtar për konsum ose përdorim personal ose shtëpiak, pavarësisht nga ku i blejnë, nga dyqanet, magazinat e mëdha, tezgat, shitjet me postë, shitësit derë më derë, shitës ambulantë, kooperativa konsumatore, shitjet me ankand etj. Përfshin shitjen e mallrave nëpërmjet sallave të ekspozitave (ku mund të blihen mallrat e ekspozuara), nëpërmjet pikave të përkohshme të shitjes (p.sh. dyqane të emergjencës) si dhe në dyqane të automatizuara të shitjes me pakicë. Shumica e shitësve me pakicë marrin pronësinë e mallrave që shesin, por disa veprojnë si agjentë për një principal dhe shesin ose me ngarkesë ose në bazë të komisionit. Nëse shitësi me pakicë nuk merr përsipër pronësinë e mallrave që tregton, klasifikohet në grupin 47.9. Nëse shitësi me pakicë merr pronësinë e mallrave, edhe nëse vepron në emër të një pale të tretë, klasifikohet në grupet 47.1-47.8. NVE-ja nuk bën asnjë dallim në nivel grupi dhe klase midis tregtisë me pakicë në dyqan dhe tregtisë me pakicë në internet. Shumica e aktiviteteve të shitjes me pakicë operojnë si në dyqan ashtu edhe në internet (si dhe kanale të tjera të shpërndarjes) dhe është e

vështirë të bëhet dallimi midis dy kanaleve të shpërndarjes/shitjes bazuar në metodat kryesore të shitjes. Kuota e shitjeve nga interneti dhe nga dyqani fizik mund të ndryshojë me kalimin e kohës duke ndikuar në stabilitetin e klasifikimit. Kriteret kryesore të klasifikimit për tregtinë me pakicë në NVE pavarësisht nga produkti i shitur, bazohen në atë çfarë shitet dhe jo në kanalet e shitjes. Tregtia me pakicë nga shitjet me postë ose internet klasifikohet sipas llojit të mallrave të shitura. Dallimi midis tregtisë me shumicë dhe pakicë nuk bazohet në sasinë e mallrave të shitura, pasi shitja me shumicë mund të bëhet për njësi, ashtu si shitja me pakicë mund të bëhet në sasi të mëdha. Përndryshe, dallimi kryesor midis tregtisë me shumicë dhe pakicë është lloji i klientit. Tregtia me shumicë zakonisht ka si klient ndërmarrjen, dhe tregtinë me pakicë zakonisht shitjet u drejtohen klientëve përfundimtarë. Nëse një tregtar i shet pa dallim edhe ndërmarrjes edhe klientëve përfundimtarë, dhe është praktikisht e pamundur të dallosh se cili klient është dominant, atëherë rekomandohet që shitësi të trajtohet si shitës me pakicë. Përzierja e pijeve që do të sigurohet nga prodhuesi ose nga një kontraktor klasifikohet në prodhim (seksioni C). Nëse kryhet si aktivitete (ose përpunim) e zakonshme lidhur me tregtinë, konsiderohet si aktivitet ndihmës dhe i integruar në seksionin G.

Përfshin gjithashtu

Ky seksion përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e transportit tregtar që konsistojnë në blerjen e mallrave, lëvizjen e tyre nga një territor doganor në tjetrin. Transporti tregtar paraqet një transaksion trekëndor në të cilin tregtari i transportit kryen transaksione eksporti dhe importi ndërmjet dy ose më shumë vendeve të ndryshme jashtë territorit të tij ekonomik. Tregtari i transportit zotëron mallin gjatë transportit të tij (ndryshimi nga ndërmjetësit që nuk marrin pronësinë e mallrave të ndërmjetësuar)
- aktivitete të specializuara dhe jo të specializuara të shërbimit të ndërmjetësimit për shitje me pakicë, shih 47.9
- shitja e ushqimit ose dhe pijeve nëpërmjet makinave ose pikave të automatizuara të shitjes

Nuk përfshin

Ky seksion nuk përfshin:

- tregtinë e energjisë elektrike, shih 35.15
- tregtimin e lëndëve djegëse të gazta për furnizim me energji përmes rrjetit, shih 35.23
- tregtinë e mallrave digjitale, transmetimin dhe shkarkimin në platforma digjitale, p.sh. librat elektronikë, audio, përfshihen në seksionin J
- aktivitetet e rishitësve të kartave të telefonisë celulare dhe shërbimeve me parapagesë, shih 61.20
- riparimin e mjeteve motorike dhe motoçikletave, shih ndarjen 95
- shoqëritë e përbëra klasifikohen sipas aktiviteteve të tyre mbizotëruese

Përshkrim

TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË

Përfshin

Kjo ndarje përfshin shitjen me shumicë për llogari të vet ose me pagesë në bazë kontrate (komisione tregtare) lidhur me shitjen me shumicë të brendshme si edhe shitjen me shumicë ndërkombëtare (import/export), duke përfshirë edhe internetin.

Shitja me shumicë për llogari të vet nënkupton zotërimin e mallrave të tregtuara derisa pronësia t'i kalojë blerësit. Në rastin e tregtisë së transportit, mallrat porositen nga një blerës, por agjenti i zotëron mallrat ndërsa ato janë në tranzit, megjithatë të dyja rastet klasifikohen në të njëjtën mënyrë (grupet 46.2-46.9).

Kjo ndarje përfshin shitjen me shumicë me pagesë në bazë kontrate (grupi 46.1), shitje të specializuara me shumicë (grupet 46.2-46.8) dhe jo të specializuara me shumicë (grupi 46.9); klasa 46.39 është një përjashtim pasi përfshin shitjen me shumicë jo të specializuar të ushqimeve, pijeve dhe duhanit.

Rregullat për përcaktimin e aktiviteteve të specializuara dhe jo të specializuara të tregtisë me shumicë përshkruhen në paragrafët xx-xx të udhëzimeve.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të mjeteve motorike dhe motoçikletave, pjesëve, pajisjeve dhe aksesoreve përkatës
- aktivitetin e transportit tregtar

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- tregtimin e energjisë elektrike, shih 35.15
- tregtimin e lëndëve djegëse të gazta për furnizim me energji përmes rrjetit, Shih 35.23
- dhënien dhe marrjen me qira të mallrave, shih ndarjen 77
- paketimin e mallrave të ngurtë dhe ambalazhimi në shishe i produkteve të lëngshëm ose të gaztë përfshirë përzierjen ose filtrimin për të tretë, shih 82.92

NVE Rev 2.1 kod

46.1

Përshkrim

Aktivitete të ndërmjetësimit në shitjen me shumicë

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit, d.m.th. të lehtësimit të transaksioneve ndërmjet shitësve dhe blerësve për porositjen e mallrave me tarifë ose komision pa marrë pronësinë e mallrave të ndërmjetësuar, duke përfshirë:

- aktivitetin e agjentëve dhe tregtarëve të tjerë me shumicë që tregtojnë për llogari të tjerëve pa zotëruar mallrat e ndërmjetësuar në çdo kohë
- aktivitetin shërbimit të bërit bashkë të shitësit dhe blerësit- aktivitetin e ndërmarrjes së transaksioneve tregtare në emër të aktivitetit kryesor, përfshirë internetin

Përfshin gjithashtu

Ky grup përfshin gjithashtu:

- aktivitetin e njërive qendrore të blerjeve, kur ato shërbejnë vetëm si ndërmjetës dhe nuk zotërojnë mallrat
- aktivitetin e shitjes me shumicë të shtëpive e të mallrave me ankand, përfshirë internetin

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9
- aktivitetin e agjentëve me komision që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9
- aktivitetin e ndërmjetësimit për shitjen me pakicë, shih 47.9
- aktivitetin e ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme, shih 68.31
- faqet e internetit që ofrojnë kërkime për mallra që lidhin klientët me shitësit, shikoni klasat korresponduese për aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit
- aktivitetin e reklamimit, kërkimit të tregut dhe marrëdhënieve me publikun, shih ndarjen 73

NVE Rev 2.1 kod

46.11

Përshkrim

Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore si dhe kafshëve të gjalla, lëndëve të para tekstile si dhe mallrave gjysmë te gatshme

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e ndërmjetësimit për shitjen me shumicë të ushqimeve për gjënë e gjallë
- aktivitetet e agjentëve të përfshirë në ankandet me shumicë për lëkurën e gëzofit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët shtëpiake, shih 46.17
- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9
- aktivitetin e agjentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9

NVE Rev 2.1 kod	46.12
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të: - karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale, përfshirë dhe plehëruesit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agjentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9

NVE Rev 2.1 kod	46.13
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të: • ndërtesave të parafabrikua dhe pajisjeve të ndërtimit • paletave të kontejnerëve prej druri dhe pjesëve të tyre • pajisje sanitare
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e ndërmjetësimit që merr përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9

NVE Rev 2.1 kod	46.14
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe avionëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të: - makinerive, duke përfshirë makineritë e zyrës dhe kompjuterët, pajisjet industriale, anijet dhe avionët - pajisjeve telefonike dhe komunikimit, duke përfshirë telefonat celularë, modemët etj.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin edhe: - aktivitetin e agentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të pajisjeve bujqësore, përfshirë traktorët - aktivitetin e agentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të jahteve dhe barkave të argëtimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetin e ndërmjetësimit për shitjen e automjeteve dhe motoçikletave, shih 46.18 - aktivitetin e ankandeve për shitjen me shumicë për të tretët të mjeteve motorike, duke përfshirë ankandet me shumicë të automjeteve nëpërmjet internetit, shih 46.18 - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9

NVE Rev 2.1 kod	46.15
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të mobilieve, artikuj shtëpiakë, artikujve elektronikë dhe hekurishteve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9

NVE Rev 2.1 kod	46.16
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve dhe artikujve prej lëkure
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agjentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9
NVE Rev 2.1 kod	46.17
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të mallrave ushqimorë, pijeve dhe duhanit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetin e ndërmjetësimit për shitjen me shumicë të suplementeve ushqimore për konsum nga njerëzit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e agjentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët shtëpiake - aktivitetet e agjentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të suplementeve ushqimore për konsum nga kafshët
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agjentëve që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9
NVE Rev 2.1 kod	46.18
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë të produkteve të tjera të veçanta
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të mallrave farmaceutike dhe mjekësore, artikujve të parfumerisë e të tualetit dhe materialeve të pastrimit - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të lojërave dhe lodrave, mallrave sportive, biçikletave, librave, gazetave, revistave dhe artikujve shkrimi, instrumenteve muzikore, orëve dhe bizhuterive, pajisjeve fotografike dhe optike - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të makinave dhe mjeteve të lehta motorike, kamionëve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, automjeteve për kamping, p.sh. karvanët dhe shtëpitë lëvizëse, motoçikletat, duke përfshirë, biçikletat, pajisjet e transportit personal me motor dhe mjetet lëvizëse; këto mjete motorike përfshijnë automjetet elektrike - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të pjesëve dhe aksesoreve të mjeteve motorike, motoçikletave, biçikletave, pajisjeve të transportit personal të motorizuar dhe mjeteve lëvizëse - aktivitetin e ndërmjetësimit në shitjen me shumicë të mbetjeve - aktivitetin e ankandeve me shumicë të mallrave të palëve të treta të mjeteve motorike, duke përfshirë ankandet me shumicë në internet të automjeteve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e ndërmjetësimit që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agjentëve të sigurimit, shih 66.22 - aktivitetin e agjentëve të pasurive të paluajtshme, shih 68.31

NVE Rev 2.1 kod	46.19
Përshkrim	Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë jo të specializuar
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e ndërmjetësimit që marrin përsipër pronësinë e mallrave, edhe nëse ata veprojnë në emër të një pale të tretë, shih 46.2 deri në 46.9 - aktivitetin e agjentëve të pasurive të patundëshme, shih 68.31 - aktivitetin e ndërmjetësimit të shërbimeve për mallra (transport, sigurime, reklama), shih klasën sipas atij shërbimi të veçantë

NVE Rev 2.1 kod	46.2
Përshkrim	Tregtia me shumicë e lëndëve të para bujqësore dhe kafshëve të gjalla
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetin e tregtarëve me shumicë që nuk marrin përsipër pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1

NVE Rev 2.1 kod	46.21
Përshkrim	Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të drithërave dhe farave për mbjellje - shitjen me shumicë të frutave vajore - shitjen me shumicë të duhanit të papërpunuar - shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët dhe mbetjeve nga nënproduktet e përdorura për ushqimin e kafshëve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të farave të luleve dhe bimëve, shih 46.22 - shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët shtëpiake, shih 46.38 - shitjen me shumicë të plehrave dhe produkteve agrokimike, shih 46.85 - shitjen me shumicë të fibrave tekstile, shih 46.86

NVE Rev 2.1 kod	46.22
Përshkrim	Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të luleve dhe bimëve - shitjen me shumicë të farave të luleve dhe bimëve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	46.23
Përshkrim	Tregtia me shumicë e kafshëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të kafshëve shtëpiake
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	46.24
Përshkrim	Tregtia me shumicë e gëzofit dhe lëkurës, si lëndë e parë dhe si produkt përfundimtar
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të lëkurës së papërpunuar, të përpunuar dhe gëzofit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: -aktivitetet e agjentëve të përfshirë në ankandet me shumicë për lëkurën e gëzofit, shih 46.11
NVE Rev 2.1 kod	46.3
Përshkrim	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit
Përfshin	Ky grup përfshin: - shitjen me shumicë të ushqimeve të freskëta, të konservuara dhe të ngrira - shitjen me shumicë, të specializuar dhe jo të specializuar, të ushqimeve, të pijeve dhe duhanit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetin e tregtarëve me shumicë që nuk marrin përsipër pronësinë e mallrave që shesin, shih 46.1

NVE Rev 2.1 kod	46.31
Përshkrim	Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të freskëta - shitjen me shumicë të bishtajoreve - shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të thata - shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të konservuara - shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të ngrira
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të kërpudhave
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 46.34 - shitjen me shumicë të ushqimeve të gatshme, shih 46.38
NVE Rev 2.1 kod	46.32
Përshkrim	Tregtia me shumicë e mishit, nënprodukteve të mishit, peshkut dhe nënprodukteve të peshkut
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të mishit dhe nënprodukteve të mishit - shitjen me shumicë të shpendëve dhe kafshëve të gjahut - shitjen me shumicë të peshkut dhe nënprodukteve të peshkut - shitjen me shumicë të prodhimeve të detit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të plëncit, sallameve dhe mishit të kriposur - shitjen me shumicë të kërmijve - shitjen me shumicë të algave dhe leshterikëve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të ushqimit për bagëtitë , shih 46.21 - shitjen me shumicë e ushqimeve të gatshme, shih 46.38 - shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët shtëpiake, shih 46.38
NVE Rev 2.1 kod	46.33
Përshkrim	Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve, vajit të gatimit dhe yndyrnave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të produkteve të qumështit - shitjen me shumicë të vezëve dhe produkteve që përmbajnë vezë - shitjen me shumicë të vajrave dhe yndyrave ushqimore me origjinë shtazore ose bimore

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të qumështit pluhur - shitjen me shumicë të akulloreve dhe sorbetove
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	46.34
Përshkrim	Tregtia me shumicë e pijeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të pijeve alkoolike - shitjen me shumicë të pijeve jo alkoolike - shitjen me shumicë të lëngjeve të frutave dhe perimeve - shitjen me shumicë të pijeve të përgatitura në kanaçe ose shishe
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - blerjen e verës në sasi të madhe dhe ambalazhimi në fuçi ose shishe pa transformim
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - përzierjen e verës, pijeve alkoolike të distiluara dhe pijeve të tjera (për të krijuar një produkt të ri), shih 11.01, 11.02, 11.07
NVE Rev 2.1 kod	46.35
Përshkrim	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të produkteve dhe aksesoreve të duhanit dhe duhanpirjes, përfshirë çakmakë, llulla, pajisjet për përgatitjen e cigareve etj.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të cigareve elektronike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të lëngjeve për cigare elektronike, shih 46.85
NVE Rev 2.1 kod	46.36
Përshkrim	Tregtia me shumicë e sheqerit, çokollatës dhe ëmbëlsirave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të sheqerit, përfshirë sheqerin në formë kubi, melasën, ëmbëlsirat dhe çokollatën - shitjen me shumicë të produkteve të furrave pjekëse (bukë, biskota etj)
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të akullores, shih 46.33

NVE Rev 2.1 kod

46.37

Përshkrim

Tregtia me shumicë e kafesë, çajit, kakaos dhe erëzave

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e çajit dhe kafesë, shih 10.83

- shitjen me shumicë të pijeve të përgatitura në kanaçe ose shishe, shih 46.34

NVE Rev 2.1 kod

46.38

Përshkrim

Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë ushqimorë

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitetet e tjera të shitjes së specializuar me shumicë, të paklasifikuara në klasat e mëparshme nga 46.31 deri në 46.37, p.sh. shitja me shumicë e kripës, uthullës, miellit, majasë, mjaltit.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të ushqimeve të gatshme

- shitjen me shumicë të preparateve ushqimore të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike

- shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët shtëpiake

- shitjen me shumicë të suplementeve ushqimore për t'u konsumuar nga njerëzit

- shitjen me shumicë të insekteve, të cilat përpunohen dhe janë të gatshëm për t'u ngrënë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të ushqimeve për kafshët, shih 46.21

NVE Rev 2.1 kod

46.39

Përshkrim

Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan

Përfshin

Kjo klasë përfshin tregtinë me shumicë të ushqimeve, pijeve dhe produkteve të duhanit të shitura në pesë ose më shumë klasa të grupit 46.3. Nëse produktet e shitura përbëjnë deri në katër klasa në grupin 46.3, njësia konsiderohet tregti e specializuar dhe klasifikohet, duke ndjekur aktivitetin kryesor të përcaktuar në bazë të vlerës së shtuar, në klasat 46.31 deri në 46.38

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	46.4
Përshkrim	Tregtia me shumicë e artikujve shtëpiakë
Përfshin	Ky grup përfshin shitjen me shumicë të mallrave shtëpiakë, duke përfshirë tekstilet dhe mobilitet.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e shitësve me shumicë që nuk marrin përsipër pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1 - shitjen me shumicë të pajisjeve të kopshtarisë dhe peizazhit, p.sh. kositëset e barit, shih 46.61

NVE Rev 2.1 kod	46.41
Përshkrim	Tregtia me shumicë e tekstileve
Përfshin	Kjo klasë përfshin : - shitjen me shumicë të fijeve që përdoren përthurje ose qepje - shitjen me shumicë të metrazheve - shitjen me shumicë të pëlhurave për përdorim shtëpiak si perde, mbulesë, peshqirë etj. - shitjen me shumicë të kinkalerive për tekstile: gjilpëra, fije për qepje etj. - shitjen me shumicë të çadrave, mushamave, velave, parashutave etj.

Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të veshjeve, shih 46.42 - shitjen me shumicë të tendave dhe çantave për fjetje, shih 46.49 - shitjen me shumicë të fibrave tekstile, shih 46.86

NVE Rev 2.1 kod	46.42
Përshkrim	Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të veshjeve, përfshirë veshjet sportive - shitjen me shumicë të aksesorëve, p.sh. doreza, kravata, rripa - shitjen me shumicë të këpucëve, përfshirë këpucët sportive jo të specializuara - shitjen me shumicë të artikujve prej gëzofi - shitjen me shumicë të ombrellave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të veshjeve, uniformave dhe kostumeve të punës
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të bizhuterive, shih 46.48 - shitjen me shumicë të artikujve prej lëkure, përveç veshjeve dhe këpucëve, shih 46.49 - shitjen me shumicë të këpucëve sportive të specializuara që përdoren vetëm në ushtrimin e sporteve, p.sh., çizme për ski, këpucë futbolli, patina për ski, këpucë

baleti, shih 46.49
- shitjen me shumicë të mjeteve mbrojtëse për motoçiklistët, shih 46.73

NVE Rev 2.1 kod

46.43

Përshkrim

Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiakeve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pajisjeve elektroshtëpiake
- shitjen me shumicë të radiove dhe televizorëve
- shitjen me shumicë të mallrave fotografike dhe optike përveç syzeve korigjuese, lenteve dhe syzeve të diellit
- shitjen me shumicë të pajisjeve elektrike për ngrohje dhe ftohje
- shitjen me shumicë të pajisjeve me ngrohje të rinovueshme
- shitjen me shumicë të pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe ajër të kondicionuar
- shitjen me shumicë të makinave qepëse të llojit shtëpiak
- shitjen me shumicë të sistemeve dhe alarmeve të sigurisë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të syzeve korigjuese, lenteve dhe syzeve të diellit, shih 46.46
- shitjen me shumicë të mediave të regjistruara, shih 46.49
- shitjen me shumicë të pajisjeve të regjistrimit, shih 46.50
- shitjen me shumicë të makinave qepëse të cilat nuk kanë përdorim shtëpiak, shih 46.64
- shitjen me shumicë të hardware-ve, pajisjeve metalike, hidraulike dhe të ngrohjes, shih 46.84
- shitjen me shumicë të pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe ajër të kondicionuar, për përdorim joshtëpiak, shih 46.84

NVE Rev 2.1 kod

46.44

Përshkrim

Tregtia me shumicë e enëve të porcelanit, xhamit dhe materialeve të pastrimit të tyre

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të produkteve prej porcelani dhe qelqi
- shitjen me shumicë të materialeve të pastrimit
- shitjen me shumicë të orendive shtëpiake, enëve të gatimit dhe enëve prej qeramike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të tiganëve, shih 46.49

NVE Rev 2.1 kod	46.45
Përshkrim	Tregtia me shumicë e produkteve të parfumerisë dhe kozmetikës
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të produkteve të parfumerisë, kozmetikës, sapunëve dhe letrës higjienike
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	46.46
Përshkrim	Tregtia me shumicë e mallrave farmaceutikë dhe mjekësorë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të mallrave farmaceutike, mjekësore dhe ortopedike - shitjen me shumicë të barnave veterinare - shitjen me shumicë të syzeve optike, lenteve dhe syzeve të diellit - shitjen me shumicë të pajisjeve mjekësore dhe kirurgjikale - shitjen me shumicë të pajisjeve spitalore
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të syzave të diellit jokorrigjuese të shikimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të ushqimeve të shëndetshme dhe produkteve dietike, shih 46.38 - shitjen me shumicë të mobilie për struktura mjekësore dhe spitale, shih 46.47
NVE Rev 2.1 kod	46.47
Përshkrim	Tregtia me shumicë e mobilie, tapetave dhe pajisjeve të ndriçimit për banesa, zyra dhe dyqane
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të mobilie - shitjen me shumicë të tapetave - shitjen me shumicë të pajisjeve të ndriçimit - shitjen me shumicë të dyshekëve dhe sustave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të mobilie për magazina, kisha, objekte mjekësore, etj.
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	46.48
Përshkrim	Tregtia me shumicë e orëve dhe bizhuterive
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të gurëve të çmuar, natyralë, sintetikë ose të përpunuar
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të stolive imitim, shih 46.49 - shitjen me shumicë të gurëve të çmuar të papërpunuar, shih 46.86 - shitjen me shumicë të gurëve të çmuar ose gjysmë të çmuar sintetikë të papunuar ose të parindërtuar, shih 46.86
NVE Rev 2.1 kod	46.49
Përshkrim	Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiakë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të mallrave prej druri, shportarie dhe tape, etj. - shitjen me shumicë të biçikletave, biçikletave elektrike, monopatinave, hoverboard-eve, skuterave, si dhe pjesëve dhe aksesoreve përkatës - shitjen me shumicë të artikujve të kancelarisë, librave, revistave dhe gazetave - shitjen me shumicë të mallrave prej lëkure dhe aksesoreve të udhëtimit - shitjen me shumicë të veglave muzikore - shitjen me shumicë të mediave të regjistruara - shitjen me shumicë të lojërave dhe lodrave, duke përfshirë edhe produktet për festa dhe ato magjike - shitjen me shumicë të produkteve sportive, duke përfshirë këpucët sportive speciale, si çizmet për ski, këpucët e futbollit, patinat, këpucët e baletit - shitjen me shumicë të barkave të argëtimit - shitjen me shumicë të pajisjeve për bebet, p.sh. karroca bebesh, karroca me shtyrje, karrocë për të ecur bebet, mbajtëse bebesh, ndenjëse makine për bebe - shitjen me shumicë të medaljeve dhe kupave sportive
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të tendave dhe çantave të gjumit - shitjen me shumicë në artikuj promocionalë - shitjen me shumicë të tenxhereve dhe tiganëve - shitjen me shumicë të takëmeve - shitjen me shumicë të bizhuterive imitim
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të cigareve elektronike, shih 46.35 - shitjen me shumicë të maskave, shih 46.42 - shitjen me shumicë të armëve dhe municioneve, shih 46.64 - shitjen me shumicë të lëngjeve elektronike për cigaret elektronike, shih 46.85

NVE Rev 2.1 kod	46.5
Përshkrim	Tregtia me shumicë e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e shitësve me shumicë që nuk marrin përsipër pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1
NVE Rev 2.1 kod	46.50
Përshkrim	Tregtia me shumicë e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin shitjen me shumicë të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të kompjuterëve, pajisjeve dhe pjesëve kompjuterike periferike - shitjen me shumicë të tabelave inteligjente - shitjen me shumicë të programeve kompjuterike të papersonalizuara, ku përfshihen videolojërat, të mundësuar në pajisje fizike, me të drejtë përdorimi të përhershëm - shitjen me shumicë të valvulave elektronike dhe tubove - shitjen me shumicë të pajisjeve gjysmëpërcjellëse - shitjen me shumicë të mikroçipave dhe qarqeve të integruara - shitjen me shumicë të qarqeve të printuara - shitjen me shumicë të pajisjeve të regjistrueshme - shitjen me shumicë të pajisjeve të telefonisë dhe komunikacionit, si telefonat celularë, modemët - shitjen me shumicë të makinerive dhe pajisjeve për zyrë
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me shumicë të mediave të regjistruara, shih 46.49 - shitjen me shumicë të makinerive për prodhim aditivësh (printerat 3D, etj.), shih 46.64 - aktivitetet botuese, shih ndarjen 58
NVE Rev 2.1 kod	46.6
Përshkrim	Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të tjera
Përfshin	Ky grup përfshin shitjen me shumicë të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve të specializuara për të gjitha llojet e përdorimit dhe makineri për përdorim të përgjithshëm, bashkë me pjesët përkatëse.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin:

- aktivitetet e shitësve me shumicë që nuk marrin përsipër pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1

NVE Rev 2.1 kod

46.61

Përshkrim

Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve të tyre

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe pyjore:

- plugje, shpërndarës të plehut organik, makineri mbjellëse
- makineri korrëse
- makineri shirëse
- makineri mjelje
- makineri për mbajtjen e shpendëve dhe bletëve
- traktorë që përdoren në bujqësi dhe pylltari

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të pajisjeve të kopshtarisë dhe peizazhit, p.sh. kositëset e barit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të ushqimeve për kafshë, shih 46.21

- shitjen me shumicë të plehëruesve dhe produkteve agrokimikë, shih 46.85

NVE Rev 2.1 kod

46.62

Përshkrim

Tregtia me shumicë e veglave të makinerive

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të veglave të makinerive të çdo lloji dhe materiali

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të veglave të makinerive që kontrollohen me kompjuter

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

46.63

Përshkrim

Tregtia me shumicë e makinerive për miniera, ndërtimi, dhe për punime inxhinierike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive dhe pajisjeve për miniera, ndërtim dhe inxhinieri ndërtimi, si makineritë e gërmimit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të skelave, shih 46.83

- shitjen me shumicë të veglave të dorës, pajisjeve metalike, hidraulike, ngrohjes dhe furnizimeve, shih 46.84

Përshkrim

Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive për industrinë tekstile dhe të makinave qepëse dhe thurëse
- shitjen me shumicë të robotëve të linjës së prodhimit
- shitjen me shumicë të makinerive për industrinë e ushqimeve, pijeve dhe duhanit
- shitjen me shumicë të mjeteve të transportit, p.sh. lokomotivat, vagonët, me përjashtim të mjeteve motorike, motoçikletave dhe biçikletave
- shitjen me shumicë të anijeve dhe varkave
- shitjen me shumicë të automjeteve të blinduara
- shitjen me shumicë të avionëve, dronave dhe sistemeve të avionëve pa pilot
- shitjen me shumicë të pajisjeve për kultivimin e peshqeve
- shitjen me shumicë të atraksioneve për parqet argëtuese dhe tematike, p.sh. pajisjet e parqeve
- shitjen me shumicë të pajisjeve për parukeri, palestra, solariume dhe qendra bukurie
- shitjen me shumicë të pajisjeve për evente, panaire dhe ekspozita
- shitjen me shumicë të makinerive të tjera p.k.t. për përdorim në industri, tregti dhe shërbime të tjera
- shitjen me shumicë të materialeve të tjera elektrike, p.sh. elektromotoret, transformatorët
- shitjen me shumicë të baterive dhe akumulatorëve për përdorim shtëpiak
- shitjen me shumicë të telave, çelësve dhe pajisjeve të tjera të instalimit për përdorim industrial
- shitjen me shumicë të paneleve fotovoltaike
- shitjen me shumicë të armëve, sistemeve të armëve dhe municioneve
- shitjen me shumicë të paletave të kutive
- shitjen me shumicë të rezervuarëve, kazanëve dhe kontejnerëve të ngjashëm, me kapacitet > 300 l, të plastikës, për përdorim industrial

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të instrumenteve dhe pajisjeve matëse
- shitjen me shumicë të makinerive për prodhimin e aditivëve (printerat 3D etj.)

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të makinave qepëse të llojit shtëpiak, shih 46.43
- shitjen me shumicë të pajisjeve mjekësore jo-shtëpiake, shih 46.46
- shitjen me shumicë të varkave rekreative, shih 46.49
- shitjen me shumicë të biçikletave, shih 46.49
- shitjen me shumicë të makinerive për miniera, ndërtim, punimeve inxhinierike, shih 46.63
- shitjen me shumicë të mjeteve motorike, duke përfshirë rimorkiot dhe fugonat, shih 46.71
- shitjen me shumicë të pjesëve të automjeteve, shih 46.72
- shitjen me shumicë të baterive dhe akumulatorëve për automjete, shih 46.72
- shitjen me shumicë të motoçikletave, shih 46.73
- shitjen me shumicë të skelave, shih 46.83
- mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike, shih seksionin 95.31
- mirëmbajtjen dhe riparimin e motoçikletave, shih 95.32

NVE Rev 2.1 kod	46.7
Përshkrim	Tregtia me shumicë e automjeteve, motoçikletave, pjesëve dhe aksesoreve të tyre
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e tregtarëve me shumicë që nuk kanë pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1 - mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike, shih 95.31 - mirëmbajtjen dhe riparimin e motoçikletave, shih 95.32
NVE Rev 2.1 kod	46.71
Përshkrim	Tregtia me shumicë e automjeteve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të mjeteve motorike të reja dhe të përdorura, duke përfshirë automjetet elektrike: • mjetet motorike për pasagjerë, duke përfshirë mjetet motorike të specializuara për pasagjerë, si ambulancat, minibusat • kamionët, rimorkiot dhe gjysmërimorkiot • automjetet për kamping, si rulotat, banesat me rrota
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitjen me shumicë të mjeteve motorike për terrene të vështira
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e agjentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të makinave dhe automjeteve të lehta, shih 46.18 - shitjen me shumicë të biçikletave elektronike, pjesëve dhe aksesoreve që lidhen me to, shih 46.49 - shitjen me shumicë të pajisjeve të transportit me motor p.sh. anije, jahte, aeroplanë, trena, shih 46.64 - shitjen me shumicë të pjesëve dhe aksesoreve për automjete, shih 46.72 - transportin e udhëtarëve sipas kërkesës me automjet me shofer, shih 49.33 - marrja me qira dhe dhënien me qira të veturave dhe mjeteve të lehta motorike pa shofer, shih 77.11 - mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike, shih seksionin 95.31

NVE Rev 2.1 kod	46.72
Përshkrim	Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve për automjete
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të pjesëve të reja dhe të përdorura, pajisjeve dhe aksesorëve përkatës si goma etj. - shitjen me shumicë të baterive dhe akumulatorëve për automjete
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e agentëve të përfshirë në shitjen me shumicë të pjesëve dhe aksesorëve të makinave dhe automjeteve të lehta, shih 46.18 - shitjen me shumicë të barkave, aeroplanëve, trenave, duke përfshirë pjesët dhe aksesorët, shih 46.64

NVE Rev 2.1 kod	46.73
Përshkrim	Tregtia me shumicë e motoçikletave, pjesëve dhe aksesorëve të tyre
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të motoçikletave të reja dhe të përdorura, duke përfshirë biçikletat me motor - shitjen me shumicë të pjesëve dhe aksesorëve për motoçikleta - shitjen me shumicë të mjeteve mbrojtëse për motoçiklistët
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e agentëve të specializuar në shitjen me shumicë të motoçikletave, shih 46.18 - shitjen me shumicë e biçikletave, biçikletave elektrike, pjesëve dhe aksesorëve që lidhen me to, shih 46.49 - marrjen me qira të motoçikletave, shih 77.11 - riparimin dhe mirëmbajtjen e motoçikletave, shih 95.32

NVE Rev 2.1 kod	46.8
Përshkrim	Tregti të tjera me shumicë të specializuara
Përfshin	Ky grup përfshin: - aktivitete të tjera të specializuara të shitjes me shumicë të paklasifikuara në grupet 46.2-46.7 të kësaj ndarje - shitjen me shumicë të produkteve të ndërmjetme, me përjashtim të atyre bujqësore, zakonisht jo për përdorim shtëpiak
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e tregtarëve me shumicë që nuk kanë pronësinë e mallrave që tregtojnë, shih 46.1

- shitjen me shumicë të baterive dhe akumulatorëve jo për automjete, shih 46.64
- shitjen me shumicë jo të specializuar, shih 46.90

NVE Rev 2.1 kod

46.81

Përshkrim

Tregtia me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të lëndëve djegëse fosile dhe lëndëve djegëse me karbon të ulët ose pa karbon, grasos, lubrifikuesit, vajrat, p.sh.:
- qymyr druri, qymyr, koks, dru zjarri, peleta druri ose biomasa, naftë
- naftë e papërpunuar, naftë bruto, karburant dizel, benzinë, naftë, lëndë djegëse për ngrohje, vajgur, karburante biologjikë , lëndë djegëse karboni të ricikluar, lëndë djegëse sintetike, të përziera ose të pastra
- gazra naftë të lëngëzuar, gazi natyror të lëngshëm, gazi butan, propan dhe format e tyre bio dhe të ripërtërishme, të përziera ose të pastra
- vajra dhe graso lubrifikuese, produkte të rafinuara të naftës

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të hidrogjenit, shih 46.85

NVE Rev 2.1 kod

46.82

Përshkrim

Tregtia me shumicë e metaleve dhe xeherorëve metalikë

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mineraleve ferore dhe jo-ferore
- shitjen me shumicë të metaleve ferore dhe jo-ferore në forma fillestare
- shitjen me shumicë të produkteve metalike ferore dhe jo-ferore të paklasifikuar në vend tjetër p.k.t
- shitjen me shumicë të arit dhe metaleve të tjerë të çmuar
- shitjen me shumicë të produkteve gjysmë të gatshme dhe xeheroreve metalike

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë të fletëve të çelikut për llogari të vet, duke përfshirë aktivitetet e zakonshme të prerjes që lidhen me tregtinë, të cilat nuk përfshijnë prodhimin e mallrave të rinj
- shitjen me shumicë të arit dhe metaleve të tjera të çmuara, të blera nga familjet ose ndërmarrjet dhe të shitura te shitësit me pakicë, përdorues industrialë, tregtarë, institucionalë ose profesionalë, ose te shitës të tjerë me pakicë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të metalit për skrap, shih 46.87
- shitjet e lingotave të arit, shih seksionin L

NVE Rev 2.1 kod	46.83
Përshkrim	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve të tualetit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shitjen me shumicë të drurit të papërpunuar - shitjen me shumicë të produkteve të përpunimit parësor të drurit - shitjen me shumicë të paletave, paneleve të tjera të ngarkesës prej druri dhe fuçive - shitjen me shumicë të parketit prej druri të papërpunuara dhe të përpunuar - shitjen me shumicë të materialeve të ndërtimit: • rërë, zhavorr, çimento, tulla etj. - shitjen me shumicë të skelave - shitjen me shumicë të bojrave, llaqeve dhe lustrave - shitjen me shumicë të letrës murale dhe veshjeve të dyshemesë, p.sh. laminat, pllaka, parket - shitjen me shumicë të xhamit të sheshtë - shitjen me shumicë të pajisjeve hidrosanitare: • vaska, lavamanë, tualete dhe pajisje të tjera hidrosanitare prej porcelani - shitjen me shumicë të dyerve, dritareve dhe grilave (nga të gjitha materialet)
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - transportin me ambulancë, shih 86.92

- transportin e eshtrave njerëzore, shih 96.30

NVE Rev 2.1 kod

49.4

Përshkrim

Transporti rrugor i mallrave dhe shërbime largimi

Përfshin

Ky grup përfshin të gjitha aktivitetet e transportit tokësor të mallrave përveç transportit hekurudhor.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

49.41

Përshkrim

Transporti rrugor i mallrave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- të gjitha operacionet e transportit rrugor të mallrave:

- transporti i prerjes së druve
- transporti i bagëtisë • transporti frigoriferik
- transporti i ngarkesave të rënda
- transporti në masë, duke përfshirë transportin në kamionë me cisternë, dhe grumbullimin e qumështit në ferma
- transporti i automobilave
- transporti i mbetjeve dhe materialeve të mbetjeve, pa grumbullim ose asgjësim

- transportin rrugor të mallrave, në emër të njësive

postare ose të korrierëve, pa kryer asnjë aktivitet tjetër postare ose të korrierëve

- transportin rrugor të objekteve ndërmjet njësive të ndryshme, p.sh. godina, njësi magazinimi, mbi bazë kontrate ose komisioni.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- dhënien me qira të mjeteve të transportit me shofer

- transportin rrugor të mallrave me mjete që tërhiqen nga njerëzit ose kafshët

- dhënien me qira të betonierëve, me shofer

- dorëzimin e mobilieve, mund të përfshihet shpaktimi dhe instalimi

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- ngarkimin e trungjeve në pyje, si pjesë e operacioneve të prerjes së druve, shih 02.40

- shpërndarjen e ujit me kamionë, shih 36.00

- transportin e mbetjeve si pjesë e integruar e aktiviteteve për grumbullimin e mbetjeve, shih 38.11, 38.12

- shërbimet e largimit, shih 49.42

- operimin e strukturave të terminaleve për trajtimin e mallrave, shih 52.2

- aktivitetet e vendosjes në arka dhe paketimit për transport, shih 52.2

- zhvendosjen e ngarkesave në kantiere industriale, zakonisht me mjete transporti që nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur në rrugë të hapura për qarkullimin e publikut, shih 52.24

- marrjen e mallrave dhe grupimin për dërgim, shih 52.25

- aktivitetet postare dhe të korrierëve, shih 53.10, 53.20

- aktivitetet e shërbimit të transportit me automjet të blinduar, shih 80.01

NVE Rev 2.1 kod

49.42

Përshkrim

Shërbime largimi

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e heqjes (zhvendosjes) për bizneset dhe familjet
nëpërmjet transportit rrugor

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- dhënien me qira të mjeteve të largimit me shofer
- magazinimin e mobilieve si pjesë të shërbimit të largimit

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

49.5

Përshkrim

Transporti me tubacion

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

49.50

Përshkrim

Transporti me tubacion

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- transportin e gazeve, lëngjeve, ujit, plehut të lëngshëm dhe produkteve të tjera nëpërmjet tubacioneve
- transportin e gazit natyror nëpërmjet tubacionit nga impiantet e përpunimit te sistemet vendore të shpërndarjes

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- operimin e stacioneve të pompimit për transport nëpërmjet tubacioneve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shpërndarjen e lëndëve djegëse të gazta, avullit ose ujit te përdoruesit fundorë nëpërmjet rrjetit vendas ose rajonal të tubacionit kryesor, shih 35.22, 35.30, 36.00
- shpërndarjen e ujit me kamionë, shih 36.00
- shitjen me pakicë të karburantit për automjete, shih 47.30
- transportin e lëngjeve me kamionë, shih 49.41

NVE Rev 2.1 kod	50
Përshkrim	Transporti ujq
Përfshin	Kjo ndarje përfshin transportin ujq të pasagjerëve ose mallrave, qoftë me orar ose jo, për arsye profesionale, personale ose argëtuese. Gjithashtu, përfshihet edhe operimi i barkave tërheqëse ose shtytëse, barkave për ekskursionë, udhëtime ose vizita, tragetet, taksitë ujore, etj. Megjithëse vendndodhja është tregues për ndarjen ndërmjet transportit detar dhe tokësor, faktori vendimtar është lloji i mjetit lundrues të përdorur. Transporti me mjete lundruese detare klasifikohet në grupet 50.1 dhe 50.2, ndërsa transporti me mjete të tjera lundruese klasifikohet në grupet 50.3 dhe 50.4.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin : -aktivitetet e restoranteve dhe bareve në anije (shih 56.11, 56.30), nëse kryhen nga njësi të veçanta.
NVE Rev 2.1 kod	50.1
Përshkrim	Transporti ujq detar dhe bregdetar i pasagjerëve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	Ky grup përfshin gjithashtu: - transportin e udhëtarëve në liqene etj., kur përdoren mjete të ngjashme si në det ose në ujërat bregdetare.
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	50.10
Përshkrim	Transporti ujq detar dhe bregdetar i pasagjerëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - transportin e pasagjerëve në rrugë detare ose bregdetare, qoftë me orar ose jo: • operimi i barkave për ekskursion, udhëtim ose vizita • operimi i trageteve, taksive ujore, etj. - operimin e barkave të udhëtimit - operimin e barkave për vizita, ekskursionë dhe forma të tjera transporti detar ose bregdetar të pasagjerëve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të barkave të argëtimit me ekuipazh për transportin ujq detar dhe bregdetar (p.sh. për varka peshkimi) - transportin me traget të pasagjerëve me ose pa mjete
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e restoranteve dhe bareve në anije, kur ofrohen nga njësi të veçanta, shih 56.11, 56.30 - qiradhënien e barkave dhe jahteve të argëtimit pa ekuipazh, shih 77.21 - qiradhënien e anijeve tregtare ose barkave pa

ekuipazh, shih 77.34
- operimin e kazinove në kroçera që nuk transportojnë pasagjerë, shih 92.00

NVE Rev 2.1 kod

50.2

Përshkrim

Transporti ujqor detar dhe bregdetar i mallrave

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Ky grup përfshin gjithashtu:

-transportin e mallrave në liqene, etj., kur përdoren mjete të ngjashme si në det ose në ujërat bregdetare.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

50.20

Përshkrim

Transporti ujqor detar dhe bregdetar i mallrave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallrave nëpërmjet rrugëve detare dhe bregdetare
- transportin nëpërmjet tërheqjes ose shtytjes së maunave, platformave të naftës, etj.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- dhënien me qira të mjeteve lundruese me ekuipazh për transportin ujqor detar dhe bregdetar të mallrave
- transportin me traget të mjeteve të pashoqëruara

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin me traget të pasagjerëve me ose pa mjete, shih 50.10
- ruajtjen e mallrave, shih 52.10
- operimin e limaneve dhe aktivitetet shtesë, p.sh. ankorimi, pilotimi, transferimi i ngarkesave ndërmjet anijeve, rikuperimi i mjeteve lundruese, shih 52.22
- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24
- qiradhënien e anijeve tregtare ose barkave pa ekuipazh, shih 77.34

NVE Rev 2.1 kod

50.3

Përshkrim

Transporti ujqor i pasagjerëve në ujërat e brendshme

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	50.30
Përshkrim	Transporti ujq i pasagjerëve në ujërat e brendshme
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - transportin e pasagjerëve nëpërmjet lumenjve, kanaleve, liqeneve dhe rrugëve të tjera ujore të brendshme, duke përfshirë edhe brenda limaneve dhe porteve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të barkave të argëtimit me ekuipazh për transportin ujq në ujërat e brendshme - operimin e barkave për vizita dhe ekskursioneve në rrugët ujore të brendshme - transportin me traget të pasagjerëve në ujërat e brendshme, me ose pa mjete
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: -aktivitetet e restoranteve dhe bareve në anije, kur ofrohen nga njësi të veçanta, shih 56.11, 56.30 - qiradhënien e barkave dhe jahteve të argëtimit pa ekuipazh, shih 77.21 - operimin e kazinove në kroçera që nuk transportojnë pasagjerë, shih 92.00
NVE Rev 2.1 kod	50.4
Përshkrim	Transporti ujq i mallrave në ujërat e brendshme
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	50.40
Përshkrim	Transporti ujq i mallrave në ujërat e brendshme
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - transportin e mallrave nëpërmjet lumenjve, kanaleve, liqeneve dhe rrugëve të tjera ujore të brendshme, duke përfshirë edhe brenda limaneve dhe porteve - transportin e mallrave nëpërmjet rrugëve ujore të brendshme, që përfshijnë mjete lundruese të papërshtatshme për transport detar
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të mjeteve lundruese me ekuipazh për transportin ujq të mallrave në ujërat e brendshme
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - trajtimin e ngarkesave, shih 52.24- qiradhënien e anijeve tregtare ose barkave pa ekuipazh, shih 77.34

NVE Rev 2.1 kod	51
Përshkrim	Transporti ajror
Përfshin	Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve dhe mallrave në mënyrë ajrore ose hapësinore.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - spërkatjen e kulturave bujqësore, shih 01.61 - riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore civile ose motorëve të tyre, shih 33.16 - operimin e aeroporteve, shih 52.23 - reklamimin ajror (shkrimin në qiell), shih 73.11 - fotografimin ajror, shih 74.20 - mbikëqyrjen ajrore civile, shih 80.09 - mbikëqyrjen ajrore ushtarake, shih 84.22

NVE Rev 2.1 kod	51.1
Përshkrim	Transporti ajror i pasagjerëve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	51.10
Përshkrim	Transporti ajror i pasagjerëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - transportin ajror me orar të pasagjerëve në itinerare të rregullta - fluturimet e paplanifikuara me mjet ajror për pasagjerët - fluturimet për vizita
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të pajisjeve të transportit ajror me operator me qëllim transportin e pasagjerëve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien e mjeteve të transportit ajror pa operator mjeti, shih 77.35 - ambulancat ajrore, shih 86.92

NVE Rev 2.1 kod	51.2
Përshkrim	Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	51.21
Përshkrim	Transporti ajror i mallrave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - transportin ajror të mallrave, qoftë me orar ose jo

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të pajisjeve të transportit ajror me operator me qëllim transportin e mallrave
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	51.22
Përshkrim	Transporti hapësinor
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - nisjen e satelitëve dhe mjeteve hapësimore - transportin hapësinor të mallrave dhe pasagjerëve

Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	52
Përshkrim	Magazinimi, ruajtja dhe aktivitete mbështetëse për transportin
Përfshin	Kjo ndarje përfshin magazinimin dhe aktivitetet mbështetëse për transportin, p.sh. operimin e infrastrukturës së transportit, p.sh. aeroportet, limanet, tunelet, urat, duke përfshirë aktivitetet e agjencive të transportit dhe trajtimin e ngarkesave. Aktivitetet e përmendura kryhen në emër të palëve të treta. Nëse shërbimet shoqëruese ofrohen vetëm për mbështetjen e aktiviteteve të transportit nga e njëjta njësi, ato do të konsiderohen si aktivitete shtesë për transportin dhe kjo njësi do të klasifikohet diku tjetër në seksionin H.

Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	52.1
Përshkrim	Magazinimi dhe ruajtja
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	52.10
Përshkrim	Magazinimi dhe ruajtja
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - operimin e objekteve të magazinimit dhe ruajtjes për të gjitha llojet e produkteve: • operimin e hambarëve të drithërave • magazinat e artikujve të përgjithshëm • magazinat frigoriferike dhe depot me ftohje • cisternat e ruajtjes, etj. - magazinimin e mobilieve, jo pjesë e shërbimit të largimit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - ruajtjen e mallrave në zona të tregtisë së jashtme - ngrirjen e shpejtë të shoqëruar me ruajtjen dhe magazinimin - aktivitetet e ruajtjes së arkivave dhe dosjeve fizike

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - magazinimin e energjisë elektrike, shih 35.16 -magazinimin e lëndëve djegëse të gazta për furnizim me energji nëpërmjet një rrjeti, shih 35.24 - magazinimin e mobilieve si pjesë të shërbimit të largimit, shih 49.42 - operimin e strukturave të parkimit për mjetet motorike, shih 52.21 - magazinimin dimëror të rulotave, anijeve dhe barkave dhe magazinimin e mjeteve fluturuese, shih 52.21, 52.22, 52.23 - operimin e strukturave për magazinim vetjak, shih 68.20 - qiradhënien e hapësirave boshe, shih 68.20
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	52.2
Përshkrim	Aktivitete mbështetëse për transportin
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitetet që mbështesin transportin e pasagjerëve ose mallrave, duke përfshirë operimin e objekteve të transportit dhe pjesët e infrastrukturës së transportit dhe aktivitetet që lidhen me trajtimin e mallrave përpara, gjatë ose ndërmjet segmenteve të transportit.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për transportin e

mallrave, shih 52.31

- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për transportin e pasagjerëve, shih 52.32

NVE Rev 2.1 kod

52.21

Përshkrim

Aktivitete shërbimi të lidhura me transportin rrugor

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e lidhura me transportin rrugor, hekurudhor ose tokësor tjetër të pasagjerëve, kafshëve ose mallrave:

- operimi i objekteve të terminaleve, p.sh. stacionet hekurudhore, stacionet e autobusit, stacionet për trajtimin e mallrave
- operimi i infrastrukturës hekurudhore dhe objekteve të lidhura me hekurudhën, terminaleve të ngarkesave, pikave teknike rezervë, ndalesave hekurudhore për furnizim me karburant
- operimi i rrugëve, urave dhe tuneleve, duke përfshirë aktivitetet e mirëmbajtjes dimërore
- këmbimin dhe shuntimin
- operimin e parkingjeve ose garazheve të automjeteve, parkingjeve të biçikletave, magazinave dimërore të rulotave
- rimorkimin dhe asistencën rrugore
- aktivitetet e mbikëqyrjes së transportit të ngarkesave me kamion
- shërbimet për mbledhjen e tarifave

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- lëngëzimin dhe/ose rigazifikimin e gazit natyror për qëllime të transportit tokësor

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- lëngëzimin e gazit natyror për qëllime të transportit, në objektin e minierës, shih 09.10
- rigazifikimin e gazit natyror për shpërndarje nëpërmjet tubacioneve, shih 35.22
- riparimin e rrugëve, shih ndarjen 42
- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24
- zhvendosjen e ngarkesave në kantieri industriale, zakonisht me mjete transporti që nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur në rrugë të hapura për qarkullimin e publikut, shih 52.24

NVE Rev 2.1 kod

52.22

Përshkrim

Aktivitete shërbimi të lidhura me transportin detar

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e lidhura me transportin ujor të pasagjerëve, kafshëve ose mallrave:
- operimi i objekteve të terminaleve, p.sh. limanet, molet
- operimi i digave të rrugëkalimeve ujore, etj.
- aktivitetet e lundrimit, pilotimit, tërheqjes dhe ankorimit
- furnizimi me karburant dhe marrja e mbetjeve portuale
- aktivitetet e transferimit të ngarkesave ndërmjet anijeve dhe rikuperimit
- aktivitetet e farit
- aktivitetet e mbikëqyrjes së ngarkesave detare
- shërbimet e informacionit për rrugëkalimet ujore
- magazinimi dimëror i anijeve dhe barkave

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

kantierit të minierës

- garantimin e sigurisë gjatë punimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës ujore
- lëngëzimin dhe rigazifikimin e gazit natyror për qëllime të transportit ujor të kryer jashtë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëkalimeve ujore, shih 42.91
- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24
- operimin e marinave, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod

52.23

Përshkrim

Aktivitete shërbimi të lidhura me transportin ajror

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e lidhura me transportin ajror të pasagjerëve, kafshëve ose mallrave:
 - operimi i strukturave të terminaleve, p.sh. terminalët ajrore
 - aktivitetet e aeroportit dhe kontrollit të qarkullimit ajror
 - aktivitetet e shërbimit tokësor në aeroporte, etj.
- garantimin e sigurisë gjatë punimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës së aeroportit
- magazinimin e mjeteve fluturuese

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shërbimet zjarrfikëse dhe të parandalimit të zjarrit në aeroporte

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24
- inspektimin e bagazheve dhe pasagjerëve në aeroporte, jo nga autoritetet publike, shih 80.01
- inspektimin e bagazheve dhe pasagjerëve në aeroporte, nga autoritetet publike, shih 84.24
- operimin e shkollave të fluturimit për pilotët profesionistë, shih 85.32
- operimin e shkollave të fluturimit që nuk lëshojnë certifikata dhe leje profesionale, shih 85.53

NVE Rev 2.1 kod

52.24

Përshkrim

Trajtimi i ngarkesave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave dhe bagazheve pavarësisht mënyrës së transportit
- aktivitetet e ngarkim-shkarkimit
- ngarkimi dhe shkarkimi i vagonëve të mallrave

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- dhënien me qira dhe leasing të vinçave urë ose vinçave kullë, me operator, për aktivitete të trajtimit të ngarkesave
- zhvendosjen e ngarkesave në kantieri industriale, zakonisht me pajisje transporti që nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur në rrugë të hapura për qarkullimin e publikut

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin ose zhvendosjen e objekteve brenda një impianti industrial,

mbi bazë komisioni ose kontrate, nëse përdoret rrugë publike, shih 49.41
- operimin e strukturave të terminaleve, shih 52.21, 52.22, 52.23
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për transportin e mallrave, shih 52.31

NVE Rev 2.1 kod

52.25

Përshkrim

Aktivitete të shërbimeve të logjistikës

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e qendrave të shpërndarjes
- marrjen e mallrave dhe grupimin për dërgim
- operacionet e trajtimit të mallrave, p.sh. paketimi i përkohshëm në arka dhe vendosja e mallrave në kuti për magazinim ose mbrojtje gjatë transportit, shpaketimit, kampionimit, peshimit të mallrave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e mallrave, shih 52.26
- ndërmjetësimin për anijet, ku përfshihet kujdesi gjatë hyrjes dhe zhdoganimit të anijeve, si ndërmjetës ndërmjet pronarëve të anijeve dhe dërguesve ose marrësve të mallrave, shih 52.31
- aktivitetet e korrierëve, shih 53.20
- ofrimin e sigurimit për automjetet, anijet, avionin dhe transportin, shih 65.12
- këshillimin e menaxhimit për logjistikën e shoqërive, shih 70.20
- aktivitetet e këshillimit të logjistikës, pra planifikimi, projektimi dhe mbështetja e operacioneve të transportit, magazinimit dhe shpërndarjes, shih 70.20

NVE Rev 2.1 kod

52.26

Përshkrim

Aktivitete të tjera mbështetëse për transportin

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- lëshimin dhe sigurimin e dokumenteve të transportit dhe faturave ajrore
- aktivitetet e agjentëve doganorë
- organizimin e aktiviteteve multimodale dhe të ndërthurura të transportit hekurudhor, rrugor, detar ose ajror (transporti ndërmodal) në emër të dërguesit ose pranuesit të mallit
- organizimin dhe dërgimin e ngarkesave në grup ose individuale në emër të klientit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- ndërmjetësimin për mallrat e transportuara në rrugë hekurudhore, ujore dhe ajrore, shih 52.31
- operimin e platformave për ndërmjetësimin e shërbimeve të transportit të mallrave, shih 52.31
- ndërmjetësimin për rezervimin e ndenjësve të pasagjerëve në anije dhe mjete fluturuese, shih 52.32
- aktivitetet e korrierëve, shih 53.20- ofrimin e sigurimit për automjetet, anijet, avionin dhe transportin, shih 65.12
- këshillimin e menaxhimit për logjistikën e shoqërive, shih 70.20
- aktivitetet e agjencive të udhëtimit, shih 79.11
- aktivitetet e operatorëve turistikë, shih 79.12

- aktivitetet e asistencës për turistët, shih 79.90

NVE Rev 2.1 kod

52.3

Përshkrim

Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit për transportin

Përfshin

Ky grup përfshin ndërmjetësimin e transportit të mallrave dhe pasagjerëve.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

52.31

Përshkrim

Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit për transportin e mallrave

Përfshin

Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e transportit të mallrave, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuar të transportit të mallrave. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimeve të transportit të mallrave. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për mallrat e transportuara në rrugë hekurudhore, ujore dhe ajrore
- operimin e platformave për ndërmjetësimin e shërbimeve të transportit të mallrave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e mallrave, shih ndarjet 49, 50, 51
- ndërmjetësimin për rezervimin e ndenjëseve të pasagjerëve në anije dhe mjete fluturuese, shih 52.32

Përshkrim

Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit për transportin e pasagjerëve

Përfshin

Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e transportit të pasagjerëve, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuar të transportit të pasagjerëve. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimeve të transportit të pasagjerëve. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.

Kjo klasë përfshin:

- operimin e platformave në internet për ndarjen e udhëtimit, që u mundësojnë pasagjerëve të rezervojnë udhëtime
- ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit për pagesën e transportit tokësor, ujor ose ajror për pasagjerët
- ndërmjetësimin për rezervimin e ndenjësive të pasagjerëve në anije dhe mjete fluturuese

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- ndërmjetësimin e transportit nëpërmjet shërbimeve radio të taksive, pa ofruar transport
- shërbimet e rezervimit me komisione për transportin e pasagjerëve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- operimin e taksive dhe format e tjera të transportit rrugor të pasagjerëve, shih 49.3
- ndërmjetësimin për mallrat e transportuara në rrugë hekurudhore, ujore dhe ajrore, shih 52.31
- aktivitetet e operimit të platformave në internet që u mundësojnë individëve të marrin me qira një automjet (veturë, biçikletë, etj.), që do t'i drejtojnë vetë, shih 77.51
- njësitë që ofrojnë shërbime rezervimi krahas këshillimit ose ekspertizës shtesë për udhëtimin, shih 79.11
- aktivitetet e ndërthurura të akomodimit, udhëtimit dhe ushqimit, pra agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, shih 79.11, 79.12

Përshkrim

Aktivitete postare dhe të korrierëve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	53.1
Përshkrim	Aktivitete postare në kudër të detyrimit të shërbimit universal
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	53.10
Përshkrim	Aktivitete postare në kudër të detyrimit të shërbimit universal
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetin e shërbimeve postare që operojnë nën detyrimin e shërbimit universal nga një ose më shumë ofrues universalë shërbimi të përcaktuar. Aktivitetet përfshijnë përdorimin e infrastrukturës së shërbimit universal, duke përfshirë vendndodhjet e shitjes me pakicë, mjediset e organizimit dhe përpunimit, si dhe itineraret e korrierëve për marrjen dhe dorëzimin e postës. Dorëzimi mund të përfshijë postën e thjeshtë, si letrat, kartolinat, shtypin (gazeta, periodikë, artikuj reklamash, etj.), paketat e vogla, mallra ose dokumente. Gjithashtu, përfshihen edhe shërbime të tjera të nevojshme për mbështetjen e detyrimit të shërbimit universal.

Kjo klasë përfshin:

- marrjen, organizimin, transportin dhe dorëzimin (e brendshëm ose ndërkombëtar) të postës së thjeshtë dhe pakove (postare) dhe paketave nga shërbimet postare që operojnë nën detyrimin e shërbimit universal. Mund të përfshihen një ose më shumë mënyra transporti dhe aktivitetet mund të kryhen nëpërmjet transportit personal (privat) ose atij publik.
- grumbullimin e postës së thjeshtë dhe pakove nga kutitë postare publike ose zyrat postare

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet nëpërmjet xhirove postare dhe kursimeve postare dhe urdhërpagesave, shih 64.19

NVE Rev 2.1 kod	53.2
Përshkrim	Aktivitete të tjera postare dhe të korrierëve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	53.20
Përshkrim	Aktivitete të tjera postare dhe të korrierëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - marrjen, organizimin, transportin dhe dorëzimin (e brendshëm ose ndërkombëtar) të postës së thjeshtë dhe pakove (postare) dhe paketave nga firmat që operojnë jashtë detyrimit të shërbimit universal. Mund të përfshihen një ose më shumë mënyra transporti dhe aktiviteti mund të kryhet nëpërmjet transportit personal (privat) ose atij publik.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimet e dorëzimit në shtëpi, përfshirë ushqimin
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - transportin e mallrave, shih (sipas mënyrës së transportit) 49.20, 49.41, 50.20, 50.40, 51.21, 51.22 - dorëzimin e mobilieve, mund të përfshihet shpaketimi dhe instalimi, shih 49.41 - dorëzimin në shtëpi të vakteve të përgatitura nëse kryhet nga e njëjta njësi që përgatit vaktet, shih ndarjen 56

NVE Rev 2.1 kod	53.3
Përshkrim	Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet postare dhe të korrierëve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	53.30
Përshkrim	Aktivitete të shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet postare dhe të korrierëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e aktiviteteve postare dhe të korrierëve, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuar postare dhe të korrierëve. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimeve postare dhe të korrierëve. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit. Kjo klasë përfshin: - çdo shërbim ndërmjetësimi të ndërmarrë nga palë të treta kundrejt pikës së aksesit të ofruesit të shërbimit postar dhe të ofruar për bizneset dhe klientët e thjeshtë - operimin e platformave në internet për t'u mundësuar individëve rezervimin e dërgesës së ushqimit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shërbimet e dorëzimit të ushqimeve, shih 53.20 - operimin e platformave në internet për dorëzimin në shtëpi të vakteve të përgatitura nëse kryhet nga e njëjta njësi që përgatit vaktet, shih 56.40 - shërbimet e ndërmjetësimit monetar, p.sh. pagesa e tarifave nëpërmjet zyrës postare, shih 64.19

NVE Rev 2.1 kod	I
Përshkrim	AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR
Përfshin	Ky seksion përfshin ofrimin e akomodimit afatshkurtër (më pak sesa një vit) për vizitorët dhe udhëtarët e tjerë, akomodimin e përkohshëm në dhoma teke ose të përbashkëta ose konvikte për studentët, punëtorët sezonalë dhe individë të tjerë, si dhe ofrimin e ushqimit dhe pijeve të përshtatshme për konsum të menjëhershëm. Sasia dhe lloji i shërbimeve shtesë të ofruara sipas këtij seksioni mund të ndryshojë ndjeshëm.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky seksion nuk përfshin: - rishitjen e ushqimeve ose pijeve nëpërmjet aktiviteteve të shitjes me shumicë ose pakicë, shih seksionin G (përgatitja e këtyre ushqimeve dhe pijeve klasifikohet te prodhimi, shih seksionin C) - ofrimin e akomodimit afatgjatë (një vit ose më shumë) si rezidenca parësore, shih seksionin M

NVE Rev 2.1 kod	55
Përshkrim	Akomodimi
Përfshin	Kjo ndarje përfshin ofrimin e akomodimit afatshkurtër për vizitorët dhe udhëtarët e tjerë. Akomodimi mund të përfshijë ushqim, mjedise argëtimi dhe shërbime të tjera.
Përfshin gjithashtu	Përfshihet gjithashtu ofrimi i akomodimit afatshkurtër për studentët, punëtorët.
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin aktivitetet që lidhen me ofrimin e rezidencave në struktura, p.sh. banesa ose apartamente, zakonisht të dhëna me qira në bazë vjetore, shih ndarjen 68.

NVE Rev 2.1 kod	55.1
Përshkrim	Hotele dhe struktura të ngjashme
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	55.10
Përshkrim	Hotele dhe struktura të ngjashme
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e akomodimit, zakonisht ditor ose javor, për qëndrime afatshkurtra. Këtu përfshihet ofrimi i akomodimit të mobiluar në dhoma dhe suita hoteli. Shërbimet e ofruara përfshijnë pastrimin e përditshëm dhe rregullimin e shtratit. Mund të ofrohen një sërë shërbimesh shtesë, p.sh. shërbime ushqimi dhe pijesh, shërbime pastrimi kimik, mjedise argëtuese, si dhe mjedise për konferenca dhe konventa. Këto aktivitete karakterizohen përgjithësisht nga ofrimi i shërbimit në çast për klientët.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - akomodim pa pastrim ditor, rregullim të shtratit dhe shërbim klienti në vend, shih 55.20 - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për akomodimin, shih 55.40

NVE Rev 2.1 kod	55.2
Përshkrim	Akomodim për pushime dhe të tjera akomodime për qëndrim afatshkurtër
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	55.20
Përshkrim	Akomodim për pushime dhe të tjera akomodime për qëndrim afatshkurtër
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e akomodimit afatshkurtër, zakonisht ditor ose javor, në dhoma ose hapësira të mobiluara me vetëshërbim për jetesë/ngrënie dhe fjetje. Zakonisht, nuk ofrohen shërbime në çast për klientët, ndërsa shërbimet shtesë janë minimale, nëse ka.

Kjo klasë përfshin akomodimin në p.sh.:

- shtëpi dhe apartamente për pushime
- apartamente dhe shtëpi për vizitorët
- shtëpi fshati dhe kabina pa shërbime pastrimi
- hostele
- njësi për fjetje dhe mëngjes
- dhoma vizitorësh të ofruara privatisht nga familjet
- kabinat dhe shtëpizat malore

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - akomodimin me shërbim të përditshëm pastrimi dhe sistemimi dhe shërbim klienti në vend, shih 55.10 - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për akomodimin, shih 55.40
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	55.3
Përshkrim	Parqe automjetesh dhe kampingje për argëtim
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	55.30
Përshkrim	Parqe automjesh dhe kampingje për argëtim
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - ofrimin e akomodimit afatshkurtër në mjedise kampingu, p.sh. kampet rekreative, kampet për peshkim dhe gjueti - ofrimin e hapësirës dhe mjediseve për automjetet rekreative
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - akomodimin për kamping luksoz - akomodim i ofruar nëpërmjet strehëve mbrojtëse ose hapësirave qëndrimi pa tenda apo mbulesa
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për akomodimin, shih 55.40

NVE Rev 2.1 kod	55.4
Përshkrim	Shërbime ndërmjetësimi për akomodim
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	55.40
Përshkrim	Shërbime ndërmjetësimi për akomodim
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e të gjitha llojeve të akomodimit duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të akomodimit. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimet e shkëmbimit me ndarje kohe - shërbimet e rezervimit për akomodim
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - njësitë që ofrojnë shërbime rezervimi krahas këshillimit ose ekspertizës shitesë për akomodimin, shih 79.11 - ndërmjetësimin ose shitjen e një ndërthurjeje të akomodimit, udhëtimit dhe ushqimit, pra agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, shih 79.11, 79.12

NVE Rev 2.1 kod	55.9
Përshkrim	Akomodime të tjera
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	55.90
Përshkrim	Akomodime të tjera
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e akomodimit të përkohshëm në shtëpi, banesa ose apartamente, si dhe në dhoma teke ose të përbashkëta ose konvikte për studentët, punëtorët sezonalë dhe individë të tjerë.

Kjo klasë përfshin akomodimin në:

- shtëpi dhe banesa të mobiluara ose jo, ose në apartamente për një periudhë më pak sesa një vit
- konvikte për punëtorët- banesa të përbashkëta
- akomodim studentor të ofruar për më pak sesa një vit njëkohësisht
- vagonët për fjetje kur nuk operohen nga shoqëritë hekurudhore

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - operimin e vagonëve të akomodimit si operacion i integruar i shoqërive hekurudhore, shih 49.11 - operimin e barkave të udhëtimit, shih 50.10, 50.30 - ndërmjetësuesit për akomodimin, shih 55.40 - çdo akomodim për një periudhë njëvjeçare ose më të gjatë, shih 68.20 - ndërmjetësimin ose shitjen e një ndërthurjeje të akomodimit, udhëtimit dhe ushqimit, pra agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, shih 79.11, 79.12
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod

56

Përshkrim

Shërbime ushqimi dhe pije

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve, që ofrojnë vakte ose pije të përshtatshme për konsum të menjëhershëm, qoftë në restorante të zakonshme, restorante me vetëshërbim ose porositje, qofshin të përhershme ose të përkohshme, me ose pa tavolina. Faktori vendimtar është ofrimi i vakteve të përshtatshme për konsum të menjëhershëm, jo lloji i objektit që i ofron.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- prodhimin e vakteve të papërshtatshme për konsum të menjëhershëm ose jo të planifikuara për t'u konsumuar menjëherë ose të ushqimit të përgatitur, që nuk konsiderohet si vakt, shih ndarjet 10, 11
- shitjen e ushqimit jo të vetëprodhuar, që nuk konsiderohet si vakt, ose vakteve që nuk janë të përshtatshme për konsum të menjëhershëm, shih seksionin G
- makinetat e kafesë dhe makineritë shitëse që shesin ushqime dhe pije të përgatitura nga vetë makineria, shih ndarjet 47

NVE Rev 2.1 kod

56.1

Përshkrim

Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm

Përfshin

Ky grup përfshin:

- aktivitetet e shërbimit të ushqimit në restorante dhe të lëvizshme për publikun e gjerë, në mënyrë të rregullt

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	56.11
Përshkrim	Restorante
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e: - restoranteve - kafeterive - restoranteve fast-food - pikave të porositjes së ushqimit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - operimin e restoranteve me pajisje transporti dhe brenda ambienteve të transportimit, nëse operojnë në njësi të veçanta që nuk janë pjesë e ofruesit të transportit - operimin e restoranteve në një hotel, nëse operojnë në njësi të veçanta që nuk janë pjesë e hotelit - operimin e restoranteve për ta marrë ushqimin me vete në një supermarket, nëse operojnë në njësi të veçanta që nuk janë pjesë e supermarketit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me pakicë të ushqimit nëpërmjet makinerive shitëse, shih 47.2 - operimin e vagonëve të konsumit të ushqimit si operacion i integruar i shoqërive hekurudhore, shih 49.11 - shërbimet ushqimore të lëvizshme, shih 56.12 - aktivitetet e kateringut të aktiviteteve, shih 56.21 - operimin me koncesion të strukturave të konsumit të ushqimit, shih 56.22 - aktivitetet e kontraktorëve të shërbimeve ushqimore, p.sh. për shoqëritë e transportit, shih 56.22 - aktivitetet e çajtove, shih 56.30
NVE Rev 2.1 kod	56.12
Përshkrim	Shërbim ushqimor i lëvizshëm
Përfshin	Kjo klasë përfshin përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve kryesisht për konsum të menjëhershëm nga karrocet e lëvizshme ose tezgat. Kjo klasë përfshin aktivitetet e operatorëve ushqimorë të lëvizshëm, që përfshijnë: - karrocet e ushqimit të nxehtë - shitësit ushqimorë - shitësit e akulloreve - përgatitjen e ushqimit në tezgat tregu - shitësit e vakteve të lehta - shitësit e kosit të ngrirë - shitësit e petullave
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me pakicë të ushqimit nëpërmjet makinerive shitëse, shih 47.2 - dorëzimin e ushqimit nga njësitë e pavarura, shih 53.20 - përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit nga karrocet e lëvizshme dhe të përkohshme ose tezgat portative me bazë marrëveshjesh kontraktuale me klientin, për një aktivitet të caktuar, shih 56.21 - operimin me koncesion të strukturave të konsumit të ushqimit, shih 56.22 - shitësit ambulantë të pijeve, shih 56.30

NVE Rev 2.1 kod	56.2
Përshkrim	Katering me porosi për raste, shërbim katering me kontratë dhe aktivitete të tjera të shërbimit ushqimor
Përfshin	Ky grup përfshin kateringun për aktivitete individuale ose për një periudhë kohore të përcaktuar dhe operimin e stendave ushqimore, p.sh. në mjedise sportive ose të ngjashme. Shërbimet ofrohen në bazë kontraktuale dhe ofrohen ndaj një klientele të kufizuar.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	56.21
Përshkrim	Katering me porosi për raste
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e ushqimit dhe dorëzimin, në bazë të marrëveshjeve kontraktuale, në vendndodhjen e përcaktuar nga klienti, për një aktivitet të caktuar.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve ushqimorë që prishen, shih 10.89
- shitjen me pakicë të artikujve ushqimorë që prishen, shih 47.2

NVE Rev 2.1 kod	56.22
Përshkrim	Shërbimi katering me kontratë dhe aktivitete të tjera të shërbimit ushqimor
Përfshin	Kjo klasë përfshin kateringun industrial, d.m.th. përgatitjen e ushqimit dhe dorëzimin bazuar te marrëveshjet kontraktuale me klientin, për një afat të përcaktuar. Gjithashtu, përfshihet edhe operimi i stendave të ushqimit, p.sh. në mjedise sportive ose të ngjashme. Ushqimi mund të përgatitet drejtpërdrejt në mjediset e organizatës së klientit ose në një njësi qendrore.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e kontraktorëve të shërbimeve ushqimore, p.sh. për shoqëritë e transportit
- operimin e mensave ose kafeterive, p.sh. për fabrikat, zyrat, spitalet ose shkollat, në bazë koncesionare

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve ushqimorë që prishen, shih 10.89
- shitjen me pakicë të artikujve ushqimorë që prishen, shih 47.2

NVE Rev 2.1 kod	56.3
Përshkrim	Aktivitete të shërbimit të pijeve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	56.30
Përshkrim	Aktivitete të shërbimit të pijeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin kryesisht servirjen e pijeve për konsum të menjëhershëm në mjedise. Aktiviteti mund të përfshijë ofrimin e drejtpërdrejtë të muzikës dhe aktiviteteve të kërcimit. Kjo klasë përfshin aktivitetet e: - bareve - bareve për kokteje - pubeve - kafeneve - çajtoreve - bareve me lëngje frutash - shitësve ambulantë të pijeve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e bareve në bordin e mjeteve të transportit, p.sh. tren ose anije, kur kryhen nga njësi të veçanta
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - rishitjen e pijeve të ambalazuara/përgatitura, shih ndarjen 47 - shitjen me pakicë të pijeve nëpërmjet makinerive shitëse, shih 47.2 - ofrimin e përgatitjes dhe mundësimit të pijeve në bazë të marrëveshjeve kontraktuale me klientin, për një afat të përcaktuar, shih 56.22 - operimin e sallave të koncerteve dhe ambienteve ku luhet muzikë, shih 90.31 - operimin e pistave të kërcimit ku shërbimi i pijeve nuk është aktivitetet kryesore, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod	56.4
Përshkrim	Shërbime ndërmjetësimi për shërbime ushqimi dhe pije
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod

56.40

Përshkrim

Shërbime ndërmjetësimi për shërbime ushqimi dhe pije

Përfshin

Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e shërbimeve të ushqimeve dhe pijeve duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuara të ushqimit dhe pijeve. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (ballë për ballë, telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimeve të ushqimit dhe pijeve. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimi mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shërbimet e rezervimit për restorante

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- operimin e platformave në internet për t'u mundësuar individëve rezervimin e dërgesës së ushqimit, shih 53.30

Përshkrim

PUBLIKIMI, TRANSMETIMI, PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES

Përfshin

Ky seksion përfshin prodhimin dhe publikimin, transmetimin dhe shpërndarje të tjera të produkteve të informacionit. Ky seksion përfshin aktivitetet e publikimit të librave, gazetave, periodekeve dhe programeve kompjuterike (ndarja 58), prodhimin e elementeve të filmave, videove dhe programeve televizive, aktivitetet e publikimit të regjistrimit të zërit dhe të muzikës (ndarja 59) dhe transmetimet në radio dhe televizion, si aktivitete prodhimi dhe të shpërndarjes televizive ose radiofonike, duke përfshirë funksionimin e platformave të transmetimit, shkarkimeve, dhe shpërndarjes (ndarjes) të përmbajtjes që nuk lidhen me publikimin e përmbajtjes, funksionimin e blegeve dhe wikipediave, faqet e rrjeteve sociale dhe funksionimin e faqeve të lojërave online/video lojërave (ndarja 60). Publikimi i referohet blerjes të të drejtave të autorit, për përmbajtjen (produktet e informacionit) dhe vënien në dispozicion të kësaj përmbajtjeje për publikun e gjerë duke u angazhuar në (ose duke rregulluar) riprodhimin dhe shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje në forma të ndryshme. Publikuesit mund të licencojnë të drejtat për të tjerët për të shpërndarë përmbajtjen e tyre, ose ata mund të publikojnë dhe shpërndajnë përmbajtje që ata krijojnë ose zotërojnë. Në këtë seksion përfshihen të gjitha format e realizueshme të botimit (në shtyp, elektronik, digjital, analog ose çdo formë tjetër) dhe aktivitetet e vetëbotimit. Komponentët individualë të programeve televizive, p.sh. filmat, serialet televizive, prodhohen nga aktivitetet e ndarjes 59, ndërsa krijimi i një programi të plotë televiziv, prodhuar nga komponentët e ndarjes 59 ose komponentë të tjerë (p.sh. programet e lajmeve live) përfshihet në ndarjen 60. Ndarja 60 përfshin edhe transmetimin e këtij programi nga producenti.

Përfshin gjithashtu

Ky seksion përfshin gjithashtu:

- krijimi dhe dhënia me qira e të drejtave të autorit për përmbajtjen e publikuar

Nuk përfshin

Ky seksion nuk përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë e mediave të regjistruara, shih seksionin G
- aktivitetet e ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit dhe aktivitetet e shërbimeve të lidhura me to, p.sh. transmetimi i zërit, të dhënave, tekstit, zërit dhe video, aktivitetet e programimit kompjuterik, infrastruktura kompjuterike dhe aktivitetet e pritjes dhe portalet e kërkimit në internet, shih seksionin K
- ofrimin e shërbimeve financiare dhe të sigurimit duke përdorur programe të publikuara të teknologjive financiare dhe të sigurimit, shih seksionin L
- menaxhimin e të drejtave të autorit, shih 74.91
- marrjen me qira të disqeve, shih 77.22
- aktivitetet e muzikantëve dhe aktorëve të pavarur (duke përfshirë influencuesit që shfaqen në blog), shkrimtarët dhe bloggerët, përmbajtja e të cilëve është publikuar nga një palë e tretë, dhe faqet e lojërave të fatit, shih seksionin S

Përshkrim

Aktivitetet e publikimit

Përfshin

Kjo ndarje përfshin publikimin e librave, broshurave, fletëpalosjeve, fjalorëve, enciklopedive, atlaseve, hartave dhe grafikëve, publikimin e gazetave, periodikëve, revistave; listat e adresave postare dhe publikime të tjera, si edhe software-ve (programe kompjuterike). Publikimi përfshin blerjen e të drejtave të autorit, për përmbajtjen (produktet e informacionit) dhe vënien në dispozicion të kësaj përmbajtjeje për publikun e gjerë duke u angazhuar në (ose duke rregulluar) riprodhimin dhe shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje në forma të ndryshme. Publikuesit mund të licencojnë të drejtat për të tjerët për të shpërndarë përmbajtjen e tyre, ose ata mund të publikojnë dhe shpërndajnë përmbajtje që ata krijojnë ose zotërojnë. Në këtë ndarje përfshihen të gjitha format e realizueshme të botimit (në shtyp, elektronik, digjital, analog apo çdo formë tjetër) dhe aktivitetet e vetëbotimit, përveç botimit të filmave dhe muzikës. Kjo ndarje mbulon transmetimin e përmbajtjes (p.sh. programe kompjuterike dhe libra), nga botuesit e përmbajtjes.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin publikimin e filmave, videove dhe filmave, publikimin e muzikës dhe prodhimin e regjistrimeve origjinale të tingullit, shih ndarjen 59. Gjithashtu nuk përfshihen marrja e të drejtave nga botuesit për transmetimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes, shih ndarjen 60, aktivitetet e programimit kompjuterik, shih ndarjen 62, shtypjen, shih 18.1 dhe riprodhimi masiv i mediave të regjistruara, shih 18.20.

Përshkrim

Botimi i librave, gazetave dhe aktiviteteve të tjera botuese, përveç publikimit të programeve kompjuterike

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet e botimit të librave, gazetave, revistave dhe periodikëve të tjerë, listave të adresave postare dhe produkte të tjera si, p.sh. katalogë, fotografi, kalendarë, kartolina urimi, kartolina, formularë, postera, riprodhime të veprave të artit. Këto produkte karakterizohen nga kërkesa për krijimtari intelektuale në zhvillimin e tyre dhe zakonisht mbrohen nga e drejta e autorit. Përfshihen të gjitha format e realizueshme të botimit (në shtyp, elektronik, digjital, analog ose çdo formë tjetër).

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	58.11
Përshkrim	Botimin e librave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - botimin e librave, broshurave dhe botime të ngjashme - botimin e fjalorëve dhe enciklopedive - botimin e atlaseve, hartave dhe skicave - botimin e librave elektronikë dhe e librave audio - botimin e librave komik dhe novela grafike Përfshihen të gjitha format e realizueshme të botimin (të shtypur, elektronik, digjital, analog, ose çdo formë tjetër).
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e globreve, shih 32.99- publikimin e materialeve të publicitetit, shih 58.19 - publikimin e muzikës dhe librave të muzikës, shih 59.20 - publikimin e përbashkët dhe shpërndarjen e podcasteve, shih 59.20 - aktivitetet e transmetimit të librave audio që nuk lidhen me publikimin e tyre, shih 60.10 - aktivitetet e autorëve të pavarur, shih 90.11
NVE Rev 2.1 kod	58.12
Përshkrim	Publikimi i gazetave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - publikimin e gazetave Përfshihen të gjitha format e mundshme të publikimit (të shtypur, elektronik, digjital, analog, ose formë tjetër). RREGULLA E ZBATIMIT: Gazetat (përfshirë gazetat reklamuese) duhet të jenë nën përgjegjësinë dhe kontrollin e redaktorëve, të shfaqen ose të përditësohen rregullisht të paktën katër herë në javë, të përbëra kryesisht nga vepra letrare të natyrës gazetareske që lidhen me lajmet dhe të kenë qëllim informimin e publikut të gjerë. Nëse produkti publikohet si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik, shpeshtësia e publikimit do të vlerësohet në bazë të shpeshtësisë së publikimit të versionit të printuar.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - gazetatat reklamuese
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e programeve televizive ose videove për lajme, shih 59.11 - aktivitetet e agjencive të lajmeve, shih 60.31 - aktivitetet e fotoreporterëve, duke mos publikuar vetë përmbajtjen e krijuar nga vetja, shih 74.20 - aktivitetet e gazetarëve, përmbajtja e të cilëve është publikuar nga një palë e tretë, shih 90.11

NVE Rev 2.1 kod

58.13

Përshkrim

Botimi i revistave dhe periodikëve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- botimin e revistave dhe periodikëve
- publikimin e programeve radio dhe televizive

Përfshihen të gjitha format e mundshme të publikimit (i shtypur, digjital, analog, ose formë tjetër).

RREGULLA E ZBATIMIT:

Botimi i një përmbledhjeje informacioni të përditësuar periodikisht ose rregullisht duhet të kryhet nën përgjegjësinë dhe kontrollin e redaktorëve, me përmbajtje kryesisht veprash letrare me natyrë gazetareske, dhe me qëllim informimin e publikut të gjerë. Periodikët dhe revistat e tjera, botohen më pak sesa katër herë në javë. Nëse produkti publikohet në format të shtypur dhe elektronik, shpeshtësia e publikimit do të vlerësohet në bazë të shpeshtësisë së publikimit të versionit të shtypur.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e programeve televizive ose video lajmeve, shih 59.11
- shpërndarja e përmbajtjeve nëpërmjet bllogeve, shih 60.39
- aktivitetet e fotoreporterëve, duke mos publikuar vetë përmbajtjen e krijuar nga vetja, shih 74.20
- aktivitetet e gazetarëve, përmbajtja e të cilëve është publikuar nga një palë e tretë, shih 90.11

NVE Rev 2.1 kod

58.19

Përshkrim

Aktivitete të tjera publikimi, përveç publikimit të programeve kompjuterike

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- publikimin në çdo format, duke përfshirë të printuar, digjital ose në internet, p.sh.:
 - adresarë dhe lista postare
 - përmbledhjet, p.sh. çështje gjyqësore, përmbledhje farmaceutike
 - katalogë
 - fotografive, gravurave dhe kartolinave
 - kalendarëve
 - kartolinave të urimit
 - formularëve
 - posterave
 - riprodhimeve të punimeve artistike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - dhënien e kredive nga institucione të specializuara jodepozitore, p.sh. për blerje shtëpie, shih 64.92 - aktivitetet e përpunimit dhe shlyerjes së transaksioneve të kartave të kreditit, shih 66.19

NVE Rev 2.1 kod	64.2
Përshkrim	Aktivitete të kompanive holding dhe kanaleve të financimit
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitetet e shoqërive të investimit në aksione dhe financimit të kanalizuar. Këto janë subjekte financiare filiale të grupeve të korporatës, pra njësi të krijuara nga një grup financiar ose jofinanciar për të kryer aktivitetet financiare specifike, aktiviteti kryesor i të cilave është të zotërojnë grupin ose të shërbejnë si mjet për organizimin dhe kanalizimin e fondeve brenda grupit, përkatësisht.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - shoqëritë filiale të faktoringut dhe faturimit, shih 64.92 - Aktivitetet e investimit në llogaritë vetjake, p.sh. nga shoqëritë me kapital sipërmarrës, firmat me kapital privat, shih 64.99 - menaxhimin aktiv të shoqërive dhe ndërmarrjeve, planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen e shoqërisë, shih 70.10 - aktivitetet e tjera të subjekteve financiare filiale të grupeve të korporatës, që do të përfshihen te klasat përkatëse të aktiviteteve

NVE Rev 2.1 kod	64.21
Përshkrim	Aktivitete të kompanive holding
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e shoqërive të investimit në aksione, pra njësi që zotërojnë aktive (zotërim niveli kapitali që mundëson kontroll) të një ose më shumë filialeve dhe qëllimi i së cilave është zotërimi i filialeve. Shoqëritë e investimit në aksione në këtë klasë nuk ofrojnë asnjë shërbim tjetër për ndërmarrjet në të cilat kanë kapital, pra nuk administrojnë apo menaxhojnë njësi të tjera.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shoqërive aksionare, që nuk zotërojnë nivele kontrolli të kapitalit, shih 64.32 - përfshirjen në tregje financiare për llogari të vet, shih 64.99 - aktivitetet e menaxhimit të aseteve mbi bazë komisioni ose kontrate, shih 66.30 - ofrimin e shërbimeve menaxheriale, p.sh. shërbimet e planifikimit strategjik, vendimmarrjes dhe ato administrative të zyrës qendrore, shih 70.10 - menaxhimin aktiv të shoqërive dhe ndërmarrjeve, planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen e shoqërisë, shih 70.10

NVE Rev 2.1 kod	64.22
Përshkrim	Aktivitetet e financimit të kanalizuar
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e financimit të kanalizuar, pra njësi të krijuara nga një grup financiar ose jofinanciar për të mbledhur ose marrë hua fonde (shpesh në tregun e hapur) dhe për t'ia dorëzuar fondet subjektit mëmë ose një subjekti tjetër brenda grupit.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e institucioneve financiare nga vetë të siguruarit, të përfshira në huadhënien brenda grupit - shoqëritë pa ekzistencë reale të angazhuara në mbledhje fondesh dhe në dorëzimin e këtyre fondeve te subjekti i tyre mëmë, pra njësi që zotërohen (direkt ose indirekt) nga një njësi jorezidente, një pjesë e madhe e bilancit të së cilës përfshin pretendime dhe detyrime ndaj njësive jorezidente, dhe që kanë pak ose asnjë punonjës, dhe pak ose aspak prani fizike në juridiksionin e themelimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shërbimet menaxhuese të fondeve publike dhe borxhit publik, shih 84.11

NVE Rev 2.1 kod	64.3
Përshkrim	Aktivitetet e trusteve, fondeve dhe organeve të ngjashme financiare
Përfshin	Ky grup përfshin subjektet juridike të organizuara për të ndarë letrat me vlerë ose aktivet e tjera financiare, pa menaxhimin ose administrimin e tyre, në emër të aksionarëve ose përfituesve. Portofolat përshtaten për të arritur karakteristika specifike investimi, si diversifikimi, risku, norma e kthimit, luhatshmëria e çmimit. Këto subjekte përfitojnë interes, dividendë dhe të ardhura të tjera nga prona, por kanë një nivel të ulët punësimi ose aspak, si dhe asnjë të ardhur nga shitja e shërbimeve.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e subjekteve që fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave ose shërbimeve. Këto lloj subjektesh klasifikohen sipas aktiviteteve kryesore në pjesë të tjera të NVE-së (si ndarja 66 për menaxhimin e fondeve, ndarja 68 për qiradhënien dhe operimin e pasurive të paluajtshme ose ndarja 77 për qiradhënien dhe leasing-un e anijeve ose aeroplanëve) - kryerjen e transaksioneve të sigurizimit nëpërmjet lëshimit të instrumenteve financiare, shih 64.92 - transaksionet e sigurimit të aktiveve të ndryshme nga huatë nëpërmjet lëshimit të instrumenteve financiare, shih 64.99 - trustet, pronat dhe llogaritë e agjencive, që fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave ose shërbimeve, shih klasën e NVE-së sipas aktivitetit kryesor

NVE Rev 2.1 kod	64.31
Përshkrim	Aktivitete të fondeve të investimeve të tregjeve monetare dhe jo-monetare
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e fondeve të investimit në tregun e parasë dhe tregun jo të parasë, pra skemat e investimit kolektiv që sigurojnë fonde nëpërmjet lëshimit të aksioneve ose njësive për publikun, të ardhurat prej së cilave investohen kryesisht në aktive financiare (duke përfshirë aktivet afatshkurta). Kjo klasë përfshin: - fondet e investimit me fund të hapur- fondet e investimit me fund të mbyllur - trustet e njësive dhe investimeve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shoqërive të investimit në aksione, shih 64.21 - aktivitetet e shoqërive aksionare jo me shumicë aksionesh, që nuk zotërojnë nivele kontrolli të kapitalit, shih 64.32 - trustet, pronat dhe llogaritë e agjencive që nuk veprojnë si skema investimi kolektiv, shih 64.32 - Aktivitetet e shoqërive të kapitalit sipërmarrës, shih 64.99 - fondet e pensionit, shih 65.30 - menaxhimin e fondeve, shih 66.30

NVE Rev 2.1 kod	64.32
Përshkrim	Aktivitetet e llogarive të trusteve, pasurive të paluajtshme dhe agjencie
Përfshin	Kjo klasë përfshin subjektet juridike, që nuk veprojnë si skema investimi kolektiv, të organizuara për të ndarë letrat me vlerë, pasuritë e paluajtshme ose aktivet e tjera financiare, pa menaxhimin e tyre, në emër të aksionarëve ose përfituesve. Portofolat përshtaten për të arritur karakteristika specifike investimi, si diversifikimi, risku, norma e kthimit, luhatshmëria e çmimit. Këto subjekte përfitojnë interes, dividendë dhe të ardhura të tjera nga prona, por kanë një nivel të ulët punësimi ose aspak, si dhe asnjë të ardhur nga shitja e shërbimeve. Kjo klasë përfshin: - trustet, pasuritë e paluajtshme ose llogaritë e agjencie, të administruara në emër të shumë përfituesve sipas kushteve të një marrëveshjeje trusti, testamenti ose marrëveshjeje agjencore
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e shoqërive aksionare, që nuk zotërojnë nivele kontrolli të kapitalit - shoqëritë sipërmarrëse ku i vetmi financim është nga aksionet dhe nuk merren komisione
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - mbledhjen e fondeve nëpërmjet lëshimit të aksioneve ose njësive dhe duke vepruar si skema investimi kolektiv, shih 64.31

NVE Rev 2.1 kod	64.9
Përshkrim	Aktivitetet e tjera të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe fondeve të pensionit
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitetet e shërbimeve financiare me përjashtim të aktiviteteve të sigurimeve dhe financimit të pensioneve, përveç atyre të kryera nga institucionet monetare, shoqëritë e investimit në aksione dhe financimit të kanalizuar, dhe trusteve, fondeve apo subjekteve të ngjashme.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet për sigurimet dhe fondet e pensionit, shih ndarjen 65

NVE Rev 2.1 kod	64.91
Përshkrim	Leasing-u financiar
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e qiradhënies financiare, një kontratë sipas së cilës qiradhënësi si pronari ligjor i një aseti ia përcjell risqet dhe përfitimet e pronësisë së asetit qiramarrësit. Sipas qiradhënies financiare, qiradhënësi i jep qiramarrësit një hua me të cilën qiramarrësi merr përsipër përfitimet dhe risqet ekonomike të qirasë. Më pas, aseti i dhënë me qira përfshihet në bilancin kontabël të qiramarrësit dhe jo të qiradhënësit; huaja përkatëse paraqitet si aset i qiradhënësit dhe detyrim financiar i qiramarrësit.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - leasing financiar të mallrave të qëndrueshëm, p.sh. mjetet
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - operimin e leasing-ut, sipas llojeve të artikujve të dhëna me qira, shih ndarjen 77

NVE Rev 2.1 kod	64.92
Përshkrim	Dhëniet e tjera të huave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e shërbimeve financiare të lidhura kryesisht me ndërmjetësimin nëpërmjet marrjes përsipër të detyrimeve, në forma të tjera veç valutës, depozitave ose zëvendësuesve të ngjashëm për depozitat, ku dhënia e kredisë mund të kryhet në një sërë formash, si hua, hipotekë, karta krediti, duke ofruar llojet vijuese të shërbimeve: • dhënia e kredisë konsumatore nga institucionet jodepozitore • financimi i tregtisë ndërkombëtare • ofrimi i financimit afatgjatë për industrinë • ofrimi i shërbimeve të ngjashme me ato bankare pa licensë bankare, në bashkëpunim me një bankë të licensuar • huadhënia e parave jashtë sistemit bankar • dhënia e kredive nga institucione të specializuara jodepozitore, p.sh. për blerje shtëpie • sigurizimi i huave • aktivitetet e financimit të faktoringut dhe zinxhirit të furnizimit • aktivitetet e fajdeve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - dhënien e kredive nga institucione të specializuara depozitamarrëse, shih 64.19 - leasing-un financiar, shih 64.91 - sigurizimin e aseteve të ndryshme nga huatë, shih 64.99 - operimin e leasing-ut, sipas llojeve të artikujve të dhënë me qira, shih ndarjen 77 - aktivitetet e dhënies së granteve nga organizata me anëtarësi, shih 94.99

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve të tjera financiare, përveç sigurimeve dhe fondeve të pensionit p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e tjera të shërbimeve financiare të lidhura kryesisht me shpërndarjen e fondeve përveç huadhënies:
 - hartimi i marrëveshjeve të këmbimit, opsioneve dhe mbrojtjes
 - aktivitetet e shoqërive për kompensimin e sigurimit për jetën
- aktivitetet e investimit dhe tregtimit të llogarive vetjake, për shembull nëpërmjet shoqërive me kapital sipërmarrës, klubeve të investimit
- veprimin si palë homologe për shlyerjen dhe kompensimin e transaksioneve

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- përfshirjen në tregje financiare për llogari të vet
- tregtinë e të arkëtueshmeve për llogari të vet
- tregtarët e letrave me vlerë dhe derivatet e tyre (që operojnë për llogari të vet)
- aktivitetet e operacioneve të instrumenteve financiare të ndryshme nga sigurizimi
- transaksionet e sigurizimit të aktiveve të ndryshme nga huat nëpërmjet lëshimit të instrumenteve financiare
- tregtisë së këmbimeve ose opsioneve për llogari të vet
- tregtinë e kontratave të mallrave
- lëshimin e kriptopasurive me pasivet përkatëse (jo nga një autoritet monetar)
- tregtimin e kriptopasurive me pasivet përkatëse për llogari të vet
- këmbimin e monedhës për llogari të vet

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- emetimin e krypto-aseteve pa një detyrim përkatës (jo nga një autoritet monetar), shih 63.10
- leasing-un financiar, shih 64.91
- sigurizimin e huave, shih 64.92
- lidhjen e kontratave të sigurimit dhe mallrave në emër të të tjerëve (ndërmjetësim), shih 66.12
- këmbimin valutë kundrejt tarifës, p.sh. zyrtarët e këmbimit valutë, shih 66.12
- ndërmjetësimin për kriptopasuritë me detyrime që kualifikohen si letra me vlerë, shih 66.12
- ndërmjetësimin për hipotekën, shih 66.19
- menaxhimin e fondeve të investimit, shih 66.30
- tregtimin, leasing-un dhe qiradhënien e pasurive të paluajtshme, shih ndarjen 68
- arkëtimin e faturave pa blerje borxhi të pashlyer, shih 82.91
- lëshimin e kriptopasurive pa pasivet përkatëse (jo nga një autoritet monetar), shih 82.99
- aktivitetet e dhënies së granteve nga organizata me anëtarësi, shih 94.99

NVE Rev 2.1 kod	65
Përshkrim	Sigurimi, risigurimi dhe fondet e pensioneve, përveç sigurimit shoqëror të detyrueshëm
Përfshin	Kjo ndarje përfshin nënshkrimin e të përvitshmeve, policave të sigurimit, p.sh. sigurimi i drejtpërdrejtë i jetës dhe jo i jetës dhe primet e investimit për krijimin e një portofoli aktivesh financiare që do të përdoren kundër pretendimeve në të ardhmen. Përfshihet ofrimi i sigurimit të drejtpërdrejtë, financimit të pensionit dhe risigurimit.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - ofrimin e shërbimeve të lidhura me sigurimet mbi bazë komisioni ose kontrate, Shih ndarjen 66

NVE Rev 2.1 kod	65.1
Përshkrim	Sigurime
Përfshin	Ky grup përfshin sigurimin e jetës me ose pa elementin e kursimeve të konsiderueshme dhe sigurimin jo të jetës. Ky grup përfshin: - sigurimin e jetës dhe risigurimin e jetës me ose pa elementin e kursimeve të konsiderueshme dhe sigurime të tjera jo të jetës - aktivitetet e ofruesve të sigurimit të vullnetshme - ndarjen dhe marrjen përsipër të risqeve të sigurimit
Përfshin gjithashtu	Ky grup përfshin gjithashtu aktivitetet e sigurimit nga vetë të siguruarit.
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - shitjen e sigurimeve si ndërmjetësues, shih 66.22

NVE Rev 2.1 kod	65.11
Përshkrim	Sigurimi i jetës
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - sigurimin e jetës me afat të caktuar - sigurimin e jetës me afat të përhershëm - nënshkrimin e të përvitshmeve dhe policave të sigurimit të jetës, policave të sigurimit për pagesën e aftësisë së kufizuar, policave të sigurimit në rast vdekjeje aksidentale, funerali dhe gjymtimi (me ose pa elementin e kursimeve të konsiderueshme)
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - sigurimet plotësuese të lëshuara krahas sigurimit të jetës, në veçanti sigurimi ndaj dëmtimeve personale, përfshirë paaftësinë për punësim, sigurimin ndaj vdekjes që mund të shkaktohet nga një aksident dhe sigurimin ndaj aftësisë së kufizuar që mund të shkaktohet nga një aksident ose sëmundje

- llojet e sigurimeve të përhershme shëndetësore që nuk janë subjekt anulimi

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

65.12

Përshkrim

Sigurimi jo jetë

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- ofrimin e shërbimeve të sigurimit të ndryshme nga sigurimi i jetës:
 - sigurim në rast aksidenti
 - sigurim mjekësor dhe shëndetësor
 - sigurim për udhëtime
 - sigurim në rast dëmtimi të pronës nga zjarri dhe forcat natyrore
 - sigurim për dëmtime të tjera ndaj pronës
 - sigurim për mjetet motorike, vagonët hekurudhorë, anijet, mjetet fluturuese dhe format e tjera të transportit
- sigurimin e mallrave
- sigurimi për humbjen dhe detyrimet financiare
- sigurimin e kredisë
- sigurimin për shpenzime ligjore
- sigurimin për mbrojtjen e të ardhurave
- sigurimin për kompensimin e punëtorëve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- skemat e sigurimeve të detyrueshme shoqërore, shih 84.30

NVE Rev 2.1 kod

65.2

Përshkrim

Risigurimi

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

65.20

Përshkrim

Risigurimi

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e marrjes përsipër plotësisht ose pjesërisht të riskut që lidhet me policat ekzistuese të sigurimit të nënshkruara fillimisht nga ofrues të tjerë sigurimi

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e risigurimit fundor

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	65.3
Përshkrim	Aktivitete të fondeve të pensionit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	65.30
Përshkrim	Aktivitete të fondeve të pensionit
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e përfitimeve të pagesës së pensionit ekskluzivisht për punonjësit ose anëtarët e sponsorit dhe produktet e tjera të sigurimit të rregulluara si fonde të lidhura me punëdhënësin. Këtu përfshihen planet e pensionit me përfitime të përcaktuara, si dhe me kontribute të përcaktuara.

Kjo klasë përfshin:

- ofrimin e planeve të përfitimeve për punonjësit
- ofrimin e fondeve dhe planeve të pensionit
- ofrimin e planeve të daljes në pension

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - menaxhimin e fondeve të pensionit, shih 66.30 - skemat e sigurimeve të detyrueshme shoqërore, shih 84.30
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	66
Përshkrim	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar dhe sigurimit
Përfshin	Kjo ndarje përfshin ofrimin e shërbimeve të lidhura me ose që mbështesin transaksionet financiare në aktivet dhe detyrimet financiare, pa marrjen në zotërim të aktiveve dhe detyrimeve financiare që i nënshtrohen transaksionit. Këto shërbime mund të ofrohen si/në media/mënyra të ndryshme, duke përfshirë dhe internetin.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	66.1
Përshkrim	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit

Përfshin Ky grup përfshin plotësimin e tregjeve fizike ose elektronike me qëllim lehtësimin e blerjes dhe shitjes së aksioneve, opsioneve të aksioneve, obligacioneve ose kontratave të mallrave, dhe tregtimin e kriptopasurive me pasive. Gjithashtu, përfshin edhe shërbime të tjera të ndryshme, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të këshillimit financiar, menaxhimit të aseteve ose ofrimin e kapitalit dhe financimit nga publiku të bazuar te borxhi.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	66.11
Përshkrim	Administrimi i tregjeve financiare
Përfshin	Kjo klasë përfshin operimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare të tjera veç bankave qendrore dhe autoriteteve publike, p.sh.: - shkëmbimet e kontratave të mallrave - shkëmbimet e kontratave të së ardhmes për mallrat - shkëmbimet e letrave me vlerë - shkëmbimet e aksioneve - shkëmbimet e opsioneve të aksioneve ose mallrave - shkëmbimet e kriptopasurive - administrimin e tregjeve financiare, me përjashtim të sigurimeve dhe financimit të pensioneve - aktivitetet e autoritetit financiar mbikëqyrës të shërbimit financiar me përjashtim të sigurimeve dhe financimit të pensioneve (jo nga banka qendrore)

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin Kjo klasë nuk përfshin:

- shkëmbimet energjetike për elektricitetin, kapacitetet e transmetimit ose shpërndarjes, shih ndarjen 35
- administrimin e tregjeve financiare për sigurimet dhe fondet e pensionit, shih 66.29
- aktivitetet e autoritetit mbikëqyrës financiar për sigurimet dhe fondet e pensioneve (jo nga banka qendrore), shih 66.29
- rregulloren financiare dhe të tregut lidhur me kryerjen e biznesit dhe mbrojtjen e konsumatorit, dhe Aktivitetet e tjera rregullatore financiare, shih 84.13

Përshkrim

Ndërmjetësimi i kontratave të letrave me vlerë dhe mallrave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- operimin në tregjet financiare në emër të të tretëve (p.sh. ndërmjetësimi për aksionet) dhe Aktivitetet shoqëruese
- ndërmjetësimin për letrat me vlerë
- ndërmjetësimin e aksioneve të fondeve të investimit
- ndërmjetësimin e kontratave të standardizuara të mallrave
- tregtimin e valutës në emër të të tretëve
- ndërmjetësimin për kriptopasuritë
- këmbimin valutor kundrejt tarifës, p.sh. zyrat e këmbimit valutor
- financimin nga publiku të bazuar te kapitali
- financimin nga publiku të bazuar te borxhi duke ofruar hua dhe letra me vlerë

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- ndërmjetësimin e letrave me vlerë për projekte investimi, p.sh. parqet e erës ose diellore

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- përfshirjen në tregje financiare për llogari të vet, shih ndarjen 64
- këmbimin e monedhës për llogari të vet, shih 64.99
- menaxhimin e portofolit mbi bazë komisioni ose kontrate, shih 66.30
- blerjen dhe shitjen e projekteve të pasurive të paluajtshme, p.sh. parqet e erës ose diellore, shih ndarjen 68
- mbledhjen e fondeve nga donacionet, shih 82.99
- ndërmjetësimin e kriptopasurive pa pasive, shih 82.99

NVE Rev 2.1 kod	66.19
Përshkrim	Aktivitete të tjera ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet dytësore të shërbimeve financiare të paklasifikuara tjetërkund, p.sh.: - aktivitetet e përpunimit dhe shlyerjes së transaksioneve financiare, duke përfshirë aktivitetet e ofrimit dhe shlyerjes së pagesave digjitale (ose të bazuara në internet) për transaksionet e kartave të kreditit - shërbimet këshillimore për investimet, duke përfshirë shërbimet këshillimore robotike - aktivitetet e këshilltarëve dhe ndërmjetësimit për hipotekën dhe huatë - aktivitetet e ofruesve të portofolave të monedhave digjitale - aktivitetet e këshilltarëve financiarë në lidhje me shërbimet e bashkimit dhe blerjes - verifikimin dhe minimin për kriptopasuritë e konsideruara si aktive financiare - mbajtjen e letrave me vlerë - tokenizimin e aseteve digjitale, duke përfshirë ofrimin e tokenave të sigurisë, ofrimin fillestar të monedhave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e zyrave të rimbursimit tatimor - ndërmjetësimin e kredive konsumatore - aktivitetet e ofruesve të pagesave, p.sh. shërbimet elektronike të transfertave të fondeve, përfshirë shërbimet e pagesavendërmjet personave - analizimin e tregjeve financiare si një shërbim këshillimi
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - publikimin e analizave të tregjeve financiare, shih 58.19 - shërbimet e kërkimit të informacionit lidhur me tregjet financiare, shih 63.92 - shkëmbimin e kriptopasurive, shih 66.11 - aktivitetet e ndërmjetësimit, shih 66.12 - aktivitetet e agjentëve dhe ndërmjetësve të sigurimeve, shih 66.22 - menaxhimin e fondeve, shih 66.30 - aktivitetet e agjencive për mbledhjen e borxhit dhe shërbyesit e huave me probleme, shih 82.91 - ndërmjetësimin e kriptopasurive pa pasive, shih 82.99

NVE Rev 2.1 kod	66.2
Përshkrim	Aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe fondeve të pensionit
Përfshin	Ky grup përfshin të vepruarit si agjentë (pra ndërmjetësues/broker) në shitjen e të përvitshmeve dhe policave të sigurimit ose ofrimin e përfitimeve për punonjësit dhe shërbimeve të tjera të lidhura me sigurimin dhe pensionet, si zgjidhja e pretendimeve, administrimi i palëve të treta.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - mbledhjen dhe marrjen përsipër të risqeve të sigurimeve nëpërmjet nënshkrimit, shih ndarjen 65

NVE Rev 2.1 kod	66.21
Përshkrim	Vlerësimi i riskut dhe dëmeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e shërbimeve të administrimit të sigurimit, si vlerësimi dhe zgjidhja e pretendimeve në lidhje me sigurimin, p.sh.: - vlerësimi i pretendimeve në lidhje me sigurimin • zgjidhja e pretendimeve • vlerësimi i riskut • vlerësimi i riskut dhe dëmeve • përshtatja e mesatares dhe humbjeve - zgjidhja e pretendimeve në lidhje me sigurimin
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shih 68.31 - vlerësimin për qëllime të tjera, shih 74.99 - aktivitetet e hetimit, shih 80.01

NVE Rev 2.1 kod	66.22
Përshkrim	Aktivitete të agjentëve të sigurimit dhe brokerave
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e agjentëve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit (ndërmjetësit e sigurimit) në shitjen, negocimin ose ofrimin e të përvitshmeve dhe policave të sigurimit dhe risigurimit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	66.29
Përshkrim	Të tjera aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe fondeve të pensionit, p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e përfshira ose që lidhen ngushtësisht me sigurimet dhe financimin e pensioneve, me përjashtim të ndërmjetësimit financiar, zgjidhjes së pretendimeve dhe aktiviteteve të agjentëve të sigurimit: • administrimi i rikuperimit • shërbimet aktuariale • aktivitetet këshillimore për pensionet dhe sigurimin • administrimi i tregjeve financiare për sigurimet dhe fondet e pensionit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet mbikëqyrëse financiare për sigurimet dhe financimin e pensioneve (jo nga banka qendrore)
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e rikuperimit detar, shih 52.22 - publikimin e programeve kompjuterike/aplikacioneve të sigurimeve, shih 58.29

NVE Rev 2.1 kod	66.3
Përshkrim	Aktivitetet e menaxhimit të fondeve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	66.30
Përshkrim	Aktivitetet e menaxhimit të fondeve
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e menaxhimit të portofolave dhe fondeve, për shembull, marrjen e vendimeve se cilat investime duhen blerë ose shitur, mbi bazë kontrate ose komisioni, për individë, biznese dhe të tjerë, p.sh.: - menaxhimin e fondeve të përbashkëta - menaxhimin e fondeve të tjera të investimit - menaxhimin e fondeve të pensionit
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e menaxhimit të aseteve mbi bazë komisioni ose kontrate - shërbimet e trusteeve, fiduciare dhe të kujdestarisë mbi bazë komisioni ose kontrate
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - përfshirjen në tregje financiare për llogari të vet, shih 64.99 - menaxhimin e pasurisë së paluajtshme, shih ndarjen 68 - menaxhimin e shërbimeve të fondeve publike dhe borxhit publik, shih 84.11

NVE Rev 2.1 kod

M

Përshkrim

AKTIVITETE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (REAL ESTATE)

Përfshin

Ky seksion përfshin aktivitetet e pronësisë, dhënies me qira, blerjes, shitjes, zhvillimit ose rinovimit (rizhvillimit) të pronës. Ai përfshin lloje të ndryshme investitorësh të pasurive të paluajtshme (për shembull, kompanitë e investimeve në pasuri të paluajtshme, trustet e investimeve në pasuri të paluajtshme (REITs), firmat e menaxhimit të aseteve të pasurive të paluajtshme, fondet e pasurive të paluajtshme, kompanitë e zhvillimit të pasurive të paluajtshme ose agjentët e pasurive të paluajtshme, kooperativat e banesave). Për më tepër, ai përfshin agjentë dhe/ose ndërmjetës në një ose më shumë nga sa vijon: shitjen ose blerjen e pasurive të paluajtshme, dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, ofrimin e shërbimeve të tjera për pasuritë e paluajtshme (për shembull, vlerësimi i pasurive të paluajtshme ose veprimi si agjent dorëzanë i pasurive të paluajtshme). Aktivitetet në këtë seksion mund të kryhen në pronësi të vetë ose me qira dhe mund të kryhen me pagesë ose kontratë.

Përfshin gjithashtu

Ky seksion përfshin gjithashtu zhvillimin e projekteve të ndërtimit për ndërtesa në pronësi ose punime inxhinierike civile për shitje ose dhënie me qira të mëvonshme.

Nuk përfshin

Ky seksion nuk përfshin:

- aktivitetet e përgjithshme dhe të specializuara të ndërtimit për ndërtesat dhe punimet inxhinierike, shih seksionin F

NVE Rev 2.1 kod

68

Përshkrim

Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	68.1
Përshkrim	Aktivitetet e pronave të paluajtshme me pronën e vet dhe zhvillimi i projekteve të ndërtimit
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitetet e blerjes, zhvillimit dhe shitjes së pasurive të paluajtshme ne pronësi.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - aktivitetet e përgjithshme dhe të specializuara të ndërtimit për godinat dhe punimet inxhinierike civile , shih seksionin F - aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike si dhe konsulenca teknike të lidhur me to, shih 71.1 - ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të projekteve arkitekturore ose inxhinierike për projektet e ndërtimit, shih 71.1

NVE Rev 2.1 kod	68.11
Përshkrim	Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi, p.sh.: • ndërtesa apartamentesh dhe banesa • ndërtesa jo-rezidenciale, duke përfshirë ndërtesat për zyra dhe industriale, magazinat, hotelet dhe ndërtesa të tjera për kalimin e kohës së lirë, salla ekspozitash, objektet e vetë-magazinimit, dyqanet e shitjes me pakicë dhe qendrat tregtare • qendrat e të dhënave • toka
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - nënndarjen e pasurive të paluajtshme në parcela, pa përmirësim të tokës
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - nënndarja dhe përmirësimi i tokës në pronësi të vet për shitje të mëvonshme, shih 68.12 - zhvillimi i projekteve të ndërtesave për shitje, shih 68.12

NVE Rev 2.1 kod	68.12
Përshkrim	Hartimi i projekteve të ndërtimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - zhvillimin e projekteve të ndërtimit për ndërtesa rezidenciale dhe jorezidenciale në vetëpronësi ose te punimeve inxhinierike duke bashkuar mjetet financiare, teknike dhe fizike për të realizuar projektet e ndërtimit për shitje të mëvonshme - nënndarjen dhe përmirësimin e tokës në vetëpronësi për shitje të mëvonshme
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - rihvillimin e projekteve të ndërtimit për ndërtesa rezidenciale dhe jorezidenciale me vetëpronësi ose punime të inxhinierisë civile për të realizuar projektet e ndërtimit për shitje të mëvonshme
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - ndërtimin e ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale, shih ndarjen 41 - rimodelimin ose rinovimin e plotë të ndërtesave ekzistuese rezidenciale ose jorezidenciale që përfshijnë disa aktivitete të specializuara ndërtimi, shih ndarjen 41 - aktivitetet e lyerjes dhe lustrimit si pjesë e mirëmbajtjes, shih 43.34 - aktivitetet e ndërtimit në lidhje me përmirësimin e tokës, shih seksionin F - zhvillimi i projekteve të ndërtimit për funksionim vetjak, d.m.th për dhënien me qira të hapësirës në këto ndërtesa, shih 68.20 - aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike, shih 71.1 - ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të projekteve arkitekturore ose inxhinierike për projektet e ndërtimit, shih 71.1

NVE Rev 2.1 kod	68.2
Përshkrim	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	68.20
Përshkrim	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - dhënien me qira dhe funksionimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet ose me qira: • ndërtesa me apartamente dhe banesa • ndërtesa jo-rezidenciale, duke përfshirë ndërtesat për zyra, ato industriale, magazinat, hotelet dhe ndërtesa të tjera për kalimin e kohës së lirë, salla ekspozitash, godinat e magazinimit vetjak, dyqanet e shitjes me pakicë dhe qendrat tregtare • qendrat e të dhënave • toka, duke përfshirë tokën bujqësore dhe pyjore - ofrimin e shtëpive dhe banesave ose apartamenteve të mobiluar ose jo për përdorim me te përhershëm, për një vit ose me shume - funksionimin e vendbanimeve rezidenciale të lëvizshme për banesa parësore - zhvillimin e projekteve të ndërtesave për funksionim vetjak, pra për dhënie me qira të hapësirës në këto ndërtesa
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - lënien e çative (p.sh. për instalimet e energjisë diellore) - dhënien me qira të impianteve dhe fabrikave industriale, duke përfshirë makineritë dhe pajisjet - sigurimin e hapësirës ekskluzivisht për strehimin e kafshëve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - funksionimin e hoteleve, shtëpive lëvizëse shtëpive te pushimit, kampingjeve, kampeve me furgona dhe të tjera vend banimi me qëndrim të shkurtër jo -rezidencial (përfshirë akomodimin e studentëve) të ofruara për më pak se një vit, shih ndarjen 55 - zhvillimin i projekteve të ndërtimit për ndërtesa rezidenciale dhe jorezidenciale, për shitje të mëvonshme, shih 68.12 - dhënien me qira e makinerive, shih 77.3 - aktivitetet e kujdesit rezidencial për personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara fizike, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe asistencën në jetën e përditshme, shih 87.30

NVE Rev 2.1 kod	68.3
Përshkrim	Aktivitete të pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	68.31
Përshkrim	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e blerjes, shitjes dhe dhënies me qira të pasurive të paluajtshme duke bashkuar klientët dhe shitësit ose ofruesit e shërbimeve kundrejt një tarife ose komision. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose përmes kanaleve jo digjitale (duke përfshirë ballë për ballë, derë më derë, telefon, postë elektronike, e kështu me radhë). Tarifa ose komisioni mund të merret ose nga klienti ose shitësi i pasurisë së paluajtshme ose ofruesi i shërbimit të pasurive të paluajtshme. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh. të ardhurat nga shitja e hapësirave reklamuese palëve të treta. Kjo klasë përfshin ofrimin e aktiviteteve të pasurive të paluajtshme nga agjencitë e pasurive të paluajtshme ose agjentë të pavarur të pasurive të paluajtshme: - ndërmjetësimin në blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme me tarifë ose kontratë baze
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimi i listimit të pasurive të paluajtshme
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e agjentëve të dorëzanës së pasurive të paluajtshme, shih 68.32 - aktivitetet ligjore, shih 69.10
NVE Rev 2.1 kod	68.32
Përshkrim	Aktivitete të tjera të pasurive të paluajtshme me tarifë ose kontratë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e agjencive të mbledhjes së qirave - menaxhimi i pasurive të paluajtshme, p.sh. menaxhimi i pronave të pasurive të paluajtshme ose banesave në pronësi të përbashkët (kryesisht bëhet me pagesë ose kontratë) - aktivitetet e vlerësimit të pasurive të paluajtshme - aktivitetet e agjentëve të ruajtjes së pasurive të paluajtshme - aktivitete këshilluese me pagesë ose kontratë , në lidhje me blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet ligjore, shih 69.10- aktivitetet e menaxhimit të aseteve si pjesë e këshillimit të menaxhimit financiar, shih 70.20 - shërbimet mbështetëse të kombinuara të objekteve (ofrimi i një kombinimi shërbimesh mbështetëse, p.sh. pastrimi i përgjithshëm i brendshëm, mirëmbajtja dhe kryerja e riparimeve të vogla, depozitimi i plehrave, rojet dhe siguria), shih 81.10

NVE Rev 2.1 kod	N
Përshkrim	AKTIVITETE PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE
Përfshin	Ky seksion përfshin aktivitete të specializuara profesionale, shkencore dhe teknike. Këto aktivitete kërkojnë një shkallë të lartë trajnimi dhe të sigurojnë per perdoruesit njohuri dhe aftësi të specializuara.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	69
Përshkrim	Aktivitete juridike dhe të kontabilitetit
Përfshin	Kjo ndarje përfshin përfaqësimin ligjor të interesave të njëres palë kundër një pale tjetër, përpara ose jo gjykatës ose trupit tjetër gjykues, ose nën mbikëqyrjen e personave që janë anëtarë të dhomës së avokatisë, si këshillim dhe përfaqësim në çështje civile, këshillim dhe përfaqësim në aktet penale, këshillim dhe përfaqësim në lidhje me mosmarrëveshjet në punës. Aktivitetet e kësaj ndarje mund të ofrohen edhe online.
Përfshin gjithashtu	Ajo përfshin gjithashtu përgatitjen e dokumenteve ligjore, si statute, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumente të ngjashme në lidhje me krijimin e shoqërisë, patentat dhe të drejtat e autorit, përgatitjen e akteve, testamenteve, trusteeve, etj. si dhe aktivitete të tjera të noterisë publike, noterive të ligjit civil, përmbarues, arbitrave, inspektorëve dhe gjyqtareve. Gjithashtu përfshihet mbajtja e llogarive dhe shërbimet e kontabilisteve, si auditimi i regjistrave kontabël, përgatitja e gjendjes financiare dhe mbajtja e kontabilitetit.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	69.1
Përshkrim	Aktivitete juridike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	69.10
Përshkrim	Aktivitete juridike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - përfaqësimin ligjor i interesave të njërës palë kundër një pale tjetër, përpara ose jo gjykatës ose trupit tjetër gjykues, ose nën mbikëqyrjen e personave që janë anëtarë të avokatisë: • këshillimin dhe përfaqësimin në çështjet civile • këshillimin dhe përfaqësimin në çështjet penale • këshillimin dhe përfaqësimin në lidhje me mosmarrëveshjet në punë - këshillimin dhe konsultimin e përgjithshëm, përgatitjen të dokumenteve ligjore: • aktet e themelimit, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumente të ngjashme në lidhje me krijimin e shoqërisë • patentat dhe të drejtat e autorit • përgatitjen e akteve, testamenteve, amaneteve etj. - aktivitete të tjera të noterëve publikë, noterive të ligjit civil, përmbaruesve, arbitrave , kontroloreve dhe gjyqtarëve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: -aktivitetet e ndërmjetësimit ligjor -aktivitetet e kujdestarëve të përcaktuar ligjorë, pa ofrimin e kujdesit rezidencial
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e gjykatave, shih 84.23 - ndërmjetësimi social, shih 88.99

NVE Rev 2.1 kod	69.2
Përshkrim	Aktivitete kontabiliteti, mbajtje të llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	69.20
Përshkrim	Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - regjistrimin e transaksioneve tregtare nga bizneset ose të tjerëve - aktivitetet e kontabilitetit për llogarite financiare dhe llogarinë e pagave etj. - përgatitjen ose auditimin e llogarive financiare - kontrolli i llogarive dhe vërtetimi i saktësisë së tyre - përgatitjen e pagesës së detyrimeve tatimore për individë ose ndërmarrje - aktivitetet këshilluese kontabël dhe përfaqësim në emër të klientëve përpara administratës publike, p.sh. autoriteteve tatimore dhe gjykatave tatimore - aktivitetet e shërbimit të llogaritjes së tarifave dhe taksave
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: -aktivitetet e shërbimeve të faturimit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - publikimin e programeve kompjuterike për kontabilitetin, shih 58.29 - programimin kompjuterik të programeve për kontabilitetin, shih 62.10 - konsulencën e menaxhimit për sistemet e kontabilitetit, procedurat e kontrollit buxhetor, shih 70.20 - grumbullimin e faturave, shih 82.91

NVE Rev 2.1 kod	70
Përshkrim	Aktivitetet e zyrave qendrore dhe konsulencë menaxheriale
Përfshin	Kjo ndarje përfshin dhënien e këshillave dhe asistencës ndaj bizneseve dhe organizatave të tjera për çështjet e menaxhimit, p.sh. planifikimi strategjik dhe organizativ; planifikimi dhe buxhetimi financiar; objektivat dhe politikat e marketingut; politikat, praktikën dhe planifikimet e burimeve njerëzore; programi i prodhimit; planifikimi i kontroleve.
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu: -mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive të tjera të së njëjtës ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh, pra aktivitetet e zyrave qendrore.
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	70.1
Përshkrim	Aktivitetet e zyrave qendrore
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	70.10
Përshkrim	Aktivitetet e zyrave qendrore
Përfshin	Kjo klasë përfshin mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive të tjera të ndërmarrjes ose grupit të ndërmarrjeve, pra, aktivitete si zyra kryesore; ndërmarrja e planifikimit strategjik ose organizativ dhe rolit të vendimmarrjes së kompanisë ose ndërmarrjes; ushtrimin e kontrollit operacional dhe menaxhimin e operacioneve të përditshme të njësive të tyre të lidhura. Këto aktivitete janë të njëjta pavarësisht se cilat veprimtari kryejnë njësitë e menaxhuara (financime, prodhim, tregti, etj.). Kjo klasë përfshin aktivitetet e: - zyrat e centralizuara administrative - zyrat e korporatave - zyrat e qarkut dhe ato rajonale - zyrat e menaxhimit të filiale
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e kompanive mbajtëse, të cilat nuk merren me aktivitete të zyrës qendrore, shih 64.21

NVE Rev 2.1 kod	70.2
Përshkrim	Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	70.20
Përshkrim	Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin
Përfshin	Kjo klasë përfshin dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe asistencës operacionale ndaj bizneseve dhe organizatave të tjera mbi çështjet e menaxhimit, p.sh. planifikimin strategjik dhe organizativ të korporatës, riprojektimin e proceseve të biznesit, menaxhimin e ndryshimeve, reduktimin e kostove dhe çështje të tjera financiare; objektivat dhe politikat e marketingut; politikat, praktikatat dhe planifikimi i burimeve njerëzore: strategjitë e kompensimit dhe daljes në pension: programimin i prodhimit dhe planifikimin e kontrollit. Ky ofrim i shërbimeve të biznesit mund të përfshijë këshilla, udhëzime ose asistencë operacionale për bizneset dhe shërbimin publik në lidhje me: - hartimin e metodave ose procedurave të kontabilitetit - programet e llogaritjes së kostos - procedurat e kontrollit buxhetor - procedurat e prokurimit publik - aktivitetet e shërbimit të ngritjes të biznesit - planifikimin, organizimin, efikasitetin dhe kontrollin - informacione të menaxhimit etj
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: -certifikimin e menaxhimit, p.sh. me auditime menaxheriale -aktivitetin e një kompanie menaxhimi që ushtron një mandat drejtori ose menaxheri
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: -dizajnin e programeve kompjuterike për sistemet e kontabilitetit, shih 62.10 -këshillimin dhe përfaqësimin ligjor, shih 69.10 -aktivitetet e kontabilitetit, të llogarive dhe të auditimit, konsultimin tatimor, shih 69.20 -aktivitetet mbikëqyrëse dhe menaxhimi i njësisë të tjera të ndërmarrjes ose grupit të ndërmarrjeve, shih 70.10 -aktivitetet këshillimore arkitekturore dhe inxhinierike, shih 71.11, 71.12 -sigurimin e këshillimit, udhëzimit dhe ndihmës operative në lidhje me marrëdhëniet publike dhe komunikimin, shih 73.30 -aktivitetet konsultative për mjedisin, agronominë dhe të ngjashme, shih 74.99 -aktivitete këshilluese për kërkimin dhe vendosjen e ekzekutivit, shih 78.10 -aktivitetet e agjentëve të gjetjes së aktoreve, shih 78.10 -aktivitetet e përzgjedhjes së stafit, shih 78.10 -aktivitetet konsultuese arsimore, shih 85.69

NVE Rev 2.1 kod	71
Përshkrim	Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike; testimi dhe analiza teknike
Përfshin	Kjo ndarje përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturore, inxhinierike, shërbime projektesh, shërbime të inspektimit të godinave dhe survejimit dhe hartimit të hartave .
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu kryerjen e shërbimeve të testimit fizik, kimik dhe analitike dhe ofrimin e shërbimeve të certifikimit teknik.
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	71.1
Përshkrim	Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to
Përfshin	Ky grup përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturore, inxhinierike, shërbime të projektimit, shërbime të inspektimit të godinave dheurvejimit dhe hartimit të harteve, etj.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	71.11
Përshkrim	Aktivitete arkitekturore
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e konsultimit arkitekturor: • projektimi dhe hartimi i ndërtimit • hartimi i planit urbanistik dhe i arkitekturës së hapësirave urbane - aktivitete arkitekturore për të mbështetur ruajtjen dhe restaurimin e pronave të trashëgimisë kulturore - arkitektura e brendshme, d.m.th. ridizajnimi i strukturës dhe paraqitjes së brendshme të një ndërtese
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - rinovimin, ripërtëritjen, rindërtimin dhe restaurimin e vendeve dhe ndërtesave historike dhe arkeologjike, shih 43.99 - aktivitetet e konsulentëve kompjuterikë, shih 62.20 - planifikimin ose mbikëqyrjen e konservimit të ndërtimeve historike të inxhinierisë së ndërtimit, shih 71.12 - dekorimin e brendshëm, shih 74.13 - ruajtjen, restaurimin dhe aktivitete të tjera mbështetëse të trashëgimisë kulturore, shih 91.30

Përshkrim

Aktivitete inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- projekte inxhinierike (d.m.th. aplikimi i ligjeve fizike dhe parimeve të inxhinierisë në projektimin e makinerive, materialeve, instrumenteve, strukturave, proceseve dhe sistemeve) dhe aktivitetet e konsultimit për:
 - makineri, procese dhe impiante industriale
 - projekte duke përfshirë inxhinierinë civile, hidraulike, transporti
 - projekte për menaxhimin e ujërave
 - Infrastruktura e bazuar në natyrë
- projektimi i sistemeve të informacionit të ndërtesave, p.sh. lidhur me sistemet e ngrohjes, fikset e zjarrit
- përpunimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në lidhje me inxhinierinë elektrike dhe elektronike, inxhinierinë e minierave, inxhinierinë kimike, mekanike, industriale dhe inxhinierinë e sistemeve
- përpunimi dhe mbikëqyrja e projekteve që përdorin ajrin e kondicionuar, ftohjen, kontrollin sanitar dhe të ndotjes, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza, inxhinierinë strukturore, Inxhinieria detare në det dhe në toke, inxhinierinë e shëndetit dhe sigurisë, inxhinierinë akustike etj.
- vërtetimet gjeofizike, gjeologjike dhe sizmike
- aktivitete vërtetimi gjeodet:
 - aktivitete të vërtetimit të tokës dhe kufirit
 - aktivitete të vërtetimit hidrologjik
 - aktivitete të vërtetimit nëntokësor
- aktivitete kartografike dhe të informacionit hapësinor
- inxhinieri mjedisore dhe aktivitetet që lidhen me konsultimin
- inxhinieri e faqe interneti
- inxhinieri për uljen e zhurmës
- inxhinieri e zgjidhjeve të ekonomisë rrethore
- hartimi i planeve kompjuterike për printimin 3D

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetin e batimetrisë- aktivitetet e vlerësimit fotogrametrik, p.sh. mbledhja e të dhënave me dronë
- përgatitjen dhe rishikimin e hartave
- mbikëqyrjen e ndërtimit
- aktivitetet e menaxhimit të projektit të lidhura me inxhinierinë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- testimin e shpimit në lidhje me operacionet e minierave, shih 09.10, 09.90
- publikimin e programeve kompjuterike, shih 58.2
- zhvillimin dhe programimin e programeve kompjuterike, shih 62.10
- aktivitetet e konsulentëve kompjuterikë, shih 62.20
- zhvillimin e projekteve të ndërtimit për ndërtesa banimi dhe jo-banimi, për shitje të mëvonshme, shih 68.12
- testimin teknik, shih 71.20
- testimin periodik i sigurisë rrugore i mjeteve motorike, p.sh. automjete dhe mjete të tjera motorike të lehta, automjete të rënda, shih 71.20
- aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me inxhinierinë, shih 72.10
- aktivitete që lidhen me shërbime të tjera të projektimit, shih 74.1
- fotografimin ajror, shih 74.20
- aktivitetet e anketuesve sasi, shih 74.99

NVE Rev 2.1 kod	71.2
Përshkrim	Testimet dhe analizat teknike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	71.20
Përshkrim	Testimet dhe analizat teknike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - kryerja e testeve fizik, kimik dhe analitik dhe të tjera të llojeve të materialeve dhe produkteve, p.sh.: • kontrolli akustik dhe i vibrimit • kontrolli i përbërjes dhe pastërtisë së mineraleve • aktivitetet e kontrollit në fushën e higjienës ushqimore, përfshirë testimet dhe kontrollin në lidhje me prodhimet ushqimore, p.sh. testimi i kafshëve para therjes • kontrolli i karakteristikave fizike dhe paraqitja e materialeve, si fortesia, trashësia, qëndrueshmëria, radioaktiviteti • kontrolli i cilësisë dhe besimit • kontrolli i efektshmerisë të të gjithë makinerive të plota: motorë, automjete, pajisje elektronike etj. • kontroll radiografik i saldimeve dhe bashkimeve • analiza e dëmtimit • kontrolli dhe matja e treguesve të mjedisit: ndotja e ajrit dhe e ujit etj. • kontrolli i cilësisë së karburanteve - certifikimin e produkteve, përfshirë mallrat e konsumit, automjetet, avionët, kontejnerëve të presuar, uzinave bërthamore etj. - kontrolli periodik i sigurisë në rrugë të mjeteve automjeteve - kontrolli me përdorimin e modeleve ose maketeve (p.sh. të avionëve, anijeve, moleve, etj) - funksionimin e laboratorëve policorë ose të mjekësisë ligjore - origjina e produktit dhe aktivitetet e vlerësimit të cilësisë

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - inspektimet e tubacioneve të ajrit, ujit dhe gazit, që nuk kanë lidhje me riparimin ose instalimin
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - inspektimet e tubave të ajrit, tubave të ujit dhe gazit, të lidhura me riparimin ose instalimin, shih seksionin F - kampionimin dhe peshimin si pjesë e operacioneve të trajtimit të mallrave, shih 52.25 - testimin e depërtimit të sistemeve kompjuterike, hakerimin etik dhe sigurinë kibernetike, shih ndarjen 62 - aktiviteti këshillues i kryer nga kompani ose profesionistë për të marrë një certifikim, shih 70.20 - Sekuestrimi(marrja) i ADN-së për kërkime të përgjithshme mbi proceset biologjike, shih 72.10 - testimi e mostrave të kafshëve, për arsye shëndetësore dhe jo të lidhura me

prodhimin e ushqimit, shih 75.00
- imazherinë diagnostikuese, testime dhe analiza të mostrave mjekësore dhe dentare, shih ndarjen 86
- Sekuestrimi (marrja) i ADN-së për të përjashtuar ose kuruar një sëmundje specifike, shih 86.91

NVE Rev 2.1 kod

72

Përshkrim

Kërkim dhe zhvillim shkencor

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e tre llojeve kërkimeve dhe zhvillimeve:

1) kërkimi bazë: punë eksperimentale ose teorike e ndërmarrë kryesisht për të fituar njohuri të reja mbi themelin e fenomenit dhe fakteve të observuara, pa zbatim ose përdorim të veçantë në dukje
2) kërkimi i aplikuar: hulumtimi origjinal i ndërmarrë për të përvetësuar njohuri të reja, të drejtuara fillimisht ndaj një qëllimi ose objektivi specifik praktik dhe
3) zhvillim eksperimental: punë sistematike, duke u mbështetur në njohuritë ekzistuese fituar nga kërkimi dhe/ose eksperiencia praktike, për të prodhuar materiale, produkte dhe pajisje, në instalimin e proceseve, sistemeve dhe shërbimeve të reja dhe për të përmirësuar thellësisht ato të prodhuara ose të instaluar tashmë. Aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit eksperimental në këtë ndarje nuk duhet të konsiderohen si aktivitete ndihmëse.
Ato ndahen në dy kategoritë e mëposhtme: shkencat e natyrores dhe inxhinieria; shkencat sociale dhe humane.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu:

- zhvillimin dhe prodhimin e prototipave me objektivin kryesor për të bërë përmirësime të mëtejshme, pavarësisht nëse lidhen ose jo me prodhimin e tij

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- kërkimin e tregut dhe sondazhet e publikut, shih 73.20

NVE Rev 2.1 kod

72.1

Përshkrim

Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinierike

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	72.10
Përshkrim	Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinierike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në shkencat natyrore dhe inxhinieri: • kërkimi dhe zhvillimi në shkencat e natyrores • kërkimi dhe zhvillimi në inxhinieri dhe teknologji • kërkimi dhe zhvillimi mbi shkencat mjekësore, shëndetësore dhe jetësore dhe veterinare • kërkimi dhe zhvillimi në bioteknologji • kërkimi dhe zhvillimi në shkencat bujqësore, pyjore dhe të peshkimit • kërkimi dhe zhvillimi ndërdisiplinor, kryesisht në shkencat e natyrës dhe inxhinieri
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - sekuencimin e ADN-së për kërkime të përgjithshme mbi proceset biologjike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - sekuestrimi (marrja) i ADN-së për përjashtimin ose kurimin e një sëmundjeje specifike, shih 86.91

NVE Rev 2.1 kod	72.2
Përshkrim	Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat sociale dhe humane
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	72.20
Përshkrim	Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat sociale dhe humane
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat sociale, si. ekonomi dhe administrim biznesi; psikologji dhe shkenca konjitive; arsimimi; sociologji; ligj; shkencat politike; media dhe komunikimi - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat humane dhe artet (si, histori dhe arkeologji; letërsi dhe gjuhët; filozofia) - kërkimin dhe zhvillimin ndërdisiplinor, kryesisht në shkencat sociale dhe humane
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - kërkimin dhe zhvillimin në marrëdhëniet social- ekonomike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kërkimin e tregut dhe sondazhet e opinionit publik, shih 73.20

Përshkrim

Aktivitetet e reklamave, kërkimit të tregut dhe marrëdhënieve me publikun

Përfshin

Kjo ndarje përfshin krijimin e fushatave publicitare dhe vendosjen e këtyre publiciteteve të tilla në periodikë, gazeta, radio, televizion dhe në internet, apo media të tjera si dhe dizenjimin e strukturave të paraqitjes dhe vendosjes. Këto aktivitete publicitare shpesh ofrohen nëpërmjet agjencive reklamuese dhe përfaqësuesve të mediave. Kjo ndarje përfshin edhe studimin e tregut dhe opinionit, p.sh. mbi qëndrimet, vlerat dhe sjelljen e popullsisë dhe të grupeve të ndryshme socio-demografike dhe socio-ekonomike në lidhje me çështjet ekonomike, sociale dhe politike. Ai përfshin gjithashtu marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- aktivitetet nga të cilat krijohen të ardhurat nga reklamat klasifikohen sipas aktivitetit aktual, p.sh. botimi i gazetave reklamuese
- shitjen e kohës ose hapësirës reklamuese direkt nga pronarët e kohës ose hapësirës (botuesit etj.), shih klasën përkatëse të aktivitetit

Përshkrim

Reklama

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive te reklamave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- krijimin i një game të plotë shërbimesh publiciteti (p.sh. nepermjet kapaciteteve të brendshme ose nënkontraktimeve), duke përfshirë shërbime këshillimi, krijimi, prodhimin e materialit publicitar
- planifikimin dhe organizimin e fushatave publicitare dhe marketingut
- vendosjen e reklamave në media
- punën për konceptimin e mesazhit publicitar
- menaxhimin e ecurisë së fushatave publicitare
- krijimin dhe realizimin e fushatave publicitare:
 - krijimi dhe vendosja e reklamave dhe planifikimi i fushatave të marketingut në mediat sociale në gazeta, periodike, radio, televizion, në internet dhe media të tjera
 - krijimi dhe vendosja e reklamave në ambient të jashtëm, p.sh. stende afishimi, panele, buletinet dhe kornizat, veshjet e dritareve, salla ekspozimi, vetura dhe autobuze
 - reklamat ajrore
 - shpërndarja ose përhapja e materialit ose mostrave reklamuese
 - krijimi i stendave dhe strukturave të tjera dhe vendeve për vendosje të reklamave
- bërjen e fushatave të marketingut dhe shërbimeve të tjera reklamuese
 - promovimin e produkteve
 - tregtimi
 - marketingu në pikën e shitjes
 - reklama direkte me postë
 - këshillim marketingu
 - marketingu i influencerave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimi i materialit reklamues, shih seksionin C në varësi të llojit të materialit
- prodhimi i stendave për panaire dhe ekspozita dhe i ekspozitave të produkteve, shih seksionin C në varësi të llojit të materialit
- instalimi i stendave për panaire dhe ekspozita, shih 43.32
- botimi i materialit reklamues, shih 58.19
- prodhimi i mesazheve komerciale televizive dhe filmike, shih 59.11
- aktivitetet e prodhimit të videove të produkteve komerciale (përfshirë prodhimin e videove për rrjetet sociale), shih 59.11
- publikimi i përmbajtjeve që përfshijnë video, p.sh. nga ndikuesit, blogerët dhe blogerët, shih 59.11
- prodhimi i mesazheve komerciale për radio, shih 59.20
- platformat e shpërndarjes (ndarjes) të përmbajtjes, duke përfshirë faqet e blogut dhe wiki-ve, faqet e rrjeteve sociale dhe faqet e pavarura të lojërave/lojërave në internet, shih 60.39
- hulumtimi i tregut dhe sondazhi i opinionit publik, shih 73.20
- fotografia reklamuese, shih 74.20
- aktivitetet postare, shih 82.10
- organizatorët e konventave dhe shfaqjeve tregtare, shih 82.30
- shërbimet reklamuese të përdorura për financimin e aktivitetit mbizotërues të biznesit të cilat mund të ofrohen pa pagesë, shih aktivitetin mbizotërues

NVE Rev 2.1 kod	73.12
Përshkrim	Përfaqësimi në media
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - përfaqësimin e mediave, p.sh. shitjen ose rishitjen e kohës dhe hapësirës për reklamat në media të ndryshme
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shitja e hapësirës për reklama në media të ndryshme
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e marrëdhëniet me publikun dhe komunikimit, shih 73.30 - shitja e kohës ose hapësirës reklamuese direkt nga pronarët e kohës ose hapësirës (botuesit, etj.), shih klasën përkatëse të aktivitetit
NVE Rev 2.1 kod	73.2
Përshkrim	Kërkim tregu dhe sondazhet e opinionit publik
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	73.20
Përshkrim	Kërkim tregu dhe sondazhet e opinionit publik
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - kryerjen e studimeve të kërkimit të tregut për ndërgjegjësimin, vlerësimin dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, mbi zhvillimin e produkteve dhe çmimet, mbi përdorimin e medias dhe mbi tërheqjen dhe ndikimin e reklamave - kryerjen e studimeve të hulumtimit të opinionit mbi cilësinë e jetës dhe stilin e jetesës, mbi pjesëmarrjen sociale dhe politike, mbi preferencat partiake dhe sjelljen e votimit.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu kryerjen shkencore të kërkimit të tregut dhe opinionit me: - orientimi metodologjik cilësor dhe sasior - procedurat e anketimit reaktive dhe joreaktive - mbledhja e të dhënave kërkimore përmes pyetjeve, vëzhgimit, matjes dhe numërimit- intervista ballë për ballë, postare, telefonike dhe online për të mbledhur të dhëna kërkimore
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - reklamat, shih 73.1 - aktivitetet e marrëdhënive me publikun dhe komunikimit, shih 73.30 - kryerjen e intervistave telefonike për studimet e tregut dhe sondazhet e opinionit mbi bazën e kontratës ose pagesës, shih 82.20

NVE Rev 2.1 kod	73.3
Përshkrim	Aktivitete të marrëdhënieve me publikun dhe të komunikimit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	73.30
Përshkrim	Aktivitete të marrëdhënieve me publikun dhe të komunikimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe asistencës operacionale, duke përfshirë aktivitetet lobuese, për bizneset dhe organizatat e tjera për marrëdhëniet me publikun dhe komunikimin.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e përfaqësuesve të shitjes, për qëllime promovimi
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shërbimet e agjencive të reklamave dhe përfaqësimit në media, shih 73.1 - kërkimin e tregut dhe sondazhi i opinionit publik, shih 73.20 - projektimin dhe konsultimin në lidhje me komunikimin vizual, shih 74.12

NVE Rev 2.1 kod	74
Përshkrim	Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike
Përfshin	Kjo ndarje përfshin sigurimin e shërbimeve profesionale shkencore dhe teknike (përveç aktivitetëve juridike dhe të kontabilitetit; aktivitetëve të arkitekturës dhe inxhinierisë; testimeve teknike dhe analizave; menaxhimit dhe aktivitetëve të konsulencës së menaxhimit ; kërkim dhe zhvillim dhe aktivitete të reklamave).
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	74.1
Përshkrim	Aktivitete të specializuara të dizajnit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	74.11
Përshkrim	Aktivitetet e produkteve industriale dhe dizajnit të modës
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - skicimin e modeleve të tekstileve, veshjeve, këpucëve, bizhuterive, mobilie dhe të tjera dekoracione të tjera të brendshme dhe mallra të tjera të modës, si dhe mallra të tjera personale ose shtëpie - skicimin industrial, i realizuar edhe nëpërmjet programeve kompjuterike të specializuara, d.m.th. krijimi dhe zhvillimi i dizenjave dhe specifikimeve që optimizojnë përdorimin, vlerën, përmirësojnë dhe pamjen e produkteve, duke përfshirë përcaktimin e materialeve, mekanizmit, formës, ngjyrës dhe përfundimeve të sipërfaqes së produktit, duke marrë parasysh karakteristikat dhe nevojat njerëzore, sigurinë, tërheqjen e tregut në shpërndarje, përdorim dhe mirëmbajtje
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - skicimi inxhinierik, pra zbatimi i ligjeve fizike dhe parimeve të inxhinierisë në projektimin e makinave, materialeve, instrumenteve, strukturave, proceseve dhe sistemeve, shih 71.12 - hartimin e planeve kompjuterike për printimin 3D, shih 71.12

NVE Rev 2.1 kod	74.12
Përshkrim	Aktivitete te dizajnit grafik dhe të komunikimit vizual
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e dizajnerëve grafikë - dizajnin grafik i faqeve te internetit - aktivitetet e projektuesve të komunikimit - aktivitete të specializuara në hartimin e mesazheve dhe informacionit, duke marrë parasysh karakteristikat dhe nevojat e njerëzve, objektivat e korporatës, atraktivitetin e tregut dhe mediat e shpërndarje - skicimi dhe këshillimi në përmbajtjen dhe paraqitjen e jashtme të fushatave dhe përmbajtjes së komunikimit, konceptimin dhe skicimin e imazheve vizuale (dizajni i korporatës) dhe mediave të komunikimit të korporatës, dizajni i markës dhe përditësimi i markës, përcaktimi i gjuhës vizuale, formës, ngjyrës, tipografisë së publikimeve , ilustrim didaktik i konteksteve komplekse dhe abstrakte

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - dizajnimi i grafikës së prodhuar nga kompjuteri për animacione, shih 59.11 - dizajnimi i strukturës së faqeve te internetit duke zbatuar parimet e inxhinierisë softuerike, shih 62.10 - dizajni i uebit në kombinim me programimin e faqeve te internetit, shih 62.10
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	74.13
Përshkrim	Aktivitetet e dizajnit të brendshëm
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e dekoruesve të brendshëm - shërbimet e dizajnit të brendshëm, p.sh. planifikimi dhe projektimi i hapësirave të brendshme për të përmbushur nevojat estetike dhe funksionale të njerëzve duke u fokusuar kryesisht në përfundimet, mobiliat dhe paletat e ngjyrave - hartimi i dizenjove për dekorimin e brendshëm

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e dizajnit arkitekturor, shih 71.11
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	74.14
Përshkrim	Aktivitete të tjera të specializuara dizajni
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - projektimi i grafikëve të prodhuar nga kompjuteri për animacione, shih 59.11

NVE Rev 2.1 kod	74.2
Përshkrim	Aktivitete fotografike
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	74.20
Përshkrim	Aktivitete fotografike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - prodhimin e fotografive tregtare dhe për klientet: • fotografi portreti për pasaporta, shkolla, dasma etj. • fotografi për qëllime tregtare, botuese, modë, imobiliare ose turizëm • fotografi ajrore dhe nënujore • xhirime video të ngjarjeve: dasma, mbledhje etj. - përpunimin e filmave: • zhvillimi, printimi dhe zmadhimi i negativave të marra nga klienti ose filmat kinematografie • laboratorë të zhvillimit të filmave dhe stampimit të fotografive • dyqane fotografie një orëshe (jo pjesë e dyqaneve të aparateve fotografike) • montimi i negativave • kopja dhe restaurimi ose rikorrigjimi transparent lidhur me fotografitë. - aktivitetet e fotoreporterëve - aktivitetet e fotografive artistike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - mikrofilmimin e dokumenteve - digjitalizimin e fotove, konvertimin e videos në programin cloud - skanimin e objekteve në formatin 3D
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e printimit të fotografive (nga telefonat celularë, kartat e memories, USB dhe mbështetëset e tjera elektronike), shih 18.12 - përpunimi i filmave për filmat kinematografik që lidhet me industrinë e filmit dhe televizionit, shih 59.12 - aktivitetet e informacionit kartografik dhe hapësinor, shih 71.12 - aktivitetet e vlerësimit fotogrametrik, shih 71.12 - funksionimin e makinave fotografike (vetë-shërbyese) me monedha, shih 96.99

NVE Rev 2.1 kod	74.3
Përshkrim	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	74.30
Përshkrim	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - përkthimin dhe interpretimin e të gjitha gjuhëve, përfshirë gjuhën e shenjave, qoftë të folur apo të shkruar

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - botimin e programeve kompjuterike të përkthimit, shih 58.29 - zhvillimin e instrumentave të përkthimit dhe motorëve të trajnimit të përkthimit, shih 62.10 - aktivitetet e mësimdhënies së gjuhës, shih 85.59
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	74.9
Përshkrim	Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	74.91
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit të patentave dhe marketingut
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e ndërmjetësimit dhe marketingut për patentat
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimet e menaxhimit për të drejtat e autorit dhe të ardhurat e tyre - shërbimet e menaxhimit për të drejtat e pronësisë industriale (patenta, licenca, marka tregtare, ekskluzivitet etj.) - aktivitetet e organizatave të menaxhimit të të drejtave kolektive - menaxhimi i të drejtave në pronësinë intelektuale, p.sh. të drejtat e autorit dhe të ardhurat e tyre
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - dhënien me qira e pronësisë intelektuale dhe produkteve të ngjashme, shih 77.40

Përshkrim

Të gjitha aktivitetet e tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin një game te gjere te aktiviteteteve dhe shërbimeve në përgjithësi realizuar ndaj klientëve komercialë. Ajo përfshin ato aktivitete për të cilat kërkohen nivele më të avancuara profesionale, shkencore dhe teknike, por nuk përfshin funksione rutine ne vazhdim të bizneseve që zakonisht janë me kohëzgjatje të shkurtër.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e ndërmjetësimit të biznesit, d.m.th. organizimi për blerjen dhe shitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, përfshirë praktikat profesionale, por duke përjashtuar ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme
- aktivitetet e vlerësimit përveç pronës të paluajtshme dhe sigurimeve (për antikitet, bizhuteri, etj.)
- auditimin e faturave dhe informacionin për tarifat e mallrave
- aktivitetet e parashikimit të motit
- konsulencë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendin e punës
- shërbimet e konsulencës agronomike
- aktivitetet e konsulencës mjedisore
- aktivitete këshilluese për kursimin e energjisë
- konsulencë të tjera teknike
- aktivitetet e anketuesve sasior

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e kryera nga agjentë dhe agjenci në emër të individëve që zakonisht përfshijnë marrjen e angazhimeve në filma, prodhim teatrale ose atraksione të tjera argëtuese ose sportive dhe vendosjen e librave, shfaqjeve, veprave artistike, fotografive etj., me botuesit, producentët etj.
- shërbimet ekonomike për projekte ndërtimi, p.sh. nga ekonomistët e ndërtimit
- aktivitetet e bordit mbikëqyrës
- aktivitetet të planifikimit dhe përpunimit të projekteve në fushën e menaxhimit të gjuetisë
- aktivitetet e vlerësimit të numrit të kafshëve të gjahut

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e shtëpive të ankandeve (shitje me shumicë) dhe aktivitetet e ankandeve në internet (shitje me shumicë), shih 46.1
- aktivitetet e shtëpive të ankandeve (shitja me pakicë) dhe aktivitetet e ankandeve online (shitja me pakicë), shih 47.9
- aktivitetet e agjentëve të pasurive të paluajtshme, shih 68.31
- aktivitetet e kontabilitetit, shih 69.20
- aktivitetet e konsulentëve të menaxhimit, shih 70.20
- aktivitetet e konsulentëve të arkitekturës dhe inxhinierisë, shih 71.1
- aktivitetet e inxhinierisë mjedisore, shih 71.12
- aktivitetet gjeodezike të rilevimit, shih 71.12
- projektimi industrial dhe i makinerive, shih 71.12, 74.11
- testimin dhe kontrollin veterinar në lidhje me prodhimin e ushqimit, shih 71.20
- shfaqjen e reklamave dhe e formave të tjera publiciteti, shih 73.11
- aktivitetet e shërbimit të promovimit të shitjeve, shih seksionin 73.11
- aktivitetet e ndërmjetësimit të patentave, shih 74.91
- menaxhimi i të drejtave të pronësisë industriale, p.sh. patentat, licencat, markat tregtare, ekskluzivitetet, shih 74.91
- aktivitetet e konsulentëve të sigurisë, shih 80.09
- aktivitetet e organizatorëve të konventave dhe panaireve tregtare, shih 82.30

- administrimi i programeve të besnikërisë, shih 82.99
- konsultimi me mjekët, shih 86.2
- këshillimi për kredinë konsumatore dhe borxhin, shih 88.99

NVE Rev 2.1 kod

75

Përshkrim

Aktivitete Veterinare

Përfshin

Kjo ndarje përfshin sigurimin e kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe aktiviteteve të kontrollit për kafshët e fermës ose kafshët shtëpiake. Këto aktivitete kryhen nga veterinerë të kualifikuar në spitale veterinare, si dhe kur vizitojnë ferma, stalla ose shtëpi, në kabinetin e vet te konsultimit dhe kirurgjisë ose gjetkë.

Përfshin gjithashtu

Ai përfshin gjithashtu aktivitetet ambulatorë të kafshëve.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

75.0

Përshkrim

Aktivitete Veterinare

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

75.00

Përshkrim

Aktivitete Veterinare

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet për kujdesin dhe kontrollin shëndetësor të kafshëve në fermat e tyre.
- aktivitetet për kujdesin dhe kontrollin shëndetësor për kafshët shtëpiake. Këto aktivitete kryhen në spitalet veterinare, si dhe në ferma, stalla ose shtëpi, në kabinetet e konsultimit dhe kirurgjisë apo gjetkë

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e asistentëve veterinar ose personelit tjetër ndihmës veterinar
- aktivitetet kliniko-patologjike dhe të tjera aktivitete diagnostikuese që lidhen me kafshët
- aktivitetet e ambulancave të kafshëve
- aktivitetet e kiropraktorit të kafshëve
- aktivitetet e dietistit të kafshëve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e strehimit të kafshëve pa kujdes shëndetësor, shih 01.62
- qethjen e dhenvë, shih 01.62
- shërbimet e testimit të kopeve, shërbime të tufave, tredhja e kafshëve, kaponizimi i shpendëve, shih 01.62
- aktivitetet në lidhje me mbarësimin artificial, shih 01.62
- testimi dhe kontrolli i kafshëve para therjes në lidhje me prodhimin e ushqimit, shih 71.20
- kërkime shkencore mbi gjenetikën e kafshëve, shih 72.10

- aktivitetet e strehimit të kafshëve shtëpiake pa kujdes shëndetësor, shih 96.99

NVE Rev 2.1 kod

O

Përshkrim

AKTIVITETET ADMINISTRATIVE DHE TË SHËRBIMIT MBËSHETËS

Përfshin

Ky seksion përfshin një sërë aktivitetesh që mbështesin operacionet e përgjithshme të punës. Këto aktivitete ndryshojnë nga ato të seksionit N, duke qenë se qëllimi i tyre parësor nuk është transferimi i njohurive të specializuara.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

77

Përshkrim

Aktivitetet e qiradhënies dhe leasing-ut

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e qiradhënies dhe leasing-ut të aktiveve materiale dhe jofinanciare jofizike dhe të shërbimit të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e tyre. Sa u përket aktiviteteteve të qiradhënies, në këtë ndarje përfshihet vetëm ofrimi i qirave operative. Qiramarrësi ose qiradhënësi merr përsipër riskun ekonomik për të mirat materiale dhe aktivet jofinanciare jofizike të ofruara, ndërsa ndërmjetësuesi nuk ka asnjë risk ekonomik për të mirat materiale dhe aktivet jofinanciare jofizike të ndërmjetësuar. Në këtë ndarje përfshihen një sërë të mirash materiale, si automobilat, kompjuterat, mallrat e konsumit, makineritë dhe pajisjet industriale, që u ofrohen klientëve kundrejt një pagese periodike qiraje.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- qiradhënien e pajisjeve me operator, shih klasat përkatëse sipas aktiviteteteve të kryera me këto pajisje, p.sh. ndërtim (seksioni F), transport (seksioni H)
- transmetimin e përmbajtjes, p.sh. programeve kompjuterike dhe librave, nga publikuesit e përmbajtjes, shih ndarjen 58
- aktivitetet e shërbimit të transmetimit të librave me zë, që nuk lidhen me publikimin e tyre, shih 60.10
- leasing-un financiar, shih 64.91
- qiradhënien e pasurive të paluajtshme, shih seksionin M

NVE Rev 2.1 kod

77.1

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i automjeteve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	77.11
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i autoveturave dhe automjeteve të vogla
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un operacional të mjeteve motorike (me peshë maksimale të lejuar nën 3,5 tonë) pa drejtues, duke mos marrë parasysh kohëzgjatjen e periudhës së qirasë ose mënyrën e pagesës, p.sh. abonim: • veturat e pasagjerëve, rulotat, mjetet e tjera motorike të lehta pa drejtues - qiradhënien e automjeteve të përbashkëta

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira dhe leasing-un operacional të një makine personale individuale pa shofer - dhënien me qira dhe leasing-un e motoçikletave
---------------------	--

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - dhënien me qira dhe leasing-un e automjeteve dhe mjeteve motorike të lehta me drejtues mjeti, shih 49.33 - aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e autoveturave dhe mjeteve motorike të lehta, shih 77.51
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	77.12
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i kamionëve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un operacional të llojeve të mëposhtme të automjeteve: • kamionë, automjete rulota, rimorkio pune dhe mjete motorike të tonazhit të rëndë (me peshë maksimale të lejuar mbi 3,5 tonë)
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien ose leasing-un e automjeteve të rënda të mallrave ose kamionëve me drejtues mjeti, shih 49.41, 49.42 - qiradhënien ose leasing-un e mjeteve të transportit tokësor (përveç mjeteve motorike) pa drejtues mjeti, p.sh. rimorkiove me rulotë, shih 77.39

NVE Rev 2.1 kod	77.2
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i artikujve personale dhe shtëpiake
Përfshin	Ky grup përfshin qiradhënien e produkteve personale dhe shtëpiake, si dhe qiradhënien e pajisjeve argëtuese dhe sportive dhe disqeve me video. aktivitetet përfshijnë përgjithësisht qiradhënien afatshkurtër të produkteve, megjithëse, në disa raste, produktet mund të lëshohen me qira për periudha më të gjata.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

77.21

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i mallrave të argëtimit dhe sportive

Përfshin

Kjo klasë përfshin lëshimin me qira të pajisjeve argëtuese dhe sportive, p.sh.:

- barka argëtimi, lundra, barka me vela dhe jahte pa operator
- biçikleta, duke përfshirë biçikletat me asistencë elektrike
- ski

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien me qira të barkave dhe barkave me vela së bashku me ekuipazh, shih 50.10, 50.30
- sigurimin e akomodimit afatshkurtër në banesa jo të lëvizshme, shih 55.20
- marrja me qira e varkave jo të lëvizshme si banesa kryesore, shih 68.20
- qiradhënien e kasetave dhe disqeve me video, shih 77.22
- qiradhënien e artikujve të tjerë personalë dhe shtëpiakë, shih 77.22
- qiradhënien dhe leasing-un e mjeteve të transportit ujor për pasagjerët ose mallrat, p.sh. barka, anije, mjet lundrues me jastëk ajri, pa operator, shih 77.34
- dhënien me qira të pajisjeve të argëtimit dhe zbavitjes si një pjesë përbërëse të ambienteve argëtuese, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod

77.22

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i artikujve të tjera personale dhe shtëpiake

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- lëshimin me qira të të gjitha llojeve të produkteve shtëpiake ose personale, për familjet ose industrinë (me përjashtim të pajisjeve argëtuese dhe sportive):
 - tekstile, veshje dhe këpucë, p.sh. perde, kostume, fustane dhe këpucë nusërie
 - mobilie, qeramikë dhe qelq, orendi kuzhine dhe servisi, pajisje elektroshtëpiake dhe për përdorim familjar
 - bizhuteri, instrumente muzikore, sfonde dhe kostume
 - libra, revista dhe periodikë
 - makineri dhe pajisje të përdorura nga persona amatorë, p.sh. vegla për riparime shtëpiake
 - lule dhe bimë
 - pajisje elektronike për përdorim shtëpiak
- lëshimin me qira të videolojërave, disqeve me video, regjistrimeve, etj.
- dhënien me qira të gazebove dhe tendave pa shërbime shtesë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- ofrimin e shërbimeve të akomodimit në tenda, shih 55.30
- ofrimin e lojërave në internet nga publikuesi (jo vetëm blerje e njëhershme, por edhe abonime, si dhe blerje brenda lojës dhe aplikacionit), shih 58.21
- faqet e pavarura të lojërave/videolojërave në internet, shih 60.39

- qiradhënien e veturave, motoçikletave, kamionëve, rimorkiove të punës dhe rulotave pa drejtues mjeti, shih 77.1
- qiradhënien e mallrave të argëtimit dhe sportive, shih 77.21
- qiradhënien e mobilieve të zyrës, shih 77.33
- qiradhënien e rimorkiove me rulotë, shih 77.39
- qiradhënien e tendave për aktivitete, shih 77.39

NVE Rev 2.1 kod

77.3

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i makinerive, pajisjeve dhe mallrave fizike të tjera

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

77.31

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i makinerive dhe pajisjeve bujqësore

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- qiradhënien dhe leasing-un operacional të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe pyjore pa operator:
- lëshimi me qira i produkteve të prodhuara nga klasa 28.30, p.sh. traktorët bujqësorë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- qiradhënien e makinerive ose pajisjeve bujqësore dhe pyjore me operator, shih 01.61, 02.40

NVE Rev 2.1 kod

77.32

Përshkrim

Qiradhënia dhe leasing-u i makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit dhe inxhinierisë së ndërtimit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- qiradhënien dhe leasing-un e makinerive dhe pajisjeve të inxhinierisë së ndërtimit dhe civile pa operator:
- kamionë vinç
- skela dhe platforma punimi, pa montim dhe çmontim

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- qiradhënien e makinerive ose pajisjeve të ndërtimit dhe inxhinierisë së ndërtimit me operator, shih ndarjen 43
- qiradhënien ose leasing-un operacional të skelave dhe platformave të punës, duke përfshirë ngritjen dhe çmontimin e tyre, shih 43.99
- qiradhënien ose leasing-un operacional të makinerive dhe pajisjeve të minierës, shih 77.39

NVE Rev 2.1 kod	77.33
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i makinerive, pajisjeve dhe kompjuterëve për zyra
Përfshin	Kjo klasë përfshin:- qiradhënien dhe leasing-un operacional të makinerive dhe pajisjeve të zyrës pa operator: • kompjuterat dhe pajisjet kompjuterike periferike • makineritë e dublimit, makinat e shkrimit dhe makineritë e përpunimit të fjalëve • makineritë dhe pajisjet e kontabilitetit: kasat, makinat llogaritëse elektronike, etj. • mobilie zyre

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	77.34
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i mjeteve të transportit ujor
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un operacional të mjeteve të transportit ujor pa operator: • barkat tregtare, anijet dhe mjetet lundruese me jastëk ajri

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien e mjeteve të transportit ujor me operator mjeti, shih ndarjen 50 - qiradhënien e barkave të argëtimit pa operator, shih 77.21
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	77.35
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i mjeteve të transportit ajror
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un operacional të mjeteve të transportit ajror pa operator: • aeroplanë • balona me ajër të nxehtë • helikopterë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien e mjeteve të transportit ajror me operator, shih ndarjen 51
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	77.39
Përshkrim	Qiradhënia dhe leasing-u i makinerive, pajisjeve dhe mallrave të tjera fizike të p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un operacional, pa operator, të makinerive dhe pajisjeve të tjera të përdorura përgjithësisht si të mira kapitale nga industritë: • motorët dhe turbinat • veglat mekanike • pajisjet e minierave dhe fushave të naftës • pajisjet profesionale të radios, televizionit dhe komunikimit • pajisjet për prodhimin e filmave • pajisjet matëse dhe kontrolluese • makineri të tjera shkencore, tregtare dhe industriale - qiradhënien dhe leasing-un operacional të pajisjeve të transportit tokësor (përveç veturave) pa drejtues: • rimorkiot me rulotë • mjetet hekurudhore - qiradhënien e gomave - qiradhënien e pajisjeve për aktivitete, panaire dhe ekspozita, p.sh. për funksionimin e pajisjeve të energjisë, ndriçimit, audios dhe skenës - qiradhënien e mobilieve për aktivitete, panaire dhe ekspozita - qiradhënien e pajisjeve mjekësore/spitalore - qiradhënien dhe leasing-un e makinave të kazinosë
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - dhënien me qira të kontejnerëve për akomodim ose zyra - dhënien me qira të kafshëve (p.sh. tufa, kuaj race) - dhënien me qira të kontejnerëve të tjerë - dhënien me qira të paletave
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien e motoçikletave, shih 77.11- qiradhënien e biçikletave, shih 77.21 - qiradhënien e makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe pyjore, shih 77.31 - qiradhënien e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit dhe inxhinierisë së ndërtimit, shih 77.32 - qiradhënien e makinerive dhe pajisjeve të zyrës, duke përfshirë kompjuterat, shih 77.33

NVE Rev 2.1 kod	77.4
Përshkrim	Leasing-u i pronësisë intelektuale dhe produkteve të ngjashme, përveç punimeve me të drejtë autori
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

Përshkrim

Leasing-u i pronësisë intelektuale dhe produkteve të ngjashme, përveç punimeve me të drejtë autori

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitetet që u mundësojnë të tjerëve përdorimin e produkteve nën pronësi intelektuale dhe produkteve të ngjashme, për të cilat pronari i produktit (pra mbajtësi i asetit) përfiton një honorar ose tarifë licensimi. Lëshimi me qira i produkteve të tilla mund të kryhet në disa forma, p.sh. si leje për shumëfishim, përdorim në procese ose produkte të mëpasshme, operimin e bizneseve pjesë e një franshise. Pronarët aktualë mund ose jo t'i kenë krijuar këto produkte.

Kjo klasë përfshin:

- leasing-un e produkteve të pronësisë intelektuale (përveç punimeve me të drejtë autori, p.sh. libra, programe kompjuterike)
- marrjen e honorarëve ose tarifave të licensimit për të përdorur:
 - subjektet e patentuara
 - markat tregtare ose markat e shërbimit
 - emrat e markës
 - eksplorimin e mineraleve dhe vlerësimin e tyre
 - marrëveshjet e franshisave
- domain-et e internetit
- të drejtat e lojërave të tavolinës të projektuara ose krijuara

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- marrjen e honorareve ose tarifave të licensimit për rezultatet e kërkimit shkencor

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- marrjen e të drejtave dhe publikimin, shih ndarjet 58, 59
- prodhimin, shumëfishimin dhe shpërndarjen e veprave me të drejtë autori (libra, programe kompjuterike, filma), shih ndarjet 58, 59
- transmetimin e përmbajtjes, p.sh. programeve kompjuterike dhe librave, nga publikuesit e përmbajtjes, shih ndarjet 58
- aktivitetet e shërbimit të transmetimit të librave me zë, që nuk lidhen me publikimin e tyre, shih 60.10
- leasing-un e pasurive të paluajtshme, shih 68.20
- leasing-un e produkteve fizike (aseteve), shih 77.1, 77.2, 77.3

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e mallrave fizike dhe pasurive të tjera jofizike jofinanciare.

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	77.51
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e autoveturave, banesave me rrota dhe rimorkiove
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e qiradhënies dhe leasing-ut të automjeteve, banesave me rrota dhe rimorkiove me rulotë, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuara të qiradhënies dhe leasing-ut. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimit të qiradhënies. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - shërbimet e rezervimit për dhënie me qira të makinave
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien e mjeteve motorike të lehta, shih 77.11 - qiradhënien e mjeteve motorike të rënda, p.sh. banesave me rrota, shih 77.12 - qiradhënien e rimorkiove me rulotë, shih 77.39
NVE Rev 2.1 kod	77.52
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e mallrave fizike dhe pasurive të tjera jofizike jofinanciare të tjera.
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e qiradhënies dhe leasing-ut të mallrave të tjera fizike dhe aktiveve jofinanciare jofizike, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuara të qiradhënies dhe leasing-ut. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimit të qiradhënies. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.
	Kjo klasë përfshin: - mundësimin e ndërmjetësimit ndërmjet familjeve që ofrojnë produktet e tyre për qiradhënie dhe familjeve që i marrin ato me qira, p.sh. korrëse bari, shkallë, biçikleta
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - qiradhënien dhe leasing-un e mallrave personale dhe shtëpiake, shih 77.2 - njësitë që kanë në pronësi makineri, pajisje dhe produkte fizike të tjera dhe/ose asete jofizike jofinanciare të dhëna me qira afatgjatë dhe afatshkurtër, shih 77.3 dhe 77.40

NVE Rev 2.1 kod	78
Përshkrim	Aktivitetet e punësimit
Përfshin	Kjo ndarje përfshin aktivitetet e shpalljes së vendeve të lira të punës dhe referimit ose përcaktimit të aplikantëve për punësim, ku individët e referuar ose të përcaktuar nuk janë punonjës të agjencive të punësimit, ofrimin e punëtorëve për bizneset e klientëve për periudha kohore të caktuara për të plotësuar fuqinë punëtore të klientit, dhe aktivitetet e ofrimit të burimeve të tjera njerëzore. Kjo ndarje përfshin: - aktivitetet e kërkimit dhe caktimit të punonjësve - aktivitetet e agjencive të rekrutimit për role teatri - aktivitetet e agjencive të rekrutimit - aktivitetet e zbulimit të talenteve
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - aktivitetet e agjentëve për artistët individualë, shih 74.99

NVE Rev 2.1 kod	78.1
Përshkrim	Aktivitetet e agjencive të gjetjes së punësimit
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	78.10
Përshkrim	Aktivitetet e agjencive të gjetjes së punësimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin shpalljen e vendeve të lira të punës dhe referimin ose përcaktimin e aplikantëve për punësim, ku individët e referuar ose të përcaktuar nuk janë punonjës të agjencive të punësimit. Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e kërkimit, përzgjedhjes, referimit dhe caktimit të punonjësve, duke përfshirë aktivitetet ekzekutive të caktimit dhe kërkimit - aktivitetet e agjencive dhe zyrave të rekrutimit për role, p.sh. agjencitë për rekrutimin e roleve të teatrit dhe modeleve - aktivitetet e agjencive të gjetjes së punësimit në internet
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e zbuluesve të talenteve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimeve të faturimit, shih 69.20 - aktivitetet e agjentëve për shfaqje teatrale personale shih 74.99

- aktivitetet e agjencive që ofrojnë dado dhe ndihmës për familjet, shih 78.20

NVE Rev 2.1 kod

78.2

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive të punësimit të përkohshëm dhe sigurimit të llojeve të tjera të burimeve njerëzore

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

78.20

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive të punësimit të përkohshëm dhe sigurimit të llojeve të tjera të burimeve njerëzore

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitetet e ofrimit të punëtorëve për bizneset e klientëve për periudha kohore të caktuara për të zëvendësuar ose plotësuar përkohësisht fuqinë punëtore të klientit. Në këtë formë punësimi, agjencia e punësimit të përkohshëm ose ofruesit e burimeve njerëzore janë punëdhënësit e individëve të ofruar si punëtorë. Megjithatë, klientët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e personelit të përkohshëm. Aktivitetet përfshijnë ofrimin e burimeve njerëzore për bizneset e klientëve. Njësitë e klasifikuara këtu përfaqësojnë punëdhënësit e regjistruar të punonjësve lidhur me çështjet e listë pagesës, taksave dhe çështjeve të tjera fiskale dhe të burimeve njerëzore, por ato nuk janë përgjegjëse për udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punonjësve. Njësitë e klasifikuara këtu kryejnë një gamë të gjerë detyrash për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe punonjësve, që lidhen me këtë aktivitet.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e shërbimeve të faturimit, shih 69.20

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive të udhëtimit, operatorëve turistikë dhe shërbimeve të tjera të rezervimit dhe aktivitete të ngjashme

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e agjencive, kryesisht të përfshira në shitjen dhe operimin e paketave të planifikuara paraprakisht ose të posaçme të udhëtimit, që përfshijnë transportin, akomodimin, argëtimin dhe kohën e lirë, vizitat turistike dhe shërbimet e tjera për publikun e gjerë dhe klientët tregtarë, si dhe aktivitetet e organizimit dhe ofrimit të vizitave turistike, që shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose drejtpërdrejt nga agjentët, p.sh. operatorët turistikë; dhe shërbimet e tjera të lidhura me turizmin, duke përfshirë shërbimet e rezervimit.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e udhërrëfyesve turistikë dhe aktivitetet e promovimit të turizmit
- shërbimet e ndërmjetësimit për udhëtimin

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit vetëm për transportin e pasagjerëve, shih 52.32
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit vetëm për akomodimin, shih 55.40
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e shërbimeve të ushqimit dhe pijeve, shih 56.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien e autoveturave, banesave me rrota dhe rimorkiove, shih 77.51
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për biletat e parqeve të lojërave, sportet dhe teatrin, shih 82.40

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet e agjencive, kryesisht të përfshira në shitjen e paketave të planifikuara paraprakisht ose të posaçme të udhëtimit, që përfshijnë transportin, akomodimin, vizitat turistike dhe shërbimet e tjera për publikun e gjerë dhe klientët tregtarë, si dhe aktivitetet e organizimit dhe ofrimit të vizitave turistike, që shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose drejtpërdrejt nga agjentët, p.sh. operatorët turistikë. Ky grup përfshin edhe aktivitetet e operatorëve turistikë.

Përfshin gjithashtu

Në këtë grup përfshihen edhe aktivitetet e operatorëve turistikë.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	79.11
Përshkrim	Aktivitetet e agjencive të udhëtimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e agjencive, të përfshira kryesisht në shitjen e paketave turistike dhe me traget për publikun e gjerë ose klientët tregtarë, krahas këshillimit ose ekspertizës shtesë për akomodimin: • shërbime rezervimi për paketat turistike, brenda dhe jashtë vendit • shërbime rezervimi për paketat turistike të personalizuar për grupe, brenda dhe jashtë vendit - aktivitetet e ndërmjetësimit për lidhjen e kontratave për ofrimin e shërbimeve turistike nga operatorët turistikë
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - ndërmjetësimin e shërbimeve të paketave të udhëtimeve në destinacion
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: -aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit vetëm për transportin e pasagjerëve, shih 52.32 - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit vetëm për akomodimin, shih 55.40 - aktivitetet e veprimeve faktike dhe ligjore të lidhura me nënshkrimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve turistike, me kërkesë të klientit, shih ndarjen 69 - shitjen e kutive të udhëtimit: forma e ofrimit të një shërbimi lidhur me udhëtimin, por shërbim i shtyrë, që mund të jetë i çfarëdolloj natyre: hotele, restorante, përkujdesje, aktivitete argëtimi, etj., shih 82.99

NVE Rev 2.1 kod	79.12
Përshkrim	Aktivitete të operatorëve turistikë
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - organizimin, ofrimin dhe marketingun e paketave turistike: • paketa turistike të parapërgatitura, brenda dhe jashtë vendit • paketa turistike të personalizuar për grupe, brenda dhe jashtë vendit. Zakonisht, një paketë e tillë përfshin transportin e udhëtarëve dhe bagazheve, akomodimin, si dhe shërbimet e ushqimit dhe vizitave. Operatorët turistikë përfshihen në operimin e paketave turistike të shitura nga agjencitë e udhëtimit, duke përfshirë organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme në paketën turistike. Operatorët turistikë mund të jenë të punësuar ose të kontraktuar nga një agjenci udhëtimi, ose mund të operojnë në mënyrë të pavarur.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen e paketave turistike, shih 79.11

NVE Rev 2.1 kod	79.9
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të tjera të rezervimit dhe aktivitete të ngjashme
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	79.90
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të tjera të rezervimit dhe aktivitete të ngjashme
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shërbimet e asistencës për vizitorët: • ofrimi i informacionit të udhëtimit për vizitorët • aktivitetet e ciceronëve turistikë të pavarur - aktivitetet e promovimit të turizmit
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e rezervimit me komisione për transportin e pasagjerëve, shih 52.32 - shërbimet e shkëmbimit me ndarje kohe, shih 55.40 -aktivitetet e agjencive të udhëtimit, shih 79.11 - aktivitetet e operatorëve turistikë, shih 79.12 - organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve, p.sh. takimeve, konventave dhe konferencave, duke përfshirë transportin, akomodimin dhe shitjen e biletave nëse menaxhohet nga vetë organizatori, shih 82.30 - aktivitetet e rezervimit dhe shitjes së biletave për teatër, sporte dhe forma të tjera argëtimi, shih 82.40

NVE Rev 2.1 kod	80
Përshkrim	Aktivitetet e hetimit dhe sigurisë
Përfshin	Kjo ndarje përfshin shërbimet që lidhen me sigurinë: - shërbimet e hetimit në të drejtën private, tregtare, të korporatës, sigurimit dhe atë penale për ushtrimin e të drejtave në gjykatë - shërbimet e rojës dhe patrullimit - tërheqja dhe dorëzimi i parave, të ardhurave ose sendeve të tjera me vlerë me staf dhe pajisje për mbrojtjen e këtyre pasurive gjatë transportit - shërbimet e sistemeve të sigurisë dhe operimin e sistemeve elektronike të alarmeve të sigurisë, p.sh. alarmet për hajdutët dhe zjarrin, si dhe shërbimet e monitorimit në distancë dhe sistemeve të mbikëqyrjes me video ku aktiviteti fokusohet te monitorimi në distancë i këtyre sistemeve, por shpesh përfshin edhe shërbimet e shitjes, instalimit dhe riparimit
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu: - shërbimet e sigurisë lidhur me parandalimin dhe sigurinë e njerëzve në ngjarjet publike dhe ambientet të hapura për publikun - shërbimet e sigurisë që ofrojnë shërbime makinash të blinduara

Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - aktivitetet e sigurisë së teknologjisë së informacionit, shih ndarjen 62
NVE Rev 2.1 kod	80.0
Përshkrim	Aktivitetet e hetimit dhe sigurisë
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitetet e sigurisë, që zakonisht kryhen nga operatorë privatë.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	80.01
Përshkrim	Aktivitetet e hetimit dhe sigurisë private
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shërbimet e hetimit në fushën private, tregtare, të sigurimit dhe atë ligjore - shërbimet e rojës, patrullës dhe sigurisë - shërbimet mbështetëse për shërbimet e mbledhjes dhe depozitimit të parave - shërbimet për shkatërrimin e sigurt dhe asgjësimin e të dhënave - shërbimet e automjeteve të blinduara
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e shërbimit të rojës dhe sigurisë, p.sh. për dyqane, qendra traume - inspektimin e valixheve dhe pasagjerëve në aeroporte, stacione hekurudhore dhe vende të tjera të ngjashme - aktivitetet e personelit të sigurisë për ngjarje, koncerte, panairë dhe ekspozita
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - analizën e riskut, këshillimin dhe konsulencën për sigurinë, shih 80.09 - aktivitetet e mbikëqyrjes në distancë, shih 80.09 - shërbimet e recepsionit, pritjes dhe rojës së sigurisë, shih 81.10, 82.10 - aktivitetet e rendit dhe sigurisë publike, shih 84.24 - trajnimin për sigurinë, duke përfshirë atë kibernetike, shih 85.59

NVE Rev 2.1 kod	80.09
Përshkrim	Aktivitetet e sigurisë p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e një ose më shumë prej shërbimeve vijuese: shërbimet e sistemeve të sigurisë si pjesë e qendrave të shërbimeve të sigurisë ose qendrave për marrjen e alarmeve (ARC); shërbimet e monitorimit në distancë dhe sistemeve të mbikëqyrjes me video, dhe, vetëm nëse ofrohen në lidhje me shërbimet e monitorimit dhe monitorimit në distancë, instalimi, riparimi dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike të sigurisë.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e konsulentëve të sigurisë - aktivitetet në një qendër thirrjesh dhe shërbimi emergjencash, ose qendër pritëse të alarmeve (ARC) - monitorimin dhe monitorimin në distancë të sistemeve elektronike të sigurisë, p.sh. alarme për vjedhje, sisteme të mbikëqyrjes me video, alarmet e zjarrit - monitorimin dhe monitorimin në distancë të pajisjeve të kyçjes mekanike ose elektronike, kasaforta dhe kutive të sigurisë - instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike të sigurisë, p.sh. alarme për vjedhje, sisteme të mbikëqyrjes me video, alarmet e zjarrit, nëse ofrohen në lidhje me shërbimet e mëvonshme të monitorimit dhe monitorimit në distancë - instalimin, riparimin, modifikimin dhe përshtatjen e pajisjeve mekanike ose elektronike të kyçjes, sistemeve elektronike të sigurisë, kasafortave dhe kutive të sigurisë, nëse ofrohen në lidhje me shërbimet e mëvonshme të monitorimit dhe monitorimit në distancë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - instalimin e sistemeve të sigurisë, p.sh. alarme për vjedhje, sisteme të mbikëqyrjes, alarme për zjarrin, pa shërbime të mëpasshme monitorimi ose monitorimi në distancë, shih 43.21 - shitjen me pakicë të sistemeve elektrike të alarmeve të sigurisë, pajisjeve me kyçe mekanike ose elektronike, kasafortave dhe kutive të sigurisë, pa shërbime të mëpasshme monitorimi, instalimi ose mirëmbajtjeje, shih 47.52 - aktivitetet e konsulencës për sigurinë kibernetike, shih 62.20 - aktivitetet e rendit dhe sigurisë publike, p.sh. policimi, shih 84.24 - ofrimin e shërbimeve të kopjimit të çelësave, shih 95.29

NVE Rev 2.1 kod	81
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve ndaj ndërtesave dhe shesheve
Përfshin	Kjo ndarje përfshin ofrimin e një sërë shërbimeve mbështetëse të përgjithshme, p.sh.: - ofrimin e një ndërthurjeje shërbimesh mbështetëse në mjediset e klientëve - pastrimin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave të të gjitha llojeve - pastrimin e makinerive industriale, pastrimin e trenave, autobusëve, aeroplanëve, etj. - pastrimin e pjesës së brendshme të boteve rrugore dhe detare - aktivitetet e dezinfektimit dhe asgjësimit të gjallesave të dëmshme për godinat, anijet, trenat, etj. - pastrimin e shisheve - pastrimin e rrugëve - heqjen e dëborës dhe ngricës

- ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe mirëmbajtjes së bimësisë dhe ofrimin e këtyre shërbimeve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

81.1

Përshkrim

Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

81.10

Përshkrim

Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e një ndërthurjeje shërbimesh mbështetëse në mjediset e klientëve. Këto shërbime përfshijnë shërbimet e pastrimit të përgjithshëm të brendshëm, mirëmbajtjes, heqjes së mbetjeve, rojet e portës dhe mbikëqyrjes, dorëzimit të postës, recepsionit, pastrimit kimik dhe shërbimet shoqëruese për mbështetjen e operacioneve në godina. Këto aktivitete mbështetëse kryhen nga stafi operativ, që nuk është i përfshirë dhe nuk ka përgjegjësi për proceset ose aktivitetet kryesore të punës së klientit.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- ofrimin e menaxhimit dhe operimit në ambient të sistemeve kompjuterike dhe/ose objekteve të përpunimit të të dhënave të klientëve, shih 62.20
- menaxhimin e pasurive të paluajtshme, p.sh. menaxhimi i pronave ose banesave nën pronësi të përbashkët (kryer kryesisht mbi bazë komisioni ose kontrate), shih 68.32
- aktivitetet e shërbimit të rojës dhe sigurisë, shih 80.01
- operimin e strukturave korrigjuese mbi bazë komisioni ose kontrate, shih 84.23
- ofrimin e vetëm një shërbimi mbështetës (p.sh. shërbime të pastrimit të brendshëm të përgjithshëm) ose trajtimin e një funksioni të vetëm (p.sh. ngrohja), shih klasën përkatëse sipas shërbimit të ofruar
- ofrimin e stafit të menaxhimit dhe operimit për operimin e plotë të një subjekti të klientit, p.sh. hotel, restorant, minierë, spital, shih klasën e njësisë së operuar

NVE Rev 2.1 kod

81.2

Përshkrim

Aktivitetet e pastrimit

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet e pastrimit të përgjithshëm, të specializuar dhe tjetër. Dallimi ndërmjet tyre nuk varet nga lloji i klientëve që u shërbehet, por nga lloji i pastrimit. Ky grup përfshin aktivitetet e pastrimit të përgjithshëm të brendshëm të të gjitha llojeve të ndërtesave, pastrimit të jashtëm të ndërtesave, aktivitetet e pastrimit të specializuar për ndërtesat ose aktivitetet e tjera të pastrimit të specializuar, pastrimit të makinerive industriale, pastrimit të pjesës së brendshme të boteve rrugore dhe detare, aktivitetet e dezinfektimit dhe asgjësimit të gjallesave të dëmshme për ndërtesat dhe makineritë industriale, pastrimin e shisheve, pastrimin e rrugëve, heqjen e borës dhe ngricës.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin:

- kontrollin e dëmtuesve bujqësorë, shih 01.61
- larjen e tapetave dhe rrugicave, pastrimin e perdeve të trasha e të holla, shih 96.10

NVE Rev 2.1 kod

81.21

Përshkrim

Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e përgjithshëm (të paspecializuar) të të gjitha llojeve të ndërtesave, p.sh.:

- zyra
- banesa private, p.sh. shtëpi ose apartamente
- fabrika
- dyqane
- institucione

- pastrimin e përgjithshëm (të paspecializuar) të mjediseve të tjera të biznesit dhe profesionale dhe ndërtesave rezidenciale me shumë njësi.

Këto aktivitete pastrimi të përgjithshëm përfshijnë kryesisht pastrimin e brendshëm, megjithëse mund të përfshijnë edhe pastrimin e hapësirave të jashtme shoqëruese, si dritaret, rrugëkalimet.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e pastrimit të specializuar, p.sh. pastrimi i xhamave, aspiratorëve, oxhaqeve, kaldajave, njësive të shkarkimit, shih 81.22

NVE Rev 2.1 kod	81.22
Përshkrim	Aktivitetet të tjera pastrimi të ndërtesave dhe pastrimi i objekteve industriale
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - pastrimin e jashtëm të ndërtesave të të gjitha llojeve, p.sh. zyra, fabrika, dyqane, shkolla dhe institucione të tjera, mjediseve të tjera të biznesit dhe profesionale dhe ndërtesave rezidenciale me shumë njësi - aktivitetet e pastrimit të specializuar për bizneset në industrinë ushqimore, duke përfshirë prodhimin, shitjen me pakicë, restorantet, etj. - aktivitetet e pastrimit të specializuar për ndërtesat, p.sh. pastrimi i fasadave dhe dritareve, pastrimi i aspiratorëve dhe oxhaqeve, sobave, furrave, inceneratorëve, kaldajave, tubave të ventilimit dhe njësive të shkarkimit - pastrimin industrial të specializuar, p.sh. pastrimi i makinerive industriale - pastrimin e tubacioneve të furnizimit me ujë - pastrimin e tubave aeraulike - aktivitetet e tjera të pastrimit të specializuar industrial dhe të ndërtesave p.k.t. - pastrimin e ndërtesave menjëherë pas ndërtimit - pastrimin me avull, me rërë dhe aktivitetet e ngjashme për pjesët e jashtme të ndërtesave

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	81.23
Përshkrim	Aktivitetet e tjera të pastrimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së pishinave - pastrimin e trenave, autobusëve, aeroplanëve, etj. - pastrimin e pjesës së brendshme të boteve rrugore dhe detare - aktivitetet e sterilizimit, dezinfektimit dhe asgjësimit të gjallesave të dëmshme - pastrimin e shisheve - pastrimin e rrugëve dhe heqjes së borës dhe ngricës- aktivitetet e tjera të pastrimit p.k.t
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - kontrollin e dëmtuesve bujqësorë, shih 01.61 - pastrimin e mjeteve motorike, duke përfshirë larjen e veturave, shih 95.31

NVE Rev 2.1 kod	81.3
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të shesheve
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	81.30
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimeve të shesheve
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - mbjelljen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e: • parqeve dhe kopshteve për: • banesat private dhe publike • ndërtesat publike dhe gjysmëpublike (shkolla, spitale, godina administrative, kisha, etj.) • mjediset bashkiake (parqe, hapësira të gjelbra, varreza, etj.) • bimësia publike (rrugë, linja treni dhe tramvaje, rrjedha ujore, porte) • godina industriale dhe tregtare - mbjelljen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e bimësisë për: • godinat (kopshtet në tarracë, bimësia e fasadës, kopshtet në mjedis të brendshëm, etj.) • fushat sportive (fushat e futbollit, fushat e golfit, etj.), fushat e lojës, sheshet për banjë dielli dhe parqe të tjera argëtuese • ujërat e palëvizshëm dhe të rrjedhshëm (basene, hapësira ujore të alternuara, pellgje, pishina, kanale kullimi, rrjedha ujore, sistemet e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura) - mbjelljen e bimësisë për mbrojtjen nga zhurma, era, erozioni, vizibiliteti - mbrojtjen dhe restaurimin e peizazhit, p.sh. për parqe, kopshte - punimet inxhinierike ekologjike për qëllimin e ruajtjes ekologjike të siteve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - restaurimin e mjediseve natyrore, p.sh. inxhinieria bimore, rigjallërimi i ekosistemeve - aktivitetet e kontrollit të erozionit në mjedisë malore, terrenet e lëshimit të vezëve dhe brigjet e lumenjve - krijimin dhe zhvendosjen e habitateve të specieve, p.sh. furriqe, strehë, strofulla – aktivitetet e parandalimit, kontrollit dhe reagimit ndaj futjes dhe përhapjes së specieve invazive në faunë dhe florë - menaxhimin mjedisor, p.sh., ndërmarrjen e masave të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes për duna, moçale, ligatina ose zona të tjera të ndjeshme, kullotjen ekologjike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e mbrojtjes ose restaurimit të tokës bujqësore dhe pyjore, shih ndarjet 01, 02 - rritjen dhe mbjelljen për qëllime tregtare për rritjen e bimëve, pemëve, shih ndarjet 01, 02 - fidanishtet e pemëve dhe drurëve pyjorë, shih 01.30, 02.10 - mbajtjen e tokës në gjendje mjedisore të mirë për përdorim bujqësor, shih 01.61 - restaurimin e ekosistemeve detare, shih 03.30 - aktivitete ndërtimi për sheshet, shih seksionin F - aktivitetet e projektimit të shesheve dhe arkitekturës, shih 71.11 - operimin e parqeve kombëtare, parqeve dhe rezervave natyrore, etj., duke përfshirë ruajtjen dhe mirëmbajtjen, shih 91.42

Përfshin	Kjo ndarje përfshin ofrimin e një game shërbimesh administrative të përditshme të zyrave, si dhe funksionet mbështetëse të vazhdueshme rutinore të biznesit për të tjerët, mbi bazë kontrate ose komisioni.
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu të gjitha aktivitetet e shërbimeve mbështetëse që u ofrohen zakonisht bizneseve, të paklasifikuara diku tjetër.
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	82.1
Përshkrim	Aktivitete administrative dhe të shërbimit mbështetës në zyra
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	82.10
Përshkrim	Aktivitete administrative dhe të shërbimit mbështetës në zyra
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e një ndërthurjeje shërbimesh administrative të përditshme të zyrës, p.sh. pritja, planifikimi financiar, faturimi dhe mbajtja e regjistrave, shërbimet e personelit dhe ato postare, etj. për të tjerët mbi bazë kontrate ose komisioni. Kjo klasë përfshin: - përgatitjen e dokumenteve, p.sh. redaktimi, korrigjimi, shkrimi, përpunimi i fjalëve, dhe arkivimi paraprak - shërbimet e tjera mbështetëse të sekretarisë - transkriptimin e dokumenteve - hartimin e shkresave ose rezymeve - ofrimin e shërbimeve të qiradhënies së kutisë postare dhe shërbimeve të tjera postare dhe të dërgesave, p.sh. organizimi paraprak, adresimi - dublimin - projektimin - operimin e makinerive të fotokopjimit për fotokopjimin si vetëshërbim - digjitalizimin e skedarëve (pa përpunimin e mëtejshëm të të dhënave) - formatimin e librave elektronikë
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu aktivitete mbështetëse për të tjerët mbi bazë kontrate ose komisioni që janë funksione mbështetëse rutinë të vazhdueshme të biznesit, të cilat bizneset dhe organizatat i bëjnë tradicionalisht për veten.
Nuk përfshin	Njësitë e klasifikuara në këtë klasë nuk ofrojnë staf operacional për kryerjen dhe administrimin e operacioneve të plota të një biznesi. Njësitë e përfshira në një aspekt të caktuar të këtyre aktiviteteteve klasifikohen sipas aktivitetit përkatës. Kjo klasë nuk përfshin: - printimin e dokumenteve (printimin me shtypje, printimin e shpejtë, printimin digjital, etj.), shih 18.12 - shërbimet përpara shtypjes, shih 18.13 - ruajtjen e skedarëve fizikë, shih 52.10 - shërbimet e korrierëve, shih 53.20 - përpunimin e të dhënave dhe digjitalizimin e skedarëve të lidhur me përpunimin e

- mëtejshëm të të dhënave, shih 63.10
- ruajtjen e skedarëve të të dhënave, shih 63.10
- qiradhënien e zyrave të papajisura, hapësirave të përbashkëta të punës dhe zyrave të pajisura plotësisht, shih 68.20
- aktivitetet e qendrave të përbashkëta të shërbimit (SSC) me veprimtari strategjike dhe menaxheriale/aktivitetete të centralizuara, shih 70.10
- zhvillimin dhe organizimin e fushatave reklamuese me postë, shih 73.11
- qiradhënien e kontejnerëve për përdorim si zyrë, shih 77.39
- shërbimet stenografike publike dhe shërbimet e specializuara të stenografisë, p.sh. stenografët, shih 82.99
- arkivimin e të gjitha llojeve të dokumenteve (në formë fizike ose elektronike), shih 91.12

NVE Rev 2.1 kod

82.2

Përshkrim

Aktivitetet e qendrave telefonike (call center)

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

82.20

Përshkrim

Aktivitetet e qendrave të thirrjeve telefonike

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- qendrave të thirrjeve hyrëse, duke përfshirë përgjigjen e telefonatave prej klientëve duke përdorur operatorë njerëzorë, shpërndarjen automatike të thirrjeve, integrimin telefon-kompjuter, sistemet ndërvepruese të përgjigjes së thirrjeve ose metodat e ngjashme për marrjen e porosive, ofrimin e informacionit për produktet, trajtimin e kërkesave të klientëve për ndihmë ose zgjidhjen e ankesave të klientëve
- qendrat e thirrjeve dalëse duke përdorur metoda të ngjashme për të mirat e tregut ose shërbimet ndaj klientëve të mundshëm, kryerjen e intervistave telefonike për studimet e tregut dhe të opinionit mbi bazë kontrate ose komisioni
- qendrat e kontaktit në rrjet

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu aktivitetet e:

- qendrave që merren me kërkesat e klientëve për ndihmë ose që trajtojnë ankesat e klientëve nëpërmjet kanaleve të tjera të komunikimit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e ndërmjetësve dhe agentëve për energjinë elektrike dhe gazin natyror, shih 35.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet e specializuara të ndërtimit, shih 43.60
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shitje me pakicë, shih 47.9
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për transportin, shih 52.3
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet postare dhe të korrierëve, shih 53.30
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për akomodimin, shih 55.40
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e shërbimeve të ushqimit dhe pijeve, shih 56.40
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për publikimin e programeve kompjuterike të videolojërave, shih 58.21
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për publikimin e programeve kompjuterike dhe shkarkimet e programeve kompjuterike, shih 58.29
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e telekomunikacionit, shih 61.20

- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit financiar dhe të sigurimeve, shih seksionin L (p.sh. klasa 66.22 për aktivitetet e agjentëve dhe ndërmjetësve të sigurimit)
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet e pasurive të paluajtshme, shih 68.31
- studimi i tregut dhe sondazhi i opinionit publik dhe analiza statistikore përkatëse, shih 73.20
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit (marketingut) të patentave, shih 74.91
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e mallrave fizike dhe pasurive të tjera jofinanciare jofizike, shih 77.5
- aktivitetet e agjencive të udhëtimit, shih 79.11
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e mbështetjes për biznesin (me përjashtim të ndërmjetësimit financiar) p.k.t., shih 82.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për kurse dhe mësues, shih 85.61
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet mjekësore, dentare dhe shëndetësore të tjera, shih 86.97
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për veprimtaritë e kujdesit rezidencial, shih 87.91
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve, artikujve personalë dhe shtëpiakë dhe mjeteve motorike dhe motoçikletave, shih 95.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet personale, shih 96.40

NVE Rev 2.1 kod

82.3

Përshkrim

Organizimi i konferencave dhe panairove tregtare

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

82.30

Përshkrim

Organizimi i konferencave dhe panairove tregtare

Përfshin

Kjo klasë përfshin organizimin, promovimin dhe/ose menaxhimin e aktiviteteve, p.sh.:

- ekspozitat për bizneset tregtare
- aktivitetet e shoqërive
- ekspozitat e përgjithshme ose të specializuara
- konferencat dhe konventat
- seminarët, simpoziumet dhe workshop-et
- tregjet fshatare dhe panairët e artizanatit

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë mund të përfshijë edhe menaxhimin dhe mundësimin e stafit për operimin e mjediseve ku zhvillohen aktivitetet e lartpërmendura, por vetëm nëse menaxhimi dhe mundësimi i stafit kryhen në lidhje me organizimin, promovimin dhe/ose menaxhimin e këtyre aktiviteteve

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- ngritjen e stendave/eksponitorëve të ekspozitave në varësi të llojit të instalimit të kryer, shih ndarjet 43
- organizimin e aktiviteteve kulturore p.sh. festivalet e filmave, teatrot muzikorë, festivalet e kërcimit, shih 90.39
- planifikimin teknik, furnizimin, ngritjen dhe operimin e pajisjeve audiovizive dhe efekteve speciale lidhur me organizimin e ngjarjeve artistike, shih 90.39
- organizimin e ngjarjeve sportive, shih 93.19
- planifikimin teknik, furnizimin, ngritjen dhe operimin e pajisjeve audiovizive dhe efekteve speciale lidhur me organizimin e ngjarjeve joartistike, shih 93.29
- organizimin e ceremonive ose kremtimeve personale, duke përfshirë dasmat, ceremonitë për vendosjen e emrit, festat e ditëlindjeve, etj., shih 96.99

NVE Rev 2.1 kod

82.4

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për veprimtaritë e shërbimit mbështetës për bizneset p.k.t.

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

82.40

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet e shërbimit mbështetës për bizneset p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet mbështetëse të biznesit p.k.t. duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimeve mbështetëse të biznesit. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shërbimet e rezervimit për bileta për zbavitje dhe sporte
- aktivitetet e shërbimi të ndërmjetësimit për lojërat e lotarisë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e ndërmjetësve dhe agentëve për energjinë elektrike dhe gazin natyror, shih 35.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet e specializuara të ndërtimit, shih 43.60
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shitje me pakicë, shih 47.9
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për transportin, shih 52.3
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet postare dhe të korrierëve, shih 53.30
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për akomodimin, shih 55.40
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e shërbimeve të ushqimit dhe pijeve, shih 56.40
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për publikimin e programeve kompjuterike të videolojërave, shih 58.21
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për publikimin e programeve kompjuterike dhe shkarkimet e programeve kompjuterike, shih 58.29
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e telekomunikacionit, shih 61.20
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit financiar dhe të sigurimeve, shih

seksionin L (p.sh. klasa 66.22 për aktivitetet e agjentëve dhe ndërmjetësve të sigurimit)

- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitete të pasurive të paluajtshme, shih 68.31
- aktivitetet e agjencive të udhëtimit, shih 79.11
- aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit (marketingut) të patentave, shih 74.91
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për qiradhënien dhe leasing-un e mallrave fizike dhe pasurive të tjera jofinanciare jofizike, shih 77.5
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për kurse dhe mësues, shih 85.61
- aktivitetet e vizitave mjekësore, shih 86.97
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet mjekësore, dentare dhe shëndetësore të tjera, shih 86.97
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për aktivitetet e kujdesit rezidencial, shih 87.91
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve, artikujve personalë dhe shtëpiakë dhe mjeteve motorike dhe motoçikletave, shih 95.40
- aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për shërbimet personale, shih 96.40

NVE Rev 2.1 kod

82.9

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve mbështetëse për biznesin p.k.t.

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet e agjencive të arkëtimit, zyrave të kreditit, agjencive të informacionit për biznesin dhe të gjitha aktivitetet mbështetëse të p.k.t. Këto aktivitete u ofrohen kryesisht bizneseve.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

82.91

Përshkrim

Aktivitetet e agjencive të arkëtimit dhe zyrave të kreditit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- arkëtimin e pagesave për pretendimet ose shlyerjen e pagesave të arkëtuara ndaj klientëve, p.sh. shërbimet për arkëtimin e faturave ose borxhit
- përpilimin dhe ofrimin e informacioneve, p.sh. historiku i kreditit ose punësimit, ndaj institucioneve financiare, shitësve me pakicë dhe të tjerëve që u nevojitet vlerësimi i vlefshmërisë për marrje kredie i individëve ose bizneseve

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e agjencive të vlerësimit
- shërbimet e rimarrjes në zotërim

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e trasaksioneve finaciare (factoring), shih 64.92

NVE Rev 2.1 kod

82.92

Përshkrim

Aktivitetet e ambalazhimit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e ambalazhimit mbi bazë kontrate ose komisioni, pavarësisht nëse përfshijnë ose jo një proces të automatizuar:
- vendosja e lëngjeve në shishe, duke përfshirë pijet dhe ushqimet
- ambalazhimi i artikujve të ngurtë (paketimi në blister, i mbështjellë, etj.)
- ambalazhimi i sigurt i përgatitjeve farmaceutike
- etiketimi, vulosja dhe printimi
- ambalazhimi i parcelave dhe paketimi i dhuratave
- sterilizimin e produkteve në lidhje me ambalazhimin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pijeve joalkoolike dhe prodhimin e ujit mineral, shih 11.07
- aktivitetet e ambalazhimit të lidhur me transportin, shih 52.26

NVE Rev 2.1 kod

82.99

Përshkrim

Aktivitetet e shërbimeve të tjera mbështetëse për biznesin p.k.t

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e organizimit të mbledhjes së fondeve mbi bazë kontrate ose komisioni
- shërbimet e raportimit ose regjistrimit stenografik në gjykatë
- shërbimet e stenografisë publike
- titrimin e integruar në kohë reale (pra të njëkohshëm) të mbledhjeve, konferencave
- shërbimet e vendosjes së barkodeve
- shërbimet e printimit të barkodeve
- shërbimet e arkëtimit të pagesës së matësve të parkimit
- aktivitetet e menaxhimit të vizës dhe lejes së punës
- aktivitetet e shërbimit të menaxhimit të kuponëve për restorante
- ofrimin e ndihmës për regjistrimin e mjeteve motorike
- aktivitetet e shërbimit të shpërnguljes
- administrimin e paketimit të dhuratave për aktivitetet argëtuese
- aktivitetet për nxjerrjen dhe menaxhimin e kuponëve
- mbledhja e fondeve për bamirësi
- shërbimet për ngritjen e shoqërive në vendndodhje të caktuara
- leximin e matësve të konsumit të ngrohjes dhe ujit të ngrohtë, duke përfshirë alokimin e kostos
- administrimin e programeve të besnikërisë
- shitjen e kutive të udhëtimit: forma e ofrimit të një shërbimi lidhur me udhëtimin, por shërbim i shtyrë, që mund të jetë i çfarëdolloj natyre: hotele, restorante, perkujdesje, aktivitete argëtimi, etj
- tregtimin dhe ndërmjetësimin e krypto-aseteve pa detyrime

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e shtëpive të ankandit (shitje me shumicë) dhe aktivitetet e ankandit në internet (shitje me shumicë), shih 46.1
- aktivitetet e shtëpive të ankandit (shitje me pakicë) dhe aktivitetet e ankandit në internet (shitje me pakicë), shih 47.9
- ofrimin e shërbimeve të mbishkrimit ose titrimit të filmave ose kasetave, shih 59.12
- aktivitetet e qendrave të përbashkëta të shërbimit (SSC) me aktivitete strategjike dhe menaxheriale/aktivitete të centralizuara, shih 70.10
- aktivitetet e konsulencës për biznesin dhe llojeve të tjera të drejtimit, shih 70.20
- aktivitetet e qendrave të përbashkëta të shërbimit (SSC) me dy ose më shumë aktivitete të ndërthurura (grup shërbimesh administrative) që ofrojnë detyra operacionale për të gjithë ndërmarrjen ose grupin, p.sh. pritje, planifikim

financiar, faturim dhe mbajtje regjistrash, shërbime personeli dhe postare për të njëjtin grup ndërmarrjeje, shih 82.10
 - ofrimin e shërbimeve të transkriptimit të dokumenteve, shih 82.10
 - aktivitetet e shërbimeve të ndërmjetësimit për veprimtaritë mbështetëse për biznesin, p.k.t., shih 82.40

NVE Rev 2.1 kod

P

Përshkrim

ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM

Përfshin

Ky seksion përfshin aktivitetet me natyrë qeveritare, që zakonisht kryhen nga administrata publike. Këtu përfshihet zbatimi dhe interpretimi gjyqësor i ligjeve dhe rregulloreve në zbatim të tyre, si dhe administrimi i programeve që bazohen te to, aktivitetet legjislativë, shërbimet e tatimit, mbrojtjes kombëtare, rendit dhe sigurisë publike, si dhe imigracionit, punët e jashtme dhe administrimi i programeve qeveritare.
 Statusi juridik ose institucional, në vetvete, nuk është faktor përcaktues që një aktivitet të përfshihet në këtë seksion, por nëse natyra e veprimtarisë përkon me përcaktimet në paragrafin pararendës. Kjo do të thotë se aktivitetet e klasifikuara tjetërkund në NVE nuk përfshihen në këtë seksion, edhe nëse kryhen nga subjekte publike. Për shembull, administrimi i sistemeve shkollore (pra, rregulloret, kontrollet, kurrikulat) përfshihen në këtë seksion, por mësimdhënia jo (shihni seksionin Q), dhe burgu ose spitali ushtarak klasifikohen si pjesë e shëndetësisë (shihni seksionin R). Veç kësaj, disa nga aktivitetet e përshkruara në këtë seksion mund të kryhen nga njësi joqeveritare.

Përfshin gjithashtu

Ky seksion përfshin gjithashtu aktivitetet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

84

Përshkrim

Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

84.1

Përshkrim

Administrimi i Shtetit dhe politikat ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit

Përfshin

Ky grup përfshin administratën e përgjithshme (p.sh, ekzekutivin, legjislativin, administrimin financiar, në të gjitha nivelet e qeverisë) dhe mbikëqyrjen në fushën e politikës sociale, ekonomike dhe mjedisore të komunitetit.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	84.11
Përshkrim	Aktivitete të administratës së përgjithshme publike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - administratën ekzekutive dhe legjislative qendrore, rajonale dhe lokale - aktivitete të ministrive në nivel kombëtar dhe rajonal - administrimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve fiskale: • funksionimi i skemave të taksimit • mbledhja e tatimeve e taksave mbi mallrat dhe hetimi i shkeljeve tatimore • administrata doganore - zbatimi i buxhetit dhe menaxhimi i fondeve publike dhe borxhit publik: • mbledhja dhe përdorimi i fondeve dhe kontrolli i shpenzimeve - administratën e përgjithshme të politikave të kërkim zhvillimit (civile) dhe fondeve përkatëse - administratën dhe punën e shërbimeve statistikore dhe të planit ekonomik e social në nivele të ndryshme të qeverisë.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetin e bankës qendrore, shih 64.11 - funksionimin e ndërtesave të zëna ose prona qeveritare, shih 68.20, 68.3 - administrimin e politikave të kërkim zhvillimit që synojnë rritjen e mirëqënies personale dhe të fondeve përkatëse, shih 84.12 - administrimin e politikave të kërkim zhvillimit që synojnë rritjen e performancës ekonomike dhe konkurrencës, shih 84.13 - administrimin e politikave të kërkim zhvillimit për mbrojtjen dhe të fondeve përkatëse, shih 84.22 - funksionimin e arkivave të qeverisë, shih 91.12
--------------	---

NVE Rev 2.1 kod	84.12
Përshkrim	Rregullimi i kujdesit të shëndetit, arsimit, kulturës dhe shërbimeve të tjera sociale
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - administrimin publik të programeve që synojnë rritjen e mirëqënies personale, p.sh.: • shëndetësi • arsim • kulturë • sport • rekreacion • mjedis • strehim • shërbime sociale - administrimin publik të politikave të kërkimit dhe zhvillimit dhe fondeve shoqëruese për këto fusha

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:
- sponsorizimin e aktiviteteve argëtuese dhe kulturore - shpërndarjen e granteve publike artistëve - administrimin e programeve të furnizimit me ujë të pijshëm - administrimin e grumbullimit të mbetjeve dhe heqjes së tyre

- administrimin e programeve të mbrojtjes së mjedisit
- administrimin e programeve të strehimit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e sistemimit, grumbullimit dhe asgjësimit të ujërave të zeza dhe të mbetjeve, shih ndarjet 37, 38, 39
- aktivitete të sigurimit social të detyrueshëm, shih klasën 84.30
- aktivitete të arsimit, shih seksionin Q
- aktivitete të lidhura me shëndetin, shih ndarjen 86
- aktivitete të muzeve dhe institucioneve të tjera kulturore, shih ndarjen 91
- aktivitete të bibliotekave dhe arkivave të qeverisë shih grupin 91.1
- aktivitete sportive dhe të tjera argëtuese, shih ndarjen 93

NVE Rev 2.1 kod

84.13

Përshkrim

Rregullimi dhe kontributi në funksionimin më efikas të bizneseve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e administrimit publik të sektorëve të ndryshëm ekonomikë, përfshirë shpërndarjen e subvencioneve, p.sh:
 - bujqësi
 - përdorimi i tokës
 - burimet energjitike dhe miniera
 - infrastrukturë
 - transport
 - komunikim
 - hotele dhe turizëm
 - tregti me shumicë dhe pakicë
- administrimi i politikave të kërkim zhvillimit dhe fondeve përkatëse për përmirësimin e ecurisë ekonomike
- administrimin e çështjeve të përgjithshme të punës
- zbatimin e masave politike të zhvillimit rajonal p.sh. për reduktimin e papunësisë

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e agjencive kombëtare të sigurisë kibernetike
- aktivitetet rregullatore financiare të orientimit të bizneseve, mbrojtjes së konsumatorit dhe të tjera aktivitete rregullatore financiare

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitete të autoritetit të mbikëqyrjes financiare të kryera nga banka qendrore, shih klasën 64.11
- aktivitete të autoritetit të mbikëqyrjes financiare për veprimtari të shërbimit financiar, përveç sigurimeve dhe financimit në pritje (jo nga Banka Qendrore), shih klasën 66.11
- aktivitete të autoritetit të mbikëqyrjes financiare për financimet e pensioneve dhe sigurimeve (jo nga Banka Qendrore), shih klasën 66.29
- aktivitete kërkimi dhe zhvillimi eksperimental, shih ndarjen 72

NVE Rev 2.1 kod

84.2

Përshkrim

Kryerja e shërbimeve ndaj komunitetit

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet që lidhen me punët e jashtme, mbrojtjen, drejtësinë dhe rendin e sigurinë publike.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

84.21

Përshkrim

Punët e jashtme

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- administrimin dhe operimin e ministrisë së punëve të jashtme dhe misioneve diplomatike dhe konsullore të vendosura jashtë vendit ose në zyrat e organizatave ndërkombëtare
- administrimin, operimin dhe mbështetjen për shërbimet e informimit dhe ato kulturore të synuara për shpërndarje përtej kufijve kombëtarë
- ndihmën ndaj vendeve të huaja, qofshin ose jo të përcjella nëpërmjet organizatave ndërkombëtare
- ofrimin e ndihmës ushtarake ndaj vendeve të huaja
- menaxhimin e tregtisë së jashtme, çështjet financiare ndërkombëtare dhe ato teknike të jashtme

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shërbimet ndaj katastrofave ndërkombëtare dhe konflikteve të refugjatëve, shih klasën 88.99
- aktivitete të trupave dhe organizatave jashtë territoriale, shih klasën 99.00

NVE Rev 2.1 kod

84.22

Përshkrim

Aktivitete të mbrojtjes

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- administrimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e mbrojtjes ushtarake dhe të forcave të mbrojtjes tokësore, detare, ajrore dhe hapësinore si:
 - forcat luftarake të ushtrisë, flotës detare dhe forcës ajrore
 - inxhinierinë, transportin, komunikacionin, inteligjencën, materialet, personelin dhe forcat komando të tjera joluftarake
 - forcat rezervë dhe mbështetëse të organeve të mbrojtjes
 - logjistikën ushtarake (sigurimi i pajisjeve, strukturave, furnizimeve etj.)
 - aktivitete shëndetësore për personelin ushtarak në terren
- administrimin, funksionimin dhe mbështetjen e forcave civile të mbrojtjes
- mbështetjen e planeve për situata emergjente dhe kryerja e provave me pjesëmarrjen e institucioneve civile dhe popullsisë
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit të lidhura me mbrojtjen dhe fondeve përkatëse

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e kërkimit dhe aktivitetet eksperimentale të zhvillimit, shih ndarjen 72
- dhënien e ndihmës ushtarake vendeve të huaja, shih klasën 84.21
- aktivitetet e gjykatave ushtarake, shih klasën 84.23
- sigurimin e ofrimit të furnizimeve për përdorim emergjent brenda vendit në rast të katastrofave të cënimit të paqes, shih klasën 84.24
- aktivitetet e edukimit të shkollave ushtarake, kolegjeve dhe akademive, shih grupin 85.40
- aktivitetet e spitaleve ushtarake, shih klasën 86.10

NVE Rev 2.1 kod	84.23
Përshkrim	Drejtësi dhe aktivitete juridike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - administrimin dhe funksionimin e gjykatave të çështjeve civile, administrative dhe kriminale, gjykatat ushtarake dhe sistemin gjyqësor - pasqyrimin e gjykimeve dhe interpretimeve të ligjit - aktivitetet e prokurorëve publikë - arbitrazhin e çështjeve civile - administrimin e burgjeve dhe shërbimeve të riedukimit, duke përfshirë dhe shërbimet e rehabilitimit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - këshillimin ligjor dhe përfaqësimin në çështjet civile, kriminale dhe çështje të tjera, shih klasën 69.10 - aktivitetet e shkollave në burgje, shih ndarjen 85 - aktivitetet e spitaleve në burgje, shih klasën 86.10
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	84.24
Përshkrim	Aktivitete të rendit publik dhe sigurimit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - administrimin dhe funksionimin e forcave policore të zakonshme dhe ndihmëse, të mbështetura nga autoritetet publike dhe portuale, policisë kufitare, rojeve bregdetare dhe forcave të tjera speciale të policisë, duke përfshirë rregullimin e trafikut, regjistrimin e personave të huaj, mbajtjen e precedentëve penalë - ofrimin e furnizimeve për përdorim në emergjenca kombëtare në rastin e fatkeqësive në kohë paqeje

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - operimin e laboratorëve të policisë, shih klasën 71.20 - vënien në punë të një personeli sigurie për evente, koncerte, panaire dhe shfaqje, shih klasën 80.01 - administrimin dhe funksionimin e forcave të armatosura ushtarake, shih klasën 84.22
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	84.25
Përshkrim	Aktivitete shërbimi kundër zjarrit
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e luftës kundër zjarrit: • administrimin dhe funksionimin e brigadave të zakonshme dhe ndihmëse në luftën kundër zjarrit, parandalimin e tij, shpëtimin e personave dhe kafshëve, asistencën në katastrofa civile, përmbytje, aksidente rrugore etj., duke përfshirë luftën kundër zjarrit nga njësi mbi bazën e një kontrate ose tarife shërbimi - aktivitetet e mbikëqyrësve të zonave të plazhit, p.sh. rojet e plazheve - aktivitetet e operacioneve të shpëtimit në zonat me ujëra të hapura dhe në zonat malore

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shërbimet e mbrojtjes dhe luftës kundër zjarrit për zonat pyjore, shih klasën 02.40 - shërbimet e parandalimit dhe luftës kundër zjarrit në zona gazi dhe naftë mbajtëse, shih klasën 09.10 - shërbimet e parandalimit dhe luftës kundër zjarrit në aeroporte, shih klasën 52.23
--------------	--

NVE Rev 2.1 kod	84.3
Përshkrim	Aktivitete të sigurimit të detyrueshëm shoqëror
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	84.30
Përshkrim	Aktivitete të sigurimit të detyrueshëm shoqëror
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - financimin dhe administrimin e programeve të sigurimeve shoqërore të mundësuar nga shteti, p.sh.: • sigurimi në rast sëmundjeje, aksidenti në punë dhe papunësie • pensionet e vjetërsisë • mbulimi i humbjeve të të ardhurave për shkak të lindjes, aftësisë së kufizuar të përkohshme, humbjes së partnerit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - sigurimet shëndetësore suplementare, shih klasën 65.12 - sigurimin e përfitimeve të të ardhurave nga pensioni ekskluzivisht për punonjësit ose anëtarët, shih klasën 65.30
--------------	---

- administrimin e shërbimeve të kujdesit social dhe të shëndetit, shih klasën 84.12
- sigurimin e shërbimeve të kujdesit dhe mbështetjes për personat rezidentë ,shih grupin 87
- sigurimin e shërbimeve të mirëqenies dhe punës sociale (pa akomodim), shih klasat 88.10, 88.99

NVE Rev 2.1 kod

Q

Përshkrim

ARSIMI

Përfshin

Ky seksion përfshin arsimin në çdo nivel ose për çdo profesion. Udhëzimet mund të jepen me gojë ose me shkrim dhe mund të jepen nëpërmjet radios, televizionit, internetit ose korrespondencës.

Aktivitetet arsimore janë ato që kanë një program arsimor, një kuadër kohor dhe një vlerësim të njohurive të arritura.

Ky seksion përfshin arsimin fillestar formal në nivele të ndryshme, të ofruar nga institucionet e ndryshme në sistemin e rregullt shkollor, të hartuar për nxënësit/studentët si një rrugëtim arsimor i vazhdueshëm përpara hyrjes së tyre të parë në tregun e punës, si dhe arsimin formal jashtë sistemit të rregullt shkollor me përmbajtje programi dhe kualifikime që janë ekuivalente me ato të një arsimi fillestar (arsimi i të rriturve, programet e shkrim-leximit etj.).

Përfshihen gjithashtu aktivitetet e ofruara nga institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë, në nivelet e tyre përkatëse.

Ky seksion përfshin shkollimin e detyrueshëm dhe jo të detyrueshëm, si dhe arsimin publik si dhe atë privat.

Për çdo nivel arsimimi parauniversitar, klasat përfshijnë arsim për personat me aftësi të kufizuara. Arsimi për fëmijët me aftësi të kufizuara ofrohet në shkolla të zakonshme, speciale dhe në qendra burimore.

Grupet 85.1, 85.2, 85.3 dhe 85.4 marrin parasysh aktivitetet e arsimit formal të ofruara sipas klasifikimit ISCED-P 2011, pra klasifikimin ndërkombëtar të programeve arsimore. Për rrjedhojë, ndarja e kategorive në këtë seksion bazohet në nivelin e arsimit të ofruar siç përcaktohet nga nivelet e ISCED-P 2011*.

Aktivitetet e institucioneve arsimore që ofrojnë kurse në nivelin 0 të ISCED-P 2011 klasifikohen te 85.10, në nivelin 1 të ISCED-P 2011 te 85.20, në nivelin 0 të ISCED-P 2011 te klasa 85.31, në nivelin 3 të ISCED-P 2011 te klasa 85.32, në nivelin 4 të ISCED-P 2011 te klasa 85.33 dhe në nivelet 5-6-7-8 të ISCED-P 2011 te grupi 85.4.

Institucionet arsimore të klasifikuara në grupet 85.2 deri në 85.4 janë të autorizuar të certifikojnë përfundimin me sukses të një programi arsimor, zakonisht në formën e një dokumenti të njohur zyrtarisht nga autoritetet arsimore përkatëse kombëtare.

SHËNIM: * Hartëzimet midis niveleve të arsimit dhe emërimit të kualifikimeve në gjuhën kombëtare mund të gjenden në: <https://europa.eu/!mDwYbG>

Përfshin gjithashtu

Ky seksion bazohet edhe në dallimin midis programeve arsimore formale dhe jo-formale të ofruara nga klasifikimi Evropian i aktiviteteve të të mësuarit (CLA). Kështu, ky seksion përfshin edhe mësimin jo-formal që ka të bëjë kryesisht me aktivitetet sportive dhe rekreative, p.sh. aktivitetet e artit dhe arsimit (në grupet 85.5-85.6). Ky seksion përfshin gjithashtu dhe aktivitetet arsimore të drejtuara nga të vetëpunësuarit/lektorët individualë/të pavarur (tutorë, akademikë, instruktorë). Aktivitete të tilla duhet të klasifikohen në grupin 85.5. Ky seksion përfshin gjithashtu aktivitete që kanë të bëjnë me administrimin, inspektimin, operimin ose mbështetjen e shkollave dhe institucioneve të tjera që ofrojnë arsim, si dhe koordinimin e programeve sportive.

Nuk përfshin

Ky seksion nuk përfshin:

- aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve, shih 88.91

NVE Rev 2.1 kod	85
Përshkrim	Arsimi
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	85.1
Përshkrim	Arsimi parashkollor
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	85.10
Përshkrim	Arsimi parashkollor
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - arsimin parashkollor. Arsimi parashkollor përkufizohet si faza fillestare e të mësuarit të organizuar, e parashikuar kryesisht për t'i njohur fëmijët në moshë shumë të vogël me një mjedis të ngjashëm me atë shkollor, pra, të shërbejë si një urë ndërmjet atmosferës në shtëpi dhe asaj në shkollë.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve, shih 88.91

NVE Rev 2.1 kod	85.2
Përshkrim	Arsimi fillor (cikli i ulët i arsimit 9 vjeçar)
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	85.20
Përshkrim	Arsimi fillor – klasa e parë deri në klasën e pestë
Përfshin	Kjo klasë përfshin arsimin fillor – klasa e parë deri në klasën e pestë kryerjen e kurseve shkollore dhe kurse shoqëruese pune që u japin nxënësve një arsimim bazë të shëndoshë në lexim, shkrim dhe matematikë dhe njohuri fillestare të lëndëve të tjera si histori, gjeografi, shkenca natyrore, shkenca sociale, art dhe muzikë.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu sigurimin e programeve të arsimit brenda ose jashtë sistemit shkollor, të cilat janë ekuivalente në përmbajtje me programet në arsimin fillor, por që hartohen për ata që konsiderohen tepër të rritur për të hyrë në shkollat fillore. Shembuj të programeve të tilla janë programet e shkrim-leximit të të rriturve, programet e shanseve të dyta ose të ri-integritit.
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - arsimin dhe trajnimin jo-formal pavarësisht moshës ose fushës së arsimit, shih 85.5 - aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve, përfshirë kujdesin ditor për nxënësit, shih 88.91
NVE Rev 2.1 kod	85.3
Përshkrim	Arsimi i mesëm dhe pas të mesmes, jo i lartë
Përfshin	Ky grup përfshin sigurimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe teknik si dhe profesional.
Përfshin gjithashtu	Ky grup përfshin gjithashtu edhe ofrimin e programeve të arsimit brenda ose jashtë sistemit shkollor, të cilat janë ekuivalente në përmbajtje me programet në arsimin e mesëm, por që janë hartuar për ata që konsiderohen tepër të rritur për të hyrë në shkollat e mesme. Shembuj të programeve të tilla janë programet e shkrim-leximit të të rriturve dhe ato të shanseve të dyta ose të ri-integritit.
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - arsimin dhe trajnimin jo-formal, shih 85.5
NVE Rev 2.1 kod	85.31
Përshkrim	Arsimi i mesëm
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e atij arsimi që vendos bazat e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit njerëzor dhe mundëson vazhdimin e të mësuarit të mëtejshëm. Aktivitetet e klasifikuara në këtë klasë bazohen te programet që zhvillohen sipas një modeli të orientuar drejt lëndës duke përdorur mësues më të specializuar dhe shpesh punësojnë mësues që japin mësim në fushën e tyre të specializimit. Specializimi për lëndën në këtë nivel shpesh fillon të ndikojë edhe te përvoja arsimore e personave që ndjekin programet e përgjithshme. Këto programe janë hartuar të kualifikojnë nxënësit si për arsimin teknik edhe për atë profesional ose për t'u pranuar në arsimin e lartë pa ndonjë kërkesë paraprake për njohuri në lëndë të veçanta.
	Kjo klasë përfshin: - arsimin e mesëm të ulët (ciklin e lartë të shkollës 9 vjeçare, klasat 6-9), që korrespondon me moshën e detyruar shkollore - arsimin e mesëm të lartë, pavarësisht nëse jep apo jo akses në arsimin e lartë

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin dhe trajnimin jo-formal, shih 85.5

NVE Rev 2.1 kod

85.32

Përshkrim

Arsim i mesëm profesional

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e atij arsimit që përgjithësisht vë theksin mbi specializimin sipas lëndëve, si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike, përgjithësisht të lidhura me punësimin aktual ose të mundshëm. Synimi i një programi mund të variojë nga përgatitja për një fushë punësimi të përgjithshme, e deri te një punë shumë specifike.

Kjo klasë përfshin:

- arsimi teknik dhe profesional nën nivelin e arsimit pas të mesëm, jo të lartë, siç përcaktohet në 85.33

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu programe që korrespondojnë me përcaktimin e arsimit dhe trajnimit formal, si për shembull në fushat e mëposhtme:

- instruksion për guidë turistike
- instruksion për shefat, hotelierët dhe punonjësit e restoranteve
- shkollat e kozmetikës dhe berberëve
- trajnim për riparim kompjuteri
- aktivitete arsimore të shkollave të drejtimit të mjeteve për shoferët profesionistë, p.sh. të kamionëve, autobusëve, trajnerëve dhe të shkollave për shoferët e pirunit dhe pilotët profesionistë, duke përfshirë instruksionet për pilotët e dronëve.

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin pas të mesëm jo të lartë, teknik dhe profesional, shih 85.33
- arsimin e lartë teknik dhe profesional, shih 85.40
- arsimin dhe trajnimin profesional jo formal, shih 85.5
- instruksione të artit skenik, për qëllime rekreative, hobi dhe vetëzhvillimi, shih 85.52
- aktivitetet arsimore të shkollave të drejtimit të mjetit që nuk janë të destinuara për shoferët profesionistë, shih 85.53
- trajnimin për punë, që është pjesë përbërëse e aktiviteteve të punës sociale pa strehim, shih 88.10, 88.99

NVE Rev 2.1 kod	85.33
Përshkrim	Arsimi pas të mesmes jo i lartë
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e programeve të arsimit dhe trajnimit pas të mesëm (si arsim i përgjithshëm ashtu edhe profesional), të cilat nuk mund të konsiderohen arsim i lartë; këto janë programe të arsimit pas të mesmes por jo i lartë. Mund të përfshijë gjithashtu ofrimin e programeve shtesë përgatitore për arsimin e lartë ose për arsimin pas të mesmes profesional por jo i lartë.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - arsimin e lartë teknik dhe profesional, shih 85.40 - arsimin dhe trajnimin jo-formal, shih 85.5
NVE Rev 2.1 kod	85.4
Përshkrim	Arsimi i lartë
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	
NVE Rev 2.1 kod	85.40
Përshkrim	Arsimi i lartë
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e studimeve akademike, profesionale dhe formuese dhe dhënien e çertifikatave/diplomave në nivelin e ciklit të shkurtër, të ciklit të parë (bachelor ose ekuivalent), ciklit të dytë (master ose ekuivalent) dhe ciklit të tretë (doktoratë) Kjo klasë përfshin arsimin në institucione publike dhe jopublike të arsimit të lartë të ofruara në nivelin e: - studime të ciklit të shkurtër, zakonisht të bazuara në mësimin praktik të përshtatshëm për kryerjen e një profesioni të caktuar dhe përgatitjen e studentëve për hyrje në tregun e punës ose në programe të tjera të arsimit të lartë - studimet e ciklit të parë, ku aplikantët pranohen me një certifikatë të përfundimit të shkollës së mesme, duke çuar në një kualifikim të shkallës së parë - studimet e ciklit të dytë të hapura për aplikantët që mbajnë të paktën një kualifikim të ciklit të parë dhe që çojnë në një kualifikim të ciklit të dytë - kurset gjithëpërfshirëse të masterit të hapura për aplikantët që mbajnë një certifikatë të përfundimit të shkollës së mesme dhe që çojnë në një kualifikim të ciklit të dytë - studimet pasuniversitare, të cilat do të jenë të hapura për kandidatët që kanë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë që çojnë në një kualifikim pasuniversitar - arsimi në shkollat e doktoratës - studime të ciklit të tretë (trajnim për studentët e doktoratës) - në të cilat kandidatët pranohen nëse kanë përfunduar të paktën studimet e ciklit të dytë, duke çuar në një kualifikim të ciklit të tretë. Arsimi do të kryhet me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- programet e arsimit dhe trajnimit profesional të ciklit të shkurtër në ISCED-P 2011 nivel 5
- programet e arsimit dhe trajnimit të lartë profesional në ISCED-P 2011 niveli 6 dhe ISCED-P 2011 niveli 7, për shembull ato që çojnë në kualifikime të ciklit të dytë
- aktivitetet edukuese të institucioneve të arsimit të lartë të arteve interpretuese
- programet e arsimit për të rritur ose të vazhdueshëm ekuivalente në kompleksitetin e përmbajtjes me arsimin e dhënë në aktivitetet arsimore tashmë të klasifikuara në këtë nivel

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin dhe trajnimin jo-formal, shih 85.5

Përshkrim

Arsim tjetër

Përfshin

Ky grup përfshin arsimin (përfshirë edhe atë jo-formal), i cili nuk është as pjesë e arsimit fillestar në sistemin shkollor të rregullt, as ekuivalent me to në përmbajtje programi dhe kualifikime. Përfshin trajnim për qëllime profesionale, hobi ose vetëzhvillimi për fëmijët dhe të rriturit, duke përfshirë arsimin dhe trajnimin joformal të vazhdueshëm profesional. Arsimi jo-formal është i përcaktuar nga ISCED-P 2011 si një arsim i institucionalizuar, që është i qëllimshëm dhe i planifikuar nga një ofrues arsimi si një shtesë, alternativë dhe/ose plotësim për arsimin formal brenda procesit të të mësuarit përgjatë gjithë jetës së individëve. Ai synon njerëz të të gjitha moshave, por nuk aplikon domosdoshmërisht një strukturë të vazhdueshme; mund të jetë i shkurtër në kohëzgjatje dhe/ose me intensitet të ulët, dhe zakonisht ofrohet në formën e kurseve ose seminareve të shkurtra.

Ky grup përfshin ofrimin e mësimit sportiv për grupe ose individë, mësimin e gjuhëve të huaja, mësimin në arte, dramë ose muzikë ose mësimet të tjera ose trajnimin të specializuar, të ofruar nga kampet dhe shkollat, jo të krahasueshme me arsimin në grupet 85.1-85.4.

Përfshin gjithashtu

Ky grup përfshin gjithashtu aktivitete arsimore të drejtuara nga të vetëpunësuar / për llogari të tyre / individuale / pedagogë të pavarur (tutorë, akademikë, instruktorë).

Nuk përfshin

Ky grup nuk përfshin aktivitetet arsimore formale siç përshkruhet në grupet 85.1-85.4, pra arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm, arsimin pas të mesmes jo të lartë ose arsimin e lartë.

NVE Rev 2.1 kod	85.51
Përshkrim	Arsimi për sporte dhe argëtim
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e mësimit në aktivitete sportive për grupe individësh, p.sh. përmes qendrash, shkollash. Përfshihen gjithashtu aktivitetet që ofrohen nga qendrat e mësimit të sporteve me ose pa akomodim. Mësimi mund të ofrohet në ambiente të ndryshme, p.sh. në objektet e trajnimit të njësisë ose klientit, institucione arsimore ose përmes mënyrave të tjera, duke përfshirë internetin. Mësimi i dhënë në këtë klasë ofron organizime të strukturuar arsimore, si marrëdhënie student-mësues, të cilat janë specifikisht të hartuara për arsim dhe mësim. Megjithatë, kjo nuk çon në kualifikime në nivelet fillore deri në të lartë. Kjo klasë përfshin: - instruksion/mësim sportiv nga qendrat ose shkollat - instruksion në gjimnastikë - instruksion në kalërim - instruksion në not - instruksion në arte marciale - instruksion për lojën me letra, p.sh. brixh - kurse për lojëra të tryezës - instruksion për jogën ose pilatë - instruksion për e-sport
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e instruktorëve profesionistë të sportit, mësuesve, trajnerëve
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e ofruara nga shkollat akademike, kolegjet dhe universitetet, shih 85.40 - arsimin kulturor, shih 85.52 - trajnimin sportiv nga klubet sportive, shih 93.12 - instruksionet e fitness-it i dhënë nga qendrat e fitness- it, studiot e yoga-s dhe ambiente të ngjashme, shih 93.13
NVE Rev 2.1 kod	85.52
Përshkrim	Arsim kulturor
Përfshin	Kjo klasë përfshin dhënien e mësimit në arte, dramë dhe muzikë, p.sh. nga shkollat, studiot, klasat. Sigurohen struktura arsimore të projektuara posaçërisht për edukimin dhe mësimin, p.sh. marrëdhënie dhe/ose ndërveprimet nxënës-mësues. Një instruksion/mësim i tillë është kryesisht për qëllime hobi, rekreative ose vetë-zhvillimi, dhe nuk çon në kualifikime në nivelet fillore deri në të lartë. Kjo klasë përfshin: - instruksion/mësim i muzikës - instruksion/mësim i artit - instruksion/mësim i kërcimit - dramë, arte të bukura, arte të skenës dhe instruksion i fotografisë
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e instruktorëve dhe mësuesve profesionistë të artit
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet arsimore të dramave, arteve të bukura, arteve të skenës dhe shkollave të fotografisë, të cilat çojnë në kualifikime në nivelet e mesme-të larta, shih 85.3, 85.4

- mësimi i gjuhës së huaj, shih 85.59
- aktivitetet e ndërmjetësimit, shih 88.99

NVE Rev 2.1 kod

85.53

Përshkrim

Aktivitete të shkollave të drejtimit të mjeteve

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet arsimore të fluturimit, lundrimit, shkollave të transportit detar që nuk lëshojnë certifikata dhe leje tregtare

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet arsimore të shkollave të drejtimit të mjetit ose fluturimit për shoferët dhe për pilotët profesionistë, shih 85.32

NVE Rev 2.1 kod

85.59

Përshkrim

Arsim tjetër p.k.t.

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- arsim që nuk është i përcaktueshëm sipas nivelit
- tutorim/mësimdhënie akademike
- kurse përmirësuese
- kurse të shqyrtimit të provimeve profesionale
- mësimi i gjuhës dhe mësimi i aftësive bashkëbiseduese
- trajnim kompjuterik (p.sh. përdorim i përgjithshëm i kompjuterit, kurse programimi, përdorim i aplikacioneve kompjuterike)
- kurset e relaksimit (p.sh. kurset e meditimit, teknikat e frymëmarrjes, kurset e ndërgjegjësimit nëpërmjet lëvizjes, kurset mbi stresin dhe teknikat e lehtësimit të ankthit)
- kurset e qepjes
- kurse enologjisë
- kurset e jetës familjare, p.sh. kurset prindër-fëmijë
- trajnim mbi produktet e mbrojtjes së bimëve

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- trajnimin e rojeve të shpëtimit
- trajnimin e mbijetesës
- trajnim për të folur në publik
- instruksione për lexim të shpejtë
- aktivitetet e instruktorëve dhe mësuesve profesionistë në lëndë të tjera përveç sportit, artit dhe vozitjes

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- programet formale të shkrim-leximit të të rriturve, shih 85.20
- arsimin e mesëm të përgjithshëm, shih 85.313
- arsimin dhe trajnimin e mesëm teknik dhe profesional, shih 85.32
- aktivitete argëtuese në shtëpitë e të moshuarve, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod

85.6

Përshkrim

Shërbime arsimore mbështetëse

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

85.61

Përshkrim

Aktivitete të ndërmjetësimit për kurse dhe mësues privat

Përfshin

Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e aktiviteteve të shërbimit për kurset dhe tutorët duke bashkuar klientët dhe ofruesit e shërbimeve për një tarifë apo komision, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetme. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platformat digjitale ose nëpërmjet kanaleve jo-digjitale (ballë për ballë, duke përfshirë derë më derë, telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret ose nga klienti ose nga ofruesi i aktiviteteve të shërbimit për kurset dhe tutorët. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh. të ardhura nga shitja e hapësirave reklamuese.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

85.69

Përshkrim

Shërbime arsimore mbështetëse

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- ofrimin e aktiviteteve jo-mësimore që mbështesin proceset ose sistemet arsimore:
- këshillim arsimor
- aktivitetet e këshillimit profesional dhe të karrierës
- aktivitetet e këshillimit të udhëzimeve arsimore
- aktivitetet e vlerësimit të testimit arsimor
- aktivitetet e testimit arsimor
- organizimi i programeve të shkëmbimit të studentëve
- ekzaminimin dhe testimin e profesioneve të rregulluara, p.sh. pilotët
- zhvillimi i kurrikulave
- aktivitete eksperte dhe rehabilituese që shqyrtojnë aftësinë e të mësuarit

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- kërkim dhe zhvillim eksperimental mbi shkencat sociale dhe shkencat humane, shih 72.20

NVE Rev 2.1 kod

R

Përshkrim

SHËNDETI I NJERIUT DHE AKTIVITETE TË PUNËS SOCIALE

Përfshin

Ky seksion përfshin ofrimin e një game të gjerë aktiviteteve shëndetësore dhe të punës sociale. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga ofruesit e shërbimeve private ose publike.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

86

Përshkrim

Aktivitete të shëndetit të njeriut

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitete të kujdesit shëndetësor afatshkurtër ose afatgjatë spitalor, të përgjithshëm ose të specializuar, kirurgjikal, të ofruara nga spitalet, qendra të parandalimit të sëmundjeve, shërbimi infermieror në shtëpi, institucionet spitalore të shëndetit mendor, qendrat e rehabilitimit dhe institucionet e tjera të shëndetit të njeriut, të cilat kanë lehtësira akomodimi dhe të cilat angazhohen në sigurimin e trajtimit diagnostik dhe mjekësor për pacientët kryesisht, me një gamë të gjerë të kushteve mjekësore.

Kjo ndarje përfshin gjithashtu konsultime mjekësore dhe trajtim në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe të specializuar, nga mjekë të përgjithshëm, mjekë specialist dhe kirurgë. Përfshihen aktivitete të praktikës dentare të një natyre të përgjithshme ose të specializuar, si dhe aktivitete ortodontike.

Për më tepër, kjo ndarje përfshin aktivitete mjekësore, kurative, rehabilituese ose parandaluese nga praktikuesit paramedik dhe profesionistë të shëndetit, përveç spitaleve ose mjekëve praktikantë.

Përfshin gjithashtu

Kjo ndarje përfshin gjithashtu aktivitete të tjera të shëndetit të njeriut, p.sh. aktivitetet e laboratorëve mjekësorë, bankave të gjakut, bankave të spermës, bankave të organeve të transplantimit etj. duke përfshirë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe transportin.

Nuk përfshin

Kjo ndarje nuk përfshin:

- aktivitetet veterinare, shih 75.00

NVE Rev 2.1 kod

86.1

Përshkrim

Aktivitete spitalore

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Përshkrim

Aktivitete spitalore

Përfshin

Ky klasë përfshin aktivitetet për shëndetin e njeriut, të kryera nga spitalet, të njohura ligjërisht për trajtimin e pacientëve.

Kjo klasë përfshin:

- ofrimin afatshkurtër ose afatgjatë të shërbimeve mjekësore, diagnostikuese dhe trajtimin, duke përfshirë shërbimet e mjekut, infermierisë dhe shërbime të tjera shëndetësore për pacientët e shtruar dhe shërbimet e specializuara të akomodimit të kërkuara nga pacientët e shtruar, nga spitalet e përgjithshme dhe spitalet e specializuara (p.sh. spitalet komunitare dhe rajonale, spitalet e organizatave jofitimprurëse, spitalet universitare, (spitalet ushtarake dhe ato të burgjeve)

Aktivitetet u drejtohen kryesisht pacientëve të shtruar, kryhen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mjekëve dhe përfshijnë:

- aktivitetet e personelit mjekësor dhe paramjekësor
- aktivitetet e laboratorëve dhe strukturave teknike, duke përfshirë aktivitetet radiologjike dhe anesteziologjike
- aktivitetet e dhomës së urgjencës
- ofrimin e shërbimeve të sallës së operacionit, shërbimeve të farmacisë, ushqimit dhe shërbimeve të tjera spitalore
- aktivitetet e qendrave të planifikimit familjar që ofrojnë trajtim mjekësor, p.sh. sterilizimi, ndërprerja e shtatzënisë, me akomodim

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e spitaleve të shëndetit mendor ose psikiatrikë, që ofrojnë trajtim diagnostikues dhe mjekësor

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- testimin dhe inspektimin laboratorik të të gjitha llojeve të materialeve dhe produkteve, përveç testeve laboratorike mjekësore, shih 71.20
- aktivitetet veterinare, shih 75.00
- aktivitetet shëndetësore për personelin ushtarak në terren, shih 84.22
- konsultat private mjekësore për pacientët e shtruar, shih 86.2
- aktivitetet e praktikës dentare të një natyre të përgjithshme ose të specializuar, p.sh. stomatologji, stomatologji endodontike dhe pediatrike; patologji orale, aktivitete ortodontike, shih 86.23
- shërbimet e imazherisë diagnostikuese dhe aktivitetet laboratorike mjekësore, jo pjesë e aktiviteteve spitalore, shih 86.91
- transportin e pacientit me ambulancë, shih 86.92

NVE Rev 2.1 kod	86.2
Përshkrim	Aktivitete të mjekëve dhe dentistëve
Përfshin	Ky grup përfshin konsultat dhe trajtimin mjekësor, të kryer nga mjekë të përgjithshëm dhe mjekë specialistë, p.sh. mjekë, dentistë, të njohur ligjërisht për të trajtuar pacientët. Këto aktivitete mund të praktikohen privatisht, në grup dhe në klinika ambulatorore spitalore, dhe në klinika p.sh. ato të lidhura me ndërmarrjet, shkollat, shtëpitë e të moshuarve, sindikatat dhe organizatat vëllazërore, si dhe në shtëpitë e pacientëve.
Përfshin gjithashtu	Ky grup përfshin gjithashtu: - konsultat private mjekësore për pacientët e shtruar

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	86.21
Përshkrim	Aktivitete të praktikës së përgjithshme mjekësore
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - konsulta dhe trajtim mjekësor në fushën e mjekësisë së përgjithshme të kryera nga mjekë të përgjithshëm
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet ambulatorore spitalore, shih 86.10 - aktivitetet e mjekëve specialistë, shih 86.22 - aktivitetet e infermierisë dhe mamisë, shih 86.94 - aktivitetet e fizioterapisë, shih 86.95 - aktivitetet e mjekësisë tradicionale, plotësuese dhe alternative, shih 86.96

NVE Rev 2.1 kod	86.22
Përshkrim	Aktivitete të mjekëve të specializuar
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - konsultimin dhe trajtimin mjekësor në fushën e mjekësisë së specializuar nga mjekët specialistë dhe kirurgët
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - qendrat e planifikimit familjar që ofrojnë trajtim mjekësor, p.sh., sterilizim, ndërprerje e shtatzënisë, pa akomodim - aktivitete të kirurgjisë kozmetike të kryera nga specialistë të mjekësisë - trajtimin në klinika ambulatorie ose ditore, p.sh., dializë, kimioterapi, terapi me insulinë, trajtim respirator, trajtim me rrezatim - analizën mjekësore dhe interpretimin e imazheve mjekësore diagnostikuese (rreze x, elektrokardiograma, endoskopi, etj.) - aktivitetet e zhvilluara nga psikiatrit - aktivitetet e qendrave të vaksinimit (imunizim, inokulim) - aktivitetet e qendrave të trombozës
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ambulatorë spitalore, shih 86.10
- aktivitetet e infermierisë dhe mamisë, shih 86.94
- aktivitetet e fizioterapistëve, shih 86.95
- aktivitetet e trajtimit të bukurisë që nuk kryhen nga mjekë specialistë, p.sh. nga kozmetologët, shih 96.22

NVE Rev 2.1 kod

86.23

Përshkrim

Aktivitete të kujdesit të praktikës dentare

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e praktikës dentare të një natyre të përgjithshme ose të specializuar, p.sh. stomatologji, stomatologji endodontike dhe pediatrike; patologji orale
- aktivitetet ortodontike

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet dentare në sallat e operimit

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dhëmbëve artificialë, protezave dhe pajisjeve protetike nga laboratorët dentarë, shih 32.50
- aktivitetet spitalore spitalore, shih 86.10
- aktivitetet e personelit paramjekësor dentar, p.sh. higjienistët dentarë, terapistët dentarë, shih 86.99

NVE Rev 2.1 kod

86.9

Përshkrim

Aktivitete të tjera të shëndetit të njeriut

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitete mjekësore, kurative, rehabilituese ose parandaluese (pa ofrimin e shërbimeve të akomodimit) nga ndihmës mjekë dhe profesionistë shëndetësorë, që nuk kryhen nga spitalet ose mjekë.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	86.91
Përshkrim	Shërbimet e imazherisë diagnostifikuese dhe aktivitetet laboratorike mjekësore
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e laboratorëve mjekësorë që ofrojnë shërbime analitike ose diagnostikuese (pa analizën mjekësore ose vetinterpretimin), duke përfshirë analizën e lëngjeve trupore ose testimin gjenetik, drejtpërdrejt te pacientët ambulatorë me ose pa referim nga praktikuesit e kujdesit shëndetësor, p.sh.: - laboratorë me rreze X dhe qendra të tjera imazherike diagnostikuese - laboratorët e analizave të gjakut - sekuenca e ADN-së për të përjashtuar ose kuruar një sëmundje specifike
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e kontrollit të dopingut në laborator
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - testimin laboratorik jo-mjekësor, aktivitetet e testimit në fushën e higjienës së ushqimit, aktivitetet e laboratorëve të mjekësisë ligjore, shih 71.20 - analizat mjekësore dhe interpretimin e imazheve mjekësore diagnostikuese (rrezet x, elektrokardiogramet, endoskopitë, etj.), shih 86.22 - aktivitetet e qendrave të të dhënave të gjenomit ose bankave të gjakut dhe organeve, shih 86.99

NVE Rev 2.1 kod	86.92
Përshkrim	Transporti i pacientit me ambulancë
Përfshin	Kjo klasë përfshin transportin e pacientëve me ambulancë me çdo lloj transporti, përfshirë edhe aeroplanët. Ambulancat transportojnë ndihmës mjekë/mjekë dhe zakonisht janë të pajisura me pajisje shpëtimi.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - transportin e specializuar të pacientëve, të shoqëruar nga ndihmës mjek - kujdesin parësor të dhënë nga një ndihmës mjek ose një mjek gjatë transportit me ambulancë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - transportin e pacientëve, me automjete pa ndihmës mjek dhe pajisje për shpëtimin e jetës, shih ndarjet 49, 50 - transportin e pacientëve, në aeroplanë pa ndihmës mjek dhe pajisje për shpëtimin e jetës, shih ndarjen 51 - transportin e gjakut dhe të organeve/lëngjeve të trupit, shih 86.99

NVE Rev 2.1 kod	86.93
Përshkrim	Aktivitete të psikologëve, psikoterapistëve, përjashtuar mjekët
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e konsultimit dhe trajtimit të psikologëve, p.sh. psikologëve klinikë, psikologëve shëndetësorë, psikoterapistëve, me përjashtim të mjekëve.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitete të terapisë muzikore të kryera nga psikoterapistët/psikologët.
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e psikiatërve, shih 86.22
NVE Rev 2.1 kod	86.94
Përshkrim	Aktivitete të infermierisë dhe mamisë
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e infermierisë dhe mamisë që nuk kryhen nga mjekët, p.sh. - aktivitetet e infermierëve të pavarur, të cilët punojnë në dhomat e tyre të konsultave ose në shtëpitë e pacientëve - aktivitetet e objekteve të maternitetit, pa mbikëqyrjen e përhershme të mjekëve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: -aktivitetet kujdesit infermieror paliativ për pacientët ambulatorë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - repartet e maternitetit në spitale, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të mjekëve, shih 86.10 - aktivitetet infermirore të kujdesit rezidencial, shih 87.10 - shërbimet e kujdesit në shtëpi, shih 88.10
NVE Rev 2.1 kod	86.95
Përshkrim	Aktivitete të fizioterapisë
Përfshin	Kjo klasë përfshin terapitë e ofruara nga profesionistë të pavarur për të përmirësuar lëvizshmërinë, rikthyer funksionin ose reduktuar dhimbjen. Terapitë e ofruara përfshijnë fizioterapinë, etj.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e terapistëve të masazheve mjekësorë - aktivitetet e ergoterapistëve - aktivitetet e terapistëve profesionistë
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e osteopatëve, shih 86.96 - aktivitetet e kiropraktorëve, shih 86.96

- teknikat e trajtimit të trupit, p.sh. shiatsu, masazh tajlandez, watsu, tuina qigong, shih 86.99
- sallonet e masazhit për masazh jo- mjekësor, shih 96.23

NVE Rev 2.1 kod

86.96

Përshkrim

Aktivitete të mjekësisë tradicionale, plotësuese dhe alternative

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parandalues, kurues ose rehabilitues nga profesionistë shëndetësorë. Përfitimet shëndetësore të këtyre shërbimeve nuk bazohen në të dhëna shkencore për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe deri më tani nuk janë vlerësuar plotësisht në mënyra që mund të pranohen botërisht si të bazuara në prova.

Kjo klasë përfshin:

- ofrimin e shërbimeve të mjekësisë tradicionale që përfshijnë një sërë praktikash të vjetra dhe ende në zhvillim, të zhvilluara brenda shoqërive të ndryshme para ose gjatë zhvillimit të mjekësisë moderne, p.sh. terapitë tradicionale kineze, p.sh. akupunkturë, ilaçe bimore kineze, unani, ilaçe tradicionale afrikane
- ofrimin e shërbimeve terapeutike plotësuese, p.sh. terapia e Aleksandrit, aromaterapia, terapia Bach dhe terapi të tjera me lule, terapi trupore, Ayurvedic, mjekësi bimore, naturopati, terapi ushqyese
- ofrimin e shërbimeve alternative terapeutike, p.sh. homeopatia, kiropraktika, osteopatia, terapia me kristal, iridologjia, kinesiologjia, radionika

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e shëruesve
- hipnoterapinë
- aktivitetet e refleksoterapisë
- terapistë përmirësues Cesar dhe Mensendieck
- naprapatinë

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- teknikat e trajtimit të trupit, p.sh. shiatsu, masazh tajlandez, watsu, tuina qigong, shih 86.99

NVE Rev 2.1 kod

86.97

Përshkrim

Aktivitete shërbimi ndërmjetësimi për shërbime mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera të shëndetit të njeriut

Përfshin

Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e shërbimeve mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera të shëndetit të njeriut, duke bashkuar klientët dhe ofruesit e shërbimeve për një tarifë ose komision, pa ndërmjetësuesin që ofron shërbimet mjekësore, dentare dhe shërbimet e tjera të shëndetit të njeriut që ndërmjetësohen. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jo digjitale (ballë për ballë, duke përfshirë derë më derë, telefon, postë etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret ose nga klienti ose nga ofruesi i shërbimeve mjekësore, dentare dhe të tjera të shëndetit të njeriut. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh. të ardhurat nga shitja e hapësirave reklamuese.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

	- rezervimet e takimeve për shërbime mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera të shëndetit të njeriut
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e kujdesit rezidencial, shih 87.91
NVE Rev 2.1 kod	86.99
Përshkrim	Të tjera aktivitete të shëndetit të njeriut p.k.t
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet për shëndetin njerëzor p.k.t.: • aktivitetet e personelit paramjekësor në fushën e optometrisë, hidroterapisë, terapisë së të folurit, podiatrisë/kiropodisë etj.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e personelit paramjekësor dentar, p.sh. terapeutët dentarë, infermierë dentarë të shkollave, higjienistët e dhëmbëve, të cilët mund të punojnë në distancë, por që mbikëqyren periodikisht nga dentistët - aktivitetet e bankave të gjakut, bankave të indeve, bankave të spermës, bankave të organeve të transplantit, biobankave, qendrave të të dhënave të gjenomit etj., duke përfshirë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe dërgimin - funksionimin e regjistrave të donatorëve të palcës së eshtrave - aktivitetet e ortoptistëve - aktivitetet e mjekëve podiatër - aktivitetet e terapistëve të lëkurës - aktivitetet e monitorimit të lidhura me shëndetin (ushqimi i foshnjave, shëndeti i fëmijëve) - aktivitetet e dietologëve - aktivitetet shëndetësore parandaluese dhe zbulimin e sëmundjeve (kanceri, tuberkulozi, sëmundjet veneriane) - transportimi i gjakut dhe i organeve dhe lëngjeve të trupit - shiatsu, masazh tajlandez, watsu, tuina qigong - aktivitetet e terapisë së kafshëve, p.sh. hipoterapia - hidroterapia e zorrës së trashë - terapi kërcimi dhe lëvizjeje - terapi arti
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e dhëmbëve artificialë, protezave dhe pajisjeve protetike nga laboratorët dentarë, shih 32.50 - testimin laboratorik jo-mjekësor, shih 71.20 - aktivitetet e testimit në fushën e higjienës së ushqimit, shih 71.20 - aktivitetet spitalore, shih 86.10 - aktivitetet e praktikës mjekësore dhe dentare, shih 86.2 - shërbimet e imazherisë diagnostikuese dhe aktivitetet laboratorike mjekësore, shih 86.91 - aktivitetet e psikologëve, p.sh. psikologë klinikë, psikologë shëndetësorë, psikoterapistë, përveç mjekëve, shih 86.93 - aktivitetet e infermierisë dhe mamisë, shih 86.94 - aktivitetet e fizioterapisë, shih 86.95- aktivitetet e terapistëve të masazhit mjekësor, shih 86.95 - aktivitete të qendrave të kujdesit infermior, shih 87.10 - aktivitetet e salloneve të masazhit për masazh jo-mjekësor, shih 96.23
NVE Rev 2.1 kod	87

Përshkrim	Aktivitete të qendrave të kujdesit
Përfshin	Kjo ndarje përfshin ofrimin e qendrave të kujdesit të kombinuar me kujdesin infermior, mbikëqyrës ose lloje të tjera të kujdesit siç kërkohet nga banorët. Kujdesi rezidencial është një ndërthurje e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, ku shërbimet shëndetësore janë kryesisht në nivel shërbimi infermior. Aktivitetet e kujdesit rezidencial ofrohen për banorët, të cilët mund të qëndrojnë përkohësisht.
Përfshin gjithashtu	Kjo ndarje përfshin gjithashtu aktivitetet e qendrave të kujdesit (që ofrojnë kujdes të rregullt të qendrave të kujdesit në vende të ndërtuara posaçërisht ose të përshtatura për disa grupe të synuara). Njësitë klasifikohen në varësi të grupeve të synuara.
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - aktivitetet infermiore jo rezidenciale, shih 86.94 - aktivitetet e kujdesit jorezidencial, shih ndarjen 88

NVE Rev 2.1 kod

87.1

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit infermior

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

87.10

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit infermior

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e qendrave të kujdesit, me asistencë mjekësore, trajtime infermiore dhe rehabilituese. Këto institucione kanë një staf qendror të përhershëm me infermiere të regjistruar ose të licencuar që, së bashku me stafin tjetër, ofrojnë kujdesin infermior në kombinim me kujdesin personal. Shërbimet e kujdesit mjekësor ose infermior zakonisht përfshijnë administrimin e mjekimeve, kryerjen e diagnozave mjekësore dhe veshjen e plagëve, dhe kryesisht ofrohen pa mbikëqyrjen e një mjeku që ndodhet në ambiente.

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- shtëpive për të moshuarit me kujdes infermior
- shtëpive të shërimit, përveç objekteve të shëndetit mendor dhe abuzimit me substancat
- shtëpive të pushimit me kujdes infermior
- shtëpive të kujdesit infermior
- bujtinave të shtëpive të të moshuarve
- bujtinave të kujdesit spitalor për kujdesin paliativ

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- kujdesin infermior paliativ për pacientët ambulatorë, shih 86.94
- aktivitetet e shtëpive për të moshuarit pa ose vetëm me kujdes minimal infermior, shih 87.30
- ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe asistencës, p.sh. jetimoret, konviktet e fëmijëve dhe bujtinat, strehimoret e përkohshme për

NVE Rev 2.1 kod

87.2

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit për personat me diagnozë të një sëmundjeje mendore ose abuzim me substanca

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

87.20

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit për personat me diagnozë të një sëmundjeje mendore ose abuzim me substanca

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e qendrave të kujdesit (por jo kujdesin spitalor të licencuar), mbikëqyrjen dhe këshillimin mbrojtës për personat që jetojnë ose kanë një diagnozë të një sëmundjeje mendore, paaftësi intelektuale ose abuzim me substanca, pavarësisht nga mosha.

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- objekteve për trajtimin e abuzimit me substancat
- shtëpive të shërimit të shëndetit mendor
- banesave grupe për personat e shqetësuar emocionalisht
- banesave që mbështesin rimëkëmbjen për njerëzit e trajtuar me probleme të shëndetit mendor
- mjediseve të asistuar të jetesës për personat me diagnozë të aftësisë së kufizuar intelektuale

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- spitalet e shëndetit mendor, shih 86.10
- ofrimin e qendrave të kujdesit të infermierisë dhe shërbimeve rehabilituese për individë të ndryshëm nga ata që jetojnë ose kanë një diagnozë të një sëmundjeje mendore, shih 87.10, 87.30
- aktivitetet e punës sociale me akomodim, p.sh. strehimoret e përkohshme për të pastrehët, shih 87.99
- aktivitetet e kujdesit për personat që jetojnë ose kanë një diagnozë të një sëmundjeje mendore, p.sh. qendrat e kujdesit për shëndetin mendor, shih seksionin 88

NVE Rev 2.1 kod

87.3

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit ose personave me paaftësi fizike

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

87.30

Përshkrim

Aktivitete të qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit ose personave me paftësi fizike

Përfshin

Kjo klasë përfshin ofrimin e shërbimeve të kujdesit rezidencial dhe personal për personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara fizike që nuk janë në gjendje të kujdesen plotësisht për veten dhe/ose që nuk dëshirojnë të jetojnë të pavarur. Kujdesi zakonisht përfshin dhomën, ushqimin, mbikëqyrjen dhe ndihmën në jetën e përditshme, p.sh. aktivitetet e mirëmbajtjes së shtëpisë. Kujdesi infermior ndonjëherë ofrohet për banorët në ambiente të veçanta në vend.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e:

- lehtësirave për jetesë të asistuar
- komuniteteve të pensionit të kujdesit të vazhdueshëm
- shtëpitë për të moshuarit me kujdes minimal infermior
- shtëpitë e pushimit pa kujdesin e të moshuarve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e qendrave të kujdesit infermior për personat e moshuar, shih 87.10
- ofrimin e shërbimeve të qendrave të infermierisë dhe rehabilitimit për personat e moshuar ose personat që jetojnë ose kanë një diagnozë të një sëmundjeje mendore, shih 87.20
- aktivitetet e punës sociale me akomodim, shih 87.99

NVE Rev 2.1 kod

87.9

Përshkrim

Aktivitete të tjera të kujdesit rezidencial

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	87.91
Përshkrim	Aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për aktivitetet e qendrave të kujdesit mjekësor rezidencial
Përfshin	Kjo klasë përfshin ndërmjetësimin e aktiviteteve të kujdesit rezidencial, duke bërë bashkë klientët dhe ofruesit e shërbimit kundrejt një tarife ose komisioni, pa ndërmjetësin që ofron shërbimet e ndërmjetësuar të kujdesit rezidencial. Këto aktivitete ndërmjetësimi mund të kryhen në platforma digjitale ose nëpërmjet kanaleve jodigjitale (përballë, duke përfshirë derë më derë, me telefon, postë, etj.). Tarifa ose komisioni mund të merret prej klientit ose ofruesit të shërbimit të kujdesit rezidencial. Të ardhurat për aktivitetet e ndërmjetësimit mund të përfshijnë burime të tjera të ardhurash, p.sh., të ardhurat nga shitja e hapësirës së reklamimit.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit për shërbime mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera të shëndetit të njeriut, shih 86.97

NVE Rev 2.1 kod	87.99
Përshkrim	Aktivitete të qendrave të tjera kujdesit p.k.t.
Përfshin	Kjo klasë përfshin ofrimin e shërbimeve të qendrave të kujdesit dhe asistencës për personat, me përjashtim të personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen plotësisht për veten e tyre ose që nuk dëshirojnë të jetojnë vetëm. Kjo klasë përfshin: - aktivitetet rezidenciale dhe të asistencës sociale që ofrohen çdo ditë për kategori të veçanta personash, por ku trajtimi mjekësor ose edukimi nuk janë elementë thelbësorë: • jetimore • konviktet dhe bujtinat e fëmijëve • ofrimi i qendrave të shërbimeve për personat e pastrehë, refugjatët, emigrantët etj. • aktivitete të tjera mbështetëse të familjes Aktivitetet zakonisht kryhen nga zyra qeveritare ose organizata private.
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu, aktivitete të: - shtëpive për rehabilitimin e personave me probleme sociale ose personale - shtëpive për rehabilitimin/rimëkëmbjen e kundërvajtësit dhe shkelësit e ligjit - shtëpive të riedukimit të të miturve në konflikt me ligjin
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - financimin dhe administrimin e programeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, shih 84.30 - aktivitetet e objekteve të qendrave të kujdesit infermieror,

shih 87.10

- ofrimin e shërbimeve të qendrave të infermierisë dhe rehabilitimit për personat që jetojnë ose kanë një diagnozë të një sëmundjeje mendore, shih 87.20
- aktivitetet e kujdesit të qendrave për personat me diagnozë të aftësisë së kufizuar intelektuale, shih 87.20
- aktivitetet e kujdesit të qendrave për personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara fizike, shih 87.30
- aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve, shih 88.91
- aktivitetet e shërbimit të birësimit, shih 88.99

NVE Rev 2.1 kod

88

Përshkrim

Aktivitete të kujdesit social pa akomodim

Përfshin

Kjo ndarje përfshin ofrimin e një sërë shërbimesh të asistencës sociale drejtpërdrejt për klientët. Aktivitetet në këtë ndarje nuk përfshijnë shërbimet e akomodimit, përveçse në baza të përkohshme.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

88.1

Përshkrim

Aktivitete të kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe të personave me aftësi të kufizuara

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

88.10

Përshkrim

Aktivitete të kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe të personave me aftësi të kufizuara

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet sociale, këshillimore, të mirëqenies, referimit dhe të ngjashme, që synojnë personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara në shtëpitë e tyre ose tjetërkund dhe që kryhen nga zyrat qeveritare ose nga organizatat private, organizatat kombëtare ose vendase me ndihmë vetjake dhe nga specialistët, që ofrojnë shërbime këshillimi:
 - vizita te personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara
 - aktivitetet e kujdesit ditor për personat e moshuar ose për të rriturit me aftësi të kufizuara
 - shërbimet e asistencës në shtëpi për personat e moshuar ose personat me aftësi të kufizuara
 - aktivitetet profesionale të rehabilitimit dhe aftësimit për personat me aftësi të kufizuara fizike, ku komponenti i edukimit është i kufizuar

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e kujdestarëve (ndihma në shtëpi)
- shërbimet e kujdesit në shtëpi
- shërbimet e asistencës në shtëpi, të tilla si kryerja e detyrave shtëpiake, të ofruara për personat që kanë një diagnozë të dëmtimit të përkohshëm mjekësor

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, shih 84.30
- aktivitete të ngjashme me ato të përshkruara në këtë klasë, por duke përfshirë akomodimin, shih 87.30
- aktivitetet e kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuar, shih 88.91

NVE Rev 2.1 kod	88.9
Përshkrim	Aktivitete të tjera të punës sociale pa akomodim
Përfshin	
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	

NVE Rev 2.1 kod	88.91
Përshkrim	Aktivitete të kujdesit ditor për fëmijët
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e kujdesit ditor për fëmijët të ofruara në shtëpi private ose qendra të kujdesit ditor - aktivitetet e kujdesit pas shkollës

Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin gjithashtu: - aktivitetet e kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara
---------------------	--

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	88.99
Përshkrim	Aktivitete të tjera të kujdesit social pa akomodim p.k.t.
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - shërbimet sociale, këshillimore, të mirëqenies, refugjatëve, referimit dhe të ngjashme, që u ofrohen individëve dhe familjeve në shtëpitë e tyre ose tjetërkund dhe që kryhen nga zyrat qeveritare ose nga organizatat private, organizatat për ndihmë në rast fatkeqësish dhe organizatat kombëtare ose vendore me ndihmë vetjake dhe nga specialistët, që ofrojnë shërbime këshillimi: • aktivitetet për mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve • aktivitetet e birësimit, veprimtaritë për parandalimin e mizorisë ndaj fëmijëve dhe të tjerëve • shërbimet e këshillimit për buxhetin familjar, këshillimit të martesës dhe familjes, këshillimit për kredinë dhe borxhin • aktivitetet në komunitet dhe lagje • aktivitetet për viktimat e fatkeqësive, refugjatët, imigrantët, etj. • aktivitetet profesionale të rehabilitimit dhe aftësimit për personat e papunë, ku komponenti i edukimit është i kufizuar • përcaktimi i pranueshmërisë në lidhje me ndihmën sociale, shtesat për qiranë ose kuponët ushqimorë • strukturat ditore për të pastrehët dhe grupet e tjera sociale të cënueshme • aktivitetet e mbledhjes së fondeve ose mbështetëse të tjera që lidhen me punën sociale

- aktivitetet e ndërmjetësimit kulturor ose ndërkulturor të synuara për parandalimin e shqetësimit të të rriturve që përballen me vështirësi për t'u integruar në shoqëri dhe në tregun e punës, eliminimin e marginalizimit social të fëmijëve dhe adoleshentëve, rehabilitimin e të rriturve dhe të miturve në burg, në shërbim prove dhe jashtë burgut, dhe integrimin e të rriturve në jetën aktive
- aktivitetet për zhvendosjen e refugjatëve

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e ndërmjetësimit ligjor, shih 69.10
- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, shih 84.30
- aktivitete të ngjashme me ato të përshkruara në këtë klasë, por duke përfshirë akomodimin, shih 87.99

NVE Rev 2.1 kod

S

Përshkrim

ARTE, SPORTE DHE ARGËTIM

Përfshin

Ky seksion përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve për të përmbushur interesat e ndryshme kulturore, sportive dhe argëtuese të klientëve të tyre, duke përfshirë shfaqjet live, argëtimin, funksionimin e vendeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe lojërat e fatit.

Përfshin gjithashtu

Ky seksion përfshin gjithashtu shërbime që lehtësojnë eventet argëtuese dhe shfaqjet live.

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

90

Përshkrim

Aktivitetet i krijimit të arteve dhe shfaqjeve artistike

Përfshin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e arteve krijuese dhe interpretuese dhe funksionimin e objekteve dhe ofrimin e shërbimeve për të përmbushur interesat kulturore dhe argëtuese. Kjo përfshin prodhimin dhe promovimin, si dhe pjesëmarrjen, në performanca të drejtpërdrejta, aktivitete ose ekspozita të destinuara për shikim publik; sigurimi i aftësive artistike, krijuese ose teknike për prodhimin e produkteve artistike dhe shfaqjeve dhe ngjarjeve live.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së filmave dhe videove, shih 59.11, 59.12, 59.13
- aktivitetet e shfaqjes së filmave, shih 59.14
- transmetimin radio, televiziv dhe të të dhënave, shih 60.10, 60.20
- aktivitetet fotografike, shih 74.20
- edukimin kulturor (mësimdhënien joakademike për luajtjen e veglave muzikore, pikturën, aktrimin, kërcimin, etj.), shih 85.52
- operimin e muzeve të të gjitha llojeve, siteve dhe monumenteve arkeologjike dhe historike, bibliotekave, arkivave, kopshteve botanike dhe zoologjike; ruajtjen e siteve historike; aktivitetet e ruajtjes së natyrës, shih ndarjen 91
- konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, shih 91.30
- aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve, shih ndarjen 92.00
- aktivitetet e sporteve dhe zbavitjes dhe aktivitetet argëtuese, shih ndarjen 93

NVE Rev 2.1 kod	90.1
Përshkrim	Aktivitetet e krijimit të arteve
Përfshin	Ky grup përfshin aktivitete në krijimtarinë letrare, kompozimin muzikor dhe krijimin e arteve pamore dhe aktivitete të shoqërore.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod	90.11
Përshkrim	Aktivitetet e krijimit letrar dhe kompozicionit muzikor
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e shkrimtarëve individualë, për të gjitha subjektet, përfshirë edhe shkrimet imagjinare (trilluara), etj. - kompozimin muzikor - shkrimin e teksteve dhe kompozimeve në emër të dikujt tjetër - aktivitetet e shkrimit të skenarit - aktivitetet e gazetarëve, përmbajtja e të cilëve publikohet nga një palë e tretë - aktivitetet e bloggerëve, përmbajtja e të cilëve publikohet nga një palë e tretë

Përfshin gjithashtu

- shkrimin teknik

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- (ri)prodhimin, shpërndarjen e librave dhe muzikës, shih seksionin J
- përkthyesit që punojnë për redaktimin e librave, shih 74.3
- aktivitetet e muzikantëve dhe aktorëve të pavarur që shfaqen në përmbajtje video dhe audiovizive të të gjitha llojeve, shih 90.20

NVE Rev 2.1 kod	90.12
Përshkrim	Aktivitete të krijimit të arteve pamore
Përfshin	Kjo klasë përfshin aktivitetet e krijimit dhe prodhimit të veprave të artit pamor. Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e artistëve të pavarur, p.sh. skulptorë, piktorë, karikaturistë, kaligrafë, gdhendës, skalitës - format digjitale të krijimit të arteve pamore - krijimi i artit me instalime të lehta

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e statujave, përveç punimeve origjinale artistike, shih 23.70
- aktivitetet e prodhimit të filmave dhe videove, shih 59.11, 59.12
- operimin e kinemave, shih 59.14

- aktivitetet fotografike, shih 74.20
- aktivitetet e agjentëve teatralë personalë ose artistikë ose agjencive, shih 74.99
- aktivitetet e rekrutimit të artistëve, shih 78.10
- aktivitetet e rezervimit dhe shitjes së biletave për teatër, sporte dhe forma të tjera argëtimi, shih 82.40
- aktivitetet koreografike, shih 90.13
- krijimin dhe prezantimin e shfaqjeve të dritave dhe tingujve, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod

90.13

Përshkrim

Aktivitete të tjera të krijimit të arteve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet koreografike

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- rehabilitimin, rinovimin, rindërtimin dhe përforsimin e vendeve dhe godinave historike dhe arkeologjike, shih 43.99
- operimin e muzeve të të gjitha llojeve, shih 91.21
- riparimin e mobilieve që nuk konsiderohen trashëgimi kulturore dhe që nuk janë historike, shih 95.24

NVE Rev 2.1 kod

90.2

Përshkrim

Aktivitete të shfaqjeve artistike

Përfshin

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

90.20

Përshkrim

Aktivitete të shfaqjeve artistike

Përfshin

Kjo klasë përfshin aktivitete në artin skenik dhe aktivitete të ngjashme.

Përfshin:

- prodhime të drejtpërdrejta në skenë (shfaqje teatrale, koncerte, opera, valle dhe të tjera):
 - aktivitetet e grupeve interpretuese, cirkut ose kompanive, orkestrave ose grupeve
 - aktivitetet e artistëve interpretues, p.sh. aktorë (përfshirë stand-up komedianët), kërcimtarë, muzikantë (përfshirë aktivitetet e muzikantëve të pavarur), dirigjentëve.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin edhe:

- aktivitetet e fotomodeleve
- aktivitetet e muzikantëve dhe aktorëve të pavarur që shfaqen në përmbajtje video dhe audiovizive të të gjitha llojeve
- operimin e strukturave të arteve performuese për ansamblin e vet
- aktivitetet e personave me ndikim që shfaqen në vlogje të publikuara nga palë të treta.

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- publikimin e teksteve dhe fotove dhe përmbajtjeve të tjera pa video nga personat me ndikim ose blogerët, shih 58.19
- prodhimin e përmbajtjes video dhe audiovizive, përfshirë vlogjet, shih 59.11
- aktivitetet e agjentëve teatralë personalë ose artistikë ose agjencive, shih 74.99
- aktivitetet e rekrutimit të artistëve, shih 78.10
- aktivitetet e blogerëve, që nuk i publikojnë vetë përmbajtjet e krijuara prej tyre, shih 90.11

NVE Rev 2.1 kod

90.3

Përshkrim

Aktivitetet mbështetëse për krijimin dhe shfaqjeve artistike

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitetet mbështetëse për krijimin dhe shfaqjeve artistike. Ai përfshin aktivitete që mbështesin prodhimin e shfaqjeve teatrale, opera dhe baleti, muzikale, evente dhe të tjera, aktivitete të producentëve të shfaqjeve artistike, brenda ose jashtë ambienteve.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

NVE Rev 2.1 kod

90.31

Përshkrim

Shfrytëzimi i objekteve dhe vendeve të artit

Përfshin

Kjo klasë përfshin:- funksionimin e objekteve të artit, (p.sh.sallat e koncerteve, teatrit, qendrat kulturore- funksionimin e objekteve të artit, që mbështesin krijimtarinë artistike në artet pamore.

Përfshin gjithashtu

Kjo klasë përfshin edhe:

- operimin e ambienteve muzikore, klubeve të muzikës dhe strukturave të ngjashme për performanca live

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të pikturave dhe skulpturave (aktivitetet e galerive tregtare të artit), shih 47.69
- aktivitetet e bareve, pubeve dhe strukturave të ngjashme, që mund të përfshijnë ofrimin e veprimtarive muzikore dhe të kërcimit në kohë reale, por që kryesisht shërbejnë pije, shih 56.30
- operimin e kinemave, shih 59.14
- aktivitetet e rezervimit dhe shitjes së biletave për teatër, sporte dhe forma të tjera argëtimi, shih 82.40
- operimin e strukturave të arteve për organizim vetjak, shih 90.20
- operimin e muzeve të të gjitha llojeve, shih 91.21
- operimin e pistave të kërcimit dhe sallave të vallëzimit ku shërbimi i pijeve nuk është veprimtaria kryesore, shih 93.29

NVE Rev 2.1 kod	90.39
Përshkrim	Aktivitete të tjera mbështetëse për shfaqje artistike
Përfshin	Kjo klasë përfshin: - aktivitetet mbështetëse për artet skenike për prodhimin e spektakleve të drejtpërdrejta në skenë, p.sh. shfaqje teatrale, koncerte, opera, valle, prodhime të tjera skenike: • aktivitetet e producentëve, skenografëve dhe ndërtuesit, ndërruesit e skenës, inxhinierët e ndriçimit etj. - organizimin i ngjarjeve kulturore dhe argëtuese, p.sh. festivale filmi, muzikalë, festivale të kërcimit. - aktivitetet e regjisorëve të filmit dhe teatrit, dramaturgëve, promovuesve të filmit dhe krijuesve të programeve
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin edhe: - aktivitetet e prodhuesve ose promovuesve të ngjarjeve artistike live, me ose pa ambiente - planifikimin teknik, furnizimin, ngritjen dhe operimin e pajisjeve audiovizive dhe efekteve speciale lidhur me organizimin e ngjarjeve artistike
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - prodhimin e filmave, duke përfshirë shpërndarjen digjitale, për shfaqje të drejtpërdrejta në kinema ose për transmetim televiziv ose në internet, shih 59.1 - transmetimin e performancave dhe ngjarjeve të drejtpërdrejta, shih 60.20 - aktivitetet e agjentëve teatralë personalë ose artistikë ose agjencive, shih 74.99 - aktivitetet e rekrutimit të artistëve, shih 78.10 - organizimin e konferencave, konventave dhe panairove tregtare, shih 82.30 - aktivitetet e prodhuesve ose promovuesve të ngjarjeve sportive, me ose pa ambiente, shih 93.19 - aktivitetet e artistëve interpretues dhe grupeve, shih 90.20 - planifikimin teknik, furnizimin, ngritjen dhe operimin e pajisjeve audiovizive dhe efekteve speciale lidhur me organizimin e ngjarjeve joartistike, shih 93.29
NVE Rev 2.1 kod	91
Përshkrim	Bibliotekat, arkivat, muzeumet dhe të tjera aktivitete kulturore
Përfshin	Kjo ndarje përfshin aktivitetet e bibliotekave dhe arkivave; funksionimin e muzeve të të gjitha llojeve, koleksionet e trashëgimisë të të gjitha llojeve, duke përfshirë dokumentet bibliotekare dhe arkivore, kopshtet botanike dhe zoologjike; funksionimin e objekteve ose objekteve arkeologjike dhe historike dhe aktiviteteve të rezervave natyrore. Këto aktivitete përfshijnë identifikimin, grumbullimin, inventarizimin, konservimin-restaurimin dhe ndërmjetësimin e trashëgimisë kulturore ose natyrore, materiale dhe jomateriale.
Përfshin gjithashtu	Këtu përfshihen edhe ruajtja dhe ekspozimi i objekteve, vendeve dhe mrekullive natyrore me interes historik, kulturor ose arsimor (p.sh., vendet e trashëgimisë botërore).
Nuk përfshin	Kjo ndarje nuk përfshin: - prodhimin e veglave muzikore, shih 32.20 - rehabilitimin, rinovimin, rindërtimin dhe përforcimin e vendeve dhe godinave historike dhe arkeologjike, shih seksionin 43.99 - shitjen me pakicë të pikturave dhe skulpturave (aktivitetet e galerive tregtare të artit), shih 47.69 - shitjen me pakicë të artikujve të përdorur, shih 47.79 - aktivitetet e transportit dhe magazinimit, shih ndarjen 52 - aktivitetet e sigurimeve, shih ndarjen 66

- aktivitetet arkitekturore për të mbështetur konservimin dhe restaurimin e pasurive të trashëgimisë kulturore, shih 71.11
- aktivitetet kërkimore, shkencat e konservimit posaçërisht për trashëgiminë kulturore, shih ndarjen 72
- aktivitetet e ciceronëve-lektorëve, shih 79.90
- aktivitetet sportive dhe argëtuese e zbavitëse, p.sh. operimi i plazheve dhe parqeve të lojërave, shih ndarjen 93
- riparimin e veglave muzikore që nuk konsiderohen trashëgimi kulturore dhe që nuk janë historike, shih 95.29

NVE Rev 2.1 kod

91.1

Përshkrim

Aktivitetet e bibliotekave dhe arkivave

Përfshin

Ky grup përfshin aktivitete që lidhen me menaxhimin, kujdesin, ruajtjen, vlerësimin e bibliotekave dhe arkivave.

Ky grup përfshin:

- aktivitetet e dokumentimit dhe informacionit të bibliotekave dhe arkivave të të gjitha llojeve, duke përfshirë sallat e leximit, dëgjimit dhe shikimit, ofrimin e shërbimeve të bibliotekave dhe arkivave për publikun e gjerë ose për një publik të caktuar, p.sh. studentë, shkencëtarë, anëtarë të stafit- funksionimin e arkivave publike (në nivel qeveritar, rajonal ose vendor) ose i arkivave private (arkivat e artistëve, historianëve, shkrimtarëve, etj.)
- organizimin e një koleksioni biblioteke, qofshin ato të specializuara ose jo për katalogimin e koleksioneve
- dhënien hua dhe ruajtja e librave, hartave, botimeve periodike, filmave, disqeve, kasetave, veprave të artit, arkivave etj.
- aktivitetet e marrjes për të përmbushur kërkesat për informacion etj.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, shih 91.30

NVE Rev 2.1 kod

91.11

Përshkrim

Aktivitete të bibliotekave

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e dokumentimit dhe informacionit të bibliotekave të të gjitha llojeve (përfshirë bibliotekat digjitale), sallat e leximit, dëgjimit dhe shikimit:
 - organizimi i një koleksioni, qoftë i specializuar apo jo
 - katalogimi i koleksioneve
 - dhenia hua dhe ruajtja e librave, hartave, periodikëve, filmave, regjistrimeve, shiritave, punimeve artistike etj
 - aktivitetet e marrjes në mënyrë që të përmbushen kërkesat për informacion etj.

Përfshin gjithashtu

Nuk përfshin

Kjo klasë nuk përfshin:

- konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, shih 91.30

NVE Rev 2.1 kod	91.12
Përshkrim	Aktivitete të arkivave
Përfshin	Aktivitetet e arkivave përfshijnë aktivitetet e kryera nga shërbimet arkivore të të gjitha llojeve, me synim ndërtimin, ruajtjen, klasifikimin, koleksionet e arkivave fizike ose digjitale dhe komunikimin e tyre me publikun e gjerë ose një kategori të caktuar përdoruesish. Kjo klasë përfshin: - aktivitetet e arkivave publike që ofrojnë shërbim për publikun e gjerë ose për një klientelë të veçantë, p.sh. studentë, shkencëtarë, staf, anëtarë si dhe funksionimi i arkivave qeveritare - aktivitetet që lidhen me përvetesimin ose mbledhjen e arkivave - aktivitetet që lidhen me identifikimin, inventarizimin, përshkrimin dhe klasifikimin e arkivave - aktivitete që lidhen me sigurinë dhe mirëmbajtjen e artikujve arkivore (monitorimi i gjendjes sanitare dhe kushteve klimatike, siguria dhe siguri, rehabilitimi) - aktivitete që lidhen me komunikimin e arkivave me publikun në terren ose në distancë - digjitalizimi i dokumenteve arkivore për koleksionet e arkivit digjital
Përfshin gjithashtu	Kjo klasë përfshin edhe: - arkivimin e të gjitha llojeve të dokumenteve (në formë fizike ose elektronike)
Nuk përfshin	Kjo klasë nuk përfshin: - shitjen me pakicë të dorëshkrimeve, shih 47.69 - ruajtjen e skedarëve të të dhënave, shih 63.10 - digjitalizimin e skedarëve (për përpunimin e mëtejshëm të të dhënave), shih 63.10 - digjitalizimin e skedarëve (pa veprimtari tjetër shoqëruese), shih 82.10 - konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, shih 91.30

NVE Rev 2.1 kod	91.2
Përshkrim	Aktivitetet e muzeve, koleksioneve, vendeve historiken dhe monumentale
Përfshin	Ky grup përfshin funksionimin, menaxhimin, kujdesin, ruajtjen, ekspozimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore: të prekshme, të paprekshme dhe digjitale në një shumëllojshmëri të gjerë të llojeve të koleksioneve (si private ashtu edhe publike). Ai përfshin aktivitete që kanë të bëjnë me vendet e trashëgimisë kulturore si rezultat i ndërhyrjes njerëzore në rrethinat e tij, nga peizazhet te kopshtet, nga vendet historike dhe arkeologjike te ndërtesat.
Përfshin gjithashtu	
Nuk përfshin	Ky grup nuk përfshin: - rehabilitimin, rinovimin, rindërtimin dhe përforcimin e vendeve dhe godinave historike dhe arkeologjike, shih seksionin 43.99 - shitjen me pakicë të pikturave dhe skulpturave (aktivitetet e galerive tregtare të artit), shih 47.69 - aktivitetet arkitekturore për të mbështetur konservimin dhe restaurimin e pasurive të trashëgimisë kulturore, shih 71.11 - aktivitetet e lidhura me konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore, shih 91.30

NVE Rev 2.1 kod

91.21

Përshkrim

Aktivitete të muzeve dhe koleksioneve

Përfshin

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin, menaxhimin, kujdesin, ruajtjen, vlerësimin dhe ekspozimin e koleksioneve të muzeve të të gjitha llojeve:
 - muzetë ose muzetë e artit, arti i aplikuar dhe muze artizanesh dhe dizajni (p.sh. për bizhuteri, mobilie, kostume, qeramika, argjendi)
 - muzetë e historisë natyrore, shkencës dhe teknologjisë, muzetë historikë, përfshirë muzetë ushtarakë
 - muze të tjerë të specializuar
- muzetë e hapura, muzeumet ekologjike si dhe muzetë digjitalë dhe Virtualë
